

**NJË ANALIZË E KUADRIT LIGJOR DHE PROCEDURAVE NË
LIDHJE ME KONTROLLIN E NDIHMËS SHTETËRORE NË
BASHKIMIN EVROPIAN**

Anduena GJEVORI

Dorëzuar
Universitetit European të Tiranës
Shkollës Doktorale

Në përmbushje të detyrimeve të programit të Doktoratës në:
Shkenca Juridike, me profil: E Drejtë Ndërkombëtare, për marrjen e gradës
shkencore “Doktor”

Udhëheqës shkencor: PhD Sokol BANA

Numri i fjalëve: 54 097

Vendi, muaji viti i dorëzimit: Tiranë 2016

DEKLARATA E AUTORESISË

Unë Anduena Gjevori vërtetoj se ky material që po paraqes për vlerësim në programin e doktoraturës në Shkenca Juridike për marrjen e gradës shkencore Doktor është tërësisht puna ime dhe unë kam ushtruar kujdes të arsyeshëm për të siguruar që puna të jetë origjinale dhe çdo burim i përdorur në të është rregullisht i referuar.

ABSTRAKT

Rregullat për ndihmën Shtetërore në Bashkimin Evropian janë pjesë e rregullave për konkurrencën. Traktati për Funkcionimin e Bashkimit Evropian ndalon dhënien e ndihmës Shtetërore nga Shtetet Anëtare tek ndërmarrjet sepse ndihma Shtetërore shtrembëron konkurrencën dhe ndikon në tregtinë ndërmjet Shteteve Anëtare të Bashkimit Evropian. Përfshirja e kontrollit të ndihmës Shtetërore në të njëjtin titull me dispozitat mbi konkurrencën është një veçanti e juridiksionit të Bashkimit Evropian. Komisioni Evropian është përgjegjës për të kontrolluar ndihmën Shtetërore. Vetë Traktati për Funkcionimin e Bashkimit Evropian vendos një objektiv për kontrollin e ndihmave Shtetërore që është mbrojtja e konkurrencës.

Tema ka si qëllim të identifikojë problemet që vërehen gjatë zbatimit të rregullave të cilat përbëjnë kuadrin ligjor për ndihmën Shtetërore. Gjithashtu kërkimi ka si qëllim të arrijë në përfundimin nëse rregullat për ndihmën Shtetërore në Bashkimin Evropian zbatohen në mënyrë efektive duke realizuar objektivin e sipërpërmendur mbrojtjen e konkurrencës. Kërkimi ka rëndësi sepse jo vetëm analizon në mënyrë kritike legjislacionin përkatës për ndihmën Shtetërore, soft-law dhe praktikën gjyqësore në Bashkimin Evropian por jep dhe rekomandime për plotësimin e të metave të këtij kuadri ligjor.

Fjalë kyçe: Bashkimi Evropian, Ndihmë Shtetërore, Konkurrenca, Komisioni Evropian.

ABSTRACT

State aid rules in the European Union are part of the rules on competition. Treaty on the Functioning of the European Union prohibits the granting of state aid by Member States to enterprises because State aid distorts competition and affects trade between Member States of the European Union. Incorporation of State aid control in the same title with the provisions on competition is a peculiarity of the jurisdiction of the European Union. The European Commission is responsible for State aid control. The Treaty on the Functioning of the European Union itself sets on objective which is the protection of competition.

The thesis aims to find out problems observed in the implementation of the rules that constitute the legal framework for State aid. The research also aims to conclude whether State aid rules in the European Union are implemented effectively in order to fulfill the above mentioned objective the protection of competition. The research is important because not only does it critically examine State aid legislation, soft -law and judicial practice in the European Union but it also provides recommendations addressing the shortcomings of this legal framework.

Key words: European Union, State Aid, Competition, European Commission.

PËRMBAJTJA E LËNDËS

KAPITULLI I: HYRJE	1
1.1. Hyrje	1
1.2. Qëllimi dhe rëndësia e studimit	8
1.3. Metodologjia dhe metodat kërkimore.....	14
1.4. Kufizimet e studimit	18
1.5. Përmbledhje dhe struktura e punimit.....	20
 KAPITULLI II: NOCIONI I NDIHMËS SHTETËRORE NË BASHKIMIN EVROPIAN..	 28
2.1. Hyrje	28
2.2. E drejta parësore e Bashkimit Evropian në lidhje me ndihmën Shtetërore	29
2.3. E drejta dytësore e Bashkimit Evropian në lidhje me ndihmën Shtetërore	36
2.4. Përkufizimi i ndihmës	43
2.5. Elementët e nenit 107(1) TFBE	45
2.5.1. Përzgjedhja.....	45
2.5.2. Avantazhi i dhënë nga Shteti nëpërmjet ndihmës	48
2.5.2.1. Parimi i investitorit privat	50
2.5.3. Ndihma e dhënë nga Shteti ose nëpërmjet burimeve Shtetërore	51
2.5.4. Shtrembërimi i konkurrencës dhe efekti në tregti	533
2.6. Neni 107 (2) TFBE – ndihmë Shtetërore e lejueshme.....	55
2.7. Neni 107(3) TFBE – ndihmë Shtetërore që mund të lejohet	58

**KAPITULLI III: ROLI DHE KOMPETENCAT E KOMISIONIT EVROPIAN NË
KONTROLLIN E NDIHMËS SHTETËRORE.....64**

3.1.	Hyrje	64
3.2.	Institucionet e Bashkimit Evropian – ndihma Shtetërore	65
3.3.	Komisioni Evropian: emërimi, përbërja.....	70
3.4.	“Burokracia” e Komisionit Evropian	74
3.5.	Kompetencat e Komisionit Evropian	75
3.6.	Komisionit Evropian - kontrolli i ndihmës Shtetërore	79
3.7.	Kontrolli ex-ante i ndihmës Shtetërore dhe monitorimi ex-post	83
3.8.	Llojet e ndihmës	84
3.8.1.	Ndihmë ekzistuese.....	84
3.8.2.	Ndihmë e re dhe ndihmë e ndryshuar	86
3.8.3.	Ndihmë Shtetërore e paligjshme dhe ndihmë Shtetërore e keqpërdorur	87
3.8.4.	Skemë ndihme Shtetërore dhe ndihmë individuale	88
3.9.	Procedurat në lidhje me ndihmën Shtetërore – katër llojet	89
3.9.1.	Procedura në lidhje me ndihmën e re	89
3.9.2.	Procedura në lidhje me ndihmën e paligjshme	92
3.9.3.	Procedura në lidhje me ndihmën e keqpërdorur	93
3.10.	Palët e interesuara – të drejtat procedurale	93
3.11.	Kthimi i ndihmës Shtetërore	96
3.11.1.	Kufizimet e kthimit të ndihmës	97
3.11.1.1.	Parimi i pritshmërisë legjitime.....	98
3.11.1.2.	Parimi i sigurisë juridike.....	99

KAPITULLI IV: GJYKATA E DREJTËSISË E BASHKIMIT EVROPIAN: ZBATIMI I RREGULLAVE PËR NDIHMËN SHTETËRORE 102

4.1.	Hyrje	102
4.2.	Statusi i Gjykatës së Drejtësisë dhe Gjykatës së Përgjithshme në rendin ligjor të Bashkimit Evropian.....	103
4.2.1	Gjykata e Drejtësisë.....	103
4.2.2.	Gjykata e Përgjithshme.....	107
4.3.	Roli i Gjykatës së Drejtësisë dhe Gjykatës së Përgjithshme në fushën e ndihmës Shtetërore	110
4.3.1.	Veprime kundër Komisionit sipas nenit 263 TFBE	111
4.3.2.	Veprime të Komisionit kundër Shteteve Anëtare	114
4.3.3.	Kërkesat nga gjykatat kombëtare për vendime paraprake.....	116
4.3.4.	Veprime kundër Komisionit sipas nenit 265 TFBE	118
4.3.5.	Veprime të një Shteti Anëtar kundër një Shteti tjetër Anëtar në fushën e së drejtës për ndihmën Shtetërore	120

KAPITULLI V: ROLI I GJYKATAVE KOMBËTARE NË ZBATIMIN E RREGULLAVE PËR NDIHMËN SHTETËRORE 122

5.1.	Hyrje	122
5.2.	Parimi i epërsisë të së drejtës së Bashkimit Evropian.....	123
5.3.	Parimi i efektit të drejtpërdrejt të së drejtës së Bashkimit Evropian	125

5.4. Njoftimi i Komisionit për zbatimin e së drejtës për ndihmën Shtetërore nga gjykatat kombëtare 127

5.5. Roli i gjykatave kombëtare në zbatimin e rregullave të ndihmës Shtetërore 129

5.6. Bashkëpunimi ndërmjet Komisionit dhe gjykatave kombëtare 132

KAPITULLI VI: REFORMA DHE MODERNIZIMI I KONTROLLIT TË NDIHMËS SHTETËRORE NË BASHKIMIN EVROPIAN 135

6.1. Hyrje 136

6.2. Reforma e ndihmës Shtetërore sipas Planit të Veprimit për Ndhmën Shtetërore të vitit 2005..... 138

6.2.1. Reforma e së drejtës materiale në kuadër të Planit të Veprimit për Ndhmën Shtetërore 138

6.2.2. Reforma procedurale në kuadër të Planit të Veprimit për Ndhmën Shtetërore.....
..... 140

6.3. Modernizimi i Ndhmës Shtetërore – një reformë tjetër..... 144

6.3.1. Reforma e së drejtës materiale për ndihmat Shtetërore 145

6.3.1.1. Rregullore “de minimis” 145

6.3.1.2. Rregullore zbatuese 146

6.3.1.3. Rregullore për përjashtimet në grup 147

6.3.1.4. Nocioni i ndihmës Shtetërore: një përkufizim më i mirë 148

6.3.2. Aspekte procedurale të reformës 149

**KAPITULLI VII: INTEGRIMI EVROPIAN DHE KONTROLLI I NDIHMËS
SHTETËRORE: RASTI I SHQIPËRISË.....135**

7.1.	Hyrje	158
7.2.	Detyrimet e Shqipërisë sipas Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit – ndihma Shtetërore	159
7.3.	Ligji për ndihmën Shtetërore	164
7.4.	Përkufizimi i ndihmës Shtetërore	165
7.5.	Komisioni i ndihmës Shtetërore	169
7.6.	Rregullat procedurale në lidhje me kontrollin e ndihmës Shtetërore	172
7.7.	Vendime të Komisionit të ndihmës Shtetërore	176
7.8.	Më pak ndihmë Shtetërore në Shqipëri	172

KAPITULLI VIII: KONKLUSIONE DHE REKOMANDIME

8.1.	Konkluzione	183
8.2.	Rekomandime	190

BIBLIOGRAFIA.....193

LISTA E SHKURTIMEVE

AUE – Akti Unik Evropian

BE – Bashkimi Evropian

DP – Drejtori e Përgjithshme e Komisionit Evropian

GJED – Gjykata Evropiane e Drejtësisë

GJEDNJ – Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut

GJKSH – Gjykata e Shkallës së Parë

KNSH – Komisioni i Ndihmës Shtetërore

KE – Komuniteti Evropian

KEE – Komuniteti Ekonomik Evropian

MSA – Marrëveshje e Stabilizim Asociimit

OBZHE – Organizata për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik

OBT – Organizata Botërore e Tregtisë

OBEE - Organizata për Bashkëpunim Evropian Ekonomik

PIP – Parimi i Investitorit Privat

PE – Parlamenti Evropian

PSA- Proçesi Stabilizim Asociimit

TBE – Traktati i Bashkimit Evropian

TKEE – Traktati për krijimin e Komunitetit Ekonomik Evropian

TKE – Traktati për Komunitetin Evropian

TFBE – Traktati për Funkcionimin e Bashkimit Evropian

TKQÇ - Traktati i Komunitetit të Qymyrit dhe Çelikut

KAPITULLI I

HYRJE

1.1. Hyrje

Rregullat në lidhje me ndihmën Shtetërore kanë qenë pjesë e Traktatit për krijimin e Komunitetit Evropian të Çelikut dhe Qymyrit (KEÇQ) të vitit 1951.¹ Ndërsa, aktualisht ato janë pjesë e Traktatit të Lisbonës, i cili prezanton ndryshimet e fundit të dy traktateve kryesore të Bashkimit Evropian: Traktatit të Bashkimit Evropian² dhe Traktatit për Krijimin e Komunitetit Evropian.³ Traktati i Lisbonës u nënshkrua nga Shtetet Anëtare të Bashkimit Evropian në 13 Dhjetor të vitit 2007 dhe hyri në fuqi në 1 Dhjetor të vitit 2009.

Bashkimi Evropian i ka themelet e tij në Bashkimin Ekonomik Evropian. Pas Luftës së Dytë Botërore, u krijuan tre Komunitete Evropiane. Së pari, u krijua në vitin 1951 në bazë të Traktatit për krijimin e Komunitetit Evropian të Çelikut dhe Qymyrit (Traktati Parisit), Komuniteti Evropian i Qymyrit dhe Çelikut (KEÇQ). Së dyti, u krijua në vitin 1957, Komuniteti Evropian Energjisë Atomike (Euratom). Së treti, u krijua në vitin 1957, Komuniteti Ekonomik Evropian, në bazë të Traktatit për krijimin e Komunitetit Ekonomik Evropian (Traktatit të Romës). Traktati për Krijimin e Komunitetit Evropian të Çelikut dhe Qymyrit u nënshkrua për një periudhë 25 vjeçare dhe ai ka qenë në fuqi deri në 23 Korrik të

¹ Traktati për Krijimin e Komunitetit Evropian të Qymyrit dhe Çelikut u nënshkruar në Paris, më 18 prill 1951 dhe hyri në fuqi në 23 korrik 1952, ndërmjet gjashtë Shteteve nënshkruese: Belgjika, Franca, Hollanda, Italia, Luksemburgu dhe Republika Federale e Gjermanisë.

² Treaty on European Union (Maastricht 1992) (Traktati për Bashkimin Evropian) OJ C191/01.

³ Traktati për Krijimin e Komunitetit Ekonomik Evropian (Rome 1957).

vitit 2002. Ndërsa, Euratom kontrollohet nga Bashkimi Evropian por ligjërisht është një entitet më vete.⁴

Në vitin 1951 Traktati i Parisit⁵ i cili siç u përmend më sipër krijoi Komunitetin Evropian të Çelikut dhe Qymyrit prezantoi për herë të parë rregullat për ndihmën Shtetërore në lidhje me projektin e integritit evropian (Ehlermann, 1994:412). Ky Traktat hodhi hapin e parë të integritit ekonomik ndonëse vetëm në fushën e industrisë së rëndë i cili do t'i hapte rrugën veprimeve të tjera (Canaj & Bana, 2014:19). Veçanërisht, neni 4(c) i këtij Traktati parashikonte që subvencionet dhe ndihmat e dhëna nga Shtetet ishin të papajtueshme me tregun e brendshëm të çelikut dhe qymyrit dhe si të tilla duhet të shfuqizoheshin dhe të ndaloheshin. Rrjedhimisht, KEÇQ parashikonte një ndalim të pakufizuar dhe të pakushtëzuar të ndihmës së dhënë nga Shtetet Anëtare. Për më tepër, Traktati nuk përmbante një përkufizim të nocionit “ndihmë” ose “subvencion”.

Ndërsa, rregullat në lidhje me ndihmën Shtetërore të parashikuara në Traktatin për Krijimin e Komunitetit Ekonomik Evropian (TKEE) nënshkruar në vitin 1957, ndalonin ndihmën Shtetërore që shtrembëronte konkurrencën. Traktati për Krijimin e Komunitetit Ekonomik Evropian krijoi Komunitetin Ekonomik Evropian. Objektivat kryesore të Traktatit ishin krijimi i një tregu të përbashkët, përafrimi i politikave ekonomike të Shteteve Anëtare, rritja e stabilitetit dhe standartit të jetesës. Për më tepër, Traktati kishte si qëllim heqjen e pengesave të tregtisë dhe vendosjen e tarifave të përbashkëta doganore, mbrojtjen e konkurrencës, harmonizimin e politikave ekonomike dhe tregtare (Craig & de Burca,

⁴ Shiko <http://ec.europa.eu/euratom/index.html>

⁵ Traktati për Krijimin e Komunitetit Evropian të Qymyrit dhe Çelikut u nënshkruar në Paris, më 18 prill 1951 dhe hyri në fuqi në 23 korrik 1952, ndërmjet gjashtë Shteteve nënshkruese: Belgjika, Franca, Holanda, Italia, Luksemburgu dhe Republika Federale e Gjermanisë.

2008:6). Ndhimja e dhënë nga Shtetet përfshihej në të njëjtin kapitull me rregullat për konkurrencën. Në ndryshim nga Traktati i Parisit, ndalimi i ndihmës Shtetërore ashtu siç parashikohej nga TKEE nuk ishte absolut apo i pakufizuar. Kështu neni 92 (1) TKEE parashikonte që çdo ndihmë e dhënë nga Shtetet Anëtare e cila rrezikonte të shtrembëronte konkurrencën duke ndikuar në tregtinë ndërmjet Shteteve Anëtare ishte e papajtueshme me tregun e brendshëm.⁶ Ndërsa paragrafi i dytë dhe i tretë i nenit 92 TKEE parashikonte ndihmën Shtetërore që ishte e pajtueshme me tregun e brendshëm dhe ndihmën Shtetërore që mund të konsiderohej e pajtueshme me tregun e brendshëm.⁷ Traktati për krijimin e Komunitetit Ekonomik Evropian ashtu si Traktati për krijimin e Komunitetit Evropian të

⁶ Neni 92 (2) Traktati për Krijimin e Komunitetit Ekonomik Evropian parashikon që: “Me përjashtim të rasteve kur Traktatet parashikojnë ndryshe, ndihma që jep një Shtet Anëtar ose që jepet përmes burimeve shtetërore në çfarëdolloj forme, e cila e shtrembëron ose rrezikon të shtrembërojë konkurrencën duke favorizuar disa ndërmarrje të caktuara ose prodhimin e disa mallrave të caktuara, është e papajtueshme me tregun e brendshëm, për aq kohë sa prek tregtinë midis Shteteve Anëtare.”

⁷ Neni 92 (2) Traktati për Krijimin e Komunitetit Ekonomik Evropian parashikon që:

“Sa më poshtë, janë të pajtueshme me tregun e brendshëm:

(a) ndihma me karakter social, që u jepet konsumatorëve individualë, me kusht që kjo ndihmë të jepet pa diskriminim lidhur me origjinën e produkteve që prek;

(b) ndihma për shlyerjen e dëmit të shkaktuar nga fatkeqësitë natyrore ose ngjarjet e jashtëzakonshme;

(c) ndihma që i jepet ekonomisë në disa zona të caktuara të Republikës Federale të Gjermanisë të prekura nga ndarja e Gjermanisë, për aq kohë sa kjo ndihmë është e nevojshme për të kompensuar pozitën e pafavorshme ekonomike që ka shkaktuar kjo ndarje. Pesë vjet pas hyrjes në fuqi të Traktatit të Lisbonës, Këshilli, me propozim të Komisionit, mund të miratojë një vendim që e shfuqizon këtë gurmë”.

Neni 92 (3) Traktati për Krijimin e Komunitetit Ekonomik Evropian parashikon që:

Sa më poshtë, mund të konsiderohen si të pajtueshme me tregun e brendshëm:

(a) ndihma për nxitjen e zhvillimit ekonomik të zonave ku standardi i jetesës është i ulët në mënyrë jo normale dhe ku ka papunësi të theksuar;

(b) ndihma për nxitjen e realizimit të një projekti të rëndësishëm me interes të përbashkët evropian ose për ndërtimin e një çregullimi të rëndë në ekonominë e një Shteti Anëtar;

(c) ndihma për lehtësimin e zhvillimit të disa aktiviteteve të caktuara ekonomike ose të disa fushave të caktuara ekonomike, ku një ndihmë e tillë nuk i prek aq keq kushtet e tregtimit sa të bien ndesh me interesin e përbashkët. Çdo ndihmon në ndërtimin e anijeve që ekziston më 1 janar 1957 do të , në atë masë që ndihmat e tilla thjesht kompensojnë mungesën e mbrojtjes doganore , të reduktohen në mënyrë progresive me të njëjtat kushte që zbatohen për heqjen e tarifave doganore , subjekt i dispozitave të këtij Traktati në lidhje me politika e përbashkët tregtare për vendet e treta ; dhe

(d) kategori të tjera të tilla ndihme të cilat mund të përcaktohen në një vendim të Këshillit, me një shumicë të cilësuar, me propozim të Komisionit.

Çelikut dhe Qymyrit nuk përmbanin një përkufizim të nocionit të ndihmës Shtetërore (Ehlermann, 1994:413).

Ndërsa, neni 93 TKEE⁸ një dispozitë procedurale i jepte të drejtën Komisionit të shqyrtonte skemat ndihmë Shtetërore dhe të autorizonte Komisionin të propozonte “masat e duhura të nevojshme për zhvillimin progresiv ose funksionimin e tregut të brendshëm”. Neni 93 (2) TKEE i jepte të drejtën Komisionit t’i kërkonte Shteteve Anëtare “të shfuqizonin ose të ndryshonin” ndihmën e cila sipas Komisionit ishte e papajtueshme me tregun e brendshëm. Procedura e parashikuar në nenin 93 (2) TKEE i lejonte Komisionit të vendoste kushte në lidhje me ndihmën e aprovuar, duke përfshirë “kufizime përsa i përket llojit të ndihmës, shumës, intensitetit, përfituesve, qëllimit dhe kohëzgjatjes së ndihmës”. Në vazhdim, neni 93(3) TKEE përmbante detyrimin e Shteteve Anëtare për të informuar

⁸ Neni 93Traktati për Krijimin e Komunitetit Ekonomik Evropian parashikon që:

1. Komisioni, në bashkëpunim me Shtetet Anëtare, i mban në shqyrtim të vazhdueshëm të gjitha sistemet e ndihmës që ekzistojnë në këto Shtete. Ai u propozon këtyre të fundit masat e duhura që janë të nevojshme për zhvillimin progresiv ose funksionimin e tregut të brendshëm.

2. Nëse, pasi u jep njoftim palëve në fjalë për të paraqitur komentet e tyre, Komisioni konstaton se ndihma e dhënë nga një Shtet ose nëpërmjet burimeve shtetërore nuk është e pajtueshme me tregun e brendshëm, duke pasur parasysh nenin 92 ose se një ndihmë e tillë është shpërdoruar, ai vendos që Shteti në fjalë ta shfuqizojë ose ta ndryshojë këtë ndihmë brenda një afati të vendosur nga Komisioni.

Nëse Shteti në fjalë nuk e zbaton këtë vendim brenda afatit të përcaktuar, Komisioni ose Shtetet e tjera të interesuara, duke iu shmangur urdhërimeve të neneve 169 dhe 170, mund ta paraqesin çështjen përpara Gjykatës së Drejtësisë të Bashkimit Evropian.

Me kërkesë të një Shteti Anëtar, Këshilli, me unanimitet, mund të vendosë që ndihma që jep ose ka si qëllim të japë ky Shtet të konsiderohet si e pajtueshme me tregun e brendshëm, duke iu shmangur urdhërimeve të nenit 92 ose të rregulloreve të parashikuara në nenin 94, nëse një vendim i tillë justifikohet me rrethana të jashtëzakonshme. Nëse lidhur me ndihmën në fjalë, Komisioni ka filluar më parë procedurën e parashikuar në nënparagrafin e parë të këtij paragrafi, fakti që Shteti i interesuar i ka paraqitur kërkesë Këshillit sjell për pasojë pezullimin e procedurës gjersa të jetë shprehur Këshilli.

Por, nëse Këshilli nuk shprehet brenda tre muajve pas paraqitjes së kërkesës në fjalë, Komisioni jep vendimin e tij për çështjen.

3. Komisioni informohet në kohë të mjaftueshme, për t’i dhënë mundësi të paraqesë komentet e tij për çdo plan që ka të bëjë me dhënien ose ndryshimin e një ndihme. Nëse gjykon se një plan i tillë nuk pajtohet me tregun e brendshëm, sipas nenit 92, Komisioni fillon pa vonesë procedurën e parashikuar në paragrafin mësipërm. Shteti Anëtar në fjalë nuk i zbaton masat e propozuara gjersa nga kjo procedurë të ketë dalë një vendim përfundimtar.

4. Komisioni mund të miratojë rregullore në lidhje me kategoritë e ndihmës shtetërore për të cilat Këshilli, në zbatim të nenit 94, ka vendosur se mund të përjashtohen nga procedura e parashikuar në paragrafin 3 të këtij neni.

Komisionin Evropian në lidhje me çdo plan për të dhënë ndihmë Shtetërore. Për më tepër, sipas të njëjtit nen Shtetet Anëtare nuk mund të zbatonin masën ndihmë të propozuar pa autorizimin e Komisionit. Traktati garantonte të drejtën e Komisionit Evropian për të shqyrtuar dhe autorizuar çdo skemë ndihmë Shtetërore. Neni 93(3) TKEE parashikonte shprehimisht të drejtën e Komisionit për t'i kërkuar Shteteve Anëtare “shfuqizimin ose ndryshimin” e ndihmës së papajtueshme me tregun e brendshëm. Ndërsa, neni 94 TKEE⁹ i jepte të drejtën Këshillit, me propozim të Komisionit të miratonte rregullore për zbatimin e neneve 92 dhe 93 të sipërpërmendur.

Traktati për krijimin e Komunitetit Ekonomik Evropian është ndryshuar disa herë. Ndryshimi më i rëndësishëm u prezantua nga Traktati i Bashkimit Evropian (TBE), i cili hyri në fuqi në 1 Nëntor të vitit 1993. TBE krijoi një entitet të ri, i cili ishte Bashkimi Evropian që shënoi një fazë të re në procesin e integrimit evropian. Ky Traktat krijoi strukturën me tre shtylla të Bashkimit Evropian, ku Komunitet bënin pjesë në shtyllën e parë. Ndërsa Traktati për krijimin e Komunitetit Ekonomik Evropian u quajt Traktati i Komunitetit Evropian (TKE). Përsa i përket dispozitave në lidhje me ndihmën Shtetërore ato nuk kanë pësuar ndryshime thelbësore që prej Traktatit të krijimit të Komunitetit Evropian.

Aktualisht, dispozitat në lidhje me ndihmën Shtetërore janë pjesë e Traktatit të Lisbonës. Traktati i Lisbonës prezanton ndryshimet e fundit të dy traktateve kryesore të

⁹ Neni 94 Traktati për Krijimin e Komunitetit Ekonomik Evropian parashikon që “Këshilli, duke vepruar me një shumicë të cilësuar me propozim të Komisionit mund të miratojë rregulloret e duhura për zbatimin e neneve 92 dhe 93 dhe, në veçanti, mund të caktojë kushtet e zbatimit të nenit 93(3) dhe kategoritë e ndihmës të përjashtuara nga kjo procedure”.

BE-së: të Traktatit të Bashkimit Evropian¹⁰ dhe të Traktatit për Krijimin e Komunitetit Evropian.¹¹ Traktati i Lisbonës u nënshkrua nga Shtetet Anëtare të Bashkimit Evropian në 13 Dhjetor të vitit 2007 dhe hyri në fuqi në 1 Dhjetor të vitit 2009. Traktati i Lisbonës i atribuon personalitet juridik Bashkimit Evropian, duke i dhënë fund sistemit të personalitetit të dyfishtë ligjor të Bashkimit Evropian dhe të Komunitetit Evropian sipas Traktateve të vjetra. Përsa i përket rregullave të konkurrencës ato përfshihen në Traktatin e ndryshuar të krijimit të Komunitetit Evropian i cili është quajtur Traktati për Funksionimin e Bashkimit Evropian (TFBE). Ndihma Shtetërore është pjesë e rregullave për konkurrencën. Përfshirja e kontrollit të ndihmës Shtetërore së bashku me dispozitat mbi konkurrencën është një veçanti e juridiksionit të Bashkimit Evropian.

Aktualisht, dispozitat bazë për ndihmën Shtetërore në Bashkimin Evropian janë nenet 107, 108 dhe 109 të Traktit për Funksionimin e Bashkimit Evropian. Dispozita bazë materiale është neni 107 i TFBE-së i cili parashikon: *“Me përjashtim të rasteve kur Traktatet parashikojnë ndryshe, ndihma që jep një Shtet Anëtar ose që jepet përmes burimeve shtetërore në çfarëdolloj forme, e cila e shtrembëron ose rrezikon të shtrembërojë konkurrencën duke favorizuar disa ndërmarrje të caktuara ose prodhimin e disa mallrave të caktuara, është e papajtueshme me tregun e brendshëm, për aq kohë sa prek tregtinë midis Shteteve Anëtare.”* Kjo dispozitë nuk përmban një përkufizim të nocionit të ndihmës Shtetërore, por përcakton elementët që duhet të ketë një masë ndihmë në mënyrë që të kategorizohet ndihmë Shtetërore. Rrjedhimisht, është e papajtueshme me tregun e brendshëm, çdo formë ndihme e cila: financohet nga Shteti ose nga burimet shtetërore,

¹⁰ Treaty on European Union (Maastricht 1992) (Traktati për Bashkimin Evropian) OJ C191/01.

¹¹ Traktati për Krijimin e Komunitetit Ekonomik Evropian (Rome 1957).

shtrembëron ose rrezikon të shtrembërojë konkurrencën, favorizon disa ndërmarrje ose prodhimin e disa të mirave, ndikon në tregtinë ndërmjet Shteteve Anëtare.

Traktati për Funkcionimin e Bashkimit Evropian ndalon dhënien e ndihmës Shtetërore nga Shtetet Anëtare tek ndërmarrjet sepse ndihma Shtetërore shtrembëron konkurrencën dhe ndikon në tregtinë ndërmjet Shteteve Anëtare të Bashkimit Evropian. Vetë Traktati për Funkcionimin e Bashkimit Evropian vendos një objektiv për kontrollin e ndihmës Shtetërore që është mbrojtja e konkurrencës së bashku me instrumente të tjerë të politikës së konkurrencës në Bashkimin Evropian. Gjithsesi, ndihma Shtetërore e papajtueshme ndalohet sa kohë që masa ndihmë nuk mund të kategorizohet sipas përjashtimeve të parashikuara nga neni 107(2) dhe 107(3) TFBE.

Ndërsa, neni 108 TFBE, është një dispozitë procedurale e cila parashikon detyrimin e Shteteve Anëtare për të njoftuar Komisionin Evropian në lidhje me masat ndihmë. Për më tepër, paragrafi i fundit i këtij neni parashikon detyrimin e Shteteve Anëtare për të pritur vendimin përfundimtar të Komisionit përpara zbatimit të masës së njoftuar sipas procedurës së sipërpërmendur. Gjithashtu, ky nen përcakton dhe kompetencat e Komisionit në lidhje me kontrollin e ndihmës Shtetërore. Komisioni në mënyrë që të mbajë në shqyrtim të vazhdueshëm të gjitha sistemet e ndihmës që ekzistojnë në Shtetet Anëtare, ka vendosur që Shtetet Anëtare duhet t'i paraqesin atij raporte vjetore. Këto raporte përmbajnë të dhëna në lidhje me skemat aktuale të ndihmës ligjore. Qëllimi i procedurës së parashikuar në nenin 108(1) TFBE është të pajisë Komisionin me mjetet e nevojshme për të kontrolluar ndihmën ekzistuese. Ky nen i jep mundësinë Komisionit të sigurojë shfuqizimin ose ndryshimin e ndihmës në Shtete të ndryshme në periudhën e para-anëtarësimit në Bashkimin Evropian.

Ndërsa, neni 109 i Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Evropian i atribuon Këshillit të drejtën për të miratuar rregullore të cilat do të bëjnë të mundur zbatimin rregullave materiale dhe procedurale të parashikuara në nenet 107 TFBE dhe 108 TFBE.

Kontrolli i ndihmës Shtetërore në Bashkimin Evropian nuk ka qenë efektiv. Në fillim të viteve 80, Komisioni Evropian (në vazhdim “Komisioni”) vetëm mund të shprehte zhgënjimin e tij në lidhje me mungesën e njoftimeve ose njoftimet me vonesë për masat ndihmë nga Shtetet Anëtare (Smith, 1998:67). Kontrolli i ndihmës Shtetërore duhej përforcuar në veçanti në lidhje me ndihmën e paligjshme dhe kthimin e saj dhe gjithashtu dhe në lidhje me monitorimin e vendimeve të Komisionit (Sinnaeve & Slot, 1999:1157). Gjithsesi, pas një periudhe të gjatë ku kontrolli për ndihmën Shtetërore nuk zbatohet Komisioni arriti të miratojë një numër të konsiderueshëm rregullash të rëndësishme dhe rregulloresh (Kleiner, 2011: 20). Në veçanti, vendime individuale të Komisionit dhe soft-law të tilla si udhëzimet në lidhje me pajtueshmërinë e ndihmës Shtetërore me tregun e brendshëm kanë fuqizuar kontrollin e ndihmës Shtetërore (Blauberger, 2011:35).

1.2. Qëllimi dhe rëndësia e studimit

Kërkimi do të analizojë rendin ligjor mbikombëtar dhe kombëtar në lidhje me ndihmën Shtetërore, si dhe rendin ligjor shqiptar. Qëllimi i analizës është që të ofrojë një panoramë të zhvillimeve historike, ligjore dhe institucionale mbi ndihmën Shtetërore dhe të identifikojë mekanizmat që kanë ndikuar në këto zhvillime. Rendi ligjor mbikombëtar përbëhet nga legjislacioni parësor dhe dytësor i Bashkimit Evropian, prej të cilit rrjedhin kompetencat e Komisionit për të marrë vendime dhe për të zbatuar politikat e Bashkimit

Evropian për ndihmën Shtetërore. Gjithashtu, në rendin ligjor mbikombëtar përfshihet dhe juridiksioni i Gjykatës së Drejtësisë së Bashkimit Evropian për të rishikuar vendimet e Komisionit. Ndërsa, përsa i përket rendit ligjor kombëtar tema analizon në mënyrë kritike kompetencat e gjykatave kombëtare të përfshira në kontrollin e ndihmës Shtetërore. Gjithashtu, kërkimi analizon dhe rendin ligjor shqiptar. Në kuadër të procesit të Stabilizim-Asociimit, Shqipëria ka nënshkruar Marrëveshjen e Stabilizim Asociimit me Bashkimin Evropian, e cila kërkon që Shqipëria të garantojë që rregullat për konkurrencën dhe ndihmën Shtetërore të jenë në përputhje me *acquis communautaire*. Bazuar në qëllimet e sipërpërmendura, tema analizon këto pyetje kërkimore:

- Si është përkufizuar ndihma Shtetërore në Bashkimin Evropian dhe cilat janë testet e ndryshme të Gjykatës së Drejtësisë aktualisht të integruara në përkufizimin e ndihmës Shtetërore?
- Cilat janë kufizimet e rendit ligjor të Bashkimit Evropian të cilat ndikojnë në kompetencat e Komisionit për të marrë vendime në lidhje me ndihmën Shtetërore në mbrojtjen e konkurrencës?
- Cilat janë arsyet që kufizojnë zbatimin e së drejtës evropiane për ndihmën Shtetërore nga Gjykata e Drejtësisë?
- A është i nevojshëm një decetralizim i pjesshëm i kontrollit të ndihmës Shtetërore në Bashkimin Evropian?
- A është plotësisht në harmoni kuadri ligjor shqiptar për kontrollin e ndihmës Shtetërore me Marrëveshjen e Stabilizim Asociimit dhe *acquis* për ndihmën Shtetërore?

Bazuar në pyetjet e mësipërme kërkimore tema parashtrohet hipotezat:

Hipoteza 1: aktualisht nuk ka një zbatim efektiv të rregullave mbi organizimin e kontrollit të ndihmës Shtetërore në Bashkimin Evropian. Në kuptimin që ndërhyrja publike në formën e ndihmës Shtetërore e cila supozohet të jetë në përputhje me qëllimet e politikës për ndihmën Shtetërore në Bashkimin Evropian, nuk ka dhënë efektet e pritura. Qëllimi kryesor i kësaj politike është të reduktojë shpenzimet për ndihmën Shtetërore dhe të ndryshojë nga ndihma Shtetërore për sektorë të veçantë në ndihmë Shtetërore horizontale e cila konsiderohet me efekte më pak shtrembëruese për konkurrencën.¹² Bazuar mbi këtë standard vlerësimi të efektivitetit të zbatimit të rregullave për ndihmën Shtetërore në Bashkimin Evropian, punimi argumenton që Bashkimi Evropian nuk po i zbaton efektivisht këto rregulla. Ndihma për sektorë të veçantë (ndihma vertikale) është ndihma që zbatohet në aktivitete ekonomike në një sektor të caktuar të ekonomisë ose industrisë (Jones & Sufrin, 2014:118). Ndërsa, ndihmë horizontale janë llojet e ndihmës të dhëna nga Shtetet Anëtare për çdo sektor ekonomik për arritjen e objektivave specifike të interesit publik. Ndihmat horizontale jepen për të mbështetur mbrojtjen e mjedisit, trajnimin e punonjësve, projekte kërkimore etj.¹³

Hipoteza 2: prezantimi i sistemit të kontrollit të ndihmës Shtetërore në rendin ligjor shqiptar nuk ka qenë efektiv. Komisioni i Ndihmës Shtetërore ka dhënë vendime pozitive duke miratuar të gjitha skemat e ndihmës Shtetërore për të cilat është njoftuar dhe nuk ka

¹² State Aid Action Plan: Less and better targeted State aid: a roadmap for State aid reform 2005-2009, (Plan Veprimi për Ndihmën Shtetërore: Me pak ndihme Shtetërore dhe me mëre e shenjestruar: udhërrëfyes për reformën e ndihmës Shtetërore 2005-2009) COM (2005) 107 final, para. 18.

¹³ Po aty.

ndërhyrë në çështje politikisht të ndjeshme. Mungesa e pavarësisë funksionale të Komisionit të Ndihmës Shtetërore e ka bërë atë një aktor të dobët në bllokimin e skemave të ndryshme të ndihmës Shtetërore në Shqipëri. Për më tepër, në lidhje me nivelet e ndihmës Shtetërore në Shqipëri edhe pas miratimit të ligjit për ndihmën Shtetërore shuma e përgjithshme e ndihmave Shtetërore në krahasim me PBB nuk ka rënë në mënyrë sistematike por mbi të gjitha në periudha të caktuara ajo është rritur.

Në shtjellimin e pyetjeve kërkimore dhe testimin e hipotezave, tema ka si qëllim të identifikojë problemet që vërehen gjatë zbatimit të rregullave për ndihmën Shtetërore nga të gjithë aktorët, si ato të përfshirë në kontrollin mbikombëtar ashtu dhe ata kombëtare si dhe në rendin ligjor shqiptar. Për këtë qëllim kërkimi analizon në mënyrë kritike kompetencat dhe përgjegjësitë e institucioneve kryesore që zbatojnë rregullat për ndihmën Shtetërore në rendin ligjor të Bashkimit Evropian, në rendin ligjor të Shteteve Anëtare, dhe rendin ligjor Shqiptar si vend kandidat. Punimi evidenton karakteristikat pozitive dhe negative të kontrollit të ndihmës Shtetërore duke bërë një analizë ligjore të legjislacionit përkatës për ndihmat Shtetërore, soft-law dhe praktikës gjyqësore si dhe duke dhënë sugjerime për plotësimin e të metave të këtij kuadri ligjor.

Ky projekt është i rëndësishëm për vetë Bashkimin Evropian. Tashmë, ndihma Shtetërore është bërë subjekt kryesor procesit të integritetit në Bashkimin Evropian dhe problem kryesor i politikës ekonomike kombëtare të Shteteve Anëtareve. Për shumë dekada e drejta për ndihmën Shtetërore përbënte një aspekt të integritetit të cilit nuk i është kushtuar vëmendje. Përpjekjet për të reformuar ndihmën Shtetërore u bënë pjesë e procesit të

Lisbonës i cili filloi në vitin 2000.¹⁴ Në vitin 2005 Komisioni prezantoi një reformë të titulluar: Plan Veprimi për Ndhmën Shtetërore: Një Udhërrëfyes për Reformën mbi Ndhmën Shtetërore 2005-2009. Në të njëjtën kohë, Bashkimi Evropian u përball me shumë çështje të reja dhe të paparashikuara. Për më tepër, kriza ekonomike dhe financiare e vendosi ndihmën Shtetërore në qendër të politikës së konkurrencës, duke e bërë pjesë të diskutimeve dhe debateve politike (Szyszczak, 2011:3).

Për më tepër, Komisioni ka prezantuar një sistem të kontrollit të ndihmës Shtetërore në Marrëveshjet e Stabilizim Asociimit (MSA) të nënshkruara me vendet e Ballkanit Perëndimor. Të gjitha MSA-të parashikojnë një ndalim të përgjithshëm të ndihmës Shtetërore dhe krijimin e një “autoriteti funksionalisht të pavaruar” “të pajisur me të gjitha kompetencat e nevojshme për zbatimin e plotë” të rregullave për ndihmën Shtetërore. Në kuadër të detyrimeve të parashikuara në Marrëveshjet e Stabilizim Asociimit të gjitha vendet e Ballkanit Perëndimor kanë krijuar autoritete të kontrollit të ndihmës Shtetërore. Kështu, Shqipëria, Mali i Zi, Kosova si dhe Bosnja dhe Hercegovina kanë krijuar Komision/Këshill të Kontrollit të Ndhmës Shtetërore. Ndërsa, Kroacia dhe Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë i kanë dhënë kompetencën për të kontrolluar ndihmën Shtetërore autoriteteve përkatëse të konkurrencës. Rrjedhimisht, kërkimi është i rëndësishëm dhe për vendet kandidate të Bashkimit Evropian në Ballkanin Perëndimor si dhe të gjithë ato që kanë nënshkruar një Marrëveshje Stabilizimi me BE-në, duke pasuruar literaturën e kufizuar në lidhje me kontrollin e ndihmës Shtetërore si një kusht për anëtarësimin në Bashkimin Evropian.

¹⁴ European Council of Lisbon, 23-24 Mars 2000, Conclusion Document of the Presidency para. 17 (Këshilli i Bashkimit Evropian i Lisbonës, 23-24 mars 2000, Konkluzionet e Presidencës, DOC/00/8 para. 17). E disponueshme: <http://www.consilium.europa.eu>; aksesuar më Nëntor 2015.

Veçanërisht, ky projekt përbën një risi për të drejtën shqiptare, pasi literatura në lidhje me kontrollin e ndihmës Shtetërore mungon. Shqipëria, në bazë të Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit e cila ka hyrë në fuqi në vitin 2009 ka një sërë detyrimesh në lidhje me kontrollin e ndihmës Shtetërore. Kështu, vendi nuk duhet të lejojë çdo ndihmë Shtetërore e cila shtrembëron ose rrezikon të shtrembërojë konkurrencën duke favorizuar ndërmarrje të caktuara ose prodhime të caktuara.¹⁵ Për më tepër, sipas nenit 71 të MSA-së të gjitha praktikatat në lidhje me ndihmën Shtetërore do të vlerësohen në bazë të kriterëve të së Drejtës Evropiane. i njëjti nen, parashikon gjithashtu detyrimin për Shqipërinë të krijojë një autoritet të pavarur për monitorimin e ndihmës Shtetërore. Gjatë fazës së para-anëtarësimit Shqipëria duhet të përmbushë tre kushte në lidhje me kontrollin e ndihmës Shtetërore: përafrimin e legjislacionit, një kapacitet administrativ të kënaqshëm dhe rezultate të besueshme të zbatimit të legjislacionit (Blauberger, 2009:1035). Në përmbushjen e detyrimeve që rrjedhin nga MSA-ja, Shqipëria ka miratuar legjislacion për ndihmën Shtetërore të përbërë kryesisht nga një Ligji për Ndhimën Shtetërore¹⁶ dhe një Vendim të Këshillit të Ministrave të vitit 2005 për miratimin e Rregullores në lidhje me procedurat dhe format e njoftimit.¹⁷ Gjithashtu është realizuar një inventar i skemave ekzistuese të ndihmës Shtetërore, në Janar të vitit 2008.¹⁸ Për më tepër, Shqipëria ka konfirmuar se nuk synon të japë ndihmë për ristrukturimin e industrisë së çelikut dhe

¹⁵ Neni 71 ligj Nr. 9590, datë 27.07.2006 “Për ratifikimin e marrëveshjes së stabilizim asociimit, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Komuniteteve Evropiane e Shteteve të tyre Anëtarë”.

¹⁶ Ligj nr. 9374, datë 21.4.2005 “Për ndihmat Shtetërore”, Gazeta Zyrtare nr. 36, fq. 36.

¹⁷ Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 817, datë 28.12.2005 “Për miratimin rregullores “Për procedurat dhe formën e njoftimit” Gazeta Zyrtare Nr. 102 fq. 103.

¹⁸ Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 45 datë 16.01.2008 “Për aprovimin e e raportit për inventarin e skemave ekzistuese të ndihmës Shtetërore në Shqipëri”, Gazeta Zyrtare Nr. 9 fq. 9.

hekurit.¹⁹ Ligji për ndihmën Shtetërore parashikon krijimin e një Komisioni për Ndhmën Shtetërore i cili është organi vendimmarrës dhe një Departament të Ndhmës Shtetërore në Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes i cili është organi administrativ.

1.3. Metodologjia dhe metodat kërkimore

Kërkimi bazohet në një analizë ligjore të kontrollit të ndihmës Shtetërore në Bashkimin Evropian. Shkenca ligjore përdor disa metoda kërkimi të cilat zbatohen në shkencat sociale duke përfshirë metodat e kërkimit cilësor dhe metodat e kërkimit sasior. Aktualisht, tema ndjek teknika cilësore për të analizuar të dhënat, për të nxjerrë përfundimet, dhe për të ofruar sugjerimet përkatëse. Gjithsesi, tema përdor të dhëna sasiore për të mbështetur me evidenca argumenta të caktuara. Mjeti kryesor i kërkuesit është analiza kritike e kuadrit ligjor në lidhje me ndihmën Shtetërore në Bashkimin Evropian dhe Shqipëri. Kuadri ligjor i kontrollit të ndihmës Shtetërore në BE përbëhet nga legjislacioni primar dhe dytësor, soft-law, procedurat kombëtare dhe praktika gjyqësore e krijuar nga Gjykata Evropiane e Drejtësisë dhe Gjykata e Përgjithshme. Ndërsa, kuadri ligjor për ndihmën Shtetërore në Shqipëri përbëhet nga ligji dhe aktet nënligjore për ndihmën Shtetërore Në përgjithësi, tema do të analizojë në mënyrë kritike të gjithë kuadrin ligjor të

¹⁹ Commission Staff Working Document – Albania 2009 Progress Report, accompanying the document from the Commission to the European Parliament and the Council enlargement strategy and main challenges 2009-2010 Dokument Pune i Stafit të Komisioni – Progres Raporti për Shqipërinë viti 2009, i cili shoqëron dokumentin nga Komisioni për Parlamentin dhe Këshillin, strategjia e zgjerimit dhe sfidat kryesore 2009-2010 COM (2009) 533, fq. 30. I disponueshëm në: http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/key_documents/2009/al_rapport_2009_en.pdf. Akseluar Nëntor 2015.

sipërpërmendur, duke dhënë dhe rekomandime për zgjidhjen e problemeve të ndryshme që identifikohen gjatë punimit.

Studimi përmban gjithashtu rastin studimor të Shqipërisë. Tema ofron një analizë krahasuese, e cila mbështet në aktet ligjore dhe nënligjore për ndihmën Shtetërore të miratuara në Shqipëri, në raportet vjetore të Komisionit të Ndhmës Shtetërore, raportet e progresit të Komisionit Evropian për Shqipërinë, vendime të Komisionit Evropian dhe Gjykatës Evropiane të Drejtësisë në lidhje me ndihmën Shtetërore. Kërkimi përfiton nga raportet e Komisionit të ndihmës Shtetërore në Shqipëri dhe nga analiza sasiore e të dhënave statistikore të Komisionit të Ndhmës Shtetërore. Këto të dhëna bëjnë të mundur nxjerrjen e konkluzioneve në lidhje me shumën dhe strukturën e ndihmës Shtetërore në Shqipëri.

Për të vlerësuar efektivitetin e kontrollit të ndihmës Shtetërore në Bashkimin Evropian tema përdor tre kritere: (i) shpejtësinë e procedurës për vlerësimin e masave ndihmë Shtetërore, (ii) transparencën e legjislacionit në fuqi në bazë të të cilit realizohet kontrolli i ndihmës Shtetërore dhe (iii) mekanizmat e zbatueshmërisë së ndihmës Shtetërore në nivel mbikombëtar dhe kombëtar. Këto kritere janë përdorur në dokumentet e Komisionit gjatë reformimit dhe modernizimit të kontrollit të ndihmës Shtetërore. Kështu një ndër objektivat e modernizimit të kontrollit të ndihmës Shtetërore në vitin 2012 ishte pikërisht marrja e vendimeve më të shpejta.²⁰ Ndërsa, Plani i Veprimit për Ndhmën Shtetërore parashikon që “Komisioni do të reduktojë vonesat duke inkurajuar njoftime të

²⁰ Communication from the Commission to the European Parliament, the Council, the European Economic and Social Committee and the Committee of the Regions (Communication on State Aid Modernisation). (Komunikim mbi Modernizimin e Ndhmës Shtetërore). (Komunikim nga Komisioni për Parlamentin Evropian, Këshillin, Komitetin Ekonomik dhe Shoqëror dhe Komitetin e Rajoneve), COM (2012) 209, 8.5.2012, para. 8

një cilësie më të lartë”.²¹ Për më tepër, në lidhje me kriterin e transparencës së legjislacionit në fuqi në bazë të të cilit realizohet kontrolli i ndihmës Shtetërore, Komisioni në Planin e Veprimit për Ndhimën Shtetërore “kërkon më shumë transparencë në parimet e përgjithshme të kontrollit të ndihmës Shtetërore.”²² Ndërsa, përsa i përket mekanizmave të zbatueshmërisë së vendimeve në lidhje me ndihmën Shtetërore në nivel mbikombëtar dhe kombëtar Komisioni në Planin e Veprimit për Ndhimën Shtetërore parashikon se “efektiviteti dhe besueshmëria e kontrollit të ndihmës Shtetërore nënkupton zbatimin e duhur të vendimeve të Komisionit”.²³

Ndërsa, për të vlerësuar efektivitetin e kontrollit të ndihmës Shtetërore në Shqipëri punimi përdor dy kritere: aftësinë e Komisionit të Ndhimës Shtetërore në Shqipëri për të zbatuar rregullat në lidhje me ndihmën Shtetërore dhe në çështje politikisht të ndjeshme, si dhe përmbushjen e qëllimeve të Planit të Veprimit për Ndhimën Shtetërore.²⁴ Ky dokument, ka theksuar rëndësinë e uljes së shumës totale të ndihmës Shtetërore të dhënë nga Shtetet Anëtare të Bashkimit Evropian në krahasim me prodhimin e brendshëm bruto (PBB). Gjithashtu, plani i sipërpërmendur synon ndryshimin nga ndihma vertikale (ndihma sektorale) e cila jepet për sektorë të veçantë në ndihmë horizontale.²⁵

²¹ State Aid Action Plan: Less and better targeted State aid: a roadmap for State aid reform 2005-2009, (Plan Veprimi për Ndhimën Shtetërore: Më pak ndihmë Shtetërore dhe më mirë e shënjestruar: udhërrëfyes për reformën e ndihmës Shtetërore 2005-2009) COM (2005) 107 final, para. 50.

²² Po aty para. 53.

²³ Po aty para. 53 dhe 51.

²⁴ State Aid Action Plan: Less and better targeted State aid: a roadmap for State aid reform 2005-2009, (Plan Veprimi për Ndhimën Shtetërore: Më pak ndihmë Shtetërore dhe më mirë e shënjestruar: udhërrëfyes për reformën e ndihmës Shtetërore 2005-2009) COM (2005) 107 final.

²⁵ Ndhimë për sektorë të veçantë (ndihma vertikale) është ndihma që zbatohet në aktivitete ekonomike në një sektor të caktuar të ekonomisë ose industrisë. Ndërsa, ndihmë horizontale janë llojet e ndihmës të dhëna nga Shtetet Anëtare për çdo sektor ekonomik për arritjen e objektivave specifike të interesit publik. Ndhimat horizontale jepen për të mbështetur mbrojtjen e mjedisit, trajnimin e punonjësve, projekte kërkimore etj

Megjithatë, vitet e fundit vetëm analiza doktrinale e ligjit, është kritikuar për arsye se ajo është e ngurtë, jofleksibël, një përjasje për të kuptuar se çfarë është ligji dhe si funksionon sistemi ligjor (Vick, 2004:31). Në të njëjtën kohë, njihen gjerësisht, përfitimet e përdorimit të disiplinave të tjera të tilla si sociologjia, shkencat politike, ekonomia, psikologjia, në ndihmë të kërimit ligjor. Ky kërkim ndër-disiplinor mendohet të sigurojë një kuptim më realist dhe më të rafinuar të ligjit (McConville & Wing Hong Chui, 2007:16). Për këtë arsye, tema përdor dhe kombinon të metoda të ndryshme kërkimi. Së pari, tema duke përdorur analizën ekonomike shpjegon nocionin e ndihmës Shtetërore. Plani i Veprimit për Ndihmën Shtetërore parashikon rolin e “qasjes ekonomike” në përkufizimin e nocionit të ndihmës Shtetërore. Paragrafi 19 i Planit të Veprimit për Ndihmën Shtetërore parashikon: *“analizat ligjore dhe ekonomike do të përdoren nga Komisioni për të përmbushur detyrimet e tij sipas Traktatit, në disa raste për të vendosur nëse një masë është ndihmë Shtetërore (psh parimi i investitorit privat[...]) dhe vecanërisht për të vendosur kur ndihma Shtetërore mund të deklarohet e pajtueshme me Traktatin”*.²⁶ Përsa i përket analizave ekonomike e drejta e konkurrencës, pjesë e së cilës është e drejta për ndihmën Shtetërore, ka si qëllim “të mbrojë konkurrencën në një ekonomi tregu” (Jonnes & Sufrin 2007:10). Ky fakt sjell nevojën e kombinimit të së drejtës me ekonominë. Nëpërmjet Planit të Veprimit për Ndihmën Shtetërore Komisioni Evropian kishte si qëllim përfshirjen e analizave ekonomike në vlerësimin e ndihmës Shtetërore. Në këtë mënyrë ndihma Shtetërore ka filluar të bashkohet me fusha të tjera të së drejtës së konkurrencës nëpërmjet një qasje e cila thekson rëndësinë e analizës ekonomike në lidhje me ndihmën

²⁶ State Aid Action Plan: and better targeted State aid: a roadmap for State aid reform 2005-2009, (Plan Veprimi për Ndihmën Shtetërore: Më pak dhe më mirë e shënjestruar: udhërrëfyes për reformën e ndihmës Shtetërore 2005-2009) COM (2005) 107 final, para.19.

Shtetërore (Coppi, 2011:80). Rrjedhimisht, duke marrë në konsideratë dhe qëllimin e kësaj teme analiza ekonomike do të përdoret kryesisht në lidhje me përkufizimin e ndihmës Shtetërore nga Traktati (TFBE) dhe zbatimin e procedurave nga Komisioni dhe Gjykata.

Gjithashtu, analiza në këtë temë përfshin edhe aspekte të teorisë politike përsa i përket veprimtarisë së Shtetit. Duhet theksuar se kontrolli i ndihmës Shtetërore mbetet në thelb “politik” të paktën në dy aspekte (Blauberger, 2011:40). Së pari, politikat e konkurrencës në përgjithësi dhe kontrolli i ndihmës Shtetërore në veçanti janë politika horizontale të cilat prekin qëllime të ndryshme përveç atyre të konkurrencës. Këto politika mund edhe të bien ndesh me njëra-tjetrën. Së dyti, zbatimi i rregullave për ndihmën Shtetërore varet nga pranimi dhe bashkëpunimi i qeverive të Shteteve Anëtare të Bashkimit Evropian. Rrjedhimisht Komisioni, në mënyrë që të zhvillojë gradualisht kontrollin e ndihmës Shtetërore, duhet të ketë në vëmendje se çfarë është politikisht e përshtatshme në nivelin e Shteteve Anëtare.

1.4. Kufizimet e studimit

Rregullat në lidhje me kontrollin e ndihmës shtetërore në Bashkimin Evropian kanë një ndikim të rëndësishëm në vendimmarrjen e Shteteve Anëtare të BE-së. Ato janë një nga instrumentet kryesore të cilët garantojnë që shpenzimet publike nuk do të çojnë në shtrembërime të konkurrencës. Gjatë dekadave të fundit, kjo fushë e ligjit është zhvilluar përsa i përket rëndësisë së saj. Rrjedhimisht, pothuajse çdo pjesë e ligjit kombëtar i nënshtrohet një shqyrtimi bazuar në kriteret e ndihmës Shtetërore.

Në Bashkimin Evropian disa sektorë të ekonomisë kanë rregulla të ndryshme në lidhje me ndihmën Shtetërore. Këto janë sektori i bujqësisë dhe ai i peshkimit. Kjo gjë reflektohet dhe në organizimin e Komisionit Evropian ku përgjegjëse për kontrollin e ndihmës Shtetërore në sektorin e bujqësisë është Drejtoria e Përgjithshme e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe në atë të peshkimit përgjegjëse është Drejtoria për Peshkimin. Ndërsa, Drejtoria përgjegjëse në Komision për kontrollin e ndihmës Shtetërore në sektorët e tjerë të ekonomisë është Drejtoria e Përgjithshme për Konkurrencën. Ky projekt nuk ka si qëllim analizimin dhe shpjegimin e rregullave për kontrollin e ndihmës Shtetërore në sektorin e bujqësisë dhe peshkimit. Për më tepër, ligji shqiptar për ndihmën Shtetërore përjashton shprehimisht nga fusha e zbatimit të tij sektorin e bujqësisë dhe peshkimit. Rrjedhimisht, rregullat për kontrollin e ndihmës Shtetërore në sektorin e bujqësisë dhe peshkimit në rendin ligjor shqiptar nuk janë pjesë e analizës në këtë studim.

Nga ana tjetër, e drejta për ndihmën Shtetërore në Bashkimin Evropian parashikon rregulla për sektorë të veçantë të ekonomisë. Ndihma sektorale është ndihma që zbatohet në aktivitete ekonomike në një sektor të caktuar të ekonomisë ose industrisë (Jones & Sufrin, 2014:118). Komisioni ka miratuar një numër të konsiderueshëm Komunikimesh, Njoftimesh, Udhëzimesh, dhe Drejtime Orientuese që kanë të bëjnë me ndihmën sektorale. Duke marrë në konsideratë, fragmentarizmin e legjislacionit dytësor të Bashkimit Evropian në lidhje me ndihmën sektorale, studimi nuk analizon rregullat për kontrollin e ndihmës Shtetërore që zbatohen në sektorë të veçantë të ekonomisë.

Subjekt i analizës në këtë kërkim është territori ligjor i Bashkimit Evropian. Ndërsa, përse i përket rregullave për ndihmën Shtetërore që zbatohen në vendet kandidate për

anëtarësim në Bashkimin Evropian, subjekt i analizës në këtë kërkim janë vetëm rregullat për ndihmën Shtetërore që zbatohen në territorin e Republikës së Shqipërisë.

1.5. Përmbledhje dhe struktura e punimit

Kapitulli i parë i temës prezanton qëllimin dhe rëndësinë e kërkimit. Gjithashtu, pyejtjet kërkimore dhe hipoteza e kërkimit, prezantohen në këtë kapitull. Për më tepër, trajtohet në mënyrë të detajuar struktura e temës dhe rëndësia e saj. Një vend të rëndësishëm në kapitullin e parë zë metodologjia dhe metodat e kërkimit të përdorura në këtë projekt.

Kapitulli i dytë analizon elementët e nocionit të ndihmës Shtetërore sipas nenit 107(1) Traktati për Funksonimin e Bashkimit Evropian. Kjo pjesë e temës shqyrton rregullat materiale në fuqi në Bashkimin Evropian në lidhje me nocionin e ndihmës Shtetërore. Komisioni dhe Gjykatat Evropiane kanë zhvilluar katër kritere kumulative të cilat duhet të përmbushen në mënyrë që të kemi të bëjmë me ndihmë Shtetërore nga pikëpamja ligjore. Kërkimi analizon secilin prej tyre: për zgjedhjen, avantazhin, ndihmën e dhënë nga Shteti ose nëpërmjet burimeve Shtetërore, shtrembërimin e konkurrencës dhe efektin në tregti. Kapitulli analizon problemet e një interpretimi të zgjeruar të nocionit të ndihmës Shtetërore në Bashkimin Evropian dhe të kompleksitetit të praktikës gjyqësore në lidhje me të. Pjesë e analizës janë dhe nenet 107(2), (3) TFBE të cilët parashikojnë përjashtime nga neni 107(1) TFBE dhe i japin Komisionit një diskrecion të gjerë në aprovimin e ndihmave.

Kapitulli i tretë analizon procedurat e Komisionit Evropian në lidhje me kontrollin e ndihmës Shtetërore. Neni 107 TFBE i jep të drejtën, vetëm Komisionit Evropian, të kontrollojë ndihmën Shtetërore në Bashkimin Evropian. Neni përcakton një përjashtim sipas të cilit Këshilli duke vepruar në mënyrë unanime mund të deklarojë ndihmën Shtetërore të pajtueshme “nëse një vendim i tillë justifikohet nga rrethana të jashtëzakonshme”. Shtetet Anëtare kanë detyrimin të njoftojnë Komisionin për çdo masë ndihmë që ato kanë qëllim të japin. Ato nuk mund të zbatojnë masën e njoftuar përpara se Komisioni të marrë një vendim. Ky kapitull analizon në mënyrë kritike kontrollin e centralizuar të ndihmave Shtetërore nga Komisioni. Analiza bazohet në legjislacionin kryesor dhe dytësor të Bashkimit Evropian të cilat plotësojnë procedurën administrative mbikombëtare të ndihmës Shtetërore. Duke u zhvilluar ndër vite ky legjislacion ka kodifikuar dhe praktikën gjyqësore të Gjykatës së Drejtësisë. Kapitulli analizon kompetencat e Komisionit në kontrollin e ndihmave Shtetërore duke përfshirë dhe kompetencën e tij për të urdhëruar kthim të ndihmës Shtetërore të paligjshme.

Një pjesë e kapitullit të tretë analizon dhe ndryshimet që ka sjellë reforma e nisur nëpërmjet Komunikimit për Modernizimin e Ndhmës Shtetërore.²⁷ Kjo reformë kishte si qëllim ndër të tjera, procedura më efektive në lidhje me kontrollin e ndihmave Shtetërore. Në kuadër të kësaj reforme në lidhje me rregullimin e procedurave për ndihmat Shtetërore u

²⁷ Communication from the Commission to the European Parliament, the Council, the European Economic and Social Committee and the Committee of the Regions, (Communication on State Aid Modernisation). (Komunikim mbi Modernizimin e Ndhmës Shtetërore). (Komunikatë nga Komisioni për Parlamentin Evropian, Këshillin, Komitetin Ekonomik dhe Shoqëror dhe Komitetin e Rajoneve), COM (2012) 209, 8.5.2012.

prezantuan disa ndryshime të Rregullores Procedurale.²⁸ Kapitulli trajton ndryshimet në trajtimin e ankimeve nga ana e Komisionit si dhe zgjerimin e kompetencave të Komisionit për të filluar hetime me iniciativën e tij. Gjithashtu, kapitulli analizon dhe kompetencën e Komisionit për të urdhëruar kthimin e ndihmës Shtetërore të paligjshme. Baza ligjore e kthimit të ndihmës Shtetërore është neni 14 i Rregullores Procedurale, i cili nuk i jep diskrecion Komisionit por e detyron atë të urdhëroje kthimin e ndihmës. Përpara miratimit të Rregullores Procedurale, kthimi njihej nga Gjykata vetëm si një alternativë në dispozicion të Komisionit i cili mund të kërkonte ripagimin e ndihmës së paligjshme.²⁹ Duke parë problemet në lidhje me kthimin e ndihmës Shtetërore si përsa i përket mosrespektimit të afateve të vendosura në vendimin e Komisionit për kthim ashtu dhe përsa i përket moszbatimit të vendimeve të Komisionit për kthim nga Shtetet Anëtare u miratua Njoftimi për Kthim.³⁰ Ky Njoftim ka si qëllim të udhëzojë Shtetet Anëtarë në lidhje me zbatimin e vendimeve të Komisionit për kthimin e ndihmës Shtetërore.

Kapitulli katërt analizon kompetencat e Gjykatës së Përgjithshme dhe Gjykatës së Drejtësisë në shqyrtimin e vendimeve të Komisionit që kanë të bëjnë me ndihmat Shtetërore. Rendi ligjor mbikombëtar i kontrollit të ndihmave Shtetërore përbëhet nga legjislacioni kryesor dhe dytësor i Bashkimit Evropian nga i cili rrjedhin kompetencat e Komisionit për të marrë vendime dhe për të zbatuar politika në lidhje me ndihmën Shtetërore. Gjithashtu në këtë rend mbikombëtar përfshihet dhe juridiksioni i Gjykatës së

²⁸ Council Regulation 1999/659/EC of 22 March 1999 laying down detailed rules for the application of Article 93 of the EC Treaty, OJ L 83/1, 27 March (Mars) 1999. (Rregullore e Këshillit 1999/659/EC, 22 Mars 1999 për përcaktimin e rregullave të detajuara për zbatimin e nenit 93 të Traktatit të Komunitetit Evropian).

²⁹ Çështje 70/72, *Commission v. Germany (Komisioni k Gjermanisë)* [1973] ECR 813 para 13.

³⁰ Notice from the Commission – Towards an effective implementation of Commission decisions ordering Member States to recover unlawful aid and incompatible State aid (Njoftim nga Komisioni – Drejt një zbatimi efektiv të vendimeve të Komisionit të cilat urdhërojnë kthimin e ndihmës Shtetërore të paligjshme dhe të papajtueshme) [2007] OJ C 272/4.

Drejtësisë për të shqyrtuar kontrollin e ndihmës Shtetërore të ushtruar nga Komisioni Evropian. Në qendër të kapitullit është zbatimi i rregullave të ndihmës Shtetërore, në Gjykatën e Drejtësisë së Bashkimit Evropian. Kapitulli bën një analizë të problemeve që kanë të bëjnë me zbatimin e së drejtës për ndihmat Shtetërore në gjykatat evropiane. Problemet megjithë zgjidhjet që ka ofruar Gjykata në vite, kanë të bëjnë kryesisht me legjitimitimin e palëve të interesuara në gjykatat evropiane.

Kapitulli pestë, analizon zbatimin e së drejtës për ndihmën Shtetërore nga Gjykatat Kombëtare të Shteteve Anëtare të Bashkimit Evropian. Rrjedhimisht tema analizon në mënyrë kritike kompetencat dhe procedurat e institucioneve kombëtare në kontrollin e ndihmave Shtetërore. Njoftimi i Komisionit në lidhje me zbatimin e së drejtës për ndihmat Shtetërore nga gjykatat kombëtare³¹ i vitit 2009 ka si qëllim “të udhëzojë gjykatat kombëtare”. Ky Njoftim është miratuar në kuadër të Planit të Veprimit për Ndhimën Shtetërore. Gjykatave Kombëtare u është besuar detyra e mbrojtjes së të drejtave të individëve në rast shkelje nga ana e Shteteve Anëtare të detyrimit për të mos zbatuar ndihmën Shtetërore përpara se ajo të miratohet nga Komisioni. Gjithashtu, gjykatat kombëtare mund të hasin çështje në lidhje me të drejtën e ndihmave Shtetërore dhe në rastet kur Komisioni ka urdhëruar kthim të ndihmës Shtetërore. Në këtë rast ankuesi mund të kërkojë anulimin e urdhrit kombëtar i cili zbaton vendimin e Komisionit. Kapitulli analizon problemet kryesore që kanë të bëjnë me kompetencën e gjykatave kombëtare për të shqyrtuar çështje në fushën e së drejtës së ndihmës Shtetërore dhe mënyrën e ndarjes së kësaj kompetence me institucionet e Bashkimit Evropian.

³¹ Commission notice on the enforcement of State aid law by national courts (Njoftim i Komisionit për zbatimin e së drejtës për ndihmat Shtetërore nga gjykatat kombëtare) OJ C85/01, 9.4.2009, para 6.

Kapitulli gjashtë analizon reformat më të rëndësishme në fushën e ndihmës Shtetërore në Bashkimin Evropian. Reformat më të rëndësishme në lidhje me të drejtën për ndihmat Shtetërore janë ato të nisura nga Komisioni nëpërmjet Planit të Veprimit për Ndhmën Shtetërore³² dhe tjetra nëpërmjet komunikimit të Komisionit mbi Modernizimin e Ndhmës Shtetërore.³³ Plani i Veprimit për Ndhmën Shtetërore përfshinte strategjinë e Lisbonës për zhvillim dhe punësim. Objektivat kryesore të Planit të Veprimit për Ndhmën Shtetërore ishin: më pak ndihmë Shtetërore dhe më mirë e shënjestruar; qasje (analizë) ekonomike; procedura më efektive, parashikueshmëri më e lartë dhe rritje e transparencës; kompetenca të ndara ndërmjet Komisionit dhe Shteteve Anëtare. Plani Veprimit për Ndhmën Shtetërore e solli ndihmën Shtetërore me pranë fushave të tjera të politikave të konkurrencës dhe promovoi ndihmën Shtetërore si një politike për mbështetjen e objektivave të përgjithshëm të Bashkimit Evropian (Kleiner, 2011:25). Ndërsa, reforma tjetër ambicioze e nisur nëpërmjet Komunitetit për Modernizimin e Ndhmës Shtetërore kishte tre objektiva kryesore: (i) nxitjen e një rritje të qëndrueshme, të zgjuar dhe përfshirëse në një treg të brendshëm konkurrues; (ii) përqendrimin e shqyrtimit *ex-ante* nga Komisioni në rastet me ndikim më të madh në tregun e brendshëm duke rritur në të njëjtën kohë bashkëpunimin me Shtetet Anëtare në zbatimin e ndihmave Shtetërore dhe (iii)

³² State Aid Action Plan: Less and better targeted State aid: a roadmap for State aid reform 2005-2009, (Plan Veprimi për Ndhmën Shtetërore: Më pak ndihmë Shtetërore dhe më mirë e shënjestruar: udhërrëfyes për reformën e ndihmës Shtetërore 2005-2009) COM (2005) 107 final.

³³ Communication from the Commission to the European Parliament, the Council, the European Economic and Social Committee and the Committee of the Regions COM (2012) 209, 8.5.2012 (Communication on State Aid Modernisation). (Komunikim për Modernizimin e Ndhmës Shtetërore). (Komunikim nga Komisioni për Parlamentin Evropian, Këshillin, Komitetin Ekonomik dhe Shoqëror dhe Komitetin e Rajoneve), COM (2012) 209, 8.5.2012.

përmirësimin e rregullave dhe sigurimin vendimeve më të shpejta.³⁴ Kjo reformë ka rezultuar në rishikimin e dokumenteve të ndryshme. Kapitulli gjashtë analizon në mënyrë kritike këto reforma. Analiza synon analizojë ndryshimet pozitive që ka sjellë secila reformë në kontrollin e ndihmës Shtetërore. Kjo pjesë e temës synon gjithashtu të identifikojë elementë të ndihmës Shtetërore të cilat kanë nevojë për reforma të mëtejshme.

Kapitulli VII analizon detyrimet e Shqipërisë që rrjedhin nga MSA në kuadër të kontrollit të ndihmës Shtetërore. Në kuadër të procesit të Stabilizim-Asociimit, MSA-ja ndërmjet Shqipërisë dhe BE-së u nënshkrua më 12 qershor 2006 dhe hyri në fuqi më 1 prill 2009. Qëllimet kryesore të MSA-së janë të mbështesë përpjekjet e Shqipërisë në forcimin e demokracisë dhe shtetit ligjor, si dhe të mbështesë tranzicionin drejt një ekonomie tregu funksionale të integruar në tregun e brendshëm të BE-së.³⁵ MSA-ja kërkon që Shqipëria të garantojë që rregullat për konkurrencën dhe ndihmën Shtetërore të jenë në përputhje me *acquis communautaire*. Gjatë periudhës së para-anëtarësimit Shqipëria duhet të ketë tregues të pranueshëm të zbatimit të këtyre rregullave. Komisioni Evropian vlerëson ligjet e miratuara nga Shqipëria në kuadër të konkurrencës dhe kontrollit të ndihmës Shtetërore dhe zbatimin e tyre nëpërmjet raportit të progresit i cili hartohet çdo vit. Sipas kushteve të MSA-së, Shqipëria nuk duhet të lejojë asnjë ndihmë Shtetërore e cila shtrembëron ose rrezikon të shtrembërojë konkurrencën duke favorizuar ndërmarrje të caktuara ose produkte të caktuara. Veçanërisht, vëmendje do t'i kushtohet Komisionit të Ndhmës Shtetërore,

³⁴ Communication from the Commission to the European Parliament, the Council, the European Economic and Social Committee and the Committee of the Regions (Communication on State Aid Modernisation). (Komunikim mbi Modernizimin e Ndhmës Shtetërore). (Komunikim nga Komisioni për Parlamentin Evropian, Këshillin, Komitetin Ekonomik dhe Shoqëror dhe Komitetin e Rajoneve), COM (2012) 209, 8.5.2012, para. 8

³⁵ Neni 1, Ligj Nr. 9590, date 27.07.2006 “Për ratifikimin e marrëveshjes së stabilizim asociimit, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Komuniteteve Evropiane e Shteteve të tyre Anëtarë”

organ i cili ka kompetencën të zbatojë dispozitat ligjore për ndihmën e Shtetërore në Shqipëri. Është e rëndësishme që ky autoritet kontrollues të jetë i pavarur si nga dhënësit e ndihmës Shtetërore ashtu dhe nga përfituesit e saj.

KAPITULLI II

NOCIONI I NDIHMËS SHETËRORE NË BASHKIMIN EVROPIAN

2.1. Hyrje

Në Traktatin për Funksionimin e Bashkimit Evropian (TFBE) dispozitat për ndihmën Shtetërore bëjnë pjesë në titullin VII “Rregulla të përbashkëta për konkurrencën, tatimet dhe përafrimin legjislativ”. Dispozitat bazë në lidhje me ndihmat Shtetërore në Bashkimin Evropian janë nenet 107, 108 dhe 109 TFBE. Dispozita bazë materiale në lidhje me ndihmën Shtetërore është neni 107 (1) TFBE, i cili parashikon që: *“çdo ndihmë e dhënë nga Shteti Anëtar ose nëpërmjet burimeve Shtetërore në çfarëdolloj forme që shtrembëron ose rrezikon të shtrembërojë konkurrencën duke favorizuar ndërmarrje të caktuara ose prodhime të caktuara është e papajtueshme me tregun e brendshëm”*.

Ky kapitull do të analizojë elementët e nocionit të ndihmës Shtetërore në bazë të nenit 107(1) të Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Evropian. Në mënyrë që të zbatohet kjo dispozitë, duhet të ekzistojnë katër elementët e parashikuar nga vetë ajo, ashtu siç janë interpretuar nga Gjykata e Drejtësisë e Bashkimit Evropian.³⁶ Elementët përbërës të ndihmës Shtetërore që do të analizohen në këtë kapitull janë: së pari për zgjedhja; së dyti dhënia e një avantazhi ekonomik; së treti, financimi nga Shteti ose nga burimet Shtetërore; së katërti efekti në tregti dhe konkurrencë. Përpara se të analizohen procedurat e Komisionit

³⁶ Çështje C-142/87 *Belgium v. Commission* (Tubemeuse) (Belgjika k. Komisionit) [1990] ECR I-959, para. 25; Çështje C-196/04 *Ryanair v. Commission* (Ryanair k. Komisionit) [2008] ECR II-03643, para. 36; Çështje *Chronopost and La Poste v. UEFA* (Chronopost dhe La Poste k. UEFA) [2008] ECR I-4777, para.122.

Evropian në lidhje me vlerësimin e pajtueshmërisë së ndihmës me tregun e brendshëm është e nevojshme të shqyrtohen rregullat materiale, në fuqi, për ndihmën Shtetërore në Bashkimin Evropian.

Gjithashtu, kapitulli analizon ndihmat Shtetërore që janë të pajtueshme si dhe ndihmat Shtetërore që mund të jenë të pajtueshme me tregun e brendshëm. Neni 107(2) TFBE identifikon tre kategori ndihmash që janë plotësisht të pajtueshme me tregun e brendshëm duke u konsideruar kështu përjashtim nga neni 107(1) TFBE. Ndërsa neni 107(3) i jep diskrecion Komisionit për të deklaruar se ndihma e cilësuar në një nga llojet e parashikuara nga ky nen është e pajtueshme me tregun e brendshëm, duke deroguar nga neni 107(1) TFBE.

2.2. E drejta parësore e Bashkimit Evropian në lidhje me ndihmën Shtetërore

Bashkimi Evropian i ka themelet e tij në Bashkimin Ekonomik Evropian. Pas Luftës së Dytë Botërore, u krijuan tre Komunitete Evropiane. Së pari, u krijua në vitin 1951 në bazë të Traktatit për krijimin e Komunitetit Evropian të Çelikut dhe Qymyrit (Traktati Parisit), Komuniteti Evropian i Qymyrit dhe Çelikut (KEÇQ). Së dyti, u krijua në vitin 1957, Komuniteti Evropian Energjisë Atomike (Euratom). Së treti, u krijua në vitin 1957, Komuniteti Ekonomik Evropian, në bazë të Traktatit për krijimin e Komunitetit Ekonomik Evropian (Traktatit të Romës). Traktati për Krijimin e Komunitetit Evropian të Çelikut dhe Qymyrit u nënshkrua për një periudhë 25 vjeçare dhe ai ka qenë në fuqi deri në 23 Korrik të

vitit 2002. Ndërsa, Euratom kontrollohet nga Bashkimi Evropian por ligjërisht është një entitet më vete.³⁷

Në vitin 1951 Traktati i Parisit³⁸ i cili siç u përmend më sipër krijoi Komunitetin Evropian të Çelikut dhe Qymyrit prezantoi për herë të parë rregullat për ndihmën Shtetërore në lidhje me projektin e integritit evropian (Ehlermann, 1994:412). Ky Traktat hodhi hapin e parë të integritit ekonomik ndonëse vetëm në fushën e industrisë së rëndë i cili do t'u hapte rrugën veprimeve të tjera (Canaj & Bana, 2014:19). Veçanërisht, neni 4(c) i këtij Traktati parashikonte që subvencionet dhe ndihmat e dhëna nga Shtetet ishin të papajtueshme me tregun e brendshëm të çelikut dhe qymyrit dhe si të tilla duhet të shfuqizoheshin dhe të ndaloheshin. Rrjedhimisht, KEÇQ parashikonte një ndalim të pakufizuar dhe të pakushtëzuar të ndihmës së dhënë nga Shtetet Anëtare. Për më tepër, Traktati nuk përmbante një përkufizim të nocionit “ndihmë” ose “subvencion”.

Ndërsa, rregullat në lidhje me ndihmën Shtetërore të parashikuara në Traktatin për Krijimin e Komunitetit Ekonomik Evropian (TKEE) nënshkruar në vitin 1957, ndalonin ndihmën Shtetërore që shtrembëronte konkurrencën. Traktati për Krijimin e Komunitetit Ekonomik Evropian krijoi Komunitetin Ekonomik Evropian. Objektivat kryesore të Traktatit ishin krijimi i një tregu të përbashkët, përafrimi i politikave ekonomike të Shteteve Anëtare, rritja e stabilitetit dhe standartit të jetesës. Për më tepër, Traktati kishte si qëllim heqjen e pengesave të tregtisë dhe vendosjen e tarifave të përbashkëta doganore, mbrojtjen e konkurrencës, harmonizimin e politikave ekonomike dhe tregtare (Craig & de Burca,

³⁷ Shiko <http://ec.europa.eu/euratom/index.html>

³⁸ Traktati për Krijimin e Komunitetit Evropian të Qymyrit dhe Çelikut u nënshkruar në Paris, më 18 prill 1951 dhe hyri në fuqi në 23 korrik 1952, ndërmjet gjashtë Shteteve nënshkruese: Belgjika, Franca, Holanda, Italia, Luksemburgu dhe Republika Federale e Gjermanisë.

2008:6). Ndhimja e dhënë nga Shtetet përfshihej në të njëjtin kapitull me rregullat për konkurrencën. Në ndryshim nga Traktati i Parisit, ndalimi i ndihmës Shtetërore ashtu siç parashikohej nga TKEE nuk ishte absolut apo i pakufizuar. Kështu neni 92 (1) TKEE parashikonte që çdo ndihmë e dhënë nga Shtetet Anëtare e cila rrezikonte të shtrembëronte konkurrencën duke ndikuar në tregtinë ndërmjet Shteteve Anëtare ishte e papajtueshme me tregun e brendshëm.³⁹ Ndërsa paragrafi i dytë dhe i tretë i nenit 92 TKEE parashikonte ndihmën Shtetërore që ishte e pajtueshme me tregun e brendshëm dhe ndihmën Shtetërore që mund të konsiderohej e pajtueshme me tregun e brendshëm.⁴⁰ Traktati për krijimin e Komunitetit Ekonomik Evropian ashtu si Traktati për krijimin e Komunitetit Evropian të

³⁹ Neni 92 (2) Traktati për Krijimin e Komunitetit Ekonomik Evropian parashikon që: “Me përjashtim të rasteve kur Traktatet parashikojnë ndryshe, ndihma që jep një Shtet Anëtar ose që jepet përmes burimeve shtetërore në çfarëdolloj forme, e cila e shtrembëron ose rrezikon të shtrembërojë konkurrencën duke favorizuar disa ndërmarrje të caktuara ose prodhimin e disa mallrave të caktuara, është e papajtueshme me tregun e brendshëm, për aq kohë sa prek tregtinë midis Shteteve Anëtare.”

⁴⁰ Neni 92 (2) Traktati për Krijimin e Komunitetit Ekonomik Evropian parashikon që:

“Sa më poshtë, janë të pajtueshme me tregun e brendshëm:

(a) ndihma me karakter social, që u jepet konsumatorëve individualë, me kusht që kjo ndihmë të jepet pa diskriminim lidhur me origjinën e produkteve që prek;

(b) ndihma për shlyerjen e dëmit të shkaktuar nga fatkeqësitë natyrore ose ngjarjet e jashtëzakonshme;

(c) ndihma që i jepet ekonomisë në disa zona të caktuara të Republikës Federale të Gjermanisë të prekura nga ndarja e Gjermanisë, për aq kohë sa kjo ndihmë është e nevojshme për të kompensuar pozitën e pafavorshme ekonomike që ka shkaktuar kjo ndarje. Pesë vjet pas hyrjes në fuqi të Traktatit të Lisbonës, Këshilli, me propozim të Komisionit, mund të miratojë një vendim që e shfuqizon këtë gërme”.

Neni 92 (3) Traktati për Krijimin e Komunitetit Ekonomik Evropian parashikon që:

Sa më poshtë, mund të konsiderohen si të pajtueshme me tregun e brendshëm:

(a) ndihma për nxitjen e zhvillimit ekonomik të zonave ku standardi i jetesës është i ulët në mënyrë jo normale dhe ku ka papunësi të theksuar;

(b) ndihma për nxitjen e realizimit të një projekti të rëndësishëm me interes të përbashkët evropian ose për ndërtimin e një çregullimi të rëndë në ekonominë e një Shteti Anëtar;

(c) ndihma për lehtësimin e zhvillimit të disa aktiviteteve të caktuara ekonomike ose të disa fushave të caktuara ekonomike, ku një ndihmë e tillë nuk i prek aq keq kushtet e tregtimit sa të bien ndesh me interesin e përbashkët. Çdo ndihmon në ndërtimin e anijeve që ekziston më 1 janar 1957 do të , në atë masë që ndihmat e tilla thjesht kompensojnë mungesën e mbrojtjes doganore , të reduktohen në mënyrë progresive me të njëjtat kushte që zbatohen për heqjen e tarifave doganore , subjekt i dispozitave të këtij Traktati në lidhje me politika e përbashkët tregtare për vendet e treta ; dhe

(d) kategori të tjera të tilla ndihme të cilat mund të përcaktohen në një vendim të Këshillit, me një shumicë të cilësuar, me propozim të Komisionit.

Çelikut dhe Qymyrit nuk përmbanin një përkufizim të nocionit të ndihmës Shtetërore (Ehlermann, 1994:413).

Ndërsa, neni 93 TKEE⁴¹ një dispozitë procedurale i jepte të drejtën Komisionit të shqyrtonte skemat ndihmë Shtetërore dhe autorizonte Komisionin të propozonte “masat e duhura të nevojshme për zhvillimin progresiv ose funksionimin e tregut të brendshëm”. Neni 93 (2) TKEE i jepte të drejtën Komisionit t’i kërkonte Shteteve Anëtare “të shfuqizonin ose të ndryshonin” ndihmën e cila sipas Komisionit ishte e papajtueshme me tregun e brendshëm. Procedura e parashikuar në nenin 93 (2) TKEE i lejonte Komisionit të vendoste kushte në lidhje me ndihmën e aprovuar, duke përfshirë “kufizime përsa i përket llojit të ndihmës, shumës, intensitetit, përfituesve, qëllimit dhe kohëzgjatjes së ndihmës”.

Në vazhdim, neni 93(3) TKEE përmbante detyrimin e Shteteve Anëtare për të informuar

⁴¹ Neni 93 Traktati për Krijimin e Komunitetit Ekonomik Evropian parashikon që:

1. Komisioni, në bashkëpunim me Shtetet Anëtare, i mban në shqyrtim të vazhdueshëm të gjitha sistemet e ndihmës që ekzistojnë në këto Shtete. Ai u propozon këtyre të fundit masat e duhura që janë të nevojshme për zhvillimin progresiv ose funksionimin e tregut të brendshëm.

2. Nëse, pasi u jep njoftim palëve në fjalë për të paraqitur komentet e tyre, Komisioni konstaton se ndihma e dhënë nga një Shtet ose nëpërmjet burimeve shtetërore nuk është e pajtueshme me tregun e brendshëm, duke pasur parasysh nenin 92 ose se një ndihmë e tillë është shpërdoruar, ai vendos që Shteti në fjalë ta shfuqizojë ose ta ndryshojë këtë ndihmë brenda një afati të vendosur nga Komisioni.

Nëse Shteti në fjalë nuk e zbaton këtë vendim brenda afatit të përcaktuar, Komisioni ose Shtetet e tjera të interesuara, duke iu shmangur urdhërimeve të neneve 169 dhe 170, mund ta paraqesin çështjen përpara Gjykatës së Drejtësisë të Bashkimit Evropian.

Me kërkesë të një Shteti Anëtar, Këshilli, me unanimitet, mund të vendosë që ndihma që jep ose ka si qëllim të japë ky Shtet të konsiderohet si e pajtueshme me tregun e brendshëm, duke iu shmangur urdhërimeve të nenit 92 ose të rregulloreve të parashikuara në nenin 94, nëse një vendim i tillë justifikohet me rrethana të jashtëzakonshme. Nëse lidhur me ndihmën në fjalë, Komisioni ka filluar më parë procedurën e parashikuar në nënparagrafin e parë të këtij paragrafi, fakti që Shteti i interesuar i ka paraqitur kërkesë Këshillit sjell për pasojë pezullimin e procedurës gjersa të jetë shprehur Këshilli.

Por, nëse Këshilli nuk shprehet brenda tre muajve pas paraqitjes së kërkesës në fjalë, Komisioni jep vendimin e tij për çështjen.

3. Komisioni informohet në kohë të mjaftueshme, për t’i dhënë mundësi të paraqesë komentet e tij për çdo plan që ka të bëjë me dhënien ose ndryshimin e një ndihme. Nëse gjykon se një plan i tillë nuk pajtohet me tregun e brendshëm, sipas nenit 92, Komisioni fillon pa vonesë procedurën e parashikuar në paragrafin mësipërm. Shteti Anëtar në fjalë nuk i zbaton masat e propozuara gjersa nga kjo procedurë të ketë dalë një vendim përfundimtar.

4. Komisioni mund të miratojë rregullore në lidhje me kategoritë e ndihmës shtetërore për të cilat Këshilli, në zbatim të nenit 94, ka vendosur se mund të përjashtohen nga procedura e parashikuar në paragrafin 3 të këtij neni.

Komisionin Evropian në lidhje me çdo plan për të dhënë ndihmë Shtetërore. Për më tepër, sipas të njëjtit nen Shtetet Anëtare nuk mund të zbatonin masën ndihmë të propozuar pa autorizimin e Komisionit. Traktati garantonte të drejtën e Komisionit Evropian për të shqyrtuar dhe autorizuar çdo skemë ndihmë Shtetërore. Neni 93(3) TKEE parashikonte shprehimisht të drejtën e Komisionit për t'i kërkuar Shteteve Anëtare “shfuqizimin ose ndryshimin” e ndihmës së papajtueshme me tregun e brendshëm. Ndërsa neni 94 TKEE⁴² i jepte të drejtën Këshillit, me propozim të Komisionit të miratonte rregullore për zbatimin e neneve 92 dhe 93 të sipërpërmendur.

Traktati për krijimin e Komunitetit Ekonomik Evropian është ndryshuar disa herë. Ndryshimi më i rëndësishëm u prezantua nga Traktati i Bashkimit Evropian (TBE) i cili hyri në fuqi në 1 Nëntor të vitit 1993. TBE krijoi një entitet të ri, i cili ishte Bashkimi Evropian që shënoi një fazë të re në procesin e integrimit evropian. Ky Traktat krijoi strukturën me tre shtylla të Bashkimit Evropian, ku Komunitet bënin pjesë në shtyllën e parë. Ndërsa Traktati për krijimin e Komunitetit Ekonomik Evropian u quajt Traktati i Komunitetit Evropian (TKE). Përsa i përket dispozitave në lidhje me ndihmën Shtetërore ato nuk kanë pësuar ndryshime thelbësore që prej Traktatit të krijimit të Komunitetit Evropian.

Aktualisht, dispozitat në lidhje me ndihmën Shtetërore janë pjesë e Traktatit të Lisbonës. Traktati i Lisbonës prezanton ndryshimet e fundit të dy traktateve kryesore të

⁴² Neni 94 Traktati për Krijimin e Komunitetit Ekonomik Evropian parashikon që “Këshilli, duke vepruar me një shumicë të cilësuar me propozim të Komisionit mund të miratojë rregulloret e duhura për zbatimin e neneve 92 dhe 93 dhe, në veçanti, mund të caktojë kushtet e zbatimit të nenit 93(3) dhe kategoritë e ndihmës të përjashtuara nga kjo procedure”.

BE-së: të Traktatit të Bashkimit Evropian⁴³ dhe të Traktatit për Krijimin e Komunitetit Evropian.⁴⁴ Traktati i Lisbonës u nënshkrua nga Shtetet Anëtare të Bashkimit Evropian në 13 Dhjetor të vitit 2007 dhe hyri në fuqi në 1 Dhjetor të vitit 2009. Traktati i Lisbonës i atribuon personalitet juridik Bashkimit Evropian, duke i dhënë fund sistemit të personalitetit të dyfishtë ligjor të Bashkimit Evropian dhe të Komunitetit Evropian sipas Traktateve të vjetra. Përsa i përket rregullave të konkurrencës ato përfshihen në Traktatin e ndryshuar të krijimit të Komunitetit Evropian i cili është quajtur Traktati për Funksionimin e Bashkimit Evropian (TFBE). Ndihma Shtetërore është pjesë e rregullave për konkurrencën. Përfshirja e kontrollit të ndihmës Shtetërore së bashku me dispozitat mbi konkurrencën është një veçanti e juridiksionit të Bashkimit Evropian.

Aktualisht, dispozitat bazë për ndihmën Shtetërore në Bashkimin Evropian janë nenet 107, 108 dhe 109 të Traktit për Funksionimin e Bashkimit Evropian. Dispozita bazë materiale është neni 107 i TFBE-së i cili parashikon: *“Me përjashtim të rasteve kur Traktatet parashikojnë ndryshe, ndihma që jep një Shtet Anëtar ose që jepet përmes burimeve shtetërore në çfarëdolloj forme, e cila e shtrembëron ose rrezikon të shtrembërojë konkurrencën duke favorizuar disa ndërmarrje të caktuara ose prodhimin e disa mallrave të caktuara, është e papajtueshme me tregun e brendshëm, për aq kohë sa prek tregtinë midis Shteteve Anëtare.”* Kjo dispozitë nuk përmban një përkufizim të nocionit të ndihmës Shtetërore, por përcakton elementët që duhet të ketë një masë ndihmë në mënyrë që të kategorizohet ndihmë Shtetërore. Rrjedhimisht, është e papajtueshme me tregun e brendshëm, çdo formë ndihme e cila: financohet nga Shteti ose nga burimet shtetërore,

⁴³ Treaty on European Union (Maastricht 1992) (Traktati për Bashkimin Evropian) OJ C191/01.

⁴⁴ Traktati për Krijimin e Komunitetit Ekonomik Evropian (Rome 1957).

shtrembëron ose rrezikon të shtrembërojë konkurrencën, favorizon disa ndërmarrje ose prodhimin e disa të mirave, ndikon në tregtinë ndërmjet Shteteve Anëtare.

Traktati për Funksionimin e Bashkimit Evropian ndalon dhënien e ndihmës Shtetërore nga Shtetet Anëtare tek ndërmarrjet sepse ndihma Shtetërore shtrembëron konkurrencën dhe ndikon në tregtinë ndërmjet Shteteve Anëtare të Bashkimit Evropian. Vetë Traktati për Funksionimin e Bashkimit Evropian vendos një objektiv për kontrollin e ndihmës Shtetërore që është mbrojtja e konkurrencës së bashku me instrumente të tjerë të politikës së konkurrencës në Bashkimin Evropian. Gjithsesi, ndihma Shtetërore e papajtueshme ndalohet sa kohë që masa ndihmë nuk mund të kategorizohet sipas përjashtimeve të parashikuara nga neni 107(2) dhe 107(3) TFBE.

Ndërsa, neni 108 TFBE, është një dispozitë procedurale e cila parashikon detyrimin e Shteteve Anëtare për të njoftuar Komisionin Evropian në lidhje me masat ndihmë. Për më tepër, paragrafi i fundit i këtij neni parashikon detyrimin e Shteteve Anëtare për të pritur vendimin përfundimtar të Komisionit përpara zbatimit të masës së njoftuar sipas procedurës së sipërpërmendur. Gjithashtu, ky nen përcakton dhe kompetencat e Komisionit në lidhje me kontrollin e ndihmës Shtetërore. Komisioni në mënyrë që të mbajë në shqyrtim të vazhdueshëm të gjitha sistemet e ndihmës që ekzistojnë në Shtetet Anëtare, ka vendosur që Shtetet Anëtare duhet t'i paraqesin atij raporte vjetore. Këto raporte përmbajnë të dhëna në lidhje me skemat aktuale të ndihmës ligjore. Qëllimi i procedurës së parashikuar në nenin 108(1) TFBE është të pajisë Komisionin me mjetet e nevojshme për të kontrolluar ndihmën ekzistuese. Ky nen i jep mundësinë Komisionit të sigurojë shfuqizimin ose ndryshimin e ndihmës në Shtete të ndryshme në periudhën e para-anëtarësimit në Bashkimin Evropian.

Ndërsa, neni 109 i Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Evropian i atribuon Këshillit të drejtën për të miratuar rregullore të cilat do të bëjnë të mundur zbatimin rregullave materiale dhe procedurale të parashikuara në nenet 107 TFBE dhe 108 TFBE.

2.3. E drejta dytësore e Bashkimit Evropian në lidhje me ndihmën Shtetërore

Përsa i përket legjislacionit dytësor në Bashkimin Evropian neni 288 TFBE parashikon që institucionet e Bashkimit Evropian miratojnë rregullore, direktiva, rekomandime dhe opinione. Rregulloret kanë një zbatim të përgjithshëm dhe janë drejtpërdrejt të zbatueshme në të gjitha Shtetet Anëtare të Bashkimit Evropian. Ndërsa, direktivat nuk janë të detyrueshme në të gjitha elementët e tyre, pasi i detyrojnë Shtetet Anëtare vetëm përsa i përket rezultatit që duhet arritur duke ua lënë në dorë këtyre të fundit zgjedhjen e mjeteve (Canaj & Bana, 2014:160). Vendimet, kanë fuqi detyruese në tërësinë e tyre dhe përcaktojnë se kujt i drejtohen. Neni 288 TFBE parashikon dhe akte të tjera që janë rekomandimet dhe opinionet të cilat nuk kanë fuqi detyruese.

Në vitet e para kontrolli i ndihmës Shtetërore bazohej vetëm në legjislacionin parësor të Bashkimit Evropian. Megjithëse, neni 94 i Traktatit për krijimin e Komunitetit Ekonomik Evropian (tani neni 107 TFBE) garantonte mundësinë e miratimit të legjislacionit dytësor në fushën e kontrollit të ndihmës Shtetërore, Komisionit i është dashur një kohë e gjatë për të miratuar rregulloret e para. Fillimisht, në mesin e viteve 1960, Komisioni paraqiti në Këshill një propozim për miratimin e një draft-rregullore procedurale në fushën e ndihmës Shtetërore. Kjo rregullore nuk u miratua nga Këshilli. Ky refuzim mund të shpjegohet në sfondin e “karriges bosh” dhe kompromisit të

Luksemburgut në vitin 1966. Ndërsa, në vitin 1972 Komisioni paraqiti në Këshill propozimin e dytë për miratimin e një drat-rregullore procedurale. Përsëri propozimi i Komisionit u refuzua nga Këshilli. Refuzimi i dytë tregoi në mënyrë të qartë “vullnetin e Shteteve Anëtare për të mos lejuar Komunitetin të kontrollojë politikat kombëtare në lidhje me ndihmën Shtetërore, duke penguar krijimin kuadrit ligjor të nevojshëm për rregullimin e ndihmës Shtetërore në Komunitet” (Lavdas & Mendrinou, 1999:30). Në këto kushte, Komisioni mund të miratonte vetëm instrumente “soft-law” të tilla si: drejtime orientuese, komunikime, udhëzime dhe njoftime. Këto instrumentë përmbanin rregulla për vlerësimin e pajtueshmërisë së masës ndihmë Shtetërore me tregun e brendshëm. Mjeti më i përdorur nga Komisioni pas viteve 70, kanë qenë pikërisht drejtimet orientuese të cilat shërbenin për vlerësimin e llojeve të ndryshme të ndihmës industriale (Smith, 2009:726). Kështu, në vitin 1971, drejtimi i parë orientues i hartuar nga Komisioni pas konsultimit me qeveritë e Shteteve Anëtare, kishte të bënte me ndihmën rajonale. Ndërsa në fushën e tekstileve drejtimi i parë orientues u miratua në korrik të vitit 1971.

Kriza e naftës vitit 1973 nxiti Shtetet Anëtare të mbronin ekonomitë e tyre në dëm të tregut të brendshëm. Shtetet Anëtare gjatë kësaj periudhe rritën ndjeshëm ndihmën Shtetërore duke bërë kështu të pamundur zbatimin e rregullave të Komisionit në lidhje me ndihmën Shtetërore (Lopez, 2015: 70). Mungesa e një rregulloreje procedurale dhe prania e krizës së naftës ndikuan ndjeshëm në moszbatimin e rregullave në lidhje me ndihmën Shtetërore. Vetëm në vitin 1977 u bë i mundur miratimi i Kodit i Fibrave Sintetike, i cili rregullonte dhënien e ndihmës Shtetërore në industrinë e fibrave. Kodi u pasua nga një komunikatë drejtuar Shteteve Anëtare në fushën e tekstileve në vitin 1977 dhe një

komunikatë për ndihmën drejtuar sektorëve të ndryshëm të industrisë në vitin 1978. Më pas, në vitin 1980 miratohet një kod për ndihmën në sektorin e çelikut.

Sipas disa autorëve fillimi i viteve 1980 shënon një fazë tjetër në zhvillimin e rregullave për ndihmën Shtetërore (Weiler, 1991:2403). Klima e përgjithshme politike ndryshoi në favor të një politike më të rreptë për ndihmën Shtetërore. Komisioni filloi të përdorte procedurën e parashikuar në nenin 93 (2) TKEE sipas së cilës Komisioni duhet të njoftojë në kohë të mjaftueshme nga Shteti Anëtar, për t'i dhënë mundësi këtij të fundit të paraqiste komentet e tij për çdo plan që kishte të bënte me dhënien ose ndryshimin e një ndihme. Sipas së njejtës procedure Shteti Anëtar në fjalë nuk mund t'i zbatonte masat e propozuara gjersa Komisioni të kishte marrë një vendim përfundimtar. Për më tepër Komisioni kishte filluar të kërkonte kthimin e ndihmës së papajtueshme në vitin 1983.⁴⁵ Në fushën e kërkimit dhe zhvillimit u miratua një udhëzim i Komisionit në vitin 1985.

Në fillim të viteve 1990, Komisioni jo vetëm që ishte mësuar me mungesën e një rregulloreje procedurale por nuk po ndërmerte më iniciativën për të propozuar në Këshill një rregullore të re procedurale (Cini, 2001:194). Rrjedhimisht, Komisioni refuzoi sugjerimin e Këshillit në vitin 1990, për të paraqitur një rregullore për zbatimin e neneve të Traktatit në lidhje me ndihmën Shtetërore (Cini, 2001:199). Në vitin 1992, Komisioni prezantoi ndihmën *de minimis* si pjesë të një programi për favorizimin e ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme.⁴⁶ Ndërsa, fundi viteve 1990 do të shënonte një kthesë të rëndësishme në lidhje me legjislacionin dytësor në fushën e ndihmës Shtetërore (Cini, 2001:196).

⁴⁵ Çështje 70/72, *Commission v. Federal Republic of Germany* (Komisioni k. Republikës Federale të Gjermanisë) [1973] ECR 3809.

⁴⁶ Community guidelines on State aid for SME's OJ C 213, 1992 (Udhëzim i Komunitetit për ndihmën Shtetërore për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme).

Komisioni propozoi dy rregullore në Këshill, të cilat u aprovuan. Rregullorja e parë e ashtuquajtura “rregullore zbatuese”, për të cilën u ra dakord në Maj të vitit 1998, garantonte të drejtën e Komisionit për të përjashtuar disa kategori ndihme nga detyrimi për të njoftuar Komisionin. Rrjedhimisht, Komisioni mund të miratonte rregulloret e tij në bazë të kufijve të përcaktuar nga Këshilli. Ndërsa, Rregullorja e dytë e cila u aprovua në 22 Mars të vitit 1999 u miratua nga Këshilli për cakton rregulla të detajuara për zbatimin e nenit 93 [tani neni 108] të Traktatit të Komunitetit Evropian” (në vazhdim “Rregullorja Procedurale”).⁴⁷ Objektivi i parë i Rregullores Procedurale ishte të kodifikonte në një dokument ligjërish të detyrueshëm rregullat procedurale, të zhvilluara nga Gjykata e Evropiane e Drejtësisë nëpërmjet praktikës së saj gjyqësore dhe praktikës së Komisionit. Ndërsa, objektivi i dytë ishte forcimi i kontrollit të ndihmave Shtetërore duke hequr ato aspekte të sistemit ekzistues që rrezikonin funksionimin e duhur dhe efektivitetin e rregullave për ndihmën Shtetërore si dhe eficienten e sistemit procedural.

Reformat kryesore të ndërmarra në kuadër të kontrollit të ndihmës Shtetërore në Bashkimin Evropian janë: Plani i Veprimit për Ndihmën Shtetërore i vitit 2005 dhe Modernizimi i Ndihmës Shtetërore i vitit 2012. Këto reforma kanë sjellë ndyrshime të rëndësishme në legjislacionin dytësor të Bashkimit Evropian në lidhje me ndihmën Shtetërore. Analiza reformave të sipërpërmendura do të jetë pjesë e këtij kërkimi.

Aktualisht, legjislacioni dytësor në lidhje me ndihmën Shtetërore në Bashkimin Evropian përbëhet kryesisht nga: rregullat procedurale, rregulloret për përjashtimet në grup, rregullat horizontale, rregullat për sektorë specifike, transparenca e ndërmarrjeve publike,

⁴⁷ Council Regulation 1999/659/EC of 22 March 1999 laying down detailed rules for the application of Article 93 of the EC Treaty, OJ L 83/1, 27 March 1999. (Rregullore e Këshillit 1999/659/EC, 22 Mars 1999 për përcaktimin e rregullave të detajuara për zbatimin e nenit 93 të Traktatit të Komunitetit Evropian).

shërbimet ekonomike me interes të përgjithshëm. Më poshtë do të trajtohet kuadri ligjor dytësor në lidhje me ndihmën Shtetërore në Bashkimin Evropian i cili së bashku me nenet e Traktatit të Lisbonës të analizuara më sipër formojnë bazën ligjore të këtij kërkimi.

Rregullat procedurale përbëhen nga: Rregullore e Këshillit e vitit 2015 e cila parashikon rregulla të detajuara për zbatimin e nenit 108 TFBE,⁴⁸ e cila ndryshon Rregulloren Procedurale të vitit 1999. Rregullore e Komisionit në lidhje me format e njoftimit.⁴⁹ Rregullore e Komisionit në lidhje me llogaritjen e afateve dhe shqyrtimin e ankimeve si dhe mbrojtjen e informacionit konfidencial.⁵⁰ Kodi i praktikave të mira.⁵¹

Rregullat për përjashtimet në grup përbëhen nga: Rregullore e Komisionit e vitit 2014 e cila deklaron disa kategori të ndihmës të pajtueshme me tregun e brendshëm në zbatim të neneve 107 dhe 108 të Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Evropian⁵² si dhe nga Rregullore Zbatuese e vitit 2015 për zbatimin e neneve 107 dhe 108 të Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Evropian për disa kategori të ndihmës Shtetërore horizontale.⁵³

Ndihma horizontale zbatohet në aktivitetet ekonomike që përfshijnë disa sektorë (Jones & Sufrin, 2014:116). Komisioni ka miratuar një numër të konsiderueshëm komunikatash, njoftimesh, udhëzimesh, dhe drejtime orientuese që kanë të bëjnë me ndihmën horizontale. Të tilla janë: Rregullore e Komisionit e vitit 2013 për zbatimin e neneve 107 dhe 108 të Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Evropian në lidhje me ndihmën *de minimis*;⁵⁴ komunikatë nga Komisioni në lidhje me kriteret e analizës së

⁴⁸ OJ L 248, 24.9.2015, fq. 9.

⁴⁹ OJ L 325, 10.12.2015, fq. 1–180.

⁵⁰ OJ L 308, 24.11.2009.

⁵¹ OJ C 136, 16.06.2009, fq. 13-20.

⁵² OJ 2014 L187/1 fq. 20-30.

⁵³ OJ L 142, 14.05.1998, fq. 1.

⁵⁴ OJ L 352, 24.12.2013, fq. 1-8.

pajtueshmërisë me tregun e brendshëm të ndihmës Shtetërore për të nxitur zbatimin e projekteve të rëndësishme me interes të përbashkët evropian;⁵⁵ Komunikatë nga Komisioni në lidhje me kriteret për analizën e pajtueshmërisë së ndihmës shtetërore për punësimin e punonjësve në vështirësi dhe me aftësi të kufizuara subjekt e njoftimit individual;⁵⁶ Komunikatë nga Komisioni në lidhje me kriteret për analizën e pajtueshmërisë së ndihmës Shtetërore për trajnim, subjekt e njoftimit individual;⁵⁷ Drejtim Orientues i ndihmës Shtetërore për kërkim dhe zhvillim dhe inovacion;⁵⁸ Udhëzim për ndihmën Shtetërore për mbrojtjen e mjedisit dhe të energjisë 2014-2020;⁵⁹ Udhëzim për ndihmën Shtetërore për shpëtimin dhe ristrukturimin e ndërmarrjeve jo-financiare në vështirësi.⁶⁰

Ndërsa, ndihma sektorale është ndihma që zbatohet në aktivitete ekonomike në një sektor të caktuar të ekonomisë ose industrisë (Jones & Sufrin, 2014:118). Ashtu si për ndihmën horizontale Komisioni ka miratuar një numër të konsiderueshëm Komunikatash, Njoftimesh, Udhëzimesh, dhe Drejtime Orientuese që kanë të bëjnë me ndihmën sektorale. Të tilla janë: Komunikatë nga Komisioni për ndihmën në lidhje me filmat ose punime të tjera audiovizuale;⁶¹ udhëzim për zbatimin e rregullave të ndihmës shtetërore në lidhje me vendosjen e rrjeteve të transmetimit;⁶² komunikatë nga Komisioni për zbatimin e rregullave në lidhje me ndihmën Shtetërore për shërbimin publik të transmetimit;⁶³ drejtim orientues

⁵⁵ OJ C 188, 20.06.2014, fq.4.

⁵⁶ OJ C 188, 11.8.2009, fq.6.

⁵⁷ OJ C 188, 11.8.2009, fq.1.

⁵⁸ OJ C 198 27.06.2014, fq. 1.

⁵⁹ OJ C19, 22.01.2014, fq. 4-34.

⁶⁰ OJ C 249, 31.07.2014, fq.1.

⁶¹ OJ C25, 26.01.2013, fq.1.

⁶² OJ C25, 26.01.2013, fq.1

⁶³ OJ C257, 27.10. 2009 fq. 1-14.

në lidhje me ndihmën Shtetërore për ndërtimin e anijeve;⁶⁴ komunikatë nga Komisioni në lidhje me ndihmën Shtetërore për sektorin e çelikut;⁶⁵ udhëzim për ndihmën Shtetërore në lidhje me aeroportet dhe linjat ajrore;⁶⁶ komunikatë nga Komisioni në lidhje me ndihmën Shtetërore për shoqëritë e menaxhimit të anijeve;⁶⁷ udhëzim në lidhje me ndihmën Shtetërore për transportin detar;⁶⁸ rregullore e Parlamentit Evropian dhe Këshillit në lidhje me ndihmën Shtetërore për transportin rrugor të pasagjerëve;⁶⁹ udhëzim për ndihmën Shtetërore në lidhje me ndërmarrjet në sektorin e transportit hekurudhor.⁷⁰

Kuadri ligjor në lidhje me transparencën e ndërmarrjeve publike përbëhet nga: direktiva e Komisionit mbi transparencën e marrëdhënieve financiare midis Shteteve Anëtare dhe ndërmarrjet publike, si dhe në transparencën financiare në kuadër të ndërmarrjeve të caktuara.⁷¹ Së fundmi, kuadri ligjor në lidhje me shërbimet ekonomike me interes të përgjithshëm përbëhet nga: Komunikatë e Komisionit për zbatimin e rregullave të ndihmës Shtetërore të Bashkimit Evropian për kompensimin e dhënë për ofrimin e shërbimeve me interes të përgjithshëm ekonomik⁷²; vendim i Komisionit për zbatimin e nenit 106 (2) të Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Evropian për ndihmën shtetërore në formën e kompensimit të shërbimeve publike dhënë ndërmarrjeve të caktuara të ngarkuara, me ofrimin e shërbimeve me interes të përgjithshëm ekonomik⁷³ si dhe

⁶⁴ OJ C364, 14.12.2011, fq.9-13.

⁶⁵ OJ C70, 19.3.2002, fq 21.

⁶⁶ OJ C 99, 4.4.2014, fq. 3.

⁶⁷ OJ C132, 11.6.2009, fq. 6

⁶⁸ OJ C013, 17.01.2004, fq. 3.

⁶⁹ OJ L 315, 3.12.2007, fq. 1

⁷⁰ OJ C92, 29.03.2014, fq. 1-21

⁷¹ OJ L 318, 17.11.2006, fq 17 – 25.

⁷² OJ C8, 11.01.2012, fq. 4-14.

⁷³ OJ L7, 11.01.2012, fq. 3-10.

komunikatë nga Komisioni për ndihmën Shtetërore në formën e kompesimit të shërbimit publik.⁷⁴

2.4. Përkufizimi i ndihmës

Neni 107(1) Traktati për Funkcionimin Bashkimit Evropian (TFBE) nuk përmban një përkufizim të ndihmës, por ky nen përcakton elementet përbërës të një mase në formën e ndihmës për t'u konsideruar e papajtueshme me tregun e brendshëm. Sipas këtij neni “*çdo ndihmë e dhënë nga Shteti Anëtar ose nëpërmjet burimeve Shtetërore në çfarëdolloj forme që shtrembëron ose rrezikon të shtrembërojë konkurrencën duke favorizuar ndërmarrje të caktuara ose prodhime të caktuara është e papajtueshme me tregun e brendshëm*”. Gjykata e Drejtësisë dhe Komisioni Evropian kanë bërë një interpretim të zgjeruar të konceptit të ndihmës Shtetërore. Përkufizimi i ndihmës ka qenë një problem për Gjykatën e cili është trajtuar, në çështjen *Gezamenlijke Steenkolenmijnen in Limburg kundër Autoritetit të Lartë* (aktualisht Komisioni Evropian).⁷⁵ Faktet e çështjes janë si më poshtë: Republika Federale Gjermane kishte financuar nga fondet publike një bonus për minatorët. Gezamenlijke Steenkolenmijnen in Limburg një shoqatë ndërmarrjesh kundërshtoi vendimin e sipërpërmendur bazuar në arsyetimin se Republika Federale Gjermane nuk kishte respektuar detyrimet e Traktatit të Themelimit të Komunitetit të Qymyrit dhe Çelikut dhe pikërisht nenin 4 i cili parashikonte që: *do të konsiderohen të papajtueshme me tregun e përbashkët të qymyrit dhe çelikut dhe do të shfuqizohen dhe ndalohen (c) subvencionet*

⁷⁴ OJ C8, 11.01.2012, fq. 15-22.

⁷⁵ Çështje 30/59 *Gezamenlijke Steenkolenmijnen in Limburg v. High Authority* (*Gezamenlijke Steenkolenmijnen in Limburg k Autoritetit të Lartë*) [1961] ECR 1.

dhe ndihmat e dhëna nga Shtetet..... Sipas Gezamenlijke Steenkolenmijnen in Limburg reduktimi artificial i çmimit të qymyrit nëpërmjet ndihmës Shtetërore i vendoste ndërmarrjet hollandeze të cilat nuk përfitonin ndihma të tilla në një pozicion të vështirë. Për më tepër, prezantimi i bonusit për minatorët në Gjermani kishte shkaktuar emigrimin e minatorëve nga Holanda në Gjermani.

Në këtë çështje Gjykata ka pranuar se në Traktatin e krijimit të Komunitetit të Qymyrit dhe Çelikut nuk kishte një përkufizim të shprehur në lidhje me nocionin e subvencionit ose të ndihmës.⁷⁶ Në çështjen e sipërpërmendur Gjykata ka deklaruar:

*“koncepti i ndihmës është më i gjere se koncepti i subvencionit sepse ai përfshin jo vetëm përfitime pozitive të tilla si vetë subvencionet, por dhe ndërhyrje të cilat, në forma të ndryshme, zvogëlojnë detyrimet të cilat normalisht përfshihen në buxhetin e një ndërmarrje dhe të cilat pa qenë subvencione në një kuptim të ngushtë të fjalës, janë të njëjta në karakter dhe kanë të njëjtin efekt.”*⁷⁷

Nga sa më sipër Gjykata e Drejtësisë përcakton se koncepti i ndihmës Shtetërore dhe i subvencioneve nuk është i njëjtë, por ndihma Shtetërore ka një kuptim më të gjere se subvencionet.⁷⁸ Në të njëjtin vendim Gjykata i përkufizon subvencionet si pagesa në para ose natyrë për të ndihmuar një ndërmarrje, të ndryshme nga pagesat e blerësit ose konsumatorit për mallrat që ajo prodhon.⁷⁹ Përkufizimi i ndihmës i dhënë nga Gjykata e Drejtësisë në vitin 1961 mbetet i vlefshëm dhe sot dhe vazhdon të përsëritet nga Gjykata dhe Komisioni Evropian (Lopez, 2015: 70).

⁷⁶ Po aty.

⁷⁷ Po aty

⁷⁸ Çështje 30/59 *Gezamenlijke Steenkolenmijnen in Limburg v. High Authority (Gezamenlijke Steenkolenmijnen in Limburg k Autoritetit të Lartë)* [1961] ECR 1, dhe gjithashtu çështje C-200/97 [1998] ECR I-7907, para 34.

⁷⁹ Po aty.

2.5. Elementët e nenit 107(1) TFBE

2.5.1. Përzgjedhja

Kushti i parë për përcaktimin e ndihmës Shtetërore si të papajtueshme me tregun e brendshëm është ai i përzgjedhjes. Në bazë të nenit 107(1) TFBE janë të papajtueshme me tregun e brendshëm masat ndihmë Shtetërore që shtrembërojnë konkurrencën “*duke favorizuar ndërmarrje të caktuara ose prodhimin e mallrave të caktuara*”.⁸⁰ Ky kusht vjen nga fjala “*të caktuara*” që siç u përmend më sipër gjendet në nenin 107(1) TFBE. Në vendimet e Komisionit në lidhje me ndihmat Shtetërore ky kusht trajtohet i pari edhe përpara se të vlerësohet nëse janë përfshirë burimet Shtetërore ose efektet në tregti (Bartosch, 2010:730). Koncepti i përzgjedhjes përbëhet nga dy komponentë i pari është ai i përzgjedhjes gjeografike dhe i dyti ai i përzgjedhjes materiale.

Përzgjedhja gjeografike do të thotë që një mase është përzgjedhëse nëse ndërmarrjet në një pjesë të caktuar të territorit të Shtetit Anëtar trajtohen ndryshe për shembull në mënyrë më favorizuese se pjesa e mbetur në pjesën tjetër të territorit. Ndërsa me përzgjedhje materiale do të kuptojmë të gjitha format e tjera të trajtimit të pabarabartë të ndërmarrjeve nëpërmjet ndërhyrjes së Shtetit Anëtar (Bartosch, 2010:735). Koncepti i përzgjedhjes gjeografike ose territoriale është analizuar nga Gjykata e Drejtësisë në një seri çështjesh dhe veçanërisht në çështjen *Portugalia kundër Komisionit*.⁸¹ Në këtë çështje Gjykata e Drejtësisë ekzaminoi një ulje të taksës për të gjithë personat fizike dhe juridike

⁸⁰ Neni 107 (1) Treaty on the Functioning of the European Union (TFEU) (Traktati për Funkcionimin e Bashkimit Evropian) (TFBE) [2012] OJ C326/47.

⁸¹ Çështje C-88/03 *Portugaly v Commission (Azores) (Portugalia k. Komisionit)* [2006] ECR I-7115.

në Azores një rajon i Portugalisë. Ekzistojnë disa kushte të cilat përcaktojnë nëse një masë e dhënë është gjeografikisht përzgjedhëse ose jo. *Së pari*, në qoftë se pushteti qendror i një Shteti Anëtar është kompetent për të vendosur në lidhje me një masë të caktuar dhe më pas vendos të aplikojë këtë masë vetëm në një zonë gjeografike të caktuar që përbën vetëm një pjesë të territorit të tij, atëherë kjo masë do të jetë *per se* gjeografikisht përzgjedhëse (Bartosch, 2011:176). *Së dyti*, në qoftë se një institucion publik, nën nivelin e pushtetit qendror për shembull një autoritet lokal ose rajonal, ka pushtetin për të miratuar një masë, fakti që ky institucion krijon një masë e cila është më favorizuese se një masë tjetër, nuk do ta bënte këtë masë gjeografikisht përzgjedhëse.⁸² *Së treti*, nëse pushteti qendror i ka dhënë një shkallë të caktuar autonomie kompetencash një rajoni i cili e përdor këtë autonomi, atëherë masa nën ekzaminim do të konsiderohet gjeografikisht përzgjedhëse vetëm nëse kompetenca e institucionit është institucionalisht, proceduralisht dhe financiarisht autonome.⁸³ Gjykata e Drejtësisë ka interpretuar tri komponentët e autonomisë, *së pari* në lidhje me autonominë institucionale mjafton që institucionet e rajonit të gëzojnë një status të veçantë politik dhe administrativ pa ndonjë kërkesë në lidhje me shkallën e autonomisë.⁸⁴ *Së dyti*, në lidhje me autonominë procedurale Gjykata kërkon vetëm që pushteti qendror të mos këtë mundësinë të ndikojë përmbajtjen e pushteteve të pavarura (Bartosch, 2011:178). *Së treti*, autonomia financiare nuk rrezikohet vetëm nga ekzistenca e një transferte financiare apo një sistemi solidariteti nëpërmjet të cilit pushteti qendror balancon humbjet e

⁸² Po aty fq. 177.

⁸³ Çështje C-88/03 *Portugaly v Commission (Azores) (Portugalia k. Komisionit)* [2006] ECR I-7115, para. 64.

⁸⁴ Çështje të bashkuara C-428, 434/06, *UGT Rioja et al* [2008] ECR para 50 e në vazhdim.

rajonit autonom. Për më tepër Gjykata kërkon ekzistencën e një lidhje shkakësore ose lidhje ndërmjet avantazheve të dhëna dhe transfertave kompesuese nga administrata qendrore.⁸⁵

Ndryshe nga nocioni i përzgjedhjes gjeografike, nocioni i përzgjedhjes materiale nuk është i qartë. Praktika gjyqësore bën dallimin midis masave përzgjedhëse të cilat janë të papajtueshme me tregun e brendshëm, në qoftë se plotësojnë dhe tri kushtet e tjera të cilat do të analizohen më poshtë, dhe si të tilla duhet t'i njoftohen Komisionit dhe masave të përgjithshme të cilat janë jashtë objektit të nenit 107(1) TFBE dhe nuk klasifikohen si ndihma Shtetërore.⁸⁶

Shumë çështje në lidhje me kufirin jo të qartë ndërmjet masave ekonomike të përgjithshme dhe ndihmës Shtetërore i përkasin taksimit (Jones & Sufrin, 2014:28). Bazuar në Traktatin për Funksionimin e Bashkimit Evropian Shtetet Anëtare ruajnë sovranitetin e tyre në lidhje me përcaktimin e politikave mbi taksat, një fushë në të cilën Komisioni nuk ka kompetenca. Megjithatë, përmes rregullimit të ndihmës Shtetërore Komisioni synon në harmonizimin e sistemeve të taksave, në mënyrë që asnjë ndihmë të mos kalojë nëpërmjet këtyre kanaleve në një Shtet Anëtar, e cila do të shtrembëronte konkurrencën në tregun e brendshëm (Lopez, 2010:820).

Një ndër çështjet më përcaktuese në lidhje me kriterin e përzgjedhjes materiale është *Adria-Wien*.⁸⁷ Gjykatës së Drejtësisë iu kërkua të jepte mendimin e saj nëse ligji austriak, i cili parashikonte një ulje në taksat e energjisë për ndërmarrje aktive në prodhimin e mallrave dhe jo për ndërmarrje në prodhimin e shërbimeve, krijonte një

⁸⁵ Po aty, para 135 e në vazhdim.

⁸⁶ Çështje C-143/99 *Adria-Wien Pipeline GmbH v. Finanzlandesdirektion für Karnten* [2001] ECR I-8365, para 35.

⁸⁷ Çështje C-143/99 *Adria-Wien Pipeline GmbH v. Finanzlandesdirektion für Karnten* [2001] ECR I-8365.

avantazh përzgjedhës. Në këtë çështje Gjykata krijoi një test për përcaktimin e natyrës përzgjedhëse të një mase. Hapi i parë, sipas të cilit masa Shtetërore në fjalë u konsiderua materiale ishte kërkimi nëse “nën një regjim statutor të veçantë, një masa Shtetërore është e tillë që të favorizojë ndërmarrje të caktuara ose prodhimin e mallrave të caktuara sipas kuptimit të nenit 92 (1) të Traktatit (tani neni 107 (1) TFBE) në krahasim me ndërmarrje të tjera të cilat janë në kushte ligjore dhe faktike të krahasueshme nën dritën e objektivit të ndjekur nga masa në fjalë.”⁸⁸ Pas këtij hapi Gjykata vazhdon duke pyetur nëse avantazhi i dhënë nga masa “justikohet nga natyra ose nga skema e përgjithshme e sistemit të cilës i përket masa/skema që po shqyrtohet”.⁸⁹ Gjykata vendosi, në lidhje me këtë çështje, që “kriteri i aplikuar nga legjislacioni kombëtar në shqyrtim”, nuk justikohet nga natyra ose skema e përgjithshme e atij legjislacioni, kështu që e kategorizoi atë si ndihmë në kuptim të nenit 92 (1) të Traktatit (tani Neni 107 (1) TFBE).⁹⁰ Në testin e sipërpërmendur në lidhje me kriterin e përzgjedhshmërisë, për Gjykatën nuk kishte rëndësi krahasimi i situatës së përfituesit përpara dhe pas ligjit përkatës, i cili kishte dhënë ndihmën, krahasimi u bë vetëm ndërmjet ndërmarrjeve në një situatë ligjore dhe faktike të ngjashme.⁹¹

2.5.2. Avantazhi i dhënë nga Shteti nëpërmjet ndihmës

Kriteri tjetër për të përcaktuar nëse një masë është ndihmë e papajtueshme me tregun e brendshëm, sipas nenit 107(1) TFBE është ai “i favorizimit të ndërmarrjeve të

⁸⁸ Po aty, para 41.

⁸⁹ Po aty, para 42.

⁹⁰ Po aty, para 53.

⁹¹ Po aty, para. 41.

caktuara” fjala kyçe në këtë rast është “*favorizim*”.⁹² Koncepti i avantazhit është shumë i gjerë (Jones & Alison, 2014:24). Ndërhyrja shtetërore nëpërmjet subvencioneve ose masave ekuivalente krijon një avantazh kur ndërmarrjet marrin përfitime të cilat nuk do t’i kishin marrë në kushte normale tregu⁹³ dhe që përmirësojnë situatën e tyre financiare ose ekonomike ose zvogëlojnë detyrime të cilat do të ishin krijuar.⁹⁴

Rregullat e ndihmës Shtetërore do të zbatohen vetëm në rast se përfituesi është një “ndërmarrje”. Nuk ka një përkufizim të termit “ndërmarrje” në TFBE, por tashmë sipas praktikës gjyqësore, “ai përfshin çdo entitet të angazhuar në një aktivitet ekonomik, pavarësisht nga statusi i tij ligjor dhe mënyra e financimit”.⁹⁵ Ndërmarrjet mund të jenë publike ose private. Aktiviteti ekonomik përfshin shitjen e mallrave dhe furnizimin e shërbimeve, pavarësisht nëse qëllimi i një ndërmarrje është jofitimprurës ose nëse është krijuar për qëllime joekonomike (Jones & Sufrin, 2014:127). Çështja *Jobcentre*⁹⁶ përbën një rast nga praktika gjyqësore të një ndërmarrje jofitimprurëse, ku një shoqëri punësimi u konsiderua ndërmarrje sipas kuptimit të nenit 107 TFBE.

Një entitet, publik ose privat i cili kryen aktivitet jo-ekonomik, nuk mund të jetë objekt i aplikimit të rregullave të ndihmës Shtetërore. Këto aktivitete përfshijnë ato aktivitete që janë në kompetencën ekskluzive të shtetit dhe të cilat nuk mund të ofrohen nga organizma jo-publike. Zakonisht këto aktivitete kanë të bëjnë me forcat e armatosura ose

⁹² Neni 107(1) Treaty on the Functioning of the European Union (TFEU) (Traktati për Funkcionimin e Bashkimit Evropian) (TFBE) [2012] OJ C326/47.

⁹³ Çështje C-39/94 *SFEI & Linde* 98/00.

⁹⁴ Draft Commission Notice on the notion of State aid pursuant to Article 107(1) TFEU, (Draft Njoftimi i Komisionit për Nocionin e Ndhmës Shtetërore sipas nenit 107(1) TFBE), 17 January (Janar) 2014, para 67-75.

⁹⁵ Çështje C 41/90 *Honer v. Macrotron*(*Honer v. Macrotron*) [1991] ECR I-1979.

⁹⁶ Çështje C-55/96 *Job Centre coop* [1997] ECR I-7119.

policinë, sistemin arsimor, shërbimet doganore, administrimin e drejtësisë të cilat financohen nga burimet shtetërore.

2.5.2.1. Parimi i investitorit privat

Parimi i investitorit privat është shumë i rëndësishëm për të vendosur nëse një mase i jep një përfitim ose avantazh një përfituesi dhe si rezultat nëse masa do të përbëjë ndihmë Shtetërore. Parimi i investitorit privat u zhvillua nga Komisioni dhe më pas u mbështet nga Këshilli (Abbamonte, 1996:268). Ai aplikohet në formën e një testi me qëllim për të arritur në përfundimin nëse një transaksion ndërmjet shtetit dhe një ndërmarrjeje përfshin ndihmë Shtetërore. Sipas testit të zhvilluar nga jurisprudenca, shteti po i jep ndërmarrjes ndihmë Shtetërore kur ndërmarrja nuk do të kishte qenë në gjendje të merrte të njejtin përfitim nga tregu, në kushte tregu normale.

Testi i investitorit privat është aplikuar nga Gjykata në një numër të madh çështjesh. Testi është përfshirë dhe në disa dokumente të Komisionit të tilla si Njoftimi mbi Bashkëpunimin ndërmjet Gjykatave Kombëtare dhe Komisionit. Në këtë Njoftim përcaktohet se investimet nga fondet publike do të konsiderohen ndihmë Shtetërore në rast se janë bërë në kushte në cilat një investitor privat nuk do të kishte ndihmuar.⁹⁷

Komisioni dhe Gjykata nuk duhet të përdorin testin e investitorit privat nëse një investitor privat merr pjesë në një transaksion së bashku me investitorin publik në të njëjtat kushte dhe pjesëmarrja e investitorit privat duhet të këtë një kuptim të vërtetë ekonomik.

⁹⁷ Notice on cooperation between national courts and the Commission in State aid field (Njoftim për bashkëpunim ndërmjet gjykatave kombëtare dhe Komisionit në fushën e ndihmës Shtetërore) [1995] OJ C312/8, para.7.

Në rast se plotësohen këto kushte, atëherë transaksioni është në përputhje me kushtet e tregut.⁹⁸ Gjykatat Evropiane kanë pranuar që investitori privat me të cilin bëhet krahasimi nuk duhet të jetë i interesuar vetëm në fitimin afatshkurtër. Ato, gjithashtu, duhet në çështjet përkatëse të konsiderojnë fitimin afatgjatë.⁹⁹

2.5.3. Ndihma e dhënë nga Shteti ose nëpërmjet burimeve Shtetërore

Elementi i tretë i nenit 107 (1) TFBE kërkon që ndihma të jetë dhënë nga Shteti Anëtar ose nëpërmjet burimeve Shtetërore. Duke qene se në Traktat përdoret lidhëza veçuese “ose” kanë ekzistuar debate nëse të dy kushtet (nga shteti dhe nëpërmjet burimeve shtetërore) ishin kritere alternative apo duhet të aplikoheshin të dy së bashku. Sipas praktikës së hershme gjyqësore¹⁰⁰ këto dy kushte nuk janë konsideruar së bashku, për Gjykatën mjaftonte të provonte që ekzistonte një avantazh i dhënë nga Shtetet Anëtare për një ndërmarrje përkundrejt konkurrentëve të tij. Ideja që elementi “ndihmë e dhënë nga Shteti” dhe elementi “nëpërmjet burimeve shtetërore” duhet të trajtohen të ndarë, tashmë konsiderohet e gabuar, sepse që një masë të kualifikohet sipas nenit 107 (1) duhet të plotësohen të dy kushtet (Winter, 2004: 480). Në çështjen *PreussenElektra*¹⁰¹ Gjykata përcakton se “detyrimi i vendosur mbi ndërmarrjet private të furnizimit me energji elektrike për të blerë energji të prodhuar nga burime të rinovueshme me një çmim minimal fiks nuk

⁹⁸ Draft Commission Notice on the notion of State aid pursuant to Article 107(1) TFEU, (Draft Njoftimi i Komisionit për Nocionin e Ndihmës Shtetërore sipas nenit 107(1) TFBE), 17 January (Janar) 2014, para. 89.

⁹⁹ Çështje C-305/89, *Italy v. Commission (Italia k Komisionit)* (Alfa Romeo Nr. 1) [1991] ECR I-1603 para. 20.

¹⁰⁰ Për shembull çështja C-57/86 *Greece v. Commission (Greqia k Komisionit)* [1988] ECR 2855 para 11-13.

¹⁰¹ Çështje C-379/98 *PreussenElektra* [2001] ECR I-2099.

përfshin ndonjë transferim direkt ose indirekt të burimeve shtetërore”.¹⁰² Fjalët transferim direkt ose indirekt i burimeve shtetërore lidhen me fjalët nëpërmjet shtetit ose burimeve shtetërore.

Një mase nuk përbën ndihmë Shtetërore në qoftë se ajo nuk i atribuohet Shtetit.¹⁰³ Autoritetet publike duhet të jenë të përfshira në shpërndarjen e burimeve Shtetërore (Jones & Sufrin, 2014:98). Kriteri i atribuimit të masave tek Shteti u krijua nga Gjykata në çështjen *Stardust Marine*, e cila kishte të bënte me ndihmë për një shoqëri barkash të dhënë nga një bankë në pronësi publike.¹⁰⁴ Në këtë çështje Gjykata krijoi një test për të vlerësuar nëse ndihma Shtetërore i atribuohet shtetit. Në kundërshtim me mendimin e Komisionit, sipas të cilit një atribuim i tillë vinte vetëm nga fakti që masa në fjalë ishte marrë nga bankat të cilat kontrolloheshin nga Shteti,¹⁰⁵ ajo shtoi që “është gjithashtu e nevojshme të analizohet nëse autoritet publike do të konsiderohen në një mënyrë ose në një tjetër të përfshira në aprovimin e këtyre masave”.¹⁰⁶ Sipas Gjykatës atribuimi i masës tek Shteti do të nënkuptohej dhe nga faktorë të cilat vijnë nga rrethanat e çështjes dhe kushtet në të cilat është vendosur një mase. Disa nga indiciet e Gjykatës përfshijnë: nivelin e integritit të ndërmarrjes në strukturat e administratës publike, natyrën e aktiviteteve të ndërmarrjes, statusin ligjor të ndërmarrjes, intensitetin e kontrollit të ushtruar nga autoritetet publike në menaxhimin e një ndërmarrje.¹⁰⁷ Kjo formulë do të ndihmojë gjykatat për të vendosur në lidhje me çështjet ku ndihma disbursohet nga ndërmarrjet publike.

¹⁰² Po aty, para. 59.

¹⁰³ Draft Commission Notice on the notion of State aid pursuant to Article 107(1) TFEU, (Draft Njoftimi i Komisionit për Nocionin e Ndhmës Shtetërore sipas nenit 107(1) TFEU), 17 January (Janar) 2014, para. 62.

¹⁰⁴ Çështje 482/99 *France v. Commission (Franca k Komisionit)* [2002] ECR I-4397.

¹⁰⁵ Po aty, para. 51.

¹⁰⁶ Po aty, para. 52.

¹⁰⁷ Po aty, para.56.

2.5.4. Shtrembërimi i konkurrencës dhe efekti në tregti

Elementi i fundit i nenit 107(1) TFBE ka të bëjë me efektet e ndihmës në tregun e brendshëm. Efekti i parë që duhet të ketë ndihma është që masa duhet të shtrembërojë konkurrencën dhe efekti i dytë është që masa duhet të ndikojë në tregtinë ndërmjet Shteteve Anëtare. Në rast se ndodhin të dy këto efekte atëherë masa do të konsiderohet e papajtueshme me tregun e brendshëm. Problemi i shtrembërimit të konkurrencës dhe efektit në tregtinë ndërmjet Shteteve Anëtare janë të lidhur dhe Komisioni dhe Gjykatat Evropiane zakonisht i trajtojnë ato së bashku.¹⁰⁸ Sipas Komisionit në draftin mbi Nocionin e Ndhmës Shtetërore: “Këto janë dy elementë të ndryshëm dhe të nevojshëm për nocionin e ndihmës Shtetërore”.

Testi për përcaktimin kriterit të shtrembërimit të konkurrencës, përmendur në nenin 107 (1) TFBE u krijua nga Gjykata në çështjen *Philip Morris*.¹⁰⁹ Sipas Gjykatës, në çështjen e sipërpërmendur konkurrenca shtrembërohet në rast se ndihma ka fuqizuar pozicionin e ndërmarrjes në treg në krahasim me ndërmarrjet e tjera me të cilat konkurron.¹¹⁰ Komisioni duhet të japë arsyet për shtrembërimin ose kërcënimin për shtrembërim të konkurrencës duke qene se sipas nenit 296 TFBE ekziston detyrimi për të arsyetuar. Megjithatë, Gjykata nuk kërkon një analize të tregut përkatës, ashtu siç nevojitet në rast se aplikohen nenet 101 dhe 102 TFBE.¹¹¹ Është e mjaftueshme që masa të jetë në

¹⁰⁸ Çështjet T-298/97, etc. *Mauro Alzetta v. Commission (Mauro Alzetta k. Komisionit)* [2000] ECR II-2319.

¹⁰⁹ Çështje 730/79 *Philip Morris v. Commission (Philip Morris k. Komisionit)* [1980] ECR 2671.

¹¹⁰ Po aty, para.11.

¹¹¹ Po aty, para. 11.

gjendje të kërcënoje shtrembërimin e konkurrencës,¹¹² kështu nuk është e nevojshme të provohen efektet aktuale shtrembëruese në konkurrencë. Pika e referimit për gjetjen e shtrembërimit të konkurrencës është gjendja konkurruese në treg përpara adoptimit të masës dhe nëse ajo ka sjellë përmirësime më pas.

Në çështjen e sipërpërmendur *Philip Morris*¹¹³ Gjykata ka analizuar shtrembërimin e konkurrencës dhe efektet në tregtinë ndërmjet Shteteve Anëtare. Si pasojë, kjo praktikë e Gjykatës mund të ndikojë në faktin që ky kusht të mos konsiderohet shumë i rëndësishëm. Ndikimi në tregtinë ndërmjet Shteteve Anëtare ka rëndësi për verifikimin e juridiksionit të Komisionit dhe të Gjykatës mbi autoritetet kombëtare (Bacon, 2009:97). Ndalimi i parashikuar nga e drejta Evropiane në lidhje me ndihmën Shtetërore ka të bëjë vetëm me ndihmën e cila ka një ndikim në tregtinë ndërmjet Shteteve Anëtare duke ndikuar kështu në ekonominë kombëtare të Shteteve të tjera Anëtare (Baudenbacher, 1997:25).

Ndihma për një ndërmarrje të angazhuar në tregtinë ndërmjet Shteteve Anëtare e cila shtrembëron pozicionin e saj konkurrues në lidhje me konkurrentët e saj normalisht do të ndikojë në tregti.¹¹⁴ Gjithashtu, mund të ketë ndikim në tregti edhe në rast se ndihma i është dhënë një ndërmarrje e cila nuk është e angazhuar në tregtinë ndërmjet Shteteve Anëtare¹¹⁵ dhe në rastet kur një pjesë e madhe e prodhimit të një ndërmarrje eksportohet jashtë BE-se.¹¹⁶ Gjithsesi, nuk është e nevojshme të provohen efektet aktuale të ndihmës në tregtinë ndërmjet Shteteve. Në çështjen *Altmark* Gjykata vendosi që kishte ndikim në tregtinë në Komunitet edhe pse ndihma u ishte dhënë shoqërive të cilat vepronin në një

¹¹² Po aty, para. 12

¹¹³ Po aty para. 13.

¹¹⁴ Çështje C-75/97, *Belgium v. Commission* (Belgjika k. Komisionit) [1999] ECR I-3671, para. 5.

¹¹⁵ Çështje C-102/87, *France v. Commission* (Franca k. Komisionit) [1998] ECR 4067, para. 19.

¹¹⁶ Çështje C-142/87, *Belgium v. Commission* (Belgjika k. Komisionit) [1990] ECR I-959.

Shtet Anëtar,¹¹⁷ sepse ndërmarrjet në Shtetet e tjera Anëtare, që vepronin në të njejtin lloj biznesi, nuk do të ishin në gjendje të vepronin lehtësisht në atë treg.¹¹⁸

Ky kusht, nuk mund të aplikohet nëse efekti i ndihmës është kombëtar dhe nuk ka ndikim në tregtinë ndërmjet Shteteve Anëtare. Në draftin për Njoftimin mbi nocionin e ndihmës Shtetërore, Komisioni ka përcaktuar karakteristikat e përbashkëta të rasteve në të cilat aktivitet kanë patur një ndikim lokal dhe nuk kanë krijuar ndonjë efekt për tregtinë ndërmjet Shteteve Anëtare.¹¹⁹ Së fundmi, sipas praktikës gjyqësore ekzistenca e një shume të vogël ndihme, ose përmasat e vogla të ndërmarrjeve, të cilat marrin ndihmë nuk përjashton *ex ante* mundësinë e ndikimit të tregtisë ndërmjet Shteteve Anëtare, ose mundësinë e shtrembërimit të konkurrencës.

2.6. Neni 107 (2) TFBE – ndihmë Shtetërore e lejueshme

Tre nënparagrafet e nenit 107(2) TFBE përmbajnë tre kategori të masave të ndihmës, të cilat konsiderohen automatikisht të pajtueshme me tregun e brendshëm, në rast se respektohen kushtet parashikuara në këtë nen për secilën prej tyre. Ndihma e cila pretendohet të kategorizohet sipas nenit të sipërpërmendur duhet t'i njoftohet Komisionit por kompetenca e Komisionit në këtë rast është e kufizuar. Ai mund të vendosë vetëm nëse ndihma klasifikohet sipas kategorive të nenit 107(2) TFBE.

¹¹⁷ Çështje C-280/00 *Altmark Trans v Nahverkehrsgesellschaft Altmark GmbH* [2003] ECR-I-7747, para 78.

¹¹⁸ Çështje 730/79 *Philip Morris v. Commission (Philip Morris k Komisionit)* [1980] ECR 2671, para 11 dhe 12.

¹¹⁹ Draft Commission Notice on the notion of State aid pursuant to Article 107(1) TFEU, (Draft Njoftimi i Komisionit për Nocionin e Ndihmës Shtetërore sipas nenit 107(1) TFBE), 17 January (Janar) 2014, para. 196. Shiko paragrafin 197 për një listë shembujsh.

Ndihma e cila ka një karakter social konsiderohet automatikisht e pajtueshme me tregun e brendshëm, nënparagrafi (a) neni 107(2) TFBE.¹²⁰ Kjo dispozitë përjashton skema nëpërmjet të cilave Shteti i jep përfitime të drejtpërdrejta konsumatorëve individuale duke mos diskriminuar përsa i përket origjinës së shërbimeve ose prodhimeve.¹²¹ Kushti i parë që parashikon kjo dispozitë është që nga ndihma të përfitojnë konsumatorët individuale, që do të thotë se një ndihme e tillë është për përfitimin e një grupi konsumatorësh dhe për këtë arsye ka një efekt specifik (Baudenbacher, 1997:29). Së dyti, ndihma duhet të mosdiskriminojë në lidhje me origjinën e siguruesve të shërbimeve. “Me karakter social” do të kuptojmë që ndihma është disponueshme për konsumatorët në nevojë për shkak të disa karakteristikave të tilla si: mosha, sëmundje, pengesë ose varfëri (Jones dhe Sufrin, 2014:91).

Nënparagrafi i dytë i nenit 107 (2) TFBE parashikon që ndihma e dhënë në raste fatkeqësish natyrore do të konsiderohet e pajtueshme me tregun e brendshëm.¹²² Komisioni dhe Gjykata kanë bërë një interpretim të ngushtuar¹²³ të kuptimit të fatkeqësive natyrore. Kjo dispozite është përdorur kryesisht për produktet bujqësore të cilat janë dëmtuar nga fatkeqësitë natyrore. Një shpjegim i plotë gjendet në Udhëzimin mbi ndihmën Shtetërore në sektorin e bujqësisë dhe atë pyjor dhe zonat rurale.¹²⁴ Kështu bazuar në udhëzimin e

¹²⁰ Neni 107(2) (a) Treaty on the Functioning of the European Union (TFEU) (Traktati për Funkcionimin e Bashkimit Evropian) (TFBE) [2012] OJ C326/47, parashikon: “ndihma me karakter social e dhënë konsumatorëve individuale me kusht që kjo ndihmë të jetë dhënë pa diskriminim lidhur me origjinën e produkteve që prek”.

¹²¹ Çështje, *Ferries Golfo de Vizcaya* [2001] OJ L 89/28.

¹²² Neni 107(2) (b) Treaty on the Functioning of the European Union (TFEU) (Traktati për Funkcionimin e Bashkimit Evropian) (TFBE) [2012] OJ C326/47; parashikon: “ndihma për shlyerjen e dëmit të shkaktuar nga fatkeqësitë natyrore ose ngjarjet e jashtëzakonshme”.

¹²³ Çështje C-278/00 *Greece v. Commission (Greqia k Komisionit)* [2004] ECR I-3997, para. 4.

¹²⁴ Community Guidelines for State aid in the agriculture and forestry sector (Udhëzim i Komisionit për Ndihmën Shtetërore në Sektorin e Bujqësisë dhe atë Pyjor dhe ne Zonat Rurale), (2014) OJ C 204/1, para. 330.

sipërpërmendur mund të konsiderohen fatkeqësi natyrore tërmetet, ortehtë, përmbytjet, rrëshqitjet e dheut.¹²⁵ Pjesa e dytë e nenit 107(2) (b) i referohet ndihmës në raste të jashtëzakonshme. Në Udhëzimin e Komisionit për ndihmën Shtetërore në sektorin e bujqësisë dhe atë pyjor dhe zonat rurale shpjegohet se çfarë janë rastet e jashtëzakonshme: “Ngjarje të jashtëzakonshme të cilat janë pranuar dhe nga Komisioni përshijnë luftën, shqetësime të brendshme ose greva dhe me rezerva dhe në varësi të përhapjes aksidente nukleare të mëdha ose industriale dhe zjarre të cilat shkaktojnë humbje të përhapura.”

Neni 107(2) (b) është përdorur dhe si bazë ligjore në lidhje me kompensimet për humbjet që pësuan linjat ajrore evropiane nga sulmet terroriste të vitit 2001 në New York.¹²⁶ Në Komunikimin përkatës Komisioni pranoi se ndihmat do të justifikoheshin si kompensim për dëmin e pësuar nga linjat ajrore evropiane, për arsye të anulimit të fluturimeve për 4 ditë, gjatë periudhës 11 deri në 14 shtator 2001.¹²⁷ Megjithatë, në çështjen *Olympiaki Aeroporia Ypiresies*¹²⁸ (OAY) Gjykata pranoi se ndihma mund të jepej për kompensimin e dëmeve të shkaktuara përtej datave të sipërpërmendura. Kushti që aplikoi Gjykata në këtë rast ishte ekzistenca e një lidhje shkakësore ndërmjet sulmeve terroriste dhe humbjes së pësuar.¹²⁹ Tashmë ekziston një praktikë gjyqësore e konsoliduar e Gjykatës e cila i kërkon Shteteve Anëtare dhe Komisionit të provojnë që ekziston një lidhje direkte midis “fatkeqësisë ose ngjarjes së jashtëzakonshme dhe dëmit për t’u kompensuar” (Jones

¹²⁵ Po aty para. 330.

¹²⁶ Communication on the repercussions of the terrorist attacks in the United States on the air transport industry, (Komunikim në lidhje me pasojat e sulmeve terroriste në Shtetet e Bashkuara në industrinë e transportit ajror), COM (2001) 574.

¹²⁷ Po aty.

¹²⁸ Çështje T-268/06, *Olympiaki Aeroporia Ypiresies AE v. Commission (Olympiaki Aeroporia Ypiresies AE k. Komisionit)* [2008] ECR II-1091

¹²⁹ Po aty.

& Surfrin, 2014:96). Praktika gjyqësore nuk kërkon që ngjarja e jashtëzakonshme dhe dëmi të ndodhin në të njëjtën kohë në mënyrë që të aplikohet neni 107(2) (b) TFBE.

Nën-paragrafi i fundit i nenit 107(2) TFBE ¹³⁰ ka lidhje me ndihmën për kompensimin e rajoneve në Gjermani të cilat ishin prekur nga ndarja pas Luftës së Dytë Botërore. Gjykata ka bërë një interpretim të ngushtuar të kësaj dispozite. Ajo ka bërë të qartë se neni 107(2)(c) nuk duhet aplikuar për të kompensuar Gjermaninë për problemet pas bashkimit në mënyrë që të inkorporojë dhe landet ekonomiksht të pazhvilluara të ish Gjermanisë Lindore. Ky nen është hartuar për të trajtuar disavantazhet nga ndarja fizike e Gjermanisë në dy pjesë.¹³¹

2.7. Neni 107(3) TFBE – ndihmë Shtetërore që mund të lejohet

Përfashtimet e parashikuara në nenin 107(3) TFBE ndryshe nga ato të parashikuara në nenin 107 (2) nuk janë automatike, ato janë përfashtime diskrecionale. Kjo vjen nga fjala “mund” që përdoret në fjalinë e parë të nenit 107(3) TFBE. Kompetenca e Komisionit për të vendosur nëse një ndihmë e caktuar është e pajtueshme me tregun e brendshëm sipas kësaj dispozite i është dhënë Komisionit nga neni 108(3) TFBE. Komisioni fillimisht vendos nëse ndihma mund të kualifikohet sipas renditjes së bërë në nenin 107(3), (a), (b), (c) (d) ose në një kategori të shtuar nga Këshilli sipas nenit 107(3) (e). Së dyti, Komisioni

¹³⁰ Neni 107(2) (c) Treaty on the Functioning of the European Union (TFEU) (Traktati për Funkcionimin e Bashkimit Evropian) (TFBE) [2012] OJ C326/47, parashikon: “Ndihma e dhënë për ekonomitë e disa zonave në Republikën Federale Gjermane të prekuara nga ndarja e Gjermanisë, për sa kohë që kjo ndihmë kërkohej në mënyrë që kompensohet për disavantazhet ekonomike të shkaktuara nga ndarja”

¹³¹ Çështje C-156/98, *Germany v. Commission (Gjermania k. Komisionit)* (Landet e Reja) [1999] ECR I-6857.

vendos nëse ndihma është e pajtueshme me tregun e brendshëm. Përpara krizës financiare kategoria më e përdorur në nenin 107 (3) TFBE ishte paragrafi (c) i cili parashikon ndihmën për të lehtësuar zhvillimin e disa aktiviteteve ekonomike ose disa zonave ekonomike.

Neni 107(3) ndërmjet përjashtimeve diskrecionale përcakton ndihmën “për promovimin e zhvillimit ekonomik të rajoneve”.¹³² Ndhma rajonale mund të jepet në bazë të nenit 107(3) (a) nëse rajoni është përfshirë si zonë “a” në “hartën rajonale” të cilën e miraton Komisioni në lidhje me çdo Shtet Anëtar pas njoftimit nga ky i fundit. Hartat që aktualisht janë në fuqi do të jenë efektive për periudhën 1 Korrik 2014 deri në vitin 2020. Komisioni ka përcaktuar politikën në lidhje me ndihmën rajonale në Udhëzimin mbi Ndhmën Rajonale 2014-2020.¹³³ Ky nënparagraf gjen zbatim në lidhje me rajonet të cilat janë në një situatë “jo normale ekstreme” krahasuar me Bashkimin Evropian në tërësi dhe Komisioni duhet t’i kushtojë rëndësi ndikimit të ndihmës në Bashkimin Evropian.¹³⁴ Kjo u bë e qartë nga Gjykata në çështjen *Philip Morris*¹³⁵ ku kërkuesi argumentoi se fabrika e favorizuar, ku do të rritej prodhimi nga ndihma në shqyrtim, ndodhej në një zonë të Holandës me një papunësi më të lartë dhe me të ardhura për frymë më të ulët se pjesa tjetër e vendit. Komisioni theksoi se Holanda si shtet kishte nivelin më të ulët të papunësisë në Komunitet. Gjykata e Drejtësisë mbështeti përdorimin e Bashkimit Evropian si standart krahasimi nga Komisioni.

¹³² Neni 107 (3) (a) Treaty on the Functioning of the European Union (TFEU) (Traktati për Funkcionimin e Bashkimit Evropian) (TFBE) [2012] OJ C326/47, parashikon: “Ndhma për nxitjen dhe zhvillimin ekonomik të rajoneve ku standarti jetesës është i ulët në mënyrë jo normale, ku ka papunësi të theksuar dhe rajoneve të përmendura në nenin 349 duke mbajtur parasysh situatën e tyre strukturore, ekonomike dhe sociale.”

¹³³ 2014-2020 Regional Aid Guidelines (Udhëzim për ndihmën rajonale) 651/2014 of June (Qershor) 2014 [2014] OJ C 209/1.

¹³⁴ Çështje C-113/00, *Commission v. Spain* (Komisioni k. Spanjes) [2002] ECR I-7601, para. 65.

¹³⁵ Çështje 730/79 *Philip Morris v. Commission* (*Philip Morris k. Komisionit*) [1980] ECR 2671.

Nënparagrafi (b) i nenit 107(3)¹³⁶ përmban dy lloje ndihmash. E para është ndihma për ‘nxitjen e realizimit të një projekti të rëndësishëm të një interesi të përbashkët evropian’ dhe e dyta është ndihma për “ndreqjen e një çrregullimi të rëndë në ekonominë e një Shteti Anëtar”. Në lidhje me llojin e parë të ndihmës praktika gjyqësore dhe Komisioni kërkojnë që ‘projekti’ të jetë pjesë një projekti evropian ndërkufitar i mbështetur bashkërisht nga një numër i qeverive të Shteteve Anëtare ose të jetë pjesë e një veprimi të përbashkët nga një numër Shtetesh Anëtare kundër një rreziku të përbashkët, të tillë si ndotja e mjedisit.¹³⁷

Përfundimi që përmban pjesa e dytë e nenit 107(3) (b) TFBE ka gjetur zbatim të kufizuar në të kaluarën (Jones dhe Sufrin, 2014:112). Kushti për zbatim është që çrregullimi duhet të prekë të gjithë ekonominë e një Shteti Anëtar (Craig dhe De Burca, 2008:1095). Në çështjen *Gjermania kundër Komisionit*¹³⁸ sipas Gjykatës së Drejtësisë në rast se çrregullohet vetëm një pjesë e ekonomisë së Shtetit Anëtar do të zbatohet neni 107(3) (c). Për më tepër neni 107(3) (b) nuk do të gjejë zbatim nëse efekti i ndihmës do të ishte transferimi i investimit nga një Shtet Anëtar në zona ekonomike më pak të favorizuara.¹³⁹

Nëse analizojmë praktikën gjyqësore në lidhje me zbatimin e nenit 107(3) (b) TFBE mund të arrijmë në përfundimin se situatat të cilat janë konsideruar si çrregullime të rënda janë si më poshtë: ndihmat e dhëna nga Shtetet Anëtare për të kaluar reçensionin e viteve 70, pas krizës së naftës. Gjithashtu në fund të viteve 80, ky nen është përdorur si bazë ligjore në

¹³⁶ Neni 107 (3) (b) Treaty on the Functioning of the European Union (TFEU) (Traktati për Funkcionimin e Bashkimit Evropian) (TFBE) [2012] OJ C326/47, parashikon: “Ndihma për nxitjen e realizimit të një projekti të rëndësishëm me interes të përbashkët evropian ose për ndreqjen e një çrregullimi të rëndë në ekonominë e një Shteti Anëtar.”

¹³⁷ Çështje C-62 dhe C-72/87 *Executif Regional Wallon v. Commission (Executif Regional Wallon k. Komisionit)* [1988] ECR 1573, para 22.

¹³⁸ Çështje C-301/96, *Germany v. Commission (Gjermania k. Komisionit)* [2003] ECR I-9199.

¹³⁹ Çështje 730/79, *Philip Morris Holland BV v. Commission (Philip Morris Holland BV k. Komisionit)* [1980] ECR 2671, para. 25.

lidhje me ndihmën për të ndihmuar rimëkëmbjen e ekonomisë greke (Jones dhe Sufrin, 2014:112). Ky përdorim i kufizuar nenit 107(3) (b) u ndryshua nga kriza financiare botërore.¹⁴⁰ Fillimisht Komisioni hezitoi të pranonte që ndihma për parandalimin e falimentimit të një banke plotësonte kushtin e rregullimit të një shqetësimi serioz në të gjithë ekonominë e Shtetit Anëtar.¹⁴¹ Në çështjet e para në të cilat Shtetet Anëtare ndihmuan institucionet e tyre financiare në prag falimentimi, Komisioni zbatoi nenin 107(3) (c) dhe ka autorizuar ndihmën në bazë të udhëzimit për shpëtim dhe ristrukturim. Kufizimet që paraqiste neni 107(3) (c) dhe pranimi i një situatë sistematike të falimentimit të sistemit bankar në Evropë bëri që Komisioni në tetor të vitit 2008 të kthehej tek përdorimi 107(3) (b) duke qenë se ai lejon një diskrecion të gjerë. Në bazë të nenit 107(3) (b) Komisioni miratoi një numër masash në sektorin bankar dhe financiar. Komisioni ka deklaruar se neni 107(3) (b) do të jetë baza për autorizimin e ndihmës së dhënë institucioneve financiare deri sa kriza të jete prezente.¹⁴²

Në vazhdim nënparagrafi 107(3) (c)¹⁴³ përmban një përjashtim i cili autorizon “ndihmën për lehtësimin e zhvillimit të aktiviteteve të caktuara ekonomike ose disa rajoneve të caktuara ekonomike”. Ky nënparagraf lejon si të pajtueshme me tregun e brendshëm ndihmën rajonale dhe ndihmën për sektorë të veçantë të ekonomisë ose industrisë, në qoftë se përmbushet kushti i një “interesi të përbashkët” (Bartosch,

¹⁴⁰ Po aty.

¹⁴¹ Decision (Vendim) C 50/2006, BAWAG-PSK [2008] OJ L 83/7.

¹⁴² Communication from the Commission on the application of State aid rules to measures taken in relation to financial institutions in the context of the current global financial crisis [2008] OJ 270/02, para. 9. (Komunikim i Komisionit – aplikimi rregullave të ndihmës Shtetërore tek masat e marra në lidhje me institucionet financiare në kontekstin e krizës financiare botërore).

¹⁴³ Neni 107 (3) (c) Treaty on the Functioning of the European Union (TFEU) (Traktati për Funkcionimin e Bashkimit Evropian) (TFBE) [2012] OJ C326/47, parashikon: “ndihma për lehtësimin e zhvillimit të disa aktiviteteve të caktuara ekonomike ose rajoneve të caktuara ekonomike ku një ndihmë e tillë nuk i prek aq keq kushtet e tregtimit sa të bien ndesh me interesin e përbashkët”.

2009:111). Neni 107(3) parashikon që ndihma do të lejohet nëse ajo nuk prek aq keq kushtet e tregtimit sa të bien ndesh me interesin e përbashkët. Kjo kërkon që Komisioni të angazhohet në balancimin e efekteve pozitive në zhvillimin e rajonit ose aktivitetit në fjalë me efektet negative (nëse ka) në konkurrencë dhe tregtinë ndërmjet Shteteve Anëtare dhe pajtueshmëria e ndihmës me tregun e përbashkët do të gjykohet në kontekstin e Bashkimit (Jones & Sufrin, 2014:113).

Përfashtimet e fundit në nenin 107(3) TFBE janë ato të parashikuara nga nënpragrafet (d) dhe (e). Ato autorizojnë respektivisht ndihmën për nxitjen dhe ruajtjen e kulturës dhe trashëgimisë¹⁴⁴ dhe “kategori të tjera të tilla ndihme të cilat përcaktohen në një vendim të Këshillit me propozim të Komisionit”. Përfashtimi në lidhje me kulturën dhe trashëgiminë është shtuar nga Traktati mbi Bashkimin Evropian (Maastricht) dhe kështu është zbatuar prej 1 Nëntorit të vitit 1993.¹⁴⁵ Sipas praktikës gjyqësore ky nënparagraf nuk mund të përdoret për të autorizuar ndihmën e cila është aplikuar përpara datës së sipërpërmendur.¹⁴⁶ Ky përfashtim është përdorur për të autorizuar ndihmën për publikimet dhe sektorët audio-vizual dhe industrinë e filmit. Ndihma për ruajtjen e kulturës dhe trashëgimisë deri në kufij të caktuar është përfashtuar në grup për herë të parë nga Rregullorja për Përfashtimet në Grup e vitit 2014¹⁴⁷ ashtu siç janë përfashtuar skemat për

¹⁴⁴ Neni 107 (3) (d) Treaty on the Functioning of the European Union (TFEU) (Traktati për Funksionimin e Bashkimit Evropian) (TFBE) [2012] OJ C326/47, parashikon: “ndihma për nxitjen e ruajtjes së kulturës dhe trashëgimisë, kur një ndihmë e tillë nuk prek aq kushtet e tregtimit dhe konkurrencën në Bashkimin Evropian sa të bien ndesh me interesin e përbashkët”.

¹⁴⁵ Neni G, Treaty of Maastricht on European Union (Traktatit i Maastricht mbi Bashkimin Evropian) [1992] OJ C-191/01.

¹⁴⁶ Çështje T-348/04, *Societe internationale de diffusion et d'edition SA (SIDE) v. Commission (Societe internationale de diffusion et d'edition SA (SIDE) k Komisionit)* [2008] ECR II-00625 para 105.

¹⁴⁷ Commission Regulation (EU) No 651/2014 of 17 June 2014 declaring certain categories of aid compatible with the internal market in application of Articles 107 and 108 of the Treaty (Rregullore e Komisionit (EU) Nr. 651/2014 e cila deklaron disa kategori të ndihmës të pajtueshme me tregun e brendshëm në aplikimin e neneve 107 dhe 108 të TFBE), [2014] EN OJ L 187/1, neni 53.

punimet audio-vizuale.¹⁴⁸ Neni 107(3) (e) lejon krijimin e përjashtimeve të tjera diskrecionale nga Këshilli duke vepruar në bazë të një propozimi nga Komisioni. Ky nënparagraf mund të përdoret vetëm për kategori ndihme dhe jo për ndihmë individuale. Sipas kësaj procedure Këshilli ka adoptuar masat në sektorin e ndërtimit të anijeve në vitin 1998¹⁴⁹ dhe për të krijuar një regjim të ri për industrinë e qymyrit.¹⁵⁰

Në Traktat dhe në legjislacionin dytësor të Bashkimit Evropian ekzistojnë dhe dispozita të tjera të cilat mund të konsiderohen përjashtime nga ndalimi i parashikuar në nenin 107(1) TFBE në lidhje me ndihmën Shtetërore. Këtu mund të përmendim nenin 106(2) të TFBE i cili përdoret për të autorizuar ndihmën e dhënë Shërbimeve me Interes të Përgjithshëm Ekonomik, sipas Gjykatës së Drejtësisë në çështjen *Altmark* kompensimi i ndërmarrjeve që kryejnë shërbime të një interesi të përgjithshëm ekonomik nuk përbën ndihmë Shtetërore nëse plotësohen disa kushte specifike.

¹⁴⁸ Po aty Neni 54.

¹⁴⁹ Rregullore e Këshillit Nr. 502/2004 datë 11 Mars 2004 e cila ndryshon Rregulloren Nr. 1177/2002 në lidhje me një mekanizëm mbrojtës në ndërtimin e anijeve.

¹⁵⁰ Rregullore 1407/2002, [2002] OJ L 205/1. Ka përfunduar në 31 Dhjetor 2010.

KAPITULLI III

ROLI DHE KOMPETENCAT E KOMISIONIT EVROPIAN NË

KONTROLLIN E NDIHMËS SHETETËRORE

3.1. Hyrje

Traktati për Funksionimin e Bashkimit Evropian përmban gjithashtu dhe rregullat bazë procedurale në lidhje me ndihmën Shtetërore, pa të cilat kontrolli mbikombëtar i ndihmës Shtetërore nuk do të ishte i plotë. Rregullat në lidhje me ndihmën Shtetërore pjesë e TFBE-së janë hartuar bazuar në idenë e një kontrolli të centralizuar të ndihmës Shtetërore nga një institucion për të gjithë Bashkimin Evropian. Gjithsesi, vitet e fundit është vënë re një tendencë për të decentralizuar kontrollin e ndihmës Shtetërore dhe konkurrencën në përgjithësi.

Në këtë kapitull do të analizohet kontrolli i centralizuar i ndihmës Shtetërore që konsiston në një proces administrativ i cili zakonisht quhet kontroll i ushtuar nga Komisioni Evropian. Fillimisht kapitulli do të analizojë nenet bazë të TFBE-së të cilat e vendosin Komisionin në qendër të zbatimit të politikave në lidhje me ndihmën Shtetërore. Gjithashtu, Traktati parashikon dhe procedurën për adoptimin e një legjislacioni më të detajuar, si një mënyrë për rritjen e shkallës së zbatueshmërisë. Ky kapitull do të analizojë në mënyrë kritike dispozitat ligjore më të rëndësishme të cilat rregullojnë kompetencën e Komisionit në lidhje me kontrollin e ndihmës Shtetërore.

Kontrolli i ndihmës Shtetërore konsiston në disa faza në varësi të llojit të ndihmës që do të zbatohet. Kontrolli i ndihmës Shtetërore përfshin dy palë të cilat janë Shteti Anëtar i cili

planifikon të japë ndihmë Shtetërore dhe Komisionin. Të dyja palët duhet të ndjekin procedurat përkatëse sipas llojit të ndihmës. Tema do të analizojë detyrimet e secilës palë dhe rezultatet e mundshme të secilës procedure kontrolli në lidhje me ndihmën Shtetërore. Kjo është nevojshme për të kuptuar strukturën e regjimit mbikombëtar të ndihmave Shtetërore, aktorët kryesore kompetencat dhe cilat janë kufizimet në lidhje me kompetencat që ato kanë.

Në këtë kapitull do të përfshihet dhe një aspekt tjetër i regjimit mbikombëtar në lidhje me kontrollin e ndihmës Shtetërore, kthimi i ndihmës Shtetërore. Tema do të analizojë probleme në lidhje me zbatimin e vendimeve të Komisionit për kthimin e ndihmës Shtetërore. Gjithashtu, do të analizohen në mënyrë kritike kompetencat e Komisionit dhe të Shteteve Anëtare gjatë këtij procesi. Për më tepër, kapitulli përmban dhe një analizë të përdorimit të parimit të pritshmërisë legjitime dhe sigurisë juridike në çështjet që kanë lidhje me ndihmat Shtetërore.

3.2. Institucionet e Bashkimit Evropian – ndihma Shtetërore

Institucionet kryesore të Bashkimit Evropian, janë: Parlamenti Evropian, Këshilli, Komisioni Evropian, Gjykata e Drejtësisë e Bashkimit Evropian. Këto insitutucione janë krijuar në bazë të Traktateve të Bashkimit Evropian, të cilët parashikojnë dhe kompetencat përkatëse. Më poshtë, do të analizohet roli i Këshillit, Komisionit dhe Gjykatës së Drejtësisë së Bashkimit Evropian në lidhje me kontrollin e ndihmës Shtetërore.

Këshilli i cili përbëhet nga perfaqësuesit e Shteteve Anëtare të Bashkimit Evropian. Kompetencat e Këshillit prekin të gjithë sektorët e veprimtarisë së Bashkimit

Evropian. Për shembull, ai ndërmerr hapin final në lidhje me miratimin e akteve e normative të Bashkimit Evropian, kompetencë të cilën tashmë e ndan gjerësisht me Parlamentin Evropian, lidh marrëveshje ndërkombëtare dhe luan një rol kyç në lidhje me buxhetin e Bashkimit Evropian (Canaj dhe Bana, 2014:111). Në fushën e së drejtës së ndihmës Shtetërore Këshilli, Traktati për Funksionimin e Bashkimit Evropian i jep të drejtën Këshillit të miratojë rregulloret e duhura për zbatimin e neneve të Traktatit në lidhje me ndihmën Shtetërore. Në veçanti, Këshilli cakton kushtet në lidhje me njoftimin e Komisionit nga Shtetet Anëtare për çdo plan që ka të bëjë me dhënien ose ndryshimin e një ndihme si dhe kategoritë e ndihmës të përjashtuara nga kjo procedurë. Gjithsesi, në këto rate Këshilli mund të veprojë vetëm me propozim të Komisionit dhe pas konsultimit me Parlamentin Evropian.

Komisioni Evropian drejtohet nga komisionarët të cilit janë individë që nuk përfaqësojnë interesat e Shteteve Anëtare. Sipas nenit 17 Traktati i Bashkimit Evropian Komisionarët zgjidhen në bazë të kompetencave të tyre të përgjithshme dhe pavarësia e tyre nuk vihet në dyshim. Rrjedhimisht, ndërsa Komisionarët vijnë nga Shtetet Anëtare ato nuk përfaqësojnë shtetin e tyre. Kjo përforcohet nga më tej nga Traktati i Bashkimit Evropian¹⁵¹, i cili parashikon që Komisionarët duhet të jenë plotësisht të pavarur dhe nuk marrin udhëzime nga ndonjë institucion tjetër. Komisioni vepron nën drejtimin e Presidentit të Komisionit dhe merr vendime me shumicën e anëtarëve të tij.¹⁵² Komisioni merr vendime si organ kolegjal ose autorizon një Komisionar të marrë vendime (Craig &

¹⁵¹ Article 17 (3) TBE; Treaty on the European Union (Traktati i Bashkimit Evropian) (TBE) [2012] OJ C326/47.

¹⁵² Neni 250 TFBE; Treaty on the Functioning of the European Union (TFEU) (Traktati për Funksionimin e Bashkimit Evropian) (TFBE) [2012] OJ C326/47.

de Burca, 2011:40). Komisioni zbaton parimin e përgjegjësisë kolegjiale. Ky parim nënkupton që anëtarët e Komisionit kanë një rol të barabartë në vendimmarrje dhe vendimet e tyre merren bashkërisht.¹⁵³ Vendimet merren nga Kolegji i Komisionarëve, i cili është përgjegjës përpara Parlamentit Evropian. Gjithashtu, Komisionarët mund të autorizohen nga Komisioni të marrin masa në emrin e tyre në një fushë të caktuar nën përgjegjësinë e tyre. Në këtë rast, ata kanë përgjegjësi politike dhe ligjore në emër të Komisionit.

Kompetencat e Komisionit parashikohen në nenin 17 të Traktatit të Bashkimit Evropian. Komisioni ka tagrin e iniciativës legjislative.¹⁵⁴ Megjithëse, propozimet legjislative të Komisionit duhet të miratohen nga Këshilli, dhe nga Parlamenti Evropian, e drejta e iniciativës i ka dhënë mundësinë Komisionit të veprojë si një “motor i integritetit” për të gjithë Bashkimin Evropian në tërësi (Craig dhe de Burca, 2011:43). Tagri ekzekutues i Komisionit do të thotë që ky i fundit është “rojtari i Traktateve sepse “kujdeset për zbatimin e dispozitave të Traktatit si dhe dispozitave të miratuara nga institucionet duke u mbështetur tek Traktati.”¹⁵⁵ Ndërkohë, Këshilli mund t’i japë Komisionit kompetenca për zbatimin e normave të vendosura nga Këshilli. Komisioni në çështjet mbi konkurrencën duke përfshirë dhe ato në lidhje me ndihmën Shtetërore, luan rolin investiguesit, gjyqtarit, prokurorit (Jones dhe Sufrin, 2014:933).

¹⁵³ Rules of the Procedure of the Commission (Rregullorja Procedurale e Komisionit) 1.1.2001 OJ L 308/2000.

¹⁵⁴ Shiko nenin 17(2); Treaty on the European Union (Traktati i Bashkimit Evropian) (TBE) [2012] OJ C326/47; dhe nenin 289 TFBE Treaty on the Functioning of the European Union (TFEU) (Traktati për Funkcionimin e Bashkimit Evropian) (TFBE) [2012] OJ C326/47.

¹⁵⁵ Neni 17 TFBE; Treaty on the European Union (Traktati i Bashkimit Evropian) (TBE) [2012] OJ C326/47.

Komisioni është organizuar në Drejtori të Përgjithshme (DP), të cilat mbulojnë fusha të caktuara për të cilat Komisioni është përgjegjës. Ekzistojnë katër shkallë të organizimit administrativ brenda Komisionit (Craig & de Burca, 2014:35). Së pari, ekziston një Komisionar i cili ka portofolin për atë fushë. Më pas është Drejtori i Përgjithshëm i cili është kreu i një Drejtorie të Përgjithshme të caktuar. Drejtori i Përgjithshëm është përgjegjës përpara Komisionarit përkatës. Çdo Drejtori e Përgjithshme ka një numër të caktuar Drejtorish, të cilat drejtohen nga një Drejtor. Drejtorët janë përgjegjës përpara Drejtorit të Përgjithshëm. Pjesa e fundit e këtij organizimi administrativ janë Drejtuesit e Njësi. Këta të fundit veprojnë nën përgjegjësinë e Drejtorit përkatës.

Drejtoria përgjegjëse në Komision për kontrollin e ndihmës Shtetërore në disa sektorë të ekonomisë është Drejtoria e Përgjithshme për Konkurrencën. Gjithsesi, ka Drejtori të tjera të Përgjithshme të cilat kanë gjithashtu kompetenca për kontrollin e subvencioneve sepse pak sektorë të ekonomisë kanë rregulla të ndryshme në lidhje me ndihmën Shtetërore. Këto sektorë janë sektori i bujqësisë, në këtë sektor përgjegjëse për kontrollin e subvencioneve është Drejtoria e Përgjithshme e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, sektori peshkimit ku përgjegjëse është Drejtoria për Peshkimin.

Përpara hyrjes në fuqi të Traktatit të Lisbonës Gjykatat e Komunitetit përfshinin Gjykatën e Drejtësisë, Gjykatën e Shkallës së Parë dhe dhomat juridiksionale. Kjo strukturë është ndryshuar nga Traktati i Lisbonës. Neni 19 TFBE ka prezantuar disa ndryshime në lidhje me strukturën e sipërpërmendur. Tani emërtimi zyrtar është Gjykata e Drejtësisë së Bashkimit Evropian dhe përbëhet nga tre gjykata: Gjykata e Drejtësisë, Gjykata e

Përgjithshme,¹⁵⁶ dhe Gjykata e Shërbimit Civil.¹⁵⁷ Gjykata Shërbimit Civil ka juridiksion në konfliktet e shërbimit civil në Bashkimin Evropian. Ndërsa, vetëm Gjykata e Drejtësisë dhe Gjykata e Përgjithshme kanë juridiksion të gjykojnë çështje që kanë të bëjnë me ndihmat Shtetërore.

Gjykata e Drejtësisë përbëhet nga një gjyqtar për çdo Shtet Anëtar sipas nenit 19(1) të Traktatit të Bashkimit Evropian. Gjykata asistohet nga tetë Avokatë të Përgjithshëm, numër i cili mund të rritet me një vendim unanim të Këshillit.¹⁵⁸ Gjyqtarët dhe Avokatët e Përgjithshëm të Gjykatës së Drejtësisë zgjidhen mes personave për pavarësinë e të cilëve nuk ka dyshime, të cilët përmbushin kushtet e nevojshme për të mbajtur postet më të larta gjyqësore në vendet e tyre përkatëse ose janë juristë me aftësi profesionale të njohura.¹⁵⁹ Ndërsa, Gjykata e Shkallës së Parë u krijua në vitin 1998 sipas Aktit Unik Evropian.¹⁶⁰ Statusi i saj u ndryshua nga Traktati i Nisës dhe Traktati i Lisbonës, i cili siç u përshkrua më lart tani, parashikon se Gjykata e Drejtësisë e Bashkimit Evropian do të përfshijë Gjykatën e Përgjithshme (ish Gjykatën e Shkallës së Parë). Përsa i përket juridiksionit, Gjykata e Përgjithshme ka një status juridiksional të plotë, i cili përfshin mbikëqyrjen e zbatimit të së Drejtës Evropiane në interpretimin dhe zbatimin e Traktatit.¹⁶¹

¹⁵⁶ Gjykata e Shkallës së Parë e cila u krijua në vitin 1988 sipas një ndryshimi në Traktat të prezantuar nga Akti i Vetëm Evropian. Council Decision 88/591 [1988] OJ L319/1.

¹⁵⁷ Council Decision 2004/752/EC, Euroatom of 2 November 2004, establishing the European Union Civil Service Tribunal [2004] OJ L333/7. (Vendim i Këshillit për krijimin e Gjykatës Evropiane të Shërbimit Civil).

¹⁵⁸ Neni 252 TFBE; Consolidated version of the Treaty on the Functioning of the European Union [2010] OJ C 83/47 (Version i konsoliduar i Traktatit për Funkcionimin e Bashkimit Evropian).

¹⁵⁹ Neni 253 TFBE; Consolidated version of the Treaty on the Functioning of the European Union [2010] OJ C 83/47 (Version i konsoliduar i Traktatit për Funkcionimin e Bashkimit Evropian).

¹⁶⁰ Single European Act (Akti Unik Evropian) OJ L 169. Akti Unik Evropian ndryshoi Traktet e Romes. Ai ndryshoi rregullat në lidhje me funksionimin e institucioneve evropiane dhe zgjeroi kompetencat e Komunitetit (Bashkimit) në fusha të tilla si kërkim, zhvillim, politikën e jashtme.

¹⁶¹ Neni 19 (1), Treaty of European Union (Traktati i Bashkimit Evropian) OJ C 191.

Në kontekstin e së drejtës për ndihmën Shtetërore Gjykatat Evropiane kanë të drejtë të dëgjojnë dy lloje kryesore çështjesh. Së pari, neni 263 TFBE parashikon shqyrtimin e ligjshmërisë së akteve të institucioneve të Bashkimit Evropian. Kjo mundësi përfshin dhe kundërshtimin e vendimeve të Komisionit që kanë lidhje me të drejtën për ndihmën Shtetërore të Bashkimit Evropian. Së dyti, sipas nenit 267 TFBE Gjykata e Drejtësisë ka juridiksion të marrë vendime paraprake në lidhje me interpretimin e Traktatit dhe gjithashtu në lidhje me vlefshmërinë dhe interpretimin e akteve të institucioneve të Bashkimit Evropian, përmes procedurës paragjykimore. Nëse një gjykatë ose tribunal i një Shteti Anëtar është e mendimit se i nevojitet një vendim në mënyrë që të gjykohej çështja si më sipër, atëherë i kërkon Gjykatës nxjerrjen e një vendimi paprak. Rëndësia e këtij juridiksioni në lidhje me çështjet mbi ndihmën Shtetërore qëndron në zbatimin uniform të legjislacionit mbi ndihmën Shtetërore. Gjyqtarët në gjykatat kombëtare mund të përdorin këtë instrument, për të sqaruar aspekte të paqarta të legjislacionit të Bashkimit mbi ndihmën Shtetërore. Vendimi paprak i Gjykatës mbi interpretimin e së drejtës evropiane është i detyrueshëm për gjykatën kombëtare që e ka kërkuar.

3.3. Komisioni Evropian: emërimi, përbërja

Është e rëndësishme të theksojmë se termi “Komision” tregon Kolegjin e Komisionarëve dhe “burokracinë” e përhershme në Bruksel e cila realizon shërbimet e Komisionit (Craig & de Burca, 2011:32). Procedura për zgjedhjen e anëtarëve të Komisionit përbëhet nga disa faza. Fillimisht, Këshilli Evropian, duke marrë në konsideratë zgjedhjet për Parlamentin Evropian dhe pasi zhvillon konsultimet e duhura, duke vepruar

me një shumicë të cilësuar, i propozon parlamentit Evropian një kandidat për Presidentin e Komisionit. Më pas Presidenti i Komisionit zgjidhet nga Parlamenti Evropian me shumicën e deputeteve që e përbejnë atë.¹⁶² Së dyti, pas zgjedhjes së Presidentit, Këshilli, në marrëveshje me Presidentin e zgjedhur, miraton listën e personave të tjerë të cilët i propozon për emërim si anëtarë të Komisionit. Anëtarët e Komisionit përzgjidhen në bazë të propozimeve që bëjnë Shtetet Anëtare. Së treti, Parlamenti Evropian duhet të shprehë një votë miratimi për Komisionin si organ. Pasi merret kjo votë miratimi, Komisioni emërohet me shumicë të cilësuar nga Këshilli Evropian.

Komisioni Evropian përbëhet nga një shtetas i secilit Shtet Anëtar. Kjo bën të mundur dhe përfaqësimin e shteteve të reja anëtare në Komision, ndërsa për shtetet e mëdha ka pasur një zvogëlim deri në një përfaqësues. Deri në vitin 2004 shtetet demografikisht më të rëndësishme janë përfaqësuar me nga dy komisionarë (Canaj & Bana, 2014:98). Traktati i Bashkimit Evropian parashikon që nga data e hyrjes së tij në fuqi deri më 31 Tetor 2014, Komisioni përbëhet nga një shtetas i secilit Shtet Anëtar, duke përfshirë dhe Presidentin e tij, Përfaqësuesin e Lartë të Bashkimit për Punët e Jashtme dhe Politikën e Sigurimit, i cili është dhe njeri prej zëvendës presidentëve.¹⁶³ Sipas të njetit Traktat duke filluar nga data 1 Nëntor 2014, Komisioni do të përbëhet nga një numër anëtarësh që përkon me dy të tretat e numrit të Shteteve Anëtare, nëse Këshilli Evropian, me unanimitet, nuk vendos ndryshe.¹⁶⁴ Aktualisht, Komisioni ka 28 Komisionarë, një për çdo Shtet Anëtar, të cilët kanë një mandat prej 5 vitesh.¹⁶⁵

¹⁶² Neni 17 TBE; Treaty on the European Union (Traktati i Bashkimit Evropian) (TBE) [2012] OJ C326/47.

¹⁶³ Neni 17 TBE; Treaty on the European Union (Traktati i Bashkimit Evropian) (TBE) [2012] OJ C326/47.

¹⁶⁴ Po aty.

¹⁶⁵ Shiko website-in e Komisionit: http://ec.europa.eu/commission/2014-2019_en.

Traktati për Funkcionimin e Bashkimit Evropian parashikon zgjedhjen e anëtarëve të Komisionit ndërmjet shtetasve të Shteteve Anëtare, në bazë të një sistemi rotacioni. Ky sistem rotacioni respekton barazinë ndërmjet Shteteve Anëtare duke pasqyruar gamën demografike dhe gjeografike të gjithë Shteteve Anëtare. Ky sistem i ri sjell progres, duke evituar kombëtarizimet e Komisionit. Megjithatë, bashkëpunimi ndërmjet Shteteve Anëtare kryesore në Komision në të ardhmen do të jetë i vështirë, kur si pasojë e rregullit të rotacionit, këto shtete nuk do të kenë përfaqësuesit e tyre (Canaj & Bana, 2014:99).

Sipas nenit 17 TBE Komisionarët zgjidhen në bazë të kompetencave të tyre të përgjithshme dhe pavarësia e tyre nuk vihet në dyshim. Rrjedhimisht, ndërsa Komisionarët vijnë nga Shtetet Anëtare ato nuk përfaqësojnë shtetin e tyre. Kjo përforcohet më tej nga TBE,¹⁶⁶ i cili parashikon që Komisionarët duhet të jenë plotësisht të pavarur dhe nuk marrin udhëzime nga ndonjë institucion tjetër. Komisioni vepron nën drejtimin e Presidentit të Komisionit dhe merr vendime me shumicën e anëtarëve të tij.¹⁶⁷

Komisioni merr vendime si organ kolegjal ose autorizon një Komisionar të marrë vendime (Craig & de Burca, 2011:40). Komisioni zbaton parimin e përgjegjësisë kolegjiale. Ky parim nënkupton që anëtarët e Komisionit kanë një rol të barabartë në vendimmarrje dhe vendimet e tyre merren bashkërisht.¹⁶⁸ Vendimet merren nga Kolegji i Komisionarëve, i cili siç u përmend më sipër është përgjegjës përpara Parlamentit Evropian. Gjithashtu, Komisionarët mund të autorizohen nga Komisioni të marrin masa në emrin e tyre në një

¹⁶⁶ Article 17 (3) TBE; Treaty on the European Union (Traktati i Bashkimit Evropian) (TBE) [2012] OJ C326/47.

¹⁶⁷ Neni 250 TFBE; Treaty on the Functioning of the European Union (TFEU) (Traktati për Funkcionimin e Bashkimit Evropian) (TFBE) [2012] OJ C326/47.

¹⁶⁸ Rules of the Procedure of the Commission (Rregullorja Procedurale e Komisionit) 1.1.2001 OJ L 308/2000.

fushë të caktuar nën përgjegjësinë e tyre. Në këtë rast, ata kanë përgjegjësi politike dhe ligjore në emër të Komisionit.

Kolegji i Komisionarëve ushtron veprimtarinë e tij në katër mënyra kryesore (Craig & de Burca, 2011:40). Çështjet më të rëndësishme trajtohen në mbledhjet e Kolegjit, të cilat zhvillohen çdo javë, në bazë të një axhende të përgatitur nga Sekretari i Përgjithshëm. Rregullorja Procedurale e detyron Komisionin të mbledhet të paktën njëherë në javë. Komisioni mbledhet zakonisht çdo të mërkurë në Bruksel.¹⁶⁹ Takimet paraprihen nga diskutime të Shefave të Kabinetit të Komisionarëve, të cilët përpiqen të zgjidhin përpara mbledhjes së Komisionit probleme të ndryshme. Kjo procedurë vendimmarrje në mbledhjet javore të Komisionit njihet si “procedura me gojë”. Ajo përdoret vetëm për propozime të rëndësishme të cilat kërkojnë diskutim nga Komisioni përpara se të miratohen. Ndërsa, procedura me shkrim përdoret atëherë kur “diskutimi në Kolegjin e Komisionarëve nuk është i nevojshëm sepse Drejtoria e Përgjithshme përkatëse ka rënë dakot për të gjitha pikat dhe Komisioni për Shërbimet Ligjore është gjithashtu dakord”.¹⁷⁰

Një mënyrë tjetër për të marrë vendime është ajo kur Kolegji i Komisionarëve i jep të drejtën për të marrë vendime një Komisionari individual. Ky tagër ushtrohet në përputhje me disa kufizime dhe kushte.¹⁷¹ Së fundmi, ekziston dhe mundësia e delegimit të vendimmarrjes tek drejtorët e përgjithshëm dhe përgjegjësit e departamenteve, të cilët veprojnë në emër dhe për llogari të Komisionit.¹⁷²

¹⁶⁹ http://ec.europa.eu/atwork/decision-making/weekly-meetings/index_en.htm.

¹⁷⁰ Rules of the Procedure of the Commission (Rregullorja Procedurale e Komisionit) 1.1.2001 OJ L 308/2000.

¹⁷¹ Po aty.

¹⁷² Po aty.

3.4. “Burokracia” e Komisionit Evropian

Punonjësit e përhershëm të cilët janë të punësuar pranë Komisionit dhe që formojnë “burokracinë” e Komisionit janë të organizuar si më poshtë.

Drejtoritë e Përgjithshme (DP) mbulojnë fusha të caktuara për të cilat Komisioni është përgjegjës. Në Komision ka Drejtori të Përgjithshme¹⁷³ për: Bujqësinë dhe Zhvillimin Rural; Buxhetin; Veprimin në lidhje me Klimën; Komunikimin; Rrjetet e Komunikimit, Përmbytjes dhe Teknologjisë; Konkurrencën; Çështjet Ekonomike dhe Financiare; Kulturën dhe Edukimin; Punësimin Çështjet Sociale dhe Shanse të Barabarta; Energjinë; Çështjet e Peshkimit dhe Transportit Detar; Mbrojtjen e Shëndetit dhe Konsumatorit; Shoqërinë e Informacionit dhe të Medias; Tregun e Brendshëm dhe Shërbimet; Qendrën e Përbashkët të Kërkimit; Drejtësinë, Lirinë dhe Sigurinë; Politikat Rajonale; Kërkimin; Taksimin dhe Bashkimin Doganor; Transportin dhe Energjinë. Ka Drejtori të Përgjithshme të cilat trajtojnë marrëdhëniet me jashtë duke përfshirë: Zhvillimin, Zgjerimin, Zyrën e Bashkëpunimit, Marrëdhëniet me Jashtë, Ndihamat Humanitare dhe Tregtinë. Çështjet financiare trajtohen nga Drejtoria e Përgjithshme për Buxhetin dhe Auditi i Brendshëm.

Gjithashtu ekzistojnë disa njësi të cilat ofrojnë shërbime të përgjithshme në të gjithë spektrin e aktiviteteve të Komisionit. Këto përfshijnë: Zyrën Evropiane Kundër Mashtrimit, Eurostat (Zyra e Statistikave), Komunikimin, Zyrën për Publikimet, Shërbimin e Përkthimit, Shërbimin Ligjor, Personelin dhe Administratën, Qendrën e Përbashkët Kërkimore, Sekretarinë e Përgjithshme të Komisionit.

¹⁷³ Shiko website-in e Komisionit http://ec.europa.eu/about/ds_en.htm.

Ekzistojnë katër shkallë të organizimit administrativ brenda Komisionit (Craig & de Burca, 2014:35). Së pari, ekziston një Komisionar i cili ka portofolin për atë fushë. Më pas është Drejtori i Përgjithshëm i cili është kreu i një Drejtorie të Përgjithshme të caktuar. Drejtori i Përgjithshëm është përgjegjës përpara Komisionarit përkatës. Çdo Drejtori e Përgjithshme ka një numër të caktuar Drejtorish, të cilat drejtohen nga një Drejtor. Drejtorët janë përgjegjës përpara Drejtorit të Përgjithshëm. Pjesa e fundit e këtij organizimi administrativ janë Drejtuesit e Njësive. Këta të fundit veprojnë nën përgjegjësinë e Drejtorit përkatës.

3.5. Kompetencat e Komisionit Evropian

Në Bashkimin Evropian nuk aplikohet një ndarje klasike e pushteteve, kjo për shkak të natyrës së tij *sui generis* (Conway, 2011:310). Kompetencat e Komisionit parashikohen në nenin 17 të Traktatit të Bashkimit Evropian i cili parashikon “1. Komisioni promovon interesin e përgjithshëm të Bashkimit dhe, për këtë qëllim, merr nismat e duhura. Ai siguron zbatimin e Traktateve dhe të masave të miratuara nga institucionet në zbatim të tyre. Ai mbikqyr zbatimin e së drejtës së Bashkimit nën kontrollin e Gjykatës së Drejtësisë të Bashkimit Evropian. Ai zbaton buxhetin dhe administron programet. Ai ushtron funksione bashkërenduese, ekzekutuese dhe administruese, që parashikohen në Traktatet. Me përjashtim të politikës së përbashkët të jashtme dhe të sigurimit, dhe të rasteve të tjera të parashikuara nga Traktatet, ai siguron përfaqësimin e jashtëm të Bashkimit. Ai çel programimin vjetor dhe shumëvjeçar të Bashkimit, me qëllim arritjen e marrëveshjeve ndërinstitucionale.

2. *Aktet legislative të Bashkimit mund të miratohen vetëm me propozim të Komisionit, nëse nuk parashikohet ndryshe nga Traktatet. Aktet e tjera miratohen me propozim të Komisionit, kur këtë e parashikojnë Traktatet.*”

Pushteti legjislativ. Komisioni ka tagrin e iniciativës legislative.¹⁷⁴ Megjithëse, propozimet legislative të Komisionit duhet të miratohen nga Këshilli, dhe nga Parlamenti Evropian, e drejta e iniciativës i ka dhënë mundësinë Komisionit të veprojë si një “motor i integritit” për të gjithë Bashkimin Evropian në tërësi (Craig & de Burca, 2011:43). Neni 241 dhe 255 TFBE parashikojnë që Këshilli Evropian dhe Parlamenti Evropian, respektivisht, mund t’i kërkojnë Komisionit të ndërmarrë iniciativën legislative për një pjesë të caktuar legjislacioni. Politikisht është shumë e vështirë për Komisionin të refuzojë një kërkesë të tillë nga Këshilli apo Parlamenti Evropian.

Pushteti ekzekutiv. Tagri ekzekutues i Komisionit do të thotë se ky i fundit është “rojtari i Traktateve” sepse “kujdeset për zbatimin e dispozitave të Traktatit si dhe dispozitave të miratuara nga institucionet duke u mbështetur tek Traktati.”¹⁷⁵ Funkcioni ekzekutiv i Komisionit dallohet në nxjerrjen e akteve të ekzekutimit dhe në mbikëqyrjen mbi respektimin e Traktatit (Canaj & Bana, 2014:104).

Aktet e ekzekutimit. Neni 202 i Traktit për Krijimin Komitetit Evropian¹⁷⁶ parashikonte mundësinë që Këshilli t’i jepte Komisionit kompetenca për zbatimin e normave të vendosura nga Këshilli. Gjithashtu, Këshilli bazuar në të njëjtin nen, mund të

¹⁷⁴ Shiko nenin 17(2); Treaty on the European Union (Traktati i Bashkimit Evropian) (TBE) [2012] OJ C326/47; dhe nenin 289 TFBE Treaty on the Functioning of the European Union (TFEU) (Traktati për Funkcionimin e Bashkimit Evropian) (TFBE) [2012] OJ C326/47.

¹⁷⁵ Neni 17 TFBE; Treaty on the European Union (Traktati i Bashkimit Evropian) (TBE) [2012] OJ C326/47.

¹⁷⁶ Council Decision 2006/512/EC of 17 July 2006 amending decision 1999/468/EC laying down the procedures for the exercise of implementing powers by the Commission (Vendim i Këshillit 2006/512/EC i 17 Korrikut 2006, i cili ndryshon vendimin 1999/468/EC që përcakton procedurat për kompetencat zbatuese të Komisionit) [2006] OJ L200/11.

përcaktonte disa kërkesa në lidhje me ushtrimin kompetencave zbatuese që i kishte dhënë Komisionit. Për me tepër, në disa raste, Këshilli mund t'i ushtronte direkt këto kompetenca zbatuese. Duke qene se Këshilli donte të ruante kontrollin e tij, ai krijoi një sistem delegimi të kompetencës legjislative subjekt të disa kufizimeve institucionale. Këto kufizime kishin formën e komiteteve, të cilat përfaqësojnë interesin e Shteteve Anëtare (Craig dhe de Burca, 2008:118). Komitetet përbëhen nga eksperte të Shteteve Anëtare dhe duhet të japin mendimin e tyre në lidhje me masat e propozuara nga Komisioni. Kjo procedurë legjislative është e rëndësishme pasi në disa fusha të caktuara, Bashkimi Evropian has ndryshime të shpejta në treg dhe mund të përballlet me to vetëm duke miratuar norma legjislative me një shpejtësi të mjaftueshme. Rrjedhimisht procedura legjislative tradicionale do të funksiononte shumë ngadalë. Ndër vite, kjo procedurë është bërë e rëndësishme dhe një sasi e madhe legjislacioni përpunohet nëpërmjet kësaj proçedure.¹⁷⁷ Në vitin 1987 Këshilli miratoi vendimin e parë në lidhje me komitetet duke përcaktuar parimet dhe rregullat që ato duhet të ndiqnin.¹⁷⁸ Në këtë vendim përcaktohet gjithashtu dhe struktura e komisioneve dhe prezantohen shtatë procedura: procedura e këshillimit, procedura menaxhimit dhe procedura rregulluese, dy të fundit kishin nga dy nën-variante secila (Canaj dhe Bana, 2014:104). Ky sistem përjashtonte plotësisht Parlamentin (Craig dhe de Burca, 2008:118). Ndryshimet e vitit 2006, (Stratulat dhe Molino, 2011:35) prezantojnë më shumë kompetenca për Parlamentin Evropian në procedurën e sipërpërmendur.

¹⁷⁷ Për shembull në vitin 2005 Komisioni ka miratuar 2.654 masa ndërsa Komitetet i kanë dhënë në total 2.582 opinione. *Shiko* Report from the Commission on the working of committees during 2005, (Raport nga Komisioni mbi punën e Komiteteve gjatë vitit 2005) COM(2006) 446 final, 9.8.2006.

¹⁷⁸ Council Decision of 13 July 1987 laying down the procedures for the exercise of implementing powers conferred on the Commission, (Vendim i Këshillit, 13 Korrik 1987, i cili përcakton procedurat për ushtrimin e kompetencave zbatuese të Komisionit) OJ [1987] L 197/33, 18.7.1987.

Ndryshime të rëndësishme sjell Traktati për Funksionimin e Bashkimit Evropian. Ai bën një ndarje të masave të miratuara sipas procedurës së sipërpërmendur në: akte të deleguara (neni 290 TFBE) dhe akte zbatuese (neni 291 TFBE).¹⁷⁹ Neni 290 TFBE parashikon që: *“Një akt legjislativ mund t’i delegojë Komisionit kompetencën për të miratuar akte jo legjislative me zbatim të përgjithshëm për të shtuar ose ndryshuar disa elementë jo thelbësorë të aktit legjislativ”*. Ndërsa neni 291 TFBE parashikon që: *“Kur nevojiten kushte të njëtrajtshme për vënien në zbatim të akteve të Bashkimit me fuqi ligjore detyruese, këto akte i japin kompetenca zbatuese Komisionit ose, në rastet e caktuara të justifikuara rregullisht dhe në rastet e parashikuara në nenet 24 dhe 26 të Traktatit për Bashkimin Evropian, këtë të drejtë ia japin Këshillit”*.

Kompetencat mbikëqyrëse: Neni 17(1) TBE i jep të drejtën Komisionit të mbikëqyrë zbatimin e dispozitave të traktateve dhe të dispozitave të miratuara nga institucionet duke u mbështetur në këto traktate. Kompetencat mbikëqyrëse të Komisionit përfshijnë dy aspekte: atë të ushtrimit të pushtetit ekzekutiv direkt dhe atë jo të drejtpërdrejt nëpërmjet çështjeve gjyqësore në Gjykatën Drejtësisë për të detyruar Shtetet Anëtare të zbatojnë të drejtën e Bashkimit Evropian. Ndërhyrje të drejtpërdrejt ka atëherë ku Traktatet ose Rregulloret parashikojnë që Komisioni të miratojë vendime detyruese (Canaj dhe Bana, 2014:105). Kjo ndodh për shembull në fushën e rregullave të konkurrencës, ku Komisioni mund të marrë vendime drejtpërdrejt të zbatueshme dhe që parashikojnë sanksione të veçanta ndaj sipërmarrjeve.

¹⁷⁹ Nenet 290 dhe 291 TFBE; Treaty on the Functioning of the European Union (TFEU) (Traktati për Funksionimin e Bashkimit Evropian) (TFBE) [2012] OJ C326/47.

Pushtetet mbikëqyrëse indirekte rrjedhin nga neni 17(1) TBE sipas të cilit Komisioni mbikëqyr zbatimin e së Drejtës së Bashkimit Evropian nën kontrollin e Gjykatës së Drejtësisë së Bashkimit Evropian. Komisioni mund të paraqesë një ankim (apel) në Gjykatën e Drejtësisë kundër një Shteti Anëtar kur ai nuk përmbush detyrimet e tij që rrjedhin nga rendi juridik evropian. Neni 258 TFBE i jep të drejtën Komisionit në rast mospërmbushje detyrimesh nga një Shtet Anëtar të dërgojë çështjen përpara Gjykatës së Drejtësisë së Bashkimit Evropian (“procedurat për shkelje”). Proçedura sipas nenit 258 TFBE përfshin 4 faza. Së pari, Shteti Anëtar ka mundësinë të shpjegojë pozicionin e tij. Së dyti, në qofte se çështja nuk sqarohet ndërmjet Komisionit dhe Shtetit Anëtar në fazën e parë, Shteti nëpërmjet një letre nga Komisioni do të njoftohet formalisht për shkeljen përkatëse të së drejtës. Zakonisht Shteti Anëtar ka një afat prej 2 muajsh për t’u përgjigjur. Së treti, nëse çështja nuk është zgjidhur pas bashkëbisedimeve me Shtetin përkatës Komisioni nxjerr një opinion të arsyetuar. Së fundmi, Komisioni referon çështjen përpara Gjykatës së Drejtësisë.

3.6. Komisionit Evropian - kontrolli i ndihmës Shtetërore

Traktati për Funksionimin e Bashkimit Evropian parashikon në nenin 108 kontrollin e ndihmës Shtetërore nga Komisioni Evropian dhe procedurat përkatëse. Traktati i jep të drejtën vetëm Komisionit për të kontrolluar ndihmat Shtetërore në nivel mbikombëtar. Neni 108 TFBE parashikon që:

“1. Komisioni, në bashkëpunim me Shtetet Anëtare, i mban në shqyrtim të vazhdueshëm të gjitha sistemet e ndihmës që ekzistojnë në këto Shtete. Ai u propozon këtyre të fundit masat e duhura që janë të nevojshme për zhvillimin progresiv ose funksionimin e tregut të brendshëm”.

2. Nëse, pasi u jep njoftim palëve në fjalë për të paraqitur komentet e tyre, Komisioni konstaton se ndihma e dhënë nga një Shtet ose nëpërmjet burimeve shtetërore nuk është e pajtueshme me tregun e brendshëm, duke pasur parasysh nenin 107 ose se një ndihmë e tillë është shpërdoruar, ai vendos që Shteti në fjalë ta ndalojë ose ta ndryshojë këtë ndihmë brenda një afati të vendosur nga Komisioni.

Nëse Shteti në fjalë nuk e zbaton këtë vendim brenda afatit të përcaktuar, Komisioni ose Shtetet e tjera të interesuara, duke iu shmangur urdhërimeve të neneve 258 dhe 259, mund ta paraqesin çështjen përpara Gjykatës së Drejtësisë të Bashkimit Europian.

Me kërkesë të një Shteti Anëtar, Këshilli, me unanimitet, mund të vendosë që ndihma që jep ose ka si qëllim të japë ky Shtet të konsiderohet si e pajtueshme me tregun e brendshëm, duke iu shmangur urdhërimeve të nenit 107 ose të rregulloreve të parashikuara në nenin 109, nëse një vendim i tillë justifikohet me rrethana të jashtëzakonshme. Nëse lidhur me ndihmën në fjalë, Komisioni ka filluar më parë procedurën e parashikuar në nënparagrafin e parë të këtij paragrafi, fakti që Shteti i interesuar i ka paraqitur kërkesë Këshillit sjell për pasojë pezullimin e procedurës gjersa të jetë shprehur Këshilli.

Por, nëse Këshilli nuk shprehet brenda tre muajve pas paraqitjes së kërkesës në fjalë, Komisioni jep vendimin e tij për çështjen.

3. Komisioni informohet në kohë të mjaftueshme, për t'i dhënë mundësi të paraqesë komentet e tij për çdo plan që ka të bëjë me dhënien ose ndryshimin e një ndihme. Nëse

gjykon se një plan i tillë nuk pajtohet me tregun e brendshëm, sipas nenit 107, Komisioni fillon pa vonesë procedurën e parashikuar në paragrafin 2. Shteti Anëtar në fjalë nuk i zbaton masat e propozuara gjersa nga kjo procedurë të ketë dalë një vendim përfundimtar”.

Siç u analizua më sipër, Komisioni është një institucion i Bashkimit Evropian kompetencat e të cilit rrjedhin nga Traktati për Funksionimin e Bashkimit Evropian. Drejtoria përgjegjëse në Komision për kontrollin e ndihmës Shtetërore në disa sektorë të ekonomisë është Drejtoria e Përgjithshme për Konkurrencën. Gjithsesi, ka Drejtori të tjera të Përgjithshme të cilat kanë gjithashtu kompetenca për kontrollin e subvencioneve duke qenë se disa sektorë të ekonomisë kanë rregulla të ndryshme në lidhje me ndihmën Shtetërore. Këto sektorë janë sektori i bujqësisë, në këtë sektor përgjegjëse për kontrollin e subvencioneve është Drejtoria e Përgjithshme e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, sektori peshkimit ku përgjegjëse është Drejtoria për Peshkimin e Komisionit. Gjithsesi Komisioni në çështjet në lidhje me konkurrencën duke përfshirë dhe ato në lidhje me ndihmën Shtetërore, luan rolin investiguesit (hetuesit), gjyqtarit, prokurorit (Jones & Sufrin, 2014:933).

Procedura administrative në lidhje me çështjet mbi ndihmën Shtetërore ka qenë fillimisht e bazuar në legjislacionin parësor të BE-së dhe praktikën e Komisionit si dhe praktikën gjyqësore të Gjykatave të Bashkimit Evropian. Në 22 Mars të vitit 1999 u miratua nga Këshilli një “Rregullore që përcakton rregulla të detajuara për zbatimin e nenit

93 [tani neni 108] të Traktatit të Komunitetit Evropian” (“Rregullorja Procedurale”).¹⁸⁰ Objektivi i parë i Rregullores Procedurale ishte të kodifikonte në një dokument ligjërish të detyrueshëm rregullat procedurale, të zhvilluara nga Gjykata e Evropiane e Drejtësisë nëpërmjet praktikës së saj gjyqësore dhe praktikës së Komisionit. Ndërsa, objektivi i dytë ishte forcimi i kontrollit të ndihmave Shtetërore duke hequr ato aspekte të sistemit ekzistues që rrezikonin funksionimin e duhur dhe efektivitetin e rregullave për ndihmën Shtetërore si dhe efikasitetin e sistemit procedural. Në kuadër të Modernizimit të Ndhmës Shtetërore u bënë disa ndryshime të Rregullores Procedurale.¹⁸¹ Këshilli miratoi në 22 Korrik 2013 Rregulloren Nr. 734/2013 e cila ndryshonte Rregulloren Nr. 659/1999 që përcakton rregulla të detajuara për zbatimin e nenit 93 [tani neni 108] të Traktatit të Komunitetit Evropian (“Rregullorja e re Procedurale”).¹⁸² Këto Rregullore përmbajnë rregulla në lidhje me kompetencat e Komisionit dhe janë direkt të zbatueshme në Shtetet Anëtare të Bashkimit Evropian. Gjithashtu ato janë të zbatueshme për të gjitha llojet e ndihmave pavarësisht nga sektori ekonomik në të cilin është zbatuar ndihma Shtetërore. Rrjedhimisht neni 108 i Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Evropian do të lexohet së bashku me Rregulloren

¹⁸⁰ Council Regulation 1999/659/EC of 22 March 1999 laying down detailed rules for the application of Article 93 of the EC Treaty, OJ L 83/1, 27 March 1999. (Rregullore e Këshillit 1999/659/EC, 22 Mars 1999 për përcaktimin e rregullave të detajuara për zbatimin e nenit 93 të Traktatit të Komunitetit Evropian).

¹⁸¹ Communication from the Commission to the European Parliament, the Council, the European Economic and Social Committee and the Committee of the Regions COM (2012) 209, 8.5.2012 (Communication on State Aid Modernisation) – (Komunikim mbi Modernizimin e Ndhmës Shtetërore). (Komunikim nga Komisioni për Parlamentin Evropian, Këshillin, Komitetin Ekonomik dhe Shoqëror dhe Komitetin e Rajoneve).

¹⁸² Council Regulation 2013/734/EC of 22 July 2013 OJ L204/15, 31 July 2013, amending Council Regulation 1999/659/EC of 22 March 1999 laying down detailed rules for the application of Article 93 of the EC Treaty, OJ L 83/1, 27 March 1999. (Rregullore e Këshillit 2013/734/EC, 22 Korrik 2013 OJ L204/15, 31 Korrik 2013, e cila ndryshon Rregulloren e Këshillit 1999/659/EC, 22 Mars 1999 për përcaktimin e rregullave të detajuara për zbatimin e nenit 93 të Traktatit të Komunitetit Evropian).

3.7. Kontrolli *ex-ante* i ndihmës Shtetërore dhe monitorimi *ex-post*

Neni 108 TFBE i jep të drejtën Komisionit së pari, të kontrollojë ndihmat e reja Shtetërore të cilat i janë njoftuar Komisionit dhe së dyti, të monitorojë ndihmën e cila është zbatuar. Ky është një sistem i dyfishtë kontrolli: kontrolli *ex ante* që do të thotë shqyrtimi i të gjitha masave të propozuara përpara se të jepet ndihma Shtetërore dhe monitorimi *ex-post* që do të thotë monitorimi i ndihmave ekzistuese.

Monitorimi *ex-post* nga Komisioni është shumë i rëndësishëm për të gjithë sistemin e kontrollit të ndihmës Shtetërore. Monitorimi *ex-post* i jep të drejtën Komisionit të sigurohet që të gjitha ndihmat Shtetërore të autorizuara të vazhdojnë të jenë të pajtueshme me tregun e brendshëm, të mos ndryshojnë dhe të mos prodhojnë efekte negative që do shtrembëronin tregun.

Për më tepër, detyrimi i Shteteve Anëtare për t'i paraqitur Komisionit raporte vjetore parashikohet nga Rregullorja Procedurale dhe mbështet Komisionin në ushtrimin e kompetencave të tij në lidhje me monitorimin *ex post*.¹⁸³ Ekzistojnë rregulla të detajuara në lidhje me formën dhe përmbajtjen e këtyre raporteve¹⁸⁴ në mënyrë që të jenë sa më efektive. Qëllimi i raporteve është të ndihmojë Komisionin të identifikojë shkelje të mundshme të vendimeve të tij në lidhje me ndihmat Shtetërore. Gjithashtu Komisioni mund

¹⁸³ Neni 27, Council Regulation 2013/734/EC of 22 July 2013 OJ L204/15, 31 July 2013, amending Council Regulation 1999/659/EC of 22 March 1999 laying down detailed rules for the application of Article 93 of the EC Treaty, OJ L 83/1, 27 March (Mars) 1999. (Rregullore e Këshillit 2013/734/EC, 22 Korrik 2013 OJ L204/15, 31 Korrik 2013, e cila ndryshon Rregulloren e Këshillit 1999/659/EC, 22 Mars 1999 për përcaktimin e rregullave të detajuara për zbatimin e nenit 93 të Traktatit të Komunitetit Evropian).

¹⁸⁴ Nenet 5,6,7 Council Regulation 2004/794/EC of 21 April 2004 implementing Council Regulation 1999/659/EC laying down detailed rules for the application of Article 93 of the EC Treaty, OJ 2004 L 140/1. (Rregullore e Këshillit 2004/794/EC, 21 Prill 2004 e cila zbaton Rregulloren e Këshillit 1999/659/EC, për përcaktimin e rregullave të detajuara për zbatimin e nenit 93 të Traktatit të Komunitetit Evropian).

të bëjë dhe verifikime në vend¹⁸⁵ kur ka dyshime nëse një Shtetet Anëtar po përmbush detyrimet e tij në lidhje me ndihmat Shtetërore të njoftuara.

3.8. Llojet e ndihmës

Bazuar në nenin 108 TFBE dhe Rregulloren Procedurale ndihma kategorizohet në katër lloje të ndryshme. Llojet e ndihmës janë: *ndihma e re* e cila është dhënë pas anëtarësimit në Bashkimin Evropian; *ndihma ekzistuese* e cila është dhënë nga Shteti Anëtar përpara anëtarësimit në Bashkimin Evropian; *ndihma e paligjshme* e cila është dhënë pa njoftuar më parë Komisionin dhe pa aprovimin e tij; *ndihma e keqpërdorur* e cila është e autorizuar nga Komisioni por për të cilën nuk janë respektuar kushtet e aprovimit.¹⁸⁶

3.8.1. Ndhmë ekzistuese

Ndihma ekzistuese janë ato ndihma të cilat kanë ekzistuar përpara anëtarësimit të çdo Shteti Anëtar në Bashkimin Evropian. Gjithashtu, bazuar në nenin 1(b) të Rregullores Procedurale ndihma ekzistuese duhet të jetë dhënë fillimisht nga Shtetet përpara anëtarësimit në Bashkimin Evropian dhe duhet të vazhdojë të ekzistojë dhe pas

¹⁸⁵ Neni 22, Council Regulation 2013/734/EC of 22 July 2013 OJ L204/15, 31 July 2013, amending Council Regulation 1999/659/EC of 22 March 1999 laying down detailed rules for the application of Article 93 of the EC Treaty, OJ L 83/1, 27 March (Mars) 1999. (Rregullore e Këshillit 2013/734/EC, 22 Korrik 2013 OJ L204/15, 31 Korrik 2013, e cila ndryshon Rregulloren e Këshillit 1999/659/EC, 22 Mars 1999 për përcaktimin e rregullave të detajuara për zbatimin e nenit 93 të Traktatit të Komunitetit Evropian).

¹⁸⁶ Neni 1, Council Regulation 2013/734/EC of 22 July 2013 OJ L204/15, 31 July 2013, amending Council Regulation 1999/659/EC of 22 March 1999 laying down detailed rules for the application of Article 93 of the EC Treaty, OJ L 83/1, 27 March (Mars) 1999. (Rregullore e Këshillit 2013/734/EC, 22 Korrik 2013 OJ L204/15, 31 Korrik 2013, e cila ndryshon Rregulloren e Këshillit 1999/659/EC, 22 Mars 1999 për përcaktimin e rregullave të detajuara për zbatimin e nenit 93 të Traktatit të Komunitetit Evropian).

anëtarësimit. Komisioni nuk mund të urdhërojë kthimin e ndihmave ekzistuese. Ai mund të rivlerësojë ndihmat ekzistuese dhe vlerëson nëse ato duhet të ndryshohen ose shfuqizohen në mënyrë që të jenë në përputhje me legjislacionin ekzistues të BE-së (Schutte, 2011:179). Ndhmë ekzistuese konsiderohet dhe ndihma e cila është autorizuar nga Komisioni ose Këshilli. Rregullorja Procedurale (Jones & Sufrin, 2014:203) konsideron si ndihmë ekzistuese, ndihmën e cila nuk përmbushte kriteret e ndihmes Shtetërore në kohën kur është dhënë por bëhet ndihmë Shtetërore si pasojë e zhvillimit të tregut të brendshëm. Koncepti i zhvillimit të tregut të brendshëm nuk ka të bëjë me aplikimin në mënyrë më rigoroze të rregullave të Traktatit nga Komisioni. Ky koncept i referohet “një ndryshimi ekonomik dhe ligjor në sektorin përkatës”.¹⁸⁷

Rregullat e BE-së në lidhje ndihmat ekzistuese janë të rëndësishme gjatë fazës së para-anëtarësimit në Bashkimin Evropian, gjatë zhvillimit të negociatave ndërmjet Shtetit aplikues dhe Komisionit, për mbylljen e Kapitullit mbi Konkurrencën. Në vitin 2004, dhjetë Shtete të reja të Evropës Qendrore dhe Lindore u bënë anëtare të BE-së. Të gjitha vendet e Evropës Qendrore dhe Lindore kishin qenë ekonomi të centralizuara kështu që ndërhyrja e Shtetit dhe mbështetja nga fondet publike konsiderohej një metodë shpeshtë për zgjidhjen e problemeve. Për më tepër, si pasojë e një procesi të vështirë tranzicioni ekonomik drejt një ekonomie tregu këto Shtete kishin zbatuar shumë skema të ndihmës për ristrukturim (Krzysztof, 2004:366). Në këto kushte, Komisioni nëpërmjet Marrëveshjeve me vendet Evropës Qendrore dhe Lindore prezantoi ndalimin e ndihmës Shtetërore një riprodhim i nenit 107 Traktati për Funksionimin e Bashkimit Evropian. Gjithashtu, vendet e

¹⁸⁷ Çështje C-182/03 dhe C-217/03 *Belgium and Forum 187 v. Commission (Belgjika dhe Forum 187 k. Komisionit)* [2006] ECR I-5479 para. 71.

Evropës Qendrore dhe Lindore do të krijonin institucione kombëtare në lidhje me monitorimin e ndihmës Shtetërore (Marise, 2003:286). Këto Shtete gjatë fazës së para-anëtarësimit në BE duhet të kishin dhe rezultate bindëse në lidhje me zbatimin e rregullave të ndihmës Shtetërore (Blauberger, 2009:1035).

Duke ndjekur shembullin e zgjerimit të vitit 2004, Komisioni ka prezantuar një sistem të brendshëm monitorimi në Marrëveshjet e Stabilizim Asociimit të nënshkruara me vendet e Ballkanit Perëndimor. Të gjithë Marrëveshjet e Stabilizim Asociimit përmbajnë një ndalim të përgjithshëm të ndihmës Shtetërore dhe krijimin e *“një autoriteti funksionalisht të pavarur të pajisur me të gjitha kompetencat e nevojshme”* për zbatimin e rregullave për ndihmat Shtetërore” (Blauberger, 2009:1035). Në përputhje me detyrimet e përfshira në MSA të gjithë Shtetet e Ballkanit Perëndimor kanë miratuar ligje në lidhje me ndihmat Shtetërore. Për më tepër, kanë krijuar institucione për monitorimin e ndihmës Shtetërore. Kështu Shqipëria, Serbia, Mali i Zi dhe Bosnja Hercegovina kanë krijuar Komisione/Këshill ndërsa Kroacia dhe ish Republika Jugosllave e Maqedonisë i kanë dhënë kompetencën për të kontrolluar ndihmën Shtetërore Autoriteteve përkatëse të Konkurrencës.

3.8.2. Ndihmë e re dhe ndihmë e ndryshuar

Ndihmë e re është çdo ndihmë që nuk është ndihmë ekzistuese ashtu siç përkufizohet ndihma ekzistuese nga Rregullorja Procedurale. Në rastin e ndihmës se re

duhet vënë në lëvizje menjëherë procedura e shqyrtimit paraprak nga Komisioni.¹⁸⁸ Në praktikë problemi kryesor është dallimi midis ndihmës së re dhe ndihmës ekzistuese pasi neni 1(c) i Rregullores Procedurale përcakton se çdo ndihmë ekzistuese që është ndryshuar, që prej vendimit të miratimit, duhet të konsiderohet dhe të trajtohet si ndihmë e re. Do të konsiderohen ndryshime të rëndësishme të cilat bëjnë që ndihma Shtetërore të konsiderohet ndihmë e re: ndryshimi organit që jep ndihmën Shtetërore, ndryshimi i përfituesve të ndihmës Shtetërore, ndryshimi i periudhës së dhënies së ndihmës Shtetërore ndryshimi i shumës së ndihmës Shtetërore. Bazuar në nenin 108(3) TFBE ndihma e re duhet t'i njoftohet Komisionit përpara se të zbatohet, nga Shteti Anëtar që do ta japë atë. Kjo kërkesë parashikohet më tej nga Rregullorja Procedurale në nenin 2 të saj.

3.8.3. Ndihmë Shtetërore e paligjshme dhe ndihmë Shtetërore e keqpërdorur

Neni 1(f) i Rregullores Procedurale përcakton se ndihma e zbatuar në kundërshtim me detyrimin për njoftim të parashikuar nga neni 108(3) TFBE është ndihmë e paligjshme. Ndihma e paligjshme përfshin çdo lloj ndihme që nuk është autorizuar në mënyrë shprehur ose të heshtur nga Komisioni.

Rregullorja Procedurale nuk përcakton ndryshimin midis koncepti të “keqpërdorimit të ndihmës” dhe ndihmës së paligjshme (Sinnaeve dhe Slot, 1999:1194). Keqpërdorimi i ndihmës përkufizohet në nenin 1(g) të Rregullores Procedurale si ndihmë e përdorur nga përfituesi në kundërshtim me vendimin që e autorizon ndihmën. Në rastet e keqpërdorimit të ndihmës është përfituesi i ndihmës i cili është përgjegjës për shkeljen e Traktatit ndërsa

¹⁸⁸ Çështje C-295/97 *Rinaldo Piaggio* [1999] ECR I-3735, para 48.

në rastin e ndihmës së paligjshme është Shteti Anëtar përkatës. Ndryshimi kryesor procedural është se vetë Traktati parashikon që Komisioni duhet të nisë procedurën e shqyrtimit formal përpara se të marrë një vendim në lidhje me ndihmën që është duke e keqpërdorur. Ndërsa, në rastin e ndihmës së paligjshme Komisioni mund të vendosë të mos ngrejë dyshime pa e nisur procedurën e shqyrtimit formal.

3.8.4. Skemë ndihme Shtetërore dhe ndihmë individuale

Për të shmangur njoftime të shumta të masave të ndihmës individuale, Shtetet Anëtare miratojnë shpesh skema ndihme Shtetërore, të cilat përcaktojnë kushtet për dhënien e ndihmës ndërmarrjeve individuale. Mekanizmi i skemave të ndihmës Shtetërore është i tillë që me miratimin e skemës, Komisioni miraton dhe zbatimet e saj në të ardhmen, përveç kur aplikohen kërkesa të veçanta në lidhje me njoftimin.¹⁸⁹ Nga pikëpamja procedurale dallimi ndërmjet një skeme ndihmë Shtetërore dhe një ndihme individuale është i rëndësishëm sepse procedura për ndihmën ekzistuese e parashikuar nga neni 108(1) TFBE zbatohet vetëm për një skeme ndihme.

Neni 1(d) i Rregullores Proçedurale e përkufizon një skeme ndihme Shtetërore si “çdo akt mbi bazën e të cilit, në formë të përgjithshme dhe pa pasur nevojën e akteve të tjera zbatuese, mund t’u jepet ndihmë ndërmarrjeve të përkufizuara në akt në mënyrë të përgjithshme dhe abstrakte”. Ndërsa neni 1(e) i Rregullores Proçedurale përkufizon ndihmën individuale. Sipas këtij neni “ndihmë individuale do të thotë ndihma e cila nuk jepet në bazë të një skeme ose ndihma e dhënë në bazë të një skeme që duhet të njoftohet”.

¹⁸⁹ Çështje C47/91, *Italy v. Commission* (Italia k. Komisionit), [1994] ECR I4635.

Rrjedhimisht neni përkufizon dy lloj ndihmash individuale. Ai përfshin ndihmën e dhënë jashtë skemës së ndihmës Shtetërore dhe ndihmën që duhet të njoftohet dhënë në bazë të një skeme ndihme Shtetërore. Kategoria e fundit ka të bëjë me situatën ku megjithë miratimin e skemës së ndihmës Shtetërore, kërkohet njoftimi i dhënies së disa ndihmave të caktuara.

3.9. Procedurat në lidhje me ndihmën Shtetërore – katër llojet

Neni 108 TFBE parashikon dy procedura. Neni 108(3) i cili përmban detyrimin për çdo Shtet Anëtar t'i njoftojë Komisionit ndihmën e re ose ndihmën e ndryshuar në një kohë të mjaftueshme për Komisionin që të bëjë komentet e tij përbën bazë për procedurën e shqyrtimit paraprak nga Komisioni e lidhje me masën përkatëse. Ndërsa neni 108(2) TFBE i cili parashikon që Komisioni të ketë njoftuar palët e interesuara për të paraqitur komentet e tyre dhe se Komisioni mund të gjejë se ndihma nuk është pajtueshme me tregun e brendshëm përbën bazën për procedurën e shqyrtimit formal. Këto hapa proceduralë zbatohen në mënyra të ndryshme për secilën prej kategorive të ndihmës të përkufizuar më sipër (Nicolaidis, 2008:90).

3.9.1. Procedura në lidhje me ndihmën e re

Rregullorja Procedurale në nenin 2 (1) dhe Traktati për Funkcionimin e Bashkimit Evropian në nenin 108 (3) TFBE parashikojnë detyrimin e çdo Shteti Anëtar për të njoftuar Komisionin në lidhje me çdo plan për dhënien e ndihmës së re në një kohë të mjaftueshme

për Komisionin që të bëjë komentet e tij. Pasi Komisioni merr një njoftim nga Shteti Anëtar në lidhje me planet për dhënien e ndihmave Shtetërore ai fillon procedurën e shqyrtimit paraprak të masës.¹⁹⁰ Gjykata e Drejtësisë ka vendosur se duhet të ketë afate të qarta për kohëzgjatjen e procedurës së shqyrtimit paraprak. Nëse Komisioni nuk ka marrë një vendim brenda dy muajve nga njoftimi atëherë Shteti Anëtar ka të drejtë të zbatojë ndihmën në fjalë. Gjithsesi, Shteti Anëtar duhet të njoftojë Komisionin në lidhje me këtë veprim.¹⁹¹ Afati prej dy muajsh është materializuar më pas në Rregulloren Procedurale.

Gjatë fazës së shqyrtimit paraprak Komisioni krijon një opinion *prima facie* në lidhje me planin e njoftuar për dhënien e ndihmës. Rrjedhimisht në përfundim të kësaj faze Komisioni është në gjendje, pa patur nevojën e një shqyrtimi me hollësi, të arrijë në përfundimin nëse masa është e pajtueshme me tregun e brendshëm ose nëse masa ngre dyshime në lidhje me pajtueshmërinë me tregun e brendshëm.¹⁹²

Siç parashikohet në Rregulloren Procedurale Komisioni mund ta përfundojë procedurën e shqyrtimit paraprak në tre mënyra të ndryshme. Së pari, Komisioni mund të arrijë në përfundimin që masa nuk përbën ndihmë.¹⁹³ Së dyti, Komisioni mund të vendosë që masa është e pajtueshme me tregun e brendshëm, Komisioni shpesh deklaron që “nuk ngre kundërshtime” në lidhje me masën pa deklaruar formalisht nëse masa është e

¹⁹⁰ Neni 108(3) Treaty on the Functioning of the European Union (TFEU) (Traktati për Funkcionimin e Bashkimit Evropian) (TFBE) [2012] OJ C326/47 dhe Neni 4 Council Regulation 1999/659/EC of 22 March 1999 laying down detailed rules for the application of Article 93 of the EC Treaty, OJ L 83/1, 27 March (Mars) 1999. (Rregullore e Këshillit 1999/659/EC, 22 Mars 1999 për përcaktimin e rregullave të detajuara për zbatimin e nenit 93 të Traktatit të Komunitetit Evropian).

¹⁹¹ Çështje 120/73 *Gebr Lorenz GmbH v. Germany (Gebr Lorenz GmbH k Gjermanise)* [1973] ECR 1471 para 4.

¹⁹² Çështje C-204/97, *Portugal v. Commission (Portugalia k. Komisionit)* [2001] ECR I-3175 para 35.

¹⁹³ Neni 4(2) Council Regulation 1999/659/EC of 22 March 1999 laying down detailed rules for the application of Article 93 of the EC Treaty, OJ L 83/1, 27 March (Mars) 1999. (Rregullore e Këshillit 1999/659/EC, 22 Mars 1999 për përcaktimin e rregullave të detajuara për zbatimin e nenit 93 të Traktatit të Komunitetit Evropian).

pajtueshme me tregun e brendshëm.¹⁹⁴ Së treti, Komisioni mund të përfundojë procedurën e shqyrtimit paraprak duke hapur procedurën e shqyrtimit formal sipas nenit 108(2) TFBE. Procedura e shqyrtimit formal hapet në rast se Komisioni ka dyshime në lidhje me pajtueshmërinë e masës me tregun e brendshëm.¹⁹⁵ Gjatë procedurës së shqyrtimit formal, Komisioni kërkon informacion të plotë nga Shteti Anëtar në lidhje me faktet e një çështje të veçantë dhe njofton palët e treta të paraqesin komentet e tyre. Në përfundim të procedurës së shqyrtimit formal Komisioni mund të marrë një vendim pozitiv ose një vendim që nuk ka ndihmë Shtetërore, ose një vendim negativ (Nourissat, 2012:374). “Vendim pozitiv” do të thotë që ekziston ndihma Shtetërore por konsiderohet në përputhje me tregun e brendshëm. Komisioni mund të japë një vendim pozitiv me kushte. Komisioni mund të konsiderojë që masa e njoftuar nuk përbën ndihmë Shtetërore nëse plotësohen elementët e nenit 107(1) TFBE. Ndërsa “vendimi negativ” do të thotë që ndihma e njoftuar nuk pajtohet me tregun e brendshëm dhe si tillë nuk duhet të zbatohet. Afati për marrjen e një vendimi nga Komisioni gjatë fazës së shqyrtimit formal është 18 muaj nga fillimi i saj. Pas këtij afati Shteti Anëtar mund t’i kërkojë Komisionit të marrë një vendim brenda dy muajve të tjerë. Nëse Komisioni nuk ka marrë informacion mjaftueshëm për të vlerësuar nëse masa është në përputhje me tregun e brendshëm atëherë ai merr një vendim negativ.

¹⁹⁴ Po aty neni 4(3).

¹⁹⁵ Po aty neni 4(4).

3.9.2. Procedura në lidhje me ndihmën e paligjshme

Procedura në lidhje me ndihmën Shtetërore të paligjshme është e ngjashme me procedurën në lidhje me ndihmën e re e cila u trajtua më sipër. Rrjedhimisht, ajo konsiston në dy faza: faza shqyrtimit paraprak dhe faza e shqyrtimit formal. Gjithsesi, ka disa elementë të cilët dallojnë procedurën në lidhje me ndihmën e re nga procedura në lidhje me ndihmën Shtetërore të paligjshme të cilat do të analizohen më poshtë.

Neni 10(1) i Rregullores Procedurale e detyron Komisionin të fillojë shqyrtimin sa herë që ka informacion nga çdo burim në lidhje me ndihmë të pretenduar si të paligjshme. Një informacion i tillë mund t'i mbërrijë Komisionit *ex officio*, nëpërmjet një ankimi ose si rezultat e bashkëpunimit me gjykatat kombëtare. Afati dy mujor i sipërpërmendur në lidhje me procedurën e shqyrtimit paraprak nuk zbatohet, por Komisioni duhet të shqyrtojë pa vonesë çdo informacion që ka në dispozicion dhe nëse është e nevojshme të kërkojë informacion shtesë nga Shteti Anëtar.¹⁹⁶ Gjithashtu, Rregullorja Procedurale nuk parashikon ndonjë afat ligjor brenda të cilit Komisioni duhet të marrë një vendim gjatë procedurës së shqyrtimit formal në lidhje me ndihmën e paligjshme. Përsa i përket llojeve të vendimeve që Komisioni mund të marrë në lidhje me ndihmën e paligjshme ato janë të njejta me vendimet që Komisioni merr në rastin e ndihmës së njoftuar. Rrjedhimisht, Komisioni mund të marrë një vendim pozitiv ose një vendim që nuk ka ndihmë Shtetërore, ose një vendim negativ (Nourissat, 2012:374). “Vendim pozitiv” do të thotë që ekziston ndihma Shtetërore por konsiderohet në përputhje me tregun e brendshëm. Komisioni mund të japë një vendim pozitiv me kushte. Komisioni mund të konsiderojë që masa e njoftuar

¹⁹⁶ Çështje C-204/97, *Portugal v. Commission (Portugalia k. Komisionit)* [2001] ECR I-3175.

nuk përbën ndihmë Shtetërore nëse plotësohen elementët e nenit 107(1) TFBE. Ndërsa “vendimi negativ” do të thotë që ndihma e njoftuar nuk pajtohet me tregun e brendshëm dhe si tillë nuk duhet të zbatohet.

3.9.3. Procedura në lidhje me ndihmën e keqpërdorur

Procedura që ndiqet në rastin e ndihmës së keqpërdorur është e ngjashme me atë që ndiqet në rastin e ndihmës së paligjshme (Nicolaidis, 2008:90). Një ndryshim në procedurën për ndihmën e paligjshme dhe ndihmën e keqpërdorur qëndron në mënyrën e fillimit të tyre. Në rastin e ndihmës së keqpërdorur, ndihma është njoftuar përpara se të zbatohet, por një ndryshim në mënyrën e përdorimit të ndihmës nga përfituesi i ndihmës Shtetërore e klasifikon atë si ndihmë të keqpërdorur. Ndërsa në rastin e ndihmës së paligjshme nuk ka patur njoftim që nga momenti i zbatimit të ndihmës.

3.10. Palët e interesuara – të drejtat procedurale

Neni 1 (h) i Rregullores Procedurale përkufizon palët e interesuara si çdo Shtet Anëtar dhe çdo person ndërmarrje ose bashkim ndërmarrjesh interesat e të cilave mund të cenohen nga dhënia e ndihmës Shtetërore. Rregullorja Procedurale ka kodifikuar të drejtat e palëve të interesuara . Ato janë si më poshtë:

- E drejta për të paraqitur komente brenda afatit të përcaktuar nga Komisioni në një vendim për hapjen e procedurës së shqyrtimit formal (neni 6(1));

- E drejta e palëve të interesuara, të cilët kanë paraqitur komentet e tyre, për të marrë një kopje të vendimit përfundimtar të Komisionit (neni 20(1));
- E drejta për të informuar Komisionin, nëse gjykohet se ndihma është e paligjshme ose nëse ndihma është keqpërdorur dhe e drejta për t'u informuar nga Komisioni, nëse ky i fundit gjykon që në bazë të informacionit në zotërim nuk ka shkaqe të mjaftueshme për të marrë çështjen në shqyrtim (neni 20(2));
- E drejta për të marrë një kopje të vendimit përfundimtar të Komisionit ku ky i fundit argumenton se në bazë të informacionit në zotërim nuk ka shkaqe të mjaftueshme për të marrë çështjen në shqyrtim (neni 20(2));
- E drejta për të marrë sipas kërkesës kopje të çdo vendimi të marrë nga Komisioni gjatë procedurave për shqyrtimin e çdo lloj ndihme (neni 20(3));

E drejta e palëve të interesuara për të paraqitur komentet tyre ushtrohet vetëm gjatë fazës së shqyrtimit formal nga Komisioni. Ndërsa, gjatë fazës së shqyrtimit paraprak palët e interesuara nuk kanë të drejtën të dëgjohen. Rregullorja Procedurale ka qenë objekt kritikash në lidhje me të drejtat e kufizuara të palëve të interesuara që ajo garanton (Bartosch, 2007:482). Sipas Rregullores Procedurale, procedurat për ndihmën Shtetërore janë një dialog bilateral ndërmjet Komisionit dhe Shtetit Anëtar përkatës. Ky karakter bilateral përjashton mundësinë e një procedure të veçantë për ankimet dhe i përfshin palët e treta vetëm gjatë procedurës së shqyrtimit formal. Palët e treta përfshihen gjatë procedurës së shqyrtimit formal me qëllim që t'i japin Komisionit të gjithë informacionin për të cilin ai ka nevojë për të vlerësuar pajtueshmërinë e ndihmës me tregun e brendshëm (Sinnaeve & Slot, 1999:1194).

Komisioni i konsideron palët e treta si burim informacioni në monitorimin e zbatimit të rregullave për ndihmën Shtetërore nga Shtetet Anëtare. Gjithsesi, roli i tyre që në fillim ka qenë i kufizuar vetëm gjatë procedurës së shqyrtimit formal. Kjo qasje evidenton konceptin “instrumental” ose “utilitar” të rregullave procedurale për ndihmën Shtetërore, të cilat konsiderojnë palët e treta si burim informacioni dhe pa një status procedural (Nehl, 2014:237).

Rregullorja e re Procedurale¹⁹⁷ përdor për herë të parë fjalën “ankim” në legjislacionin dytësor të BE-së në lidhje me ndihmat Shtetërore. Ajo formalizon disa hapa në lidhje me procedurën trajtimit të ankimeve. Së pari, çdo ankues duhet të demonstrojë se ai është një palë e interesuar sipas kuptimit të nenit 108(2) TFBE dhe nenit 1(h) të Rregullores Procedurale.¹⁹⁸ Së dyti, sipas ndryshimeve që i janë bërë nenit 20(1) dhe (2) të Rregullores Procedurale çdo palë e interesuar (përfshirë dhe ankuesin) duhet të plotësojë një formë ankimi e cila përmban disa informacione të detyrueshme që janë përcaktuar nga Rregullorja Zbatuese miratuar nga Komisioni.¹⁹⁹ Qëllimi i Komisionit është të përmirësojë cilësinë e ankimeve të paraqitura dhe të rrisë transparencën dhe sigurinë juridike.²⁰⁰ Ankimet e paraqitura që nuk plotësojnë këto kushte do të trajtohen si informacione mbi

¹⁹⁷ Council Regulation 2013/734/EC of 22 July 2013 OJ L204/15, 31 July 2013, amending Council Regulation 1999/659/EC of 22 March 1999 laying down detailed rules for the application of Article 93 of the EC Treaty, OJ L 83/1, 27 March 1999. (Rregullore e Këshillit 2013/734/EC, 22 Korrik 2013 OJ L204/15, 31 Korrik 2013, e cila ndryshon Rregulloren e Këshillit 1999/659/EC, 22 Mars 1999 për përcaktimin e rregullave të detajuara për zbatimin e nenit 93 të Traktatit të Komunitetit Evropian).

¹⁹⁸ Po aty Recitali 15.

¹⁹⁹ Po aty.

²⁰⁰ Council Regulation 2013/734/EC of 22 July 2013 OJ L204/15, 31 July 2013, amending Council Regulation 1999/659/EC of 22 March 1999 laying down detailed rules for the application of Article 93 of the EC Treaty, OJ L 83/1, 27 March 1999, Recital 15, Recitali 14. (Rregullore e Këshillit 2013/734/EC, 22 Korrik 2013 OJ L204/15, 31 Korrik 2013, e cila ndryshon Rregulloren e Këshillit 1999/659/EC, 22 Mars 1999 për përcaktimin e rregullave të detajuara për zbatimin e nenit 93 të Traktatit të Komunitetit Evropian)

tregun dhe nuk do të çojnë domosdoshmërisht në investigime *ex officio*.²⁰¹ Së treti, neni 20(2) i Rregullores së re Procedurale formalizon mundësinë e Komisionit për t'i konsideruar të tërhequr ankimet në qofte se ankuesi nuk jep informacion të rëndësishëm ose nuk bashkëpunon gjatë procedurës.

3.11. Kthimi i ndihmës Shtetërore

Kthimi është një pasoje logjike e një ndihme që është dhënë në mënyrë të paligjshme dhe që është e papajtueshme me tregun e brendshëm.²⁰² Kthimi ka si qëllim të rivendosë pozicionin “*ex ante*” përpara prishjes së konkurrencës të shkaktuar nga dhënia e ndihmës.²⁰³ Kështu, kthimi nuk ka si qëllim dënojë sjelljen e Shtetit Anëtar dhe aq më pak sjelljen e ndërmarrjes përfituese të ndihmës Shtetërore. Baza ligjore e kthimit të ndihmës Shtetërore është neni 14 i Rregullores Procedurale, i cili nuk i jep diskrecion Komisionit por e detyron atë të urdhërojë kthimin e ndihmës. Përpara miratimit të Rregullores Procedurale, kthimi njihej nga Gjykata vetëm si një alternativë në dispozicion të Komisionit, i cili mund të kërkonte riparimin e ndihmës së paligjshme.²⁰⁴

Komisioni mund të japë një vendim për kthim në rastet kur ka të bëjë me ndihmë që nuk është njoftuar dhe nuk është e pajtueshme me tregun e brendshëm. Një ndihmë e panjoftuar nuk është automatikisht e papajtueshme me tregun e brendshëm. Komisioni mund të vendosë që një ndihmë e panjoftuar të jetë e pajtueshme me tregun e brendshëm

²⁰¹ Po aty.

²⁰² Gjykatat Evropiane kanë një interpretim të qëndrueshëm. Shiko çështje C-214/07 *Commission v. France* (Komisioni k Francës) [2008] ECR I-8357; Çështje T-75/03 *Banco Commercial des Acores* [2009] ECR II-43.

²⁰³ Çështje C-280/92, *Spain v. Commission* (Spanja k. Komisionit) [1994] ECR I-4103, para. 75.

²⁰⁴ Çështje 70/72, *Commission v. Germany* (Komisioni k Gjermanisë) [1973] ECR 813 para 13.

sipas nenit 107 TFBE. Kthimi mund të urdhërohet për ndihmën e paligjshme dhe ndihmën e keqpërdorur. Ku ndihma e paligjshme është ndihma që nuk është njoftuar dhe nuk është e pajtueshme me tregun e brendshëm sipas nenit 107(2) ose nuk mund të deklarohet e pajtueshme me tregun e brendshëm sipas nenit 107(3) TFBE. Ndërsa ndihma e keqpërdorur është ndihma që nuk është përdorur në përputhje me vendimin e Komisionit që e ka deklaruar atë të papajtueshme me tregun e brendshëm.

3.11.1. Kufizimet e kthimit të ndihmës

I vetmi kufizim në lidhje me detyrimin për kthimin e ndihmës së paligjshme ka të bëjë me ekzistencën e rrethanave të jashtëzakonshme të cilat do ta bënin absolutisht të pamundur kthimin e ndihmës nga Shteti Anëtar.²⁰⁵ Termi “pamundësi absolute” është interpretuar në mënyrë të ngushtuar nga Gjykatat Evropiane. Vështirësi praktike administrative të tilla si numri i madh i përfituesve të ndihmës Shtetërore dhe i autoriteteve të përfshira nuk përbejnë pamundësi absolute sipas saj.²⁰⁶

Rregullorja Procedurale ka kodifikuar dy kufizime të tjera. Kështu, neni 14 i Rregullores Procedurale parashikon një përjashtim nga detyrimi për të urdhëruar kthimin e ndihmës së papajtueshme të paligjshme. Kështu neni 14(1) i Rregullores Procedurale parashikon që *“Komisioni nuk mund të kërkojë kthim të ndihmës nëse kjo do të ishte në kundërshtim me parimet e përgjithshme të së Drejtës Evropiane”*. Parimet e përgjithshme të së Drejtës Evropiane që përdoren zakonisht në këtë kontekst janë: parimi i pritshmërisë

²⁰⁵ Çështje C-52/84, *Commission v. Belgium* (Komisioni k. Belgjikës) [1986] ECR 89, para. 14.

²⁰⁶ Çështje C-214/07 *Commission v. France* (Komisioni k. Francës) [2008] ECR I-8357.

legjitime dhe parimi i sigurisë juridike, të cilat do të trajtohen më poshtë. Një kufizim tjetër parashikohet nga neni 15 i Rregullores Procedurale. Sipas këtij neni “kompetencat e Komisionit për të urdhëruar kthimin e ndihmës janë subjekt i një afati kohor prej dhjetë vjetësh.”.

3.11.1.1. Parimi i pritshmërisë legjitime dhe kthimi i ndihmës Shtetërore

Shtetet Anëtare dhe përfituesit e ndihmës Shtetërore mund të ndalojnë Komisionin nga vendosja e detyrimit për kthimin e ndihmës Shtetërore ndaj një Shteti Anëtar, duke përdorur parimet e përgjithshme të së drejtës evropiane. Parimi i pritshmërisë legjitime dhe sigurisë juridike janë përdorur në shumë çështje dhe në shumicën e rasteve pa sukses.

Sipas praktikës gjyqësore për një aplikimin të suksesshëm të parimit të pritshmërisë legjitime duhet të plotësohen disa kushte. Kërkuesi duhet të provojë se ai/ajo ishte siguruar nga ligjvënësi, nga organet zbatuese të ligjit, që situata e tij/saj nuk do të ndryshonte negativisht. Parimi i pritshmërisë legjitime mund të pretendohet vetëm nga përfituesi i ndihmës dhe jo nga një Shtet Anëtar. Në çështje *Fleuren Compost*²⁰⁷ Gjykata e Shkallës së Parë (tani Gjykata e Përgjithshme) deklaroi se çdo pritshmëri e krijuar gabimisht nga Shteti Anëtar për të cilën Komisioni nuk është informuar nuk mund të ndikojë në pajtueshmërinë e vendimit të kundërshtuar me ligjin. Ndërsa në çështjen *Landbroke Racing*²⁰⁸ Gjykata e Shkallës së Parë deklaroi se vetëm përfituesi i ndihmës

²⁰⁷ Çështje T-109/01, *Fleuren Compost BV v. Commission (Fleuren Compost BV k Komisionit)*, [2004], ECR 1-127, para. 147.

²⁰⁸ Çështje T-67/94, *Ladbroke Racing Ltd. v. Commission (Ladbroke Racing Ltd. k Komisionit)*, [1998], ECR 11-1, para. 183.

Shtetërore dhe jo Shteti Anëtar mund të ngrejë pretendimin bazuar në ekzistencën e rrethanave të jashtëzakonshme në bazë të të cilave ai ka krijuar pritshmëri legjitime që do të çojnë në refuzimin për të kthyer ndihmën Shtetërore. Një përfitues i ndihmës Shtetërore duhet të plotësojë disa kushte për një aplikim të suksesshëm të parimit të pritshmërisë legjitime: së pari duhet të provojë se siguria i është dhënë nga një institucion i Bashkimit Evropian dhe jo nga një institucion i Shtetit Anëtar;²⁰⁹ së dyti, edhe operatori më i matur dhe më kujdesshëm në treg nuk mund të ketë qenë në gjendje të parashikojë ndryshimin negativ të situatës së tij/saj ligjore.²¹⁰

Normalisht një përfitues i ndihmës Shtetërore i cili nuk ka kontrolluar respektimin të gjitha procedurave të parashikuara në nenin 108 TFBE në lidhje me ndihmën që i është dhënë nuk mund të pretendojë shkelje të parimit të pritshmërisë legjitime. Kjo për arsye se një operator i matur dhe i kujdesshëm në treg duhet ta kishte ditur nëse procedura ishte ndjekur ose jo.²¹¹ Kjo do të thotë se pothuajse në të gjitha rastet kur nuk është bërë njoftimi, përfituesi duhet të presë një kthim të mundshëm të ndihmës pas një vendimi negativ të Komisionit.

3.11.1.2. Parimi i sigurisë juridike dhe kthimi i ndihmës Shtetërore

Parimi i sigurisë juridike është një nga parimet e përgjithshme të së drejtës evropiane dhe gjithashtu një nga parimet e përgjithshme të një sistemi ligjor të zhvilluar.

²⁰⁹ Çështje C-217/03, *Belgium and Forum 187 v. Commission (Belgium dhe Forum 187 k. Komisionit)* [2006], ECR I-5479, para. 16.

²¹⁰ Çështje T-109/01, *Fleuren Compost BV v. Commission (Fleuren Compost BV k Komisionit)*, [2004], ECR I-127, para. 147.

²¹¹ Çështje C-301/87, *France v. Commission (Franca k Komisionit)*, [1990] ECR I-307, para 104.

Sipas këtij parimi një person ka të drejtë të presë që të drejtat e tij/saj të mos shkelen pa një arsye të vlefshme. Pretendime të bazuara në këtë parim shpesh ngrihen para gjykatave të Bashkimit Evropian kundër vendimeve të Komisionit të cilat urdhërojnë Shtetet Anëtare të kthejnë ndihmën Shtetërore së bashku me pretendimin për shkeljen e parimit të pritshmërisë legjitime. Kjo mund të ngrejë dyshime nëse këto janë dy parime të veçanta ose nëse në bazë të një parimi të vetëm palët në proces përpiqen të paraqesin pretendime të ndara.

Këto dyshime fitojnë terren shtesë bazuar edhe në faktin që praktika gjyqësore nuk e ka sqaruar definitivisht këtë problem. Në të vërtetë këto dy parime megjithëse referohen veçmas në praktikën gjyqësore shpesh konsiderohen së bashku.²¹² Gjithsesi, çështja *Salzgitter* përbën një hap përpara pasi Gjykata e Shkallës së Parë deklaroi se: “Gjithsesi kërkuuesi nuk po kërkon respektimin e parimit të pritshmërisë legjitime bazuar në faktin se ndihma ishte dhënë në mënyrë të ligjshme por pretendon një shkelje të parimit të sigurisë juridike një çështje e cila nuk varet vetëm nga kushtet për krijimin e një pritshmërie legjitime nga ana e përfituesit të ndihmës”.²¹³

Në gjykimin e sipërpërmendur Gjykata e Shkallës së Parë jo vetëm bëri dallimin midis këtyre dy parimeve por gjithashtu vuri në dukje se në lidhje me parimin e sigurisë juridike, kërkesat duhet të jenë më të rrepta sesa në lidhje me parimin e pritshmërisë legjitime. Ky konkluzion është konfirmuar gjithashtu nga deklarata e Gjykatës së Shkallës së Parë se shkelja nga Komisioni i parimit themelor të sigurisë juridike nuk mund të

²¹² Çështje 21/81, *Openbaar Ministerie dhe Daniel Bout dhe BVI Bout en Zonen*, [1982], ECR 381, para. 13; Çështje C-34/92, *Gru Sa Fleisch GmbH&Co. KG, Import-Export dhe Hauptzollamt Hamburg-Jonas*, [1993], ECR 1-4147, para. 22; Çështje C-1 62/00, *Pokrzeptowicz-Meyer*, [2002], ECR 1-1049, para. 49.

²¹³ Çështje T-308/00, *SalzgitterAG and Germany v Commission (SalzgitterAG dhe Gjermania k Komisionit)*, [2004], ECR 11-1933, para. 166.

përfashtohet as për shkak të mungesës së një kufizimi kohor as për shkak të dështimit të një Shteti Anëtar për të bërë njoftimin paraprak të ndihmës.²¹⁴

Është vështirë të thuhet nëse ky gjykim fillon një linjë të praktikës gjyqësore, por është e qartë se një sqarim i kuptimit të saktë të parimit të sigurisë juridike është i nevojshëm, veçanërisht pasi kjo çështje nuk është sqaruar deri tani në vendimmarrjen e Komisionit.

²¹⁴ Çështje T-308/00, *SalzgitterAG and Germany v Commission (SalzgitterAG dhe Gjermania k Komisionit)*, [2004], ECR 11-1933.

KAPITULLI IV

GJYKATA E DREJTËSISË E BASHKIMIT EVROPIAN: ZBATIMI I RREGULLAVE PËR NDIHMËN SHETETËRORE

4.1. Hyrje

Komisioni Evropian dhe Gjykata e Drejtësisë e Bashkimit Evropian ndajnë kompetenca në kontrollin ndihmës Shtetërore në Bashkimin Evropian. Komisioni Evropian dhe Gjykata e Drejtësisë përbëjnë mekanizmin mbikombëtar të kontrollit të ndihmës Shtetërore. Kompetencat e tyre janë sanksionuar në Traktat dhe në legjislacionin dytësor të Bashkimit Evropian. Ky kapitull do të analizojë në mënyrë kritike kompetencat e Gjykatës së Drejtësisë në kontrollin e ndihmës Shtetërore, duke plotësuar aspektin mbikombëtar të kontrollit të ndihmës Shtetërore në BE.

Fillimisht kapitulli bën një analizë të shkurtër të statusit të përgjithshëm të Gjykatës së Drejtësisë së Bashkimit Evropian, për të kuptuar më mirë kompetencat e saj në fushën e ndihmave Shtetërore. Gjithashtu, do të analizohet juridiksioni i Gjykatës së Drejtësisë që ndihmon në arritjen e një konkluzioni në lidhje me ndikimin e saj në politikat për ndihmën Shtetërore në Bashkim. Një problem tjetër që ngrihet në këtë kapitull është vështirësia për të fituar të drejtën për të ngritur padi përpara Gjykatës së Drejtësisë. Ky është një problem për palët e treta që duan të mbrojnë të drejtat e tyre në Gjykatë.

4.2. Statusi i Gjykatës së Drejtësisë dhe Gjykatës së Përgjithshme në rendin ligjor të Bashkimit Evropian

Përpara hyrjes në fuqi të Traktatit të Lisbonës Gjykatat e Komunitetit përfshinin Gjykatën e Drejtësisë, Gjykatën e Shkallës së Parë dhe dhomat juridiksionale. Kjo strukturë është ndryshuar nga Traktati i Lisbonës. Neni 19 TFBE ka prezantuar disa ndryshime në lidhje me strukturën e sipërpërmendur. Tani emërtimi zyrtar është Gjykata e Drejtësisë së Bashkimit Evropian dhe përbëhet nga tre gjykata: Gjykata e Drejtësisë, Gjykata e Përgjithshme,²¹⁵ dhe Gjykata e Shërbimit Civil.²¹⁶ Gjykata Shërbimit Civil ka juridiksion në konfliktet e shërbimit civil në Bashkimin Evropian. Ndërsa, vetëm Gjykata e Drejtësisë dhe Gjykata e Përgjithshme kanë juridiksion të gjykojnë çështje që kanë të bëjnë me ndihmat Shtetërore. Më poshtë do të analizohen përbërja, funksionimi dhe kompetencat e Gjykatës së Drejtësisë dhe Gjykatës së Përgjithshme.

4.2.1. Gjykata e Drejtësisë

Gjykata e Drejtësisë përbëhet nga një gjyqtar për çdo Shtet Anëtar sipas nenit 19(1) të Traktatit të Bashkimit Evropian. Anëtarët emërohen me “një marrëveshje të përbashkët të Qeverive të Shteteve Anëtare”²¹⁷ pas konsultimeve me një panel i cili jep mendimin e tij

²¹⁵ Gjykata e Shkallës së Parë e cila u krijua në vitin 1988 sipas një ndryshimi në Traktat të prezantuar nga Akti i Vetëm Evropian. Council Decision 88/591 [1988] OJ L319/1.

²¹⁶ Council Decision 2004/752/EC, Euroatom of 2 November 2004, establishing the European Union Civil Service Tribunal [2004] OJ L333/7. (Vendim i Këshillit për krijimin e Gjykatës Evropiane të Shërbimit Civil).

²¹⁷ Neni 253 TFBE; Consolidated version of the Treaty on the Functioning of the European Union [2010] OJ C 83/47. (Version i konsoliduar i Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Evropian).

lidhur me përshtatshmërinë e kandidateve për të kryer funksionin e gjyqtarit në Gjykatën e Drejtësisë.²¹⁸ Gjyqtarët dhe Avokatët e Përgjithshëm të Gjykatës së Drejtësisë zgjidhen mes personave për pavarësinë e të cilëve nuk ka dyshime, të cilët përmbushin kushtet e nevojshme për të mbajtur postet më të larta gjyqësore në vendet e tyre përkatëse ose janë juristë me aftësi profesionale të njohura.²¹⁹ Gjykatësit qëndrojnë në detyrë për një periudhë gjashtë vjeçare, me të drejtë riemërimi. Gjithsesi, çdo tre vjet procedohet me një rinovim të pjesshëm të gjyqtarëve.²²⁰ Gjyqtarët zgjedhin një Kryetar nga rradhët e gjyqtarëve.²²¹ Gjithashtu, Gjykata emëron dhe Kancelarin e saj.²²²

Gjykata asistohet nga tetë Avokatë të Përgjithshëm, numër i cili mund të rritet me një vendim unanim të Këshillit.²²³ Kriteret për zgjedhjen dhe procedura e emërimit për Avokatët e Përgjithshëm janë të njejta me ato të gjyqtarëve të Gjykatës së Drejtësisë. Detyra kryesore e Avokatit të Përgjithshëm është që “me paanshmëri dhe pavarësi të plotë, të bëjë parashtrime të arsyetuara në seancë të hapur gjyqësore, për çështje të cilat sipas Statutit të Gjykatës së Drejtësisë të Bashkimit Evropian, kërkojnë përfshirjen e tij.”²²⁴

Gjykata e Drejtësisë gjykon në sesione të mëdha (të përbëra nga trembëdhjetë gjyqtarë) ose në sesione të veçanta të përbëra nga tre ose pesë gjyqtarë në përputhje me rregullat e parashikuara nga statuti i saj. Sesioni i përbërë nga trembëdhjetë gjyqtarë,

²¹⁸ Neni 255 TFBE; Consolidated version of the Treaty on the Functioning of the European Union [2010] OJ C 83/47 (Version i konsoliduar i Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Evropian).

²¹⁹ Neni 253 TFBE; Consolidated version of the Treaty on the Functioning of the European Union [2010] OJ C 83/47 (Version i konsoliduar i Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Evropian).

²²⁰ Po aty.

²²¹ Po aty.

²²² Po aty.

²²³ Neni 252 TFBE; Consolidated version of the Treaty on the Functioning of the European Union [2010] OJ C 83/47 (Version i konsoliduar i Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Evropian).

²²⁴ Po aty.

mbledhet kur kërkohet nga një palë në proces që mund të jetë një Shtet Anëtar ose një institucion, ose në çështje veçanërisht komplekse.²²⁵

Neni 19 TFBE i jep të drejtën Gjykatës së Drejtësisë të “garantojë respektimin e së drejtës së Bashkimit Evropian në interpretimin dhe zbatimin e Traktateve”. Kompetencat e Gjykatës janë të pakundërshtueshme me përjashtim të rasteve të parashikuara shprehimisht nga Traktatet, ku kompetenca i përket gjykatës kombëtare (Canaj & Bana, 2014:123). Gjykata e Drejtësisë ka juridiksion të shqyrtojë:

- ankimet kundër vendimeve të Gjykatës së Përgjithshme;²²⁶
- paditë për anulimin e një akti të miratuar nga institucionet e Bashkimit;²²⁷
- paditë për mospërbushje të detyrimeve nga një Shtet Anëtar sipas së Drejtës së Bashkimit Evropian;²²⁸
- kërkesat për një vendim paraprak të paraqitura nga gjykatat kombëtare;²²⁹
- paditë për mosveprim ndaj një institucioni të Bashkimit Evropian;²³⁰
- paditë për shpërblimin e dëmeve që rrjedhin nga përgjegjësia jashtkontraktore e Bashkimit Evropian.

²²⁵ Neni 16, Protocol (No 3) On the Statute of the Court of Justice of the European Union (Protokoll Nr. 3 Mbi statutin e Gjykatës së Drejtësisë së Bashkimit Evropian) OJ C 83/210.

²²⁶ Neni 257 TFBE; Consolidated version of the Treaty on the Functioning of the European Union [2010] OJ C 83/47 (Version i konsoliduar i Traktatit për Funkcionimin e Bashkimit Evropian).

²²⁷ Neni 263 dhe 264 TFBE; Consolidated version of the Treaty on the Functioning of the European Union [2010] OJ C 83/47 (Version i konsoliduar i Traktatit për Funkcionimin e Bashkimit Evropian).

²²⁸ Neni 258, 259 dhe 260 TFBE; Consolidated version of the Treaty on the Functioning of the European Union [2010] OJ C 83/47 (Version i konsoliduar i Traktatit për Funkcionimin e Bashkimit Evropian).

²²⁹ Neni 267 TFBE; Consolidated version of the Treaty on the Functioning of the European Union [2010] OJ C 83/47 (Version i konsoliduar i Traktatit për Funkcionimin e Bashkimit Evropian).

²³⁰ Neni 265 dhe 266 TFBE; Consolidated version of the Treaty on the Functioning of the European Union [2010] OJ C 83/47 (Version i konsoliduar i Traktatit për Funkcionimin e Bashkimit Evropian).

Gjykata interpreton të drejtën e Bashkimit Evropian – gjykatat kombëtare të Shteteve Anëtare në rast se kanë dyshime për interpretimin e Traktateve ose vlefshmërinë dhe interpretimin e legjislacionit dytësor të miratuar nga institucionet e Bashkimit Evropian, mund të pyesin Gjykatën e Drejtësisë.

Gjykata zbaton të drejtën e Bashkimit Evropian. Në rast moszbatimi të detyrimeve që rrjedhin nga Traktati nga një Shtet Anëtar, Komisioni ose çdo Shtet tjetër Anëtar i Bashkimit Evropian ka të drejtë të ngrejë padi në Gjykatën e Drejtësisë. Nëse pas shqyrtimit një Shtet Anëtar rezulton se nuk ka përmbushur detyrimet e tij atëherë ai duhet të ndërmarrë çdo masë për të eliminuar shkeljen dhe pasojat.²³¹ Nëse Shteti nuk e zbaton vendimin e Gjykatës së Drejtësisë atëherë rrezikon një çështje të dytë, në përfundim të së cilës mund të vendoset dhe një gjobë për Shtetin Anëtar përkatës.

Gjykata anulon akte ligjore të Bashkimit Evropian. Nëse një akt i Bashkimit nuk respekton Traktatet ose të drejtat themelore, ai mund të dërgohet për anulim përpara Gjykatës së Drejtësisë. Kërkues në këtë rast mund të jenë: një prej Shteteve Anëtare të BE-së, Këshilli Evropian, Komisioni Evropian dhe në disa raste Parlamenti Evropian. Gjithashtu dhe individët mund të kërkojnë në Gjykatë anulimin e një akti ligjor të BE-së. Sipas nenit 263(4) TFBE personat fizikë ose juridikë, përveç atyre të cilëve i adresohet akti, mund ta kundërshtojnë një akt nëse ai përbën “një interes të drejtpërdrejt dhe direkt” për ata, ndërsa në rastin e akteve rregulluese ato mund t’i kundërshtojnë ato nëse përbëjnë një interes direkt për ata dhe nuk kërkojnë masa të tjera zbatuese. Kushti i fundit në lidhje me “aktet rregulluese” është shtuar nga Traktati i Lisbonës (Hofmann dhe Morini, 2011:340).

²³¹ Çështje 70/72 *Commission v. Germany* (Komisioni k. Gjermanisë) [1973] ECR 813, para. 13.

Gjykata shqyrton rastet e mosveprimit të Shteteve Anëtare. Parlamenti, Këshilli, Komisioni janë të detyruar të marrin vendime në kushte të caktuara. Nëse ato dështojnë në marrjen e këtyre vendimeve atëherë Shtetet Anëtare ose institucionet e Bashkimit Evropian ose individët (duke plotësuar disa kushte) mund të ankohen në Gjykatë.

Gjykata mund të vendosë sanksione ndaj institucioneve të Bashkimit Evropian në rastin e padive për dëmshpërblim. Kështu çdo person apo shoqëri interesat e të cilëve janë dëmtuar për shkak të veprimeve ose mosveprimeve të institucioneve të Bashkimit Evropian mund të paraqesin padi në Gjykatë.

4.2.2. Gjykata e Përgjithshme

Gjykata e Shkallës së Parë u krijua në vitin 1998 sipas Aktit Unik Evropian.²³² Statusi i saj u ndryshua nga Traktati i Nisës dhe Traktati i Lisbonës, i cili siç u përshkrua me lart tani, parashikon se Gjykata e Drejtësisë e Bashkimit Evropian do të përfshijë Gjykatën e Përgjithshme (ish Gjykatën e Shkallës së Parë). Përsa i përket juridiksionit, Gjykata e Përgjithshme ka një status juridiksional të plotë, i cili përfshin mbikëqyrjen e zbatimit të së Drejtës Evropiane në interpretimin dhe zbatimin e Traktatit.²³³

Gjykata e Përgjithshme përbëhet nga të paktën një gjyqtar për çdo Shtet Anëtar.²³⁴ Numri i gjyqtarëve të Gjykatës së Përgjithshme përcaktohet në statutin e Gjykatës së Drejtësisë së Bashkimit Evropian. Gjithashtu, statuti mund të parashikojë që Gjykata e

²³² Single European Act (Akti Unik Evropian) OJ L 169. Akti Unik Evropian ndryshoi Traktet e Romës. Ai ndryshoi rregullat në lidhje me funksionimin e institucioneve evropiane dhe zgjeroi kompetencat e Komunitetit (Bashkimit) në fusha të tilla si kërkim, zhvillim, politikën e jashtme.

²³³ Neni 19 (1), Treaty of European Union (Traktati i Bashkimit Evropian) OJ C 191.

²³⁴ Neni 19(2), Treaty of European Union (Traktati i Bashkimit Evropian) OJ C 191.

Përgjithshme të mbështet nga Avokatët e Përgjithshëm. Anëtarët e Gjykatës së Përgjithshme zgjidhen “mes personave për pavarësinë e të cilëve nuk ka dyshime dhe të cilët kanë aftësitë që kërkohen për emërimin në poste të larta gjyqësore.”²³⁵ Ata emërohen me miratimin e përbashkët të qeverive të Shteteve Anëtare²³⁶ pas konsultimit me një panel të krijuar për të dhënë mendimin e tij në lidhje me përshtatshmërinë e kandidaturave.²³⁷ Gjykata e Përgjithshme zgjedh Kryetarin e saj nga rradhët e gjyqtarëve për një mandat tre vjeçar me të drejtë rizgjedhje.²³⁸ Gjithashtu, Gjykata emëron dhe Kancelarin e saj.²³⁹ Gjykata e Përgjithshme gjykon në panele të përbëra nga tre dhe pesë gjyqtarë ose në disa raste nga një gjyqtar i vetëm (Canaj dhe Bana, 2014:126). Gjithashtu gjykata mund të gjykojë dhe në një sesion të madh të përbërë nga të gjithë gjyqtaret e Gjykatës së Përgjithshme.

Juridiksioni i Gjykatës së Përgjithshme përcaktohet në nenin 256 TFBE. Gjykata e Përgjithshme u krijua fillimisht për të lehtësuar ngarkesën e volumit të punës të Gjykatës së Drejtësisë (Craig dhe de Burca, 2011:429). Neni 256 TFBE parashikon se Gjykata e Përgjithshme ka kompetencë të dëgjojë dhe të vendosë mbi çështjet si më poshtë:

- Padi për anulim (neni 263 TFBE);
- Padi për mosveprim (neni 265 TFBE);

²³⁵ Neni 254 TFBE; Consolidated version of the Treaty on the Functioning of the European Union [2010] OJ C 83/47 (Version i konsoliduar i Traktatit për Funkcionimin e Bashkimit Evropian).

²³⁶ Neni 253 TFBE; Consolidated version of the Treaty on the Functioning of the European Union [2010] OJ C 83/47 (Version i konsoliduar i Traktatit për Funkcionimin e Bashkimit Evropian).

²³⁷ Neni 255 TFBE; Consolidated version of the Treaty on the Functioning of the European Union [2010] OJ C 83/47 (Version i konsoliduar i Traktatit për Funkcionimin e Bashkimit Evropian).

²³⁸ Neni 254 TFBE; Consolidated version of the Treaty on the Functioning of the European Union [2010] OJ C 83/47 (Version i konsoliduar i Traktatit për Funkcionimin e Bashkimit Evropian).

²³⁹ Po aty.

- Padi për shpërblimin e dëmeve të shkaktuara nga përgjegjësitë jashtkontraktore të Bashkimit Evropian (neni 268 TFBE);
- Mosmarrëveshjet midis Bashkimit Evropian dhe punonjësve të tij (neni 270 TFBE);
- Padi të paraqitura bazuar në një klauzole arbitrazhi (kompromisi) (neni 272 TFBE).

Megjithatë, neni i sipërpërmendur parashikon dhe kufizime përsa i përket kompetencës së Gjykatës së Përgjithshme. Kështu, Gjykata nuk mund të shqyrtojë çështje të cilat i takojnë një gjykate të specializuar dhe çështje të cilat sipas Statutit janë në kompetencën ekskluzive të Gjykatës së Drejtësisë. Çështjet të cilat kanë bazë ligjore nenet 258 dhe 259 TFBE, të cilat kanë të bëjnë me padi direkte kundër Shteteve Anëtare për mospërbushje të detyrimeve që rrjedhin nga Traktet janë kompetencë ekskluzive e Gjykatës së Drejtësisë. Neni 263 TFBE parashikon juridiksionin ekskluziv të Gjykatës së Drejtësisë në lidhje me paditë e anulimit të paraqitura nga Shtetet Anëtare kundër Parlamentit dhe/ose Këshillit ose të paraqitura nga çdo institucion tjetër i Bashkimit Evropian. Për më tepër neni 265 parashikon juridiksionin ekskluziv të Gjykatës së Drejtësisë për të konstatuar mosveprimin e institucioneve të Bashkimit Evropian. Paditë indirekte që fillojnë në gjykatat kombëtare të cilat mund të kërkojnë një vendim paraprak nga Gjykata e Drejtësisë. Më pas gjykata kombëtare vendos duke marrë në konsideratë këtë vendim paraprak të dhënë nga Gjykata e Drejtësisë. Përpara Traktit të Nisës dhënia e vendimeve paraprake ishte një kompetencë ekskluzive e Gjykatës së Drejtësisë. Traktati i Nisës parashikon kompetencën e Gjykatës së Përgjithshme për të marrë vendime paraprake sipas procedurës së sipërpërmendur. Kjo skemë sanksionohet më tej në Traktatin për Funkcionimin e Bashkimit Evropian. Rrjedhimisht, Gjykata e Drejtësisë ka kompetencën të

japë vendime paraprake sipas nenit 267 TFBE, në fusha specifike të përcaktuara nga statuti, subjekt i një kontrolli të caktuar nga Gjykata e Drejtësisë.²⁴⁰

Gjykata e Përgjithshme shqyrton në shkallë të parë dhe rrjedhimisht i nënshtrohet mbikëqyrjes ligjore të Gjykatës së Drejtësisë. Ka gjithmonë, mundësi për të kundërshtuar vendimet e Gjykatës së Përgjithshme përpara Gjykatës së Drejtësisë (Canaj dhe Bana, 2014:126). Apelimi është i mundur vetëm për çështje të interpretimit ligjor sipas kushteve dhe brenda kufijve që përcakton Statuti.²⁴¹ Apelimi mund të përfshijë: mungesën e kompetencës së Gjykatës së Përgjithshme, mosrespektimin e procedurave nga ana e Gjykatës së Përgjithshme gjë që prek interesat e ankuesit dhe mosrespektimin e ligjit nga Gjykata e Përgjithshme.²⁴²

Gjykata e Përgjithshme ka dhe juridiksion rishikues. Gjykata ka në kompetencë të dëgjojë dhe të vendosë për çështjet ose procedurat kundër vendimeve të gjykatave të specializuara.²⁴³

4.3. Roli i Gjykatës së Drejtësisë dhe Gjykatës së Përgjithshme në fushën e ndihmës Shtetërore

Çështjet në lidhje me ndihmat Shtetërore të paraqitura përpara Gjykatës së Drejtësisë dhe Gjykatës së Përgjithshme mund të jenë të llojeve të ndryshme. Rrjedhimisht,

²⁴⁰ Neni 256 (3) TFBE; Consolidated version of the Treaty on the Functioning of the European Union [2010] OJ C 83/47 (Version i konsoliduar i Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Evropian).

²⁴¹ Neni 58, Protocol (No 3) On the Statute of the Court of Justice of the European Union (Protokoll Nr. 3, Mbi statutin e Gjykatës së Drejtësisë së Bashkimit Evropian) OJ C 83/210.

²⁴² Po aty.

²⁴³ Neni 256 TFBE; Consolidated version of the Treaty on the Functioning of the European Union [2010] OJ C 83/47 (Version i konsoliduar i Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Evropian).

gjykatat mund të shqyrtojnë ankime në lidhje me ligjshmërinë e vendimeve të Komisionit në lidhje me ndihmën Shtetërore. Gjithashtu, Komisioni mund të ngrejë një padi kundër një Shteti Anëtar për mospërbushje të një detyrimi të parashikuar nga nenet përkatëse të Traktatit mbi ndihmat Shtetërore. Për më tepër, paditë indirekte, të paraqitura përpara gjykatave të Shteteve Anëtare mund të kenë të bëjnë me të drejtën evropiane për ndihmën Shtetërore. Më poshtë do të analizohen në mënyrë të detajuar veprimet që mund të ndërmerren në fushën e ndihmës Shtetërore përpara Gjykatave Evropiane.

4.3.1. Veprime kundër Komisionit sipas nenit 263 TFBE

Neni 263 Traktati për Funkcionimin e Bashkimit Evropian parashikon si më poshtë:

“Gjykata e Drejtësisë e Bashkimit Evropian shqyrton ligjshmërinë e akteve legislative, e akteve të Këshillit, të Komisionit dhe të Bankës Qendrore Evropiane, që nuk janë rekomandime dhe opinione, dhe të akteve të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit Evropian të cilat kanë për qëllim të prodhojnë pasoja ligjore kundrejt të tretëve. Ajo shqyrton edhe ligjshmërinë e akteve të organeve, zyrave ose agjencive të Bashkimit të cilat kanë për qëllim të prodhojnë pasoja ligjore kundrejt të tretëve.

Për këtë qëllim ajo ka kompetencë mbi çështjet e ngritura nga një Shtet Anëtar, Parlamenti Evropian, Këshilli ose Komisioni për mungesë kompetence, për shkelje të një kërkesë thelbësore procedurale, për shkelje të Traktateve ose të një norme ligjore që ka të bëjë me zbatimin e tyre, ose për shpërdorim detyre.

Bazuar në të njëjtat kushte, Gjykata ka kompetencë mbi çështjet e ngritura nga Gjykata e Audituesve, nga Banka Qendrore Evropiane dhe nga Komiteti i Rajoneve me qëllim mbrojtjen e kompetencave të tyre.

Bazuar në kushtet e përcaktuara në paragrafin e parë dhe të dytë, çdo person fizik ose juridik mund të fillojë proces kundër një akti që i drejtohet atij personi ose i cili është në interes të drejtpërdrejtë të atij personi dhe kundër një akti rregullator i cili është në interes të drejtpërdrejtë të atij personi dhe i cili nuk nënkupton masa zbatuese.

Aktet përmes të cilave krijohen organe, zyra dhe agjenci të Bashkimit mund të përcaktojnë kushte dhe masa organizative të caktuara lidhur me paditë e ngritura nga persona fizikë ose juridikë kundër akteve të këtyre organeve, zyrave ose agjencive, të cilat kanë për qëllim prodhimin e pasojave ligjore kundrejt tyre.

Proceset e parashikuara në këtë nen fillojnë brenda dy muajve nga botimi i masës ose nga njoftimi i masës paditësit ose, në mungesë të kësaj, nga dita kur ky ka marrë dijeni për këtë të fundit, sipas rastit”.

Gjykata e Drejtësisë e Bashkimit Evropian, sipas nenit 263 TFBE, shqyrton ligjshmërinë e akteve legislative, akteve të Këshillit, të Komisionit dhe të Bankës Qendrore të cilat nuk janë rekomandime ose opinione. Gjithashtu, Gjykata e Drejtësisë e Bashkimit Evropian shqyrton ligjshmërinë e akteve të Parlamentit Evropian të cilat kanë për qëllim të prodhojnë pasoja ligjore kundrejt të tretëve. Rrjedhimisht akte të Komisionit, në kontekstin e procedurës për ndihmën Shtetërore, mund të kundërshtohen sipas procedurës së parashikuar nga neni 263 TFBE i sipërpërmendur. Bazuar në nenin 263 (6) TFBE proceset e parashikuara në këtë nen fillojnë brenda dy muajve nga botimi i masës ose nga njoftimi i masës paditësit ose, në mungesë të kësaj, nga dita kur ky ka marrë dijeni për këtë të fundit,

sipas rastit. Të gjitha proceset e parashikuara në nenin 263 TFBE duhet të paraqiten fillimisht në Gjykatën e Përgjithshme dhe më pas mund të ankimohen në Gjykatën e Drejtësisë.

Neni 263 TFBE parashikon legjitimimin e kërkuarve të ndryshëm në çështjet për anulimin e vendimeve të Komisionit për ndihmat Shtetërore. Ky nen bën një dallim midis kërkuarve të privilegjuar dhe atyre që nuk janë të privilegjuar. Shtetet Anëtare kanë një pozicion të privilegjuar përse i përket legjitimitetit²⁴⁴ krahasuar me individët. Shtetet Anëtare mund të kërkojnë në Gjykatë anulimin e vendimeve të Komisionit pa qenë nevoja të provojnë nëse veprimet e tyre janë të pranueshme për t'u shqyrtuar ose jo.²⁴⁵

Sipas nenit 263(4) TFBE aplikuesit personat fizikë ose juridikë, përveç atyre të cilëve i adresohet akti mund ta kundërshtojnë një akt nëse ai përbën “një interes të drejtpërdrejt dhe individual” për ata. Praktika gjyqësore në lidhje me nenin 263(4) TFBE përse i përket “interesit të drejtpërdrejt dhe individual” është e komplikuar. Termi i “drejtpërdrejt” i referohet një mase e cila prodhon efekte ligjore për personat fizikë ose personat juridikë, si e tillë, pa qenë i nevojshëm ndonjë akt ligjor shtesë nga një institucion kombëtar apo i Bashkimit Evropian (Kreuschitz, 2008:371). Ky interpretim është pranuar nga Gjykata e Drejtësisë e cila ka deklaruar se “një masë e Bashkimit Evropian konsiderohet e një interesi të drejtpërdrejt nëse ajo prek direkt situatën ligjore të një individi”.²⁴⁶ Gjithsesi, Gjykata e Drejtësisë shkon më tej dhe kërkon që zbatimi i masës të jetë automatik dhe rezultat i rregullave të Bashkimit dhe të mos ketë nevojë për rregulla të ndërmjetme (Craig & de Burca, 2008:509).

²⁴⁴ Çështje C-208/99, *Portugaly v. Commission (Portugalia k. Komisionit)* [2004] ECR I-9183, para 22.

²⁴⁵ Çështje 131/86, *United Kingdom v. Council (Mbretëria e Bashkuar k. Këshillit)* [1988] ECR 905.

²⁴⁶ Çështje C-386/96 P, *Dreyfus v. Commission (Dreyfus k. Komisionit)* [1998] I-2309, para. 43.

Ndërsa, në çështjen *Plaumann*²⁴⁷ Gjykata e Drejtësisë përcakton parimin e “interesit individual”. Sipas saj: “personat, përveç atyre që u drejtohet vendimi mund të pretendojnë të jenë të interesuar individualisht nëse ai vendim i prek ato për arsye të disa cilësive të veçanta të tyre ose për arsye të rrethanave të cilat i dallojnë ata nga të gjithë personat e tjerë dhe për arsye të këtyre faktorëve i dallon ato individualisht si në rastin e personave të adresuar”.²⁴⁸ Ky test ka qenë subjekt kritikash dhe ka patur një efekt kufizues. Bazuar në testin e sipërpërmendur shumë padi direkte nga palët e treta të cilat kundërshtonin vendime adresuar të tjerëve, nuk janë pranuar përshqyrtim nga Gjykatat Evropiane (Craig & de Burca, 2011:495). Në çështjet për ndihmat Shtetërore palët e treta nuk e kanë të vështirë të provojnë parimin e “interesit të drejtpërdrejt”. Në fushën e së drejtës së ndihmave Shtetërore vendimet i adresohen Shteteve Anëtare, të cilët ndoshta duhet të ndërmarrin masa kombëtare për zbatimin e vendimeve të Komisionit. Ndërsa, provueshmëria e “interesit individual” është më vështirë, në rastin e anulimit të vendimeve të Komisionit kërkuar nga palët e treta.

4.3.2. Veprime të Komisionit kundër Shteteve Anëtare

Neni 17 (1) Traktati i Bashkimit Evropian i jep Komisionit titullin “Ruajtës i Traktateve”. Komisioni ka detyrimin të sigurojë zbatimin e ligjit të Bashkimit Evropian. Rrjedhimisht, përsa i përket ndihmës Shtetërore Komisioni ka të drejtën të mbrojë Traktatet dhe të zbatojë ligjin e Bashkimit Evropian. Shtetet Anëtare për arsye të ndryshme mund të

²⁴⁷ Çështje 25/62, *Plaumann v. Commission (Plaumann k. Komisionit)* [1963] ECR 95.

²⁴⁸ Po aty.

mos zbatojnë dispozita të caktuara të legjislacionit të Bashkimit Evropian. Në këtë rast Komisioni ka të drejtën të dërgojë çështjen në gjykatë.

Neni 258 Traktati për Funksionimin e Bashkimit Evropian parashikon:

“Nëse Komisioni është i mendimit se një Shtet Anëtar nuk e ka përmbushur një detyrim që rrjedh nga Traktatet, ai nxjerr një opinion të arsyetuar për çështjen në fjalë pasi i ka dhënë Shtetit në fjalë mundësinë të paraqesë komentet e veta.

Nëse Shteti në fjalë nuk e zbaton opinionin brenda periudhës së vendosur nga Komisioni, ky i fundit mund ta ngrejë çështjen përpara Gjykatës së Drejtësisë të Bashkimit Evropian”.

Neni 258 TFBE i jep të drejtën Komisionit në rast mospërmbushje detyrimesh nga një Shtet Anëtar të dërgojë çështjen përpara Gjykatës së Drejtësisë së Bashkimit Evropian (“procedurat për shkelje”). Procedura e parashikuar nga neni i sipërpërmendur fillon në bazë të një ankimi ose me iniciativën e Komisionit (Craig & de Burca, 2008:429).

Procedura sipas nenit 258 TFBE ndahet në katër faza (Craig & de Burca, 2008:432). Së pari, Shteti Anëtar ka mundësinë të shpjegojë pozicionin e tij. Së dyti, në qoftë se çështja nuk sqarohet ndërmjet Komisionit dhe Shtetit Anëtar në fazën e parë, Shteti nëpërmjet një letre nga Komisioni do të njoftohet formalisht për shkeljen përkatëse të së drejtës. Zakonisht Shteti Anëtar ka një afat prej 2 muajsh për t’u përgjigjur. Së treti, nëse çështja nuk është zgjidhur pas bashkëbisedimeve me Shtetin përkatës Komisioni nxjerr një opinion të arsyetuar. Së fundmi, Komisioni referon çështjen përpara Gjykatës së Drejtësisë.

4.3.3. Kërkesat nga gjykatat kombëtare për vendime paraprake

Neni 267 Traktati për Funkcionimin e Bashkimit Evropian parashikon:

“Gjykata e Drejtësisë e Bashkimit Evropian ka juridiksion të shprehet përmes procedures paragjykimore lidhur me:

(a) interpretimin e Traktateve;

(b) vlefshmërinë dhe interpretimin e akteve të institucioneve, organeve, zyrave ose agjencive të Bashkimit;

Kur një çështje e tillë ngrihet përpara një gjykate ose tribunali të një Shteti Anëtar, kjo gjykatë ose tribunal, nëse është e mendimit se nevojitet një vendim në mënyrë që të gjykohet çështja, i kërkon Gjykatës nxjerrjen e një vendimi paraprak për të.

Kur një çështje e tillë ngrihet në një çështje gjyqësore që ndodhet për gjykim përpara një gjykate ose tribunali të një Shteti Anëtar kundër vendimeve të të cilit nuk ka zgjidhje ligjore që mund të ndiqet në bazë të legjislacionit kombëtar, kjo gjykatë ose ky tribunal mund ta paraqesë çështjen përpara Gjykatës.

Nëse një çështje e tillë ngrihet në një çështje gjyqësore që ndodhet për gjykim përpara një gjykate ose tribunali të një Shteti Anëtar në lidhje me një person të shoqëruar, Gjykata e Drejtësisë e Bashkimit Evropian vepron me vonesën më të vogël”.

Sipas nenit 267 TFBE Gjykata e Drejtësisë ka juridiksion të marrë vendime paraprake në lidhje me interpretimin e Traktatit dhe gjithashtu në lidhje me vlefshmërinë dhe interpretimin e akteve të institucioneve të Bashkimit Evropian. Ky mekanizëm është mjeti më i suksesshëm i Gjykatës së Drejtësisë dhe ka luajtur një rol të rëndësishëm në zhvillimet kushtetuese në Bashkimin Evropian (Broerg, 2013:500). Qëllimi i këtij

mekanizmi është zbatimi dhe interpretimi uniform i së drejtës së Bashkimit Evropian.²⁴⁹

Roli i Gjykatës së Drejtësisë sipas kësaj procedure është të interpretojë të drejtën e Bashkimit Evropian ose të vendosë në lidhje me vlefshmërinë e saj. Gjykata e Drejtësisë nuk e zbaton atë ligj mbi faktet e çështjes që është duke u shqyrtuar nga gjykata ose tribunali kombëtar. Këto të fundit kanë juridiksion të vendosin mbi faktet e ngritura gjatë shqyrtimit të çështjes.

Sipas nenit 267 TFBE, kërkesa për një vendim paraprak mund të paraqitet, nga çdo gjykatë ose tribunal i një Shteti Anëtar. Nëse këto të fundit janë të mendimit që u nevojitet një vendim në mënyrë që të gjykojnë një çështje konkrete atëherë i kërkojnë Gjykatës marrjen e një vendimi paraprak. Gjykata e Drejtësisë vendos nëse një organ është gjykatë ose tribunal.²⁵⁰ Gjykata e Drejtësisë në marrjen e vendimit merr në konsideratë një numër faktorësh duke përfshirë: nëse organi është krijuar me ligj, nëse ai është i përhershëm, nëse ka juridiksion të detyrueshëm, nëse procedura është *inter partes*, nëse zbaton parimin e shtetit të së drejtës, dhe nëse është i pavarur.²⁵¹

Bazuar në nenin 94 të Rregullores Procedurale të Gjykatës së Drejtësisë kërkesa për vendim paraprak duhet të përmbajë: (i) përmbledhje të çështjes që po shqyrtohet, faktet ashtu siç janë vendosur nga gjykata ose tribunali referues, ose të paktën një përmbledhje të fakteve mbi të cilat bazohen pyetjet që referohen; (ii) dispozitat ligjore kombëtare të aplikueshme në çështjen konkrete, dhe aty ku është e rëndësishme dhe jurisprudencën përkatëse; (iii) arsyet që kanë nxitur gjykatën ose tribunalin referues për të pyetur në lidhje

²⁴⁹ Recommendations to national courts and tribunals in relation to the initiation of preliminary ruling proceedings (Rekomandime për gjykatat kombëtare në lidhje me fillimin e procedurës paragjykimore), (2012/C 338/01).

²⁵⁰ Çështje 43/71, *Polity v. Italy (Polity v. Italisë)* [1971] ECR 1039.

²⁵¹ Çështje C-54/96 *Dorsch Consult Ingenieurgesellschaft mbH v. Bundesbaugesellschaft Berlin mbH* [1997] ECR I-4961.

me interpretimin ose vlefshmërinë e dispozitave të Bashkimit Evropian, dhe marrëdhënien ndërmjet këtyre dispozitave dhe legjislacionit kombëtar të zbatueshëm në zgjidhjen e mosmarrëveshjes konkrete.

Rëndësia e këtij juridiksioni në lidhje me çështjet për ndihmën Shtetërore qëndron në zbatimin uniform të legjislacionit për ndihmën Shtetërore. Gjyqtarët në gjykatat kombëtare mund të përdorin këtë instrument, për të sqaruar aspekte të paqarta të legjislacionit të Bashkimit Evropian për ndihmën Shtetërore. Vendimi paraprak i Gjykatës në lidhje me interpretimin e së drejtës evropiane është i detyrueshëm për gjykatën kombëtare që e ka kërkuar. Në lidhje me çështjet që kanë të bëjnë me të drejtën evropiane për ndihmën Shtetërore gjykatat kombëtare mund të pyesin mbi interpretimin e neneve 107(1) TFBE dhe 108 TFBE. Ato mund të pyesin gjithashtu dhe në lidhje me vlefshmërinë e vendimeve të Komisionit, në lidhje me çështje të veçanta për ndihmat Shtetërore. E vetmja gjë për të cilën Gjykata e Drejtësisë nuk mund të përgjigjet është problemi i pajtueshmërisë së masës ndihmë Shtetërore me tregun e brendshëm. Ky interpretim është kompetence ekskluzive e Komisionit dhe jo e gjykatave kombëtare.²⁵²

4.3.4. Veprime kundër Komisionit sipas nenit 265 TFBE

Neni 265 Traktati për Funksionimin e Bashkimit Evropian parashikon:

“Nëse Parlamenti Evropian, Këshilli Evropian, Këshilli, Komisioni ose Banka Qendrore Evropiane, në shkelje të Traktateve nuk veprojnë, Shtetet Anëtare dhe institucionet e tjera të Bashkimit mund të ngrenë padi përpara Gjykatës së Drejtësisë të Bashkimit Evropian

²⁵² Kjo çështje trajtohet më gjerësisht në kapitullin pasardhës.

për të konstatuar shkeljen. Ky nen zbatohet me të njëjtat kushte për organet, zyrat dhe agjencitë e Bashkimit të cilat nuk veprojnë.

Padia është e pranueshme vetëm nëse i është bërë më parë thirrje për të vepruar institucionit, organit, zyrës ose agjencisë. Nëse, brenda dy muajve pas thirrjes, institucioni, organi, zyra ose agjencia në fjalë nuk ka dalë me një qëndrim, padia mund të ngrihet brenda një periudhe shtesë dymujore.

Çdo person fizik ose juridik mund të ankohe përpara Gjykatës sipas kushteve të përcaktuara në paragrafët e mësipërme, se një institucion, organ, zyrë ose agjenci e Bashkimit nuk i është drejtuar personit me asnjë akt, përveç një rekomandimi ose një opinion”.

Neni 265 TFBE parashikon që në rrethana të caktuara Shtetet Anëtare, institucionet e Bashkimit dhe persona të tjerë fizike ose juridike mund të ngrenë padi përpara Gjykatës së Drejtësisë së Bashkimit Evropian, në rast se institucionet e Bashkimit Evropian nuk veprojnë. Paragrafi i dytë i nenit 265 TFBE parashikon kushtet e pranimi për shqyrtim nga Gjykata të padisë: kërkuesi i ka bërë më parë thirrje për të vepruar institucionit dhe ka kaluar një afat prej dy muajsh nga koha kur është bërë thirrja. Në fushën e ndihmës Shtetërore ky veprim mund të konsiderohet i mundshëm sa herë që Komisioni nuk arrin të marrë një vendim për të përfunduar fazën e shqyrtimit paraprak ose formal.²⁵³

Në ngjashmëri me nenin 263 TFBE dhe neni 265 TFBE bën një dallim ndërmjet kërkuessve të privilegjuar dhe jo të privilegjuar. Rrjedhimisht, Shtetet Anëtare dhe institucionet janë kërkuessit e privilegjuar ndërsa personat fizikë ose juridikë janë kërkuessit jo të privilegjuar.

²⁵³ Çështje C-302/99 P dhe C-308/99 P *Commission v. TF1* [2001] ECR I-5603.

4.3.5. Veprime të një Shteti Anëtar kundër një Shteti tjetër Anëtar në fushën e së drejtës për ndihmën Shtetërore

Neni 259 Traktati për Funkcionimin e Bashkimit Evropian parashikon:

“Një Shtet Anëtar i cili mendon se një Shtet tjetër Anëtar nuk e ka përmbushur një detyrim që rrjedh nga Traktatet mund ta ngrejë çështjen përpara Gjykatës së Drejtësisë të Bashkimit Evropian.

Përpara se Shteti Anëtar të ngrejë padi kundër një Shteti tjetër Anëtar për një shkelje të dyshuar të një detyrimi që rrjedh nga Traktatet, ai e ngre këtë çështje përpara Komisionit.

Komisioni nxjerr një opinion të arsyetuar pasi i ka dhënë secilit prej Shteteve në fjalë mundësinë të paraqesin argumentet e tyre dhe komentet e tyre për argumentet e palës tjetër, me gojë dhe me shkrim.

Nëse Komisioni nuk e nxjerr opinionin brenda tre muajve pas datës kur është ngritur çështja përpara tij, mungesa e opinionit nuk përbën pengesë që çështja të kalojë në Gjykatë”.

Sipas nenit 259 TFBE një Shtet Anëtar i cili mendon se një Shtet tjetër Anëtar nuk ka përmbushur një detyrim që rrjedh nga Traktatet mund ta ngrejë çështjen përpara Gjykatës së Drejtësisë. Gjithsesi, neni i sipërpërmendur, parashikon detyrimin që çështja të shqyrtohet nga Komisioni përpara se të ngrihet një padi në Gjykatë. Komisioni duhet të nxjerrë një opinion të arsyetuar, pasi t'i ketë dhënë mundësinë secilit Shtet Anëtar të paraqesin argumentet e tyre dhe komentet e tyre në lidhje me argumentet e palës tjetër. Nëse Komisioni nuk paraqet një opinion brenda tre muajve pas datës së paraqitjes së

ankesës pranë tij, atëherë çështja mund të paraqitet në Gjykatë. Në fushën e ndihmës Shtetërore ky nen nuk është përdorur nga Shtetet Anëtare.

KAPITULLI V

ROLI I GJYKATAVE KOMBËTARE NË ZBATIMIN E RREGULLAVE PËR NDIHMËN SHTETËRORE

5.1. Hyrje

Komisioni ka trajtuar rolin e gjykatave kombëtare në zbatimin e rregullave në lidhje me ndihmën Shtetërore që në vitin 1995. Në këtë vit Komisioni miratoi një Njoftim për Bashkëpunim Ndërmjet Gjykatave Kombëtare dhe Komisionit në Fushën e Ndhmës Shtetërore.²⁵⁴ Në këtë njoftim prezantoheshin mekanizmat për bashkëpunim dhe shkëmbimin e informacionit ndërmjet gjykatave kombëtare dhe Komisionit. Qëllimi i Njoftimit ishte të ofronte udhëzime në lidhje me bashkëpunimin ndërmjet gjykatave kombëtare dhe Komisionit në fushën e ndihmës Shtetërore. Njoftimi shpjegonte mënyrën sipas së cilës Komisioni do të ndihmonte gjykatat kombëtare duke krijuar një bashkëpunim më të ngushtë në zbatimin e neneve 92 dhe 93 TKEE (tani nenet 107 dhe 108 TFBE).

Në vitin 2006 Komisioni publikoi një studim mbi zbatueshmërinë e së drejtës për ndihmat Shtetërore në nivel kombëtar (Lovells & Overy, 2006). Ky studim ndikoi në miratimin e Njoftimit të Komisionit në lidhje me Zbatimin e së Drejtës për Ndhmat Shtetërore nga Gjykatat Kombëtare në vitin 2009 (në vazhdim “Njoftimi për Zbatim i vitit

²⁵⁴ Notice on cooperation between national courts and the Commission in the state aid field (Njoftim për bashkëpunimin ndërmjet gjykata kombëtare dhe Komisionit në fushën e ndihmës Shtetërore), [1995] OJ C312/8.

2009”)²⁵⁵ Ky njoftim u prezantua në kuadër Planit të Veprimit për Ndhimat Shtetërore²⁵⁶ i cili përfshinte një reformë të procedurave në lidhje me ndihmën Shtetërore duke përfshirë procedura më efektive, zbatim më të mirë dhe rritje të transparencës. Të gjithë këto dokumente ligjore së bashku me nenet përkatëse të Traktit të Lisbonës përbëjnë kuadrin ligjor për zbatimin e rregullave për ndihmën Shtetërore nga gjykatat kombëtare, i cili do të analizohet në këtë kapitull.

Gjykatave Kombëtare u është besuar detyra e mbrojtjes së të drejtave të individëve në rast shkelje nga ana e Shteteve Anëtare të detyrimit për të mos zbatuar ndihmën Shtetërore përpara se ajo të miratohet nga Komisioni. Gjithashtu, gjykatat kombëtare mund të hasin çështje në lidhje me të drejtën e ndihmave Shtetërore dhe në rastet kur Komisioni ka urdhëruar kthim të ndihmës Shtetërore. Në këtë rast ankuesi mund të kërkojë anulimin e urdhrit kombëtar i cili zbaton vendimin e Komisionit. Ky kapitull do të analizojë problemet kryesore që kanë të bëjnë me kompetencën e gjykatave kombëtare për të shqyrtuar çështje në fushën e së drejtës së ndihmës Shtetërore dhe mënyrën e ndarjes së kësaj kompetence me institucionet e Bashkimit Evropian.

5.2. Parimi i epërsisë të së drejtës së Bashkimit Evropian

Dy parimet kryesore në lidhje me statusin e së drejtës evropiane janë parimi i epërsisë dhe ai efektit të drejtpërdrejt, të cilat janë zhvilluar nga Gjykata e Drejtësisë pa një

²⁵⁵ Commission notice on the enforcement of State aid law by national courts (Njoftim i Komisionit për zbatimin e së drejtës për ndihmën Shtetërore nga gjykatat kombëtare) OJ C85/01, 9.4.2009.

²⁵⁶ State Aid Action Plan: Less and better targeted State aid: a roadmap for State aid reform 2005-2009, (Plan Veprimi për Ndhimën Shtetërore: Më pak ndihmë Shtetërore dhe më mirë e shënjestruar: udhërrëfyes për reformën e ndihmës Shtetërore 2005-2009) COM (2005) 107 final.

bazë ligjore në Traktat (Craig & de Burca, 2008:344). Parimi i epërsisë të së drejtës evropiane ashtu siç është krijuar nga Gjykata e Drejtësisë, nënkupton që në rast konflikti, kundërshtimi ose mospërputhje midis normave të së drejtës së Bashkimit Evropian dhe normave kombëtare, të parat do të mbizotërojnë mbi të dytat (Canaj & Bana, 2014:194). Gjykata e Drejtësisë që në ekzistencën e hershme të Komunitetit (Bashkimit Evropian) ka prekur çështjen e epërsisë të së drejtës evropiane duke deklaruar në çështjen *Van Gend en Loos*²⁵⁷ që Komuniteti (Bashkimi Evropian) krijon një rend të ri ligjor të së drejtës ndërkombëtare, për të cilin Shtetet Anëtare kanë kufizuar sovranitetin e tyre (Craig & de Burca, 2008:345). Ky parim ka qenë gjithashtu në qendër të vendimit në çështjen *Costa kundër Enel*.²⁵⁸ Në këtë çështje Gjykata e Drejtësisë ka deklaruar se Traktati i Komunitetit Evropian ka krijuar një rend ligjor më vete, i cili ishte bërë pjesë e rendeve ligjore të Shteteve Anëtare dhe Shtetet Anëtare kishin transferuar tek institucionet e Komunitetit “pushtete reale që rridhinin nga kufizimi i sovranitetit”. Gjykata ka vazhduar më tej me argumente të tjera të tilla si fryma dhe qëllimi i Traktatit të cilat e bënin të “pamundur” për Shtetet Anëtare t’i jepnin epërsi të drejtës së tyre kombëtare (Craig dhe de Burca, 2008:346). Përfundimisht, Gjykata argumentoi se neni 288 TFBE nuk do të kishte kuptim nëse Shtetet Anëtare nuk do ta respektonin atë duke miratuar legjislacion kombëtar në kundërshtim me të drejtën evropiane. Pasi krijoi bazën në çështjen *Costa kundër Enel* në çështje të tjera të tilla si: *Internationale Handelsgesellschaft*²⁵⁹ dhe *Simmenthal*²⁶⁰, Gjykata e Drejtësisë deklaroi se edhe një rregull pjesë e një kushtetute kombëtare nuk mund të

²⁵⁷ Çështje 26/62 *NV Algemene Transporten Expeditie Onderneming van Gend en Loos v. Nederlandse Amministratie der Belastingen* [1963] ECR 1.

²⁵⁸ Çështje 6/64 *Faminio Costa k. Enel* [1964] ECR 585, 593

²⁵⁹ Çështje 11/70 *Internationale Hnadelsgesellschaft mbH v. Einfuhr und Vorratsstelle fur Getreide und Futtermittel* [1970] ECR 1125.

²⁶⁰ Çështje 106/77 *Amministrazione delle Finanze dello Stato v. Simmenthal SpA* [1978] ECR 629.

kundërshtojë epërsinë e së drejtës evropiane direkt të zbatueshme. Tashmë është vendosur nga praktika gjyqësore se e drejta evropiane ka epërsi mbi të drejtën kombëtare të Shteteve Anëtare, duke përfshirë dhe norma të kushtetutave të tyre kombëtare (Albi, 2007:25).

5.3. Parimi i efektit të drejtpërdrejt të së drejtës së Bashkimit Evropian

Një parim tjetër i rëndësishëm që ka lidhje me statusin e së drejtës evropiane është ai i efektit të drejtpërdrejt. Sipas parimit të efektit të drejtpërdrejtë në rast se një normë e Traktatit ose një akt i Bashkimit Evropian paraqet karakteristika të caktuara, ai krijon të drejta dhe detyrime në favor të individëve, të cilët legjitimohen të kërkojnë para juridiksionit kombëtar të njejtën mbrojtje në bazë të normave të diktuar nga sistemi i brendshëm. (Canaj & Bana, 2014:189). Rrjedhimisht, sipas interpretimit të gjere të këtij parimi, norma të Traktatit ose akte të BE-së të cilat janë të qarta dhe të pakushtëzuara mund të përdoren si bazë ligjore nga individët përpara gjykatave kombëtare (Craig & de Burca, 2008:268). Dhe sipas interpretimit të ngushtë ose nocionit “klasik” të efektit të drejtpërdrejt ai mund të përkufizohet si mundësia e një dispozite për t’i dhënë të drejta individëve (Craig & de Burca, 2008:268). Ky parim u krijua fillimisht nga Gjykata e Drejtësisë në çështjen *Van Gend en Loos* dhe më pas u zgjerua dhe tani gjen zbatim në të drejtën kryesore të Bashkimit Evropian, në atë dytësore si dhe marrëveshjet ndërkombëtare.

Në lidhje me dispozitat e Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Evropian për ndihmën Shtetërore neni 108(3) TFBE ka efekt të drejtpërdrejt. Neni 108 (3) TFBE parashikon që: *“Komisioni informohet në kohë të mjaftueshme, për t’i dhënë mundësi të paraqesë komentet e tij për çdo plan që ka të bëjë me dhënien ose ndryshimin e një ndihme.*

Nëse gjykon se një plan i tillë nuk pajtohet me tregun e brendshëm, sipas nenit 107, Komisioni fillon pa vonesë procedurën e parashikuar në paragrafin 2. Shteti Anëtar në fjalë nuk i zbaton masat e propozuara gjersa nga kjo procedurë të ketë dalë një vendim përfundimtar”. Rrjedhimisht, bazuar në nenin e sipërpërmendur Shtetet Anëtare kanë detyrimin ligjor të njoftojnë Komisionin në lidhje me çdo plan për dhënie ose ndryshim ndihme. Për më tepër, ato kanë detyrimin të mos zbatojnë ndihmën Shtetërore deri sa Komisioni të ketë vendosur në lidhje me pajtueshmërinë e saj. Në qoftë se detyrimi për të njoftuar nuk zbatohet nga Shtetet Anëtare, atëherë kemi shkelje të së drejtës evropiane dhe kjo mund të pretendohet nga individët në gjykatat kombëtare.

Ndërsa, neni 107(1) TFBE²⁶¹ i cili parashikon kushtet sipas të cilave një mase do të konsiderohet ndihmë Shtetërore nuk ka efekt të drejtpërdrejt. Neni 107 (1) TFBE parashikon që: *“Me përjashtim të rasteve kur Traktatet parashikojnë ndryshe, ndihma që jep një Shtet Anëtar ose që jepet përmes burimeve shtetërore në çfarëdolloj forme, e cila e shtrembëron ose rrezikon ta shtrembërojë konkurrencën duke favorizuar disa ndërmarrje të caktuara ose prodhimin e disa mallrave të caktuara, është e papajtueshme me tregun e brendshëm, për aq kohë sa prek tregtinë midis Shteteve Anëtare”.* Vendimet në lidhje me pajtueshmërinë e një ndihme me tregun e brendshëm janë një kompetence ekskluzive e Komisionit. Ky është ndryshimi ndërmjet kompetencave të dy aktorëve në kontrollin e ndihmës Shtetërore: Komisionit dhe gjykatave kombëtare.

²⁶¹ Elementët e këtij neni janë analizuar në kapitullin e parë.

5.4. Njoftimi i Komisionit për zbatimin e së drejtës për ndihmën Shtetërore nga gjykatat kombëtare

Samiti i Lisbonës i mbajtur në Mars të vitit 2000, përmend, në mënyrë specifike, nevojën e ripërkufizimit të qëllimeve dhe funksionimit të politikës për ndihmat Shtetërore.²⁶² Mbi këtë bazë Komisioni prezantoi Planin e Veprimit për Ndhmën Shtetërore, i cili u publikua në vitin 2005.²⁶³ Ky dokument do të shërbente si një udhërrëfyes për reformat e ndihmës Shtetërore deri në vitin 2009. Objektivat kryesore të reformës ishin: më pak ndihmë Shtetërore dhe më mirë e shënjestruar; qasje (analize) ekonomike; procedura më efektive, parashikueshmëri më e lartë dhe rritje e transparencës; kompetenca të ndara ndërmjet Komisionit dhe Shteteve Anëtare. Plani i Veprimit për Ndhmën Shtetërore përbënte një program pune ambicioz, i cili konsistonte në rishikimin e shumicës së rregullave ekzistuese për ndihmat Shtetërore brenda një periudhe pesë vjeçare. Komisionari për konkurrencën në Komisionin Evropian, në atë kohë, Neelie Kroes e konsideroi si një udhërrëfyes për zhvillimin të politikës në lidhje me ndihmën Shtetërore në Bashkimin Evropian në të ardhmen.

Përmirësimi i zbatimit të rregullave për ndihmën Shtetërore në të gjitha nivelet përbënte një pjesë thelbësore të Planit të Veprimit për Ndhmën Shtetërore. Zbatimi efektiv i rregullave për ndihmën Shtetërore është i rëndësishëm për garantimin e konkurrencës në tregun e përbashkët. Autoritet kombëtare dhe gjykatat kombëtare luajnë një rol të

²⁶² European Council of Lisbon, 23-24 Mars 2000, Conclusion Document of the Presidency para. 17 (Këshilli i Bashkimit Evropian i Lisbonës, 23-24 mars 2000, Konkluzionet e Presidencës, DOC/00/8 para. 17).

²⁶³ State Aid Action Plan: Less and better targeted State aid: a roadmap for State aid reform 2005-2009, (Plan Veprimi për Ndhmën Shtetërore: Më pak ndihmë Shtetërore dhe më mirë e shënjestruar: udhërrëfyes për reformën e ndihmës Shtetërore 2005-2009) COM (2005) 107 final.

rëndësishëm në zbatimin e rregullave për ndihmën Shtetërore (Lovells & Overy, 2006). Në kuadër të Planit të Veprimit për Ndihmën Shtetërore, Komisioni miratoi një Njoftim për Zbatimin e së Drejtës për Ndihmën Shtetërore nga Gjykatat Kombëtare.

Roli i gjykatave kombëtare ishte trajtuar, më herët, nga Komisioni në Njoftimin për Bashkëpunim ndërmjet Gjykatave Kombëtare dhe Komisionit në fushën e ndihmës Shtetërore të publikuar në vitin 1995 (në vazhdim “Njoftimi për Bashkëpunim i vitit 1995”). Njoftimi për Bashkëpunim i vitit 1995 prezantoi mekanizmat për bashkëpunim dhe shkëmbim informacioni ndërmjet Komisionit dhe gjykatave kombëtare. Gjithsesi, një studim i vitit 2006, në lidhje me zbatimin e rregullave të ndihmës Shtetërore në Shtetet Anëtare të Bashkimit Evropian arriti në konkluzionin që gjykatat kombëtare kanë luajtur një rol kufizuar në fushën e ndihmës Shtetërore (Lovells & Overy, 2006). Por, Komisioni, duke marrë në konsideratë përfitimet që mund të sjellë roli i gjykatave kombëtare në politikën për ndihmën Shtetërore miratoi Njoftimin për Zbatimin e së Drejtës për Ndihmën Shtetërore nga Gjykatat Kombëtare në vitin 2009.

Qëllimi kryesor i Njoftimit për Zbatimin e së Drejtës për Ndihmën Shtetërore nga Gjykatat Kombëtare përmban dy elemente thelbësore. Së pari, ai shpjegon rolin e gjykatave kombëtare në fushën e ndihmës Shtetërore dhe së dyti, i ofron gjykatave kombëtare mbështetje në lidhje me çështje individuale. Komisioni kërkon të zhvillojë bashkëpunimin me gjykatat kombëtare duke prezantuar mjete më praktike për të mbështetur gjyqtarin kombëtar në punën e tij të përditshme.

5.5. Roli i gjykatave kombëtare në zbatimin e rregullave të ndihmës Shtetërore

Gjykata e Drejtësisë ka konfirmuar disa herë që rolet e Komisionit dhe gjykatave kombëtare janë të ndara dhe se ato plotësojnë njëri-tjetrin.²⁶⁴

Rregullorja Procedurale në nenin 2 (1) dhe Traktati për Funkcionimin e Bashkimit Evropian në nenin 108 (3) TFBE parashikojnë detyrimin e çdo Shteti Anëtar për të njoftuar Komisionin në lidhje me çdo plan për dhënien e ndihmës së re në një kohë të mjaftueshme për Komisionin në mënyrë që ky i fundit të bëjë komentet e tij. Shteti Anëtar nuk mund të zbatojë masën ndihmë gjatë periudhës që ajo është duke u shqyrtuar nga Komisioni. Pasi Komisioni merr një njoftim nga Shteti Anëtar në lidhje me planet për dhënien e ndihmave Shtetërore ai fillon procedurën e shqyrtimit paraprak të masës.²⁶⁵ Komisioni bazuar në Rregulloren Procedurale duhet të marrë një vendim brenda dy muajsh nga marrja e një njoftimi të plotë. Gjatë fazës së shqyrtimit paraprak Komisioni krijon një opinion *prima facie* në lidhje me planin e njoftuar për dhënien e ndihmës. Rrjedhimisht në përfundim të kësaj faze Komisioni është në gjendje, pa patur nevojën e një shqyrtimi me hollësi, të arrijë në përfundimin nëse masa është e pajtueshme me tregun e brendshëm ose nëse masa ngre dyshime në lidhje me pajtueshmërinë me tregun e brendshëm.²⁶⁶

Siç parashikohet në Rregulloren Procedurale Komisioni mund ta përfundojë procedurën e shqyrtimit paraprak në tre mënyra të ndryshme. Së pari, Komisioni mund të

²⁶⁴ Çështje C-368/04, *Trirsilpine Olleitur in Osterreich*, [2001] ECRI19957 para. 37 -39.

²⁶⁵ Neni 108(3) Treaty on the Functioning of the European Union (TFEU) (Traktati për Funkcionimin e Bashkimit Evropian) (TFBE) [2012] OJ C326/47 dhe Neni 4 Council Regulation 1999/659/EC of 22 March 1999 laying down detailed rules for the application of Article 93 of the EC Treaty, OJ L 83/1, 27 March 1999. (Rregullore e Këshillit 1999/659/EC, 22 Mars 1999 për përcaktimin e rregullave të detajuara për zbatimin e nenit 93 të Traktatit të Komunitetit Evropian).

²⁶⁶ Çështje C-204/97, *Portugal v. Commission (Portugalia k. Komisionit)* [2001] ECR I-3175 para 35.

arrijë në përfundimin që masa nuk përbën ndihmë.²⁶⁷ Së dyti, Komisioni mund të vendosë që masa është e pajtueshme me tregun e brendshëm. Pa deklaruar formalisht nëse masa është e pajtueshme me tregun e brendshëm, Komisioni shpesh deklaron që “nuk ngre kundërshtime” në lidhje me masën.²⁶⁸ Së treti, Komisioni mund të përfundojë procedurën e shqyrtimit paraprak duke hapur procedurën e shqyrtimit formal sipas nenit 108(2) TFBE.

Procedura e shqyrtimit formal hapet në rast se Komisioni ka dyshime në lidhje me pajtueshmërinë e masës me tregun e brendshëm.²⁶⁹ Gjatë procedurës së shqyrtimit formal, Komisioni kërkon informacion të plotë nga Shteti Anëtar në lidhje me faktet e një çështje të veçantë dhe njofton palët e treta të paraqesin komentet e tyre. Në përfundim të procedurës së shqyrtimit formal Komisioni mund të marrë një vendim pozitiv ose një vendim që nuk ka ndihmë Shtetërore, ose një vendim negativ (Nourissat, 2012:374). “Vendim pozitiv” do të thotë që ekziston ndihma Shtetërore por konsiderohet në përputhje me tregun e brendshëm. Komisioni mund të japë një vendim pozitiv me kushte. Komisioni mund të konsiderojë që masa e njoftuar nuk përbën ndihmë Shtetërore nëse plotësohen elementët e nenit 107(1) TFBE. Ndërsa “vendimi negativ” do të thotë që ndihma e njoftuar nuk pajtohet me tregun e brendshëm dhe si tillë nuk duhet të zbatohet. Afati për marrjen e një vendimi nga Komisioni gjatë fazës së shqyrtimit formal është 18 muaj nga fillimi i saj. Pas këtij afati Shteti Anëtar mund t’i kërkojë Komisionit të marrë një vendim brenda dy muajve të tjerë. Nëse Komisioni nuk ka marrë informacion mjaftueshëm për të vlerësuar nëse masa është në përputhje me tregun e brendshëm atëherë ai merr një vendim negativ.

²⁶⁷ Neni 4(2) Council Regulation 1999/659/EC of 22 March 1999 laying down detailed rules for the application of Article 93 of the EC Treaty, OJ L 83/1, 27 March (Mars) 1999. (Rregullore e Këshillit 1999/659/EC, 22 Mars 1999 për përcaktimin e rregullave të detajuara për zbatimin e nenit 93 të Traktatit të Komunitetit Evropian).

²⁶⁸ Po aty neni 4(3).

²⁶⁹ Po aty neni 4(4).

Ndërsa roli i gjykatave kombëtare është të mbrojnë të drejtat e individëve duke qene se ashtu siç u analizua më lart neni 108 (3) TFBE ka efekt të drejtpërdrejt. Rrjedhimisht gjykatat kombëtare kanë detyrimin të mbrojnë interesat e individëve në rast moszbatimi të detyrimit për njoftim nga Shtetet Anetare të parashkuar në nenin e sipërpërmendur. Gjykatat kombëtare duhet të përdorin të gjitha mjetet e përshtatshme të parashikuara në legjislacionin e brendshëm për të garantuar zbatimin e drejtpërdrejt të nenit 108 (3) TFBE.²⁷⁰

Një gjykatë kombëtare mund të zbatojë vendimet e Komisionit. Siç u përmend më sipër Komisioni mund të marrë një vendim pozitiv ose një vendim negativ. Vendimet negative të Komisionit deklarojnë që një masë nuk është në përputhje me nenin 107 TFBE. Në rast se nëpërmjet një vendimi negativ të Komisionit kërkohet kthimi i ndihmës së paligjshme, atëhere kthimi do të realizohet sipas procedurave të përcaktuara nga legjislacioni i brendshëm.²⁷¹ Ndërsa, përsa i përket vendimeve pozitive të Komisionit sipas të cilëve ndihma Shtetërore ekziston por konsiderohet në përputhje me tregun e brendshëm ato mund të kundërshtohen nga një konkurrent i përfituesit të ndihmës Shtetërore në gjykatën kombëtare. Gjykata e drejtësisë ka deklaruar se në këtë rast gjykata kombëtare duhet të përdorë procedurën e parashikuar në nenin 267 TFBE.²⁷² Sipas këtij neni një gjykatë e një Shteti Anëtar mund t'i kërkojë Gjykatës së Drejtësisë nxjerrjen e një vendimi paraprak, nëse ky vendim është i nevojshëm për gjykimin e një çështje konkrete. Bazuar në nenin 94 të Rregullores Procedurale të Gjykatës së Drejtësisë kërkesa për vendim paraprak

²⁷⁰ Çështje C-39/94, *Syndicat Français de l'Express International (SFEI) a.o. v La Poste a.o.* [1996] ECR I-3547.

²⁷¹ Çështje C-142/87, *Belgium v Commission (Belgium k. Komisionit)* [1990] ECR I-959.

²⁷² Çështje C-188/92, *TWD v Germany (TWD k. Gjermanisë)* [1994] ECR I-833.

duhet të përmbajë: (i) përmbledhje të çështjes që po shqyrtohet, faktet ashtu siç janë vendosur nga gjykata ose tribunali referues, ose të paktën një përmbledhje të fakteve mbi të cilat bazohen pyetjet që referohen; (ii) dispozitat ligjore kombëtare të aplikueshme në çështjen konkrete, dhe aty ku është e rëndësishme dhe jurisprudencën përkatëse; (iii) arsyet që kanë nxitur gjykatën ose tribunalin referues për të pyetur në lidhje me interpretimin ose vlefshmërinë e dispozitave të Bashkimit Evropian, dhe marrëdhënien ndërmjet këtyre dispozitave dhe legjislacionit kombëtar të zbatueshëm në zgjidhjen e mosmarrëveshjes konkrete.

5.6. Bashkëpunimi ndërmjet Komisionit dhe gjykatave kombëtare

Njoftimi për Zbatim i vitit 2009 inicion një bashkëpunim jo-detyrues ndërmjet Komisionit dhe gjykatave kombëtare. Në këtë drejtim Komisioni është frymëzuar nga eksperiencia e tij në fushën e zbatimit të së drejtës së konkurrencës (Nehl, 2014:248). Rrjedhimisht mësimet e nxjerra nga procesi i decentralizimit të zbatimit të së drejtës së konkurrencës janë të vlefshme dhe për zbatimin e së drejtës për ndihmën Shtetërore në nivelin mbikombëtar dhe kombëtar nëse decentralizimi është një mundësi. Tashmë tema ka sqaruar rolin e Komisionit dhe gjykatave kombëtare duke arritur në konkluzionin që rolet e tyre janë të ndara por plotësuese. Rrjedhimisht kërkohet një bashkëpunim ndërmjet tyre për zbatimin e rregullave të së drejtës për ndihmën Shtetërore. Njoftimi për Zbatim i vitit 2009 prezanton kompetencat e reja të Komisionit në lidhje me bashkëpunimin me gjykatat kombëtare. Kështu Komisioni mund të ndihmojë gjykatat kombëtare në dy mënyra të ndryshme që kanë si qëllim të ndihmojnë këto gjykata në shqyrtimin e çështjeve mbi

ndihmat Shtetërore. Së pari, gjykata kombëtare mund t'i kërkojë Komisionit t'i transmetojë informacionin që ky i fundit disponon. Kjo mund të përfshijë dhe dokumentet që mund të ketë Komisioni. Së dyti, Njoftimi për Zbatim i vitit 2009 prezanton mundësinë e gjykatave kombëtare për t'i drejtuar pyetje Komisionit në lidhje me zbatimin e rregullave mbi ndihmat Shtetërore. Kjo mundësi rrit efektivitetin e procedurave kombëtare në lidhje me ndihmat Shtetërore. Këto opinione mund të kërkojnë për të gjitha problemet ekonomike, faktike ose ligjore të cilat lindin në kontekstin e procedurave kombëtare. Neni 91 i Njoftimit për Zbatim të vitit 2009 liston disa nga çështjet për të cilat mund të kërkojë opinion i Komisionit nga ana e gjykatave kombëtare. Këto kanë të bëjnë me çështje të tilla si: nëse një mase e caktuar mund të kualifikohet si ndihmë Shtetërore sipas kuptimit të nenit 107(1) TFBE dhe nëse ky është rasti si duhet të llogaritet shuma ekzakte e ndihmës Shtetërore; nëse një mase e caktuar plotëson kushtet e parashikuara nga Rregullorja për Përfshirjet në Grup; nëse një mase e caktuar është pjesë e një skeme ndihme e cila është njoftuar dhe aprovuar nga Komisioni ose ndryshe kualifikohet si ndihmë ekzistuese; nëse ekzistojnë rrethana të jashtëzakonshme të cilat nuk do të lejonin gjykatën kombëtare të urdhëronte kthim të plotë të ndihmës Shtetërore sipas së drejtës së ndihmave Shtetërore të Bashkimit Evropian.

Përpara miratimit të Njoftimit për Zbatim të vitit 2009, gjykatat kombëtare nuk kishin mundësi të kërkonin mendimin e Komisionit. Rrjedhimisht mundësia për të kërkuar informacion nuk është përdorur shumë nga gjykatat kombëtare. Gjithsesi dhe pse gjykatat kombëtare kanë mundësinë të kërkojnë mendimin e Komisionit, ato nuk mund të kërkojnë mendimin e këtij të fundit në lidhje me pajtueshmërinë e një mase ndihme sepse një gjë e tillë është kompetence ekskluzive e Komisionit. Përgjigjet e Komisionit nuk janë as

detyruese dhe as përfundimtare dhe kjo procedurë nuk e pengon gjykatën kombëtare t'i referojë pyetje Gjykatës së Drejtësisë.

Komisioni ka detyrimin t'i përgjigjet një kërkesë nga gjykatat kombëtare sa më shpejt që të jetë e mundur.²⁷³ Kjo si rrjedhojë e detyrimit të bashkëpunimit të singertë ndërmjet institucioneve të Bashkimit Evropian dhe Shteteve Anëtare (Ritter & Brawn, 2004:175). Në përmbushjen e detyrimit bashkëpunim, Komisioni duhet të respektojë detyrimin e tij për mbrojtjen e sekretit profesional dhe të ruajë funksionimin dhe pavarësinë e tij duke qëndruar neutral.

²⁷³ Njoftimi për Zbatim parashikon një afat prej një muaj nga data e kërkesës, para. 84.

KAPITULLI VI

REFORMA DHE MODERNIZIMI I KONTROLLIT TË NDIHMËS SHETËRORE

NË BASHKIMIN EVROPIAN

6.1. Hyrje

Reformat kryesore të ndërmarra në kuadër të kontrollit të ndihmës Shtetërore në Bashkimin Evropian janë: Plani i Veprimit për Ndhmën Shtetërore i vitit 2005 dhe Modernizimi i Ndhmës Shtetërore i vitit 2012. Analiza e këtyre reformave do të jetë në qendër të këtij kapitulli. Plani i Veprimit për Ndhmën Shtetërore përfshinte strategjinë e Lisbonës për zhvillim dhe punësim. Objektivat kryesore të Planit të Veprimit për Ndhmën Shtetërore ishin: më pak ndihmë Shtetërore dhe më mirë e shënjestruar; qasje (analizë) ekonomike; procedura më efektive, parashikueshmëri më e lartë dhe rritje e transparencës; kompetenca të ndara ndërmjet Komisionit dhe Shteteve Anëtare. Ndërsa, reforma tjetër ambicioze e nisur nëpërmjet Komunikimit për Modernizimin e Ndhmës Shtetërore, në vitin 2012 kishte tre objektiva kryesore: (i) nxitjen e një rritje të qëndrueshme, të zgjuar dhe përfshirëse në një treg të brendshëm konkurrues; (ii) përqendrimin e shqyrtimit *ex-ante* nga Komisioni në rastet me ndikim më të madh në tregun e brendshëm duke rritur në të njëjtën kohë bashkëpunimin me Shtetet Anëtare në zbatimin e rregullave për ndihmën Shtetërore dhe (iii) përmirësimin e rregullave dhe dhënien e vendimeve më të shpejta.²⁷⁴

²⁷⁴ Communication from the Commission to the European Parliament, the Council, the European Economic and Social Committee and the Committee of the Regions (Communication on State Aid Modernisation). (Komunikim mbi Modernizimin e Ndhmës Shtetërore). (Komunikim nga Komisioni për Parlamentin

Ky kapitull do të analizojë në mënyrë kritike secilën prej këtyre reformave. Në qendër të analizës do të jenë efektet e secilës prej reformave të sipërpërmendura. Analiza do të hedhë idenë se ekzistojnë akoma disa elementë të kontrollit të ndihmës Shtetërore të cilët kanë nevojë për ndryshim.

6.2. Reforma e ndihmës Shtetërore sipas Planit të Veprimit për Ndihmën Shtetërore të vitit 2005

Samiti i Lisbonës i mbajtur në Mars të vitit 2000, në mënyrë specifike, përmend nevojën e ripërkufizimit të qëllimeve të politikës për ndihmën Shtetërore.²⁷⁵ Mbi këtë bazë Komisioni prezantoi Planin e Veprimit për Ndihmën Shtetërore, i cili u publikua në vitin 2005.²⁷⁶ Ky dokument do të shërbente si një udhërrëfyes për reformat e ndihmës Shtetërore deri në vitin 2009. Objektivat kryesore të reformës ishin: më pak ndihmë Shtetërore dhe më mirë e shënjestruar; qasje (analizë) ekonomike; procedura më efektive, parashikueshmëri më e lartë dhe rritje e transparencës; kompetenca të ndara ndërmjet Komisionit dhe Shteteve Anëtare.

Plani i Veprimit për Ndihmën Shtetërore përbënte një program ambicioz pune, i cili konsistonte në rishikimin e shumicës së rregullave ekzistuese për ndihmat Shtetërore, brenda një periudhe pesë vjeçare. Komisionari për konkurrencën në Komisionin Evropian,

Evropian, Këshillin, Komitetin Ekonomik dhe Shoqëror dhe Komitetin e Rajoneve), COM (2012) 209, 8.5.201, para. 8.

²⁷⁵ European Council of Lisbon, 23-24 Mars 2000, Conclusion Document of the Presidency para. 17 (Këshilli i Bashkimit Evropian i Lisbonës, 23-24 mars 2000, Konkluzionet e Presidencës, DOC/00/8 para. 17).

²⁷⁶ State Aid Action Plan: Less and better targeted State aid: a roadmap for State aid reform 2005-2009, (Plan Veprimi për Ndihmën Shtetërore: Më pak ndihmë Shtetërore dhe më mirë e shënjestruar: udhërrëfyes për reformën e ndihmës Shtetërore 2005-2009) COM (2005) 107 final.

në atë kohë, Neelie Kroes e konsideroi si një udhërrëfyes për zhvillimin në të ardhmen të politikës për ndihmën Shtetërore në Bashkimin Evropian. Plani përbënte atë që mund të konsiderohej si një hap i tretë në reformën e legjislacionit dytësor të konkurrencës në Bashkimin Evropian të filluar më parë nga paraardhësi i Komisionarit Kroes (Koenig & Oliver, 2005:592). Në kuadër të Planit të Veprimit për Ndihmën Shtetërore u ndryshua legjislacioni dytësor dhe rrjedhimisht u prezantuan: Rregullore e Komisionit e cila deklaronte kategori të caktuara të ndihmës të pajtueshme me tregun e përbashkët, në zbatim të neneve 87 dhe 88 të Traktatit²⁷⁷; udhëzim në lidhje me ndihmën për mbrojtjen e mjedisit;²⁷⁸ drejtim orientues për ndihmën shtetërore për kërkim, zhvillim dhe inovacion;²⁷⁹ udhëzimet për ndihmën kombëtare rajonale për 2007-2013;²⁸⁰ udhëzime për ndihmën Shtetërore për të nxitur investimet në lidhje me ndihmën për riskun e kapitalit në ndërmarrjet e vogla dhe të mesme;²⁸¹ komunikatë e Komisionit mbi elementë të ndihmës Shtetërore në shitjen e tokës dhe të ndërtesave nga autoritetet publike;²⁸² vendim i Komisionit 2005/842/KE mbi zbatimin e nenit 86 (2) të Traktatit të KE-së për ndihmën Shtetërore në formën e kompensimit të shërbimeve publike e dhënë ndërmarrjeve të caktuara të ngarkuara me

²⁷⁷ Commission Regulation (EC) No 800/2008 of 6 August 2008 declaring certain categories of aid compatible with the common market in application of Articles 87 and 88 of the Treaty, OJ L 214, 9.8.2008, fq. 3-47 (Rregullore e Komisionit e cila deklaronte kategori të caktuara të ndihmës në përputhje me tregun e përbashkët, në zbatim të neneve 87 dhe 88 të Traktatit).

²⁷⁸ Community Guidelines on State aid for Environmental Protection, OJ C 82, 1.4.2008, fq.1 (Udhëzim i Komunitetit në lidhje me ndihmën për mbrojtjen e mjedisit).

²⁷⁹ Community Framework for State aid for Research and Development and Innovation, OJ C 323 of 30.12.2006, fq. 1 (drejtim orientues i Komunitetit për ndihmën shtetërore për kërkim, zhvillim dhe inovacion).

²⁸⁰ The Guidelines on National Regional Aid for 2007-2013, OJ C 54, 4.3.2006, fq.13. (udhëzimet për ndihmën kombëtare rajonale për 2007-2013).

²⁸¹ Community Guidelines on State Aid to Promote Risk Capital Investments in Small and Medium-sized Enterprises OJ C 194, 18.08.2006, fq. 2, (udhëzime të Komunitetit për ndihmën Shtetërore për të nxitur investimet në lidhje me ndihmën për riskun e kapitalit në ndërmarrjet e vogla dhe të mesme).

²⁸² Commission Communication on State aid elements in sale of land and buildings by public authorities OJ C 209, 10.7.1997, fq.3, (komunikatë e Komisionit mbi elementë të ndihmës shtetërore në shitjen e tokës dhe të ndërtesave nga autoritetet publike).

kryerjen e shërbimeve me interes të përgjithshëm ekonomik;²⁸³Rregullore e Komisionit për zbatimin e neneve 87 dhe 88 të Traktatit në lidhje me ndihmën *de minimis*;²⁸⁴ Kodi i Praktikave të Mira.²⁸⁵ Më poshtë do të analizohen ndryshimet kryesore që solli reforma e sipërpërmendur në aspektin e së drejtës materiale dhe asaj procedurale për ndihmën Shtetërore në Bashkimin Evropian.

6.2.1. Reforma e së drejtës materiale në kuadër të Planit të Veprimit për Ndihmën Shtetërore

Një nga idetë kryesore të Planit të Veprimit për Ndihmën Shtetërore ishte prezantimi i “analizës ekonomike” gjatë vlerësimit të masës ndihmë nga Komisioni. Komisionari për konkurrencën Neelie Kroes pranoi se analiza ekonomike nuk mungonte në marrjen e vendimit nëse një masë përbënte ose jo ndihmë Shtetërore, ose nëse ajo masë do të lejohej ose jo. Megjithatë, analiza ekonomike nuk përdorej sistematikisht (Kroes:2007).

Paragrafi 19 i Planit të Veprimit për Ndihmën Shtetërore parashikon që: *“analizat ligjore dhe ekonomike do të përdoren nga Komisioni për të përmbushur detyrimet e tij sipas Traktatit, në disa raste për të vendosur nëse një masë është ndihmë Shtetërore dhe*

²⁸³ Commission Decision of 28 November 2005 on the application of Article 86(2) of the EC Treaty to State aid in the form of public service compensation granted to certain undertakings entrusted with the operation of services of general economic interest” (2005/842/EC) OJ L 312, 29.11.2005, fq. 67-73 (vendim i Komisionit 2005/842/KE mbi zbatimin e nenit 86 (2) të Traktatit të KE-së për ndihmën Shtetërore në formën e kompensimit të shërbimeve publike e dhënë ndërmarrjeve të caktuara të ngarkuara me kryerjen e shërbimeve me interes të përgjithshëm ekonomik)

²⁸⁴ The Commission Regulation (EC) No 1998/2006 of 15 December 2006 on the application of Articles 87 and 88 of the Treaty to *de minimis* aid OJ L 379, 28.12.2006, fq. 5 (Rregullore e Komisioni (EC) Nr 1998/2006 e 15 dhjetorit 2006 mbi zbatimin e neneve 87 dhe 88 të Traktatit në lidhje me ndihmën *de minimis*).

²⁸⁵ Code of Best Practice for the conduct of State aid control procedures (Kodi i Praktikave të Mira për kryerjen e procedurave të kontrollit të ndihmës Shtetërore) OJ C136/04, 16.6.2009.

veçanërisht për të vendosur kur ndihma Shtetërore mund të deklarohet e pajtueshme me Traktatin”.²⁸⁶ Kështu, Komisioni zbaton testin balancues në fazën e dytë të vlerësimit të një mase ndihmë Shtetërore dhe pikërisht gjatë shqyrtimit të pajtueshmërisë së masës me nenin 107(3) TFBE. Neni 107(3) TFBE parashikon që: “....mund të konsiderohen si të pajtueshme me tregun e brendshëm: (a) ndihma për nxitjen e zhvillimit ekonomik të zonave ku standardi i jetesës është i ulët në mënyrë jo normale dhe ku ka papunësi të theksuar dhe, të rajoneve të përmendura në nenin 349, duke mbajtur parasysh situatën e tyre strukturore, ekonomike dhe sociale; (b) ndihma për nxitjen e realizimit të një projekti të rëndësishëm me interes të përbashkët europian ose për ndreqjen e një çrregullimi të rëndë në ekonominë e një Shteti Anëtar; (c) ndihma për lehtësimin e zhvillimit të disa aktiviteteve të caktuara ekonomike ose të disa fushave të caktuara ekonomike, ku një ndihmë e tillë nuk i prek aq keq kushtet e tregtimit sa të bien ndesh me interesin e përbashkët; (d) ndihma për nxitjen e ruajtjes së kulturës dhe trashëgimisë, kur një ndihmë e tillë nuk i prek aq kushtet e tregtimit dhe konkurrencën në Bashkimin sa të bien ndesh me interesin e përbashkët; (e) kategori të tjera të tilla ndihme të cilat mund të përcaktohen në një vendim të Këshillit me propozim të Komisionit.” Rrjedhimisht, Plani i Veprimit për Ndhmën Shtetërore e kufizon rolin e “qasjes ekonomike” në përcaktimin e nocionit të ndihmës (Sierra & Smulder, 2008:13).

²⁸⁶ State Aid Action Plan: and better targeted State aid: a roadmap for State aid reform 2005-2009, (Plan Veprimi për Ndhmën Shtetërore: Më pak dhe më mirë e shënjestruar: udhërrëfyes për reformën e ndihmës Shtetërore 2005-2009) COM (2005) 107 final, para.19.

6.2.2. Reforma procedurale në kuadër të Planit të Veprimit për Ndhimën Shtetërore

Komisioni, nëpërmjet miratimit të Njoftimit për Procedura të Thjeshtuara (në vazhdim “Njoftimi”)²⁸⁷ dhe Kodit të Praktikave të Mira (në vazhdim “Kodi”)²⁸⁸ kishte si qëllim të thjeshtonte procedurat në lidhje me ndihmën Shtetërore. Njoftimi për Procedura të Thjeshtuara kontribuon për një kontroll më të parashikueshëm dhe më eficient të ndihmës Shtetërore. Sipas Njoftimit, Komisioni shqyrton brenda një afati kohor të përsheptuar disa lloje masash ndihmë Shtetërore. Njoftimi zbatohet vetëm në lidhje me ato masa ndihmë Shtetërore për të cilat Komisioni verifikon nëse masa është në përputhje me rregullat dhe praktikatat ekzistuese.

Ndërsa, nëpërmjet Kodit të Praktikave të Mira, Komisioni kishte si qëllim të prezantonte procedura më efektive për të gjitha palët. Kodi synon të jetë një guidë për procedurat në lidhje me ndihmën Shtetërore duke zhvilluar bashkëpunimin dhe mirëkuptimin e Shteteve Anëtare, shërbimeve të Komisionit dhe komunitetit të biznesit. Gjithashtu, Kodi i Praktikave të Mira ka si qëllim rritjen e transparencës dhe efikasitetit të procedurave në lidhje me ndihmën Shtetërore duke plotësuar Rregulloren Procedurale ekzistuese.²⁸⁹

Kodi prezanton një fazë paraprake njoftimi, rregullon mundësinë e një planifikimi për të cilin shërbimet e Komisionit dhe Shteti Anëtar bien dakord. Gjithashtu, ai synon të

²⁸⁷ Notice from the Commission on a simplified procedure for treatment of certain types of State Aid, (Njoftim i Komisionit për procedura të thjeshtuara për disa lloje ndihmash) OJ C 136/03 16.6.2009.

²⁸⁸ Code of Best Practice for the conduct of State aid control procedures (Kodi i Praktikave të Mira për kryerjen e procedurave të kontrollit të ndihmës Shtetërore) OJ C136/04, 16.6.2009.

²⁸⁹ Po aty para 2, 3 dhe 7.

rrisë eficientë të procedurës së shqyrtimit paraprak dhe procedurës së shqyrtimit formal si dhe procedurës së shqyrtimit të ankimeve.

Faza e njoftimit paraprak e prezantuar nga Kodi për herë të parë thekson vlerën e shtuar të kontakteve përpara njoftimit me Shtetet Anëtare në mënyrë që të krijojë mundësinë për një shqyrtim më të shpejtë të njoftimeve.²⁹⁰ Kontaktet përpara njoftimit krijojnë mundësinë të diskutohet në lidhje me procesin e njoftimit. Këto kontakte ndihmojnë Shtetin Anëtar të përcaktojë informacionin që do të paraqesë ose të kuptojë nëse çështja mund të kualifikohet *prima facie* për procedurën e thjeshtuar. Sic u përmend dhe më sipër kjo procedurë do të zbatohet vetëm në lidhje me ato masa ndihmë Shtetërore për të cilat Komisioni verifikon nëse masa është në përputhje me rregullat dhe praktikat ekzistuese. Kodi parashikon një afat prej dy muajsh, por faza e diskutimeve përpara njoftimit mund të zgjasë disa muaj në varësi të kompleksitetit të çështjes.²⁹¹ Në fund të kësaj faze Komisioni i jep Shtetit Anëtar përkatës një vlerësim paraprak të projektit. Vlerësimi është joformal dhe nuk përbën një qëndrim zyrtar i Komisionit. Ai përbën një udhëzim në lidhje me faktin nëse drafti i njoftimit është i plotë ose jo dhe pajtueshmërinë *prima facie* të projektit me tregun e brendshëm.²⁹² Komisioni parashikon dhe përfshirjen e përfituesit të ndihmës Shtetërore gjatë bisedimeve paraprake por nuk parashikon detaje të mëtejshme.²⁹³

Faza e njoftimit paraprak është kritikuar sepse fokusi në kontaktet para njoftimit mund të kufizojë të drejtat e palëve të palëve të interesuara (Filpo, 2010:329). Nëse faza e

²⁹⁰ Po aty para 10.

²⁹¹ Po aty para 14.

²⁹² Po aty para. 16.

²⁹³ Po aty para. 15.

njoftimit paraprak përdoret shpesh për të mbledhur informacion ajo mund të dublikojë procedurën e shqyrtimit paraprak të parashikuar nga Rregullorja Procedurale. Për më tepër, neni 4(6) i Rregullores Procedurale parashikon ndihmën që mund të zbatohet nga Shteti Anëtar nëse Komisioni nuk ka qenë në gjendje të marrë një vendim brenda dy muajve nga njoftimi i ndihmës së re. Neni 4/6 i Rregullores Procedurale parashikon që: *“Në rastet kur Komisioni nuk ka marrë një vendim në përputhje me paragrafët 2, 3 ose 4 brenda afatit të parashikuar në paragrafin 5, ndihma do të konsiderohet e autorizuar nga Komisioni. Shteti Anëtar përkatës mund të zbatojë masat në fjalë pasi ka njoftuar paraprakisht Komisionin.....”* Për më tepër, 4/5 i Rregullores Procedurale parashikon që: *“Vendimet e përmendura në paragrafët 2, 3 dhe 4 të këtij neni do të merret brenda 2 muajve. Kjo periudhë do të fillojë në ditën e marrjes së një njoftimi të plotë”* Ndërsa, gjatë fazës së para-njoftimit Komisioni nuk ka një detyrim të tillë, kështu që ka më shumë kohë dhe më pak përgjegjësi. Për më tepër, diskutimi i thelbit të çështjes gjatë fazës së njoftimit paraprak i mohon palëve të interesuara mundësinë të ushtrojnë dhe ato të drejta të kufizuara që atyre u njihen nga Rregullorja Procedurale dhe në të njëjtën kohë i mohon Komisionit një burim të dhënash (Filpo, 2010:330). Gjithashtu, kjo fazë përfundon me një “vendim” nga Komisioni që nuk është i detyrueshëm por që ndikon në vendimin përfundimtar dhe gjithashtu vonon vendimin përfundimtar duke shtuar dhe një hap tjetër.

Seksioni 7 i Kodit të Praktikave të Mira, ka të bëjë me shqyrtimin e ankimeve. Kodi prezanton një formë ankimi me qëllim rritjen e efikasitetit dhe transparencës si dhe të cilësisë së ankimeve.²⁹⁴ Më pas, trajtohen afatet brenda të cilave Komisioni duhet të shqyrtojë ankimet e paraqitura nga subjektet e ndryshme. Afatet e parashikuara nga Kodi

²⁹⁴ Po aty para. 45-51.

nuk janë të detyrueshme. Ato janë subjekt i diskrecionit të Komisionit dhe Shteteve Anëtare. Në raste të caktuara afatet rrezikojnë të dëmtojnë përfituesit potenciale të ndihmës Shtetërore dhe palët e treta (Nordlander, 2010:361). Kodi parashikon afatet e më poshtme²⁹⁵:

- Kontaktet paraprake të njoftimit nuk duhet të zgjasin me tepër se dy muaj, gjithsesi, në varësi të kompleksitetit të çështjes kontaktet paraprake të njoftimit mund të zgjasin dhe disa muaj;
- Një kërkesë për informacion në lidhje me vlerësimin paraprak duhet të dërgohet brenda 4-6 javësh nga data e njoftimit (Shteti Anëtar ka afat një muaj për t'u përgjigjur);
- Procedura paraprake e shqyrtimit duhet të fillojë brenda dy muajve pas paraqitjes së një njoftimi të plotë.²⁹⁶ Gjithsesi, Komisioni mund t'i dërgojë Shtetit Anëtar kërkesa të ndryshme për informacion gjatë procedurës së shqyrtimit paraprak dhe kjo periudhë mund të zgjatet me miratimin e Shtetit Anëtar përkatës dhe Komisionit;
- Pas fillimit të procedurës së shqyrtimit formal Komisioni duhet të marrë një vendim brenda 18 muajve, gjithsesi ky afat mund të zgjatet me marrëveshje ndërmjet Komisionit dhe Shtetit Anëtar përkatës.

²⁹⁵ Code of Best Practice for the conduct of State aid control procedures (Kodi i Praktikave të Mira për kryerjen e procedurave të kontrollit të ndihmës Shtetërore) para. 14, 25, 25-28, 43.

²⁹⁶ Council Regulation 1999/659/EC of 22 March 1999 laying down detailed rules for the application of Article 93 of the EC Treaty, OJ L 83/1, 27 March (Mars) 1999. (Rregullore e Këshillit 1999/659/EC, 22 Mars 1999 për përcaktimin e rregullave të detajuara për zbatimin e nenit 93 të Traktatit të Komunitetit Evropian).

6.3. Modernizimi i Ndhmës Shtetërore – një reformë tjetër

Në maj të vitit 2012, Komisioni miratoi një Komunikatë e cila përbënte një reformë tjetër ambicioze në fushën e ndihmës Shtetërore.²⁹⁷ Objektivi i reformës ishte: (i) të nxiste një rritje të qëndrueshme, të zgjuar, në tregun e brendshëm konkurrues; (ii) të përqendronte shqyrtimin *ex ante* të Komisionit në çështje me ndikimin më të madh në tregun e brendshëm ndërsa forconte bashkëpunimin me Shtetet Anëtare në zbatimin e ndihmës Shtetërore; (iii) të modernizonte rregullat dhe të siguronte vendimmarrje më të shpejtë.²⁹⁸ Reforma ka rezultuar në rishikimin e legjislacionit dytësor në lidhje me ndihmën Shtetërore.²⁹⁹

²⁹⁷ Communication from the Commission to the European Parliament, the Council, the European Economic and Social Committee and the Committee of the Regions (Communication on State Aid Modernisation). (Komunikatë nga Komisioni për Parlamentin Evropian, Këshillin, Komitetin Social dhe Ekonomik dhe Komitetin e Rajoneve) (Komunikatë mbi Modernizimin e Ndhmës Shtetërore)) COM (2012) 209, 8.5.2012.

²⁹⁸ Po aty, para. 8.

²⁹⁹ Te tilla si: Council Regulation No 733/2013 of 22 July 2013 amending Regulation (EC) No 994/98 on the application of Articles 92 and 93 of the Treaty establishing the European Community to certain categories of horizontal State aid, OJ 2013 L204/11, (Rregullore e Këshillit Nr. 733/2013 të 22 Korrikut 2013 e cila ndryshon Rregulloren (KE) Nr. 994/98 për zbatimin e Neneve 92 dhe 93 të Traktatit për Krijimin e Komunitetit Evropian për disa kategori të ndihmës horizontale); Commission Regulation (EU) No 651/2014 of 17 June 2014 declaring certain categories of aid compatible with the internal market in application of Articles 107 and 108 of the Treaty, OJ 2014 L187/1, (Rregullore e Komisionit (BE) Nr. 651/2014 e 17 Shkurtit 2014 e cila deklaron disa kategori të ndihmës të pajtueshme me tregun e brendshëm në zbatim të neneve 107 dhe 108 të Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Evropian); Commission Regulation (EU) No 1407/2013 of 18 December 2013 on the application of Articles 107 and 108 of the Treaty on the Functioning of the European Union to de minimis aid, OJ 2013 L 352/1 (Rregullore e Komisionit (BE) e 18 Dhjetorit Nr. 1407/2013 e 18 Dhjetorit 2013 për aplikimin e neneve 107 dhe 108 të Traktit për Funksionimin e Bashkimit Evropian në lidhje me ndihmën *de minimis*); Guidelines on regional State aid for 2014-2020, OJ 2013 C209/1, (Udhëzim për ndihmën rajonale për vitet 2014-2020); Guidelines for the application of State rules in relation to the rapid deployment of broadband network, OJ 2013 C 25/01, (Udhëzim për zbatimin e rregullave për ndihmën Shtetërore në lidhje me zhvillimin e shpejtë të rrjetit të transmetimit); Guidelines on State aid for rescuing and restructuring non-financial undertakings in difficulty, OJ 2014 C249/01, Framework for State aid for research and development and innovation, OJ 2014 C198/01, (Drejtimit orientues për ndihmën Shtetërore për shpëtimin dhe ristrukturimin e ndërmarrjeve jo financiare në vështirësi); Guidelines on State aid for environmental protection and energy, 2014-2020 OJ 2014 C200/01, (Udhëzim për ndihmën Shtetërore për mbrojtjen e mjedisit dhe energjisë 2014-2020); Criteria for the analysis of the compatibility with the internal market of State aid to promote the execution of important projects of common European interest, OJ 2014 C188/02, (Kriteret për analizën e pajtueshmërisë me tregun e brendshëm të ndihmës Shtetërore për

6.3.1. Reforma e së drejtës materiale për ndihmat Shtetërore

6.3.1.1. Rregullore “de minimis”

Komisioni zbaton një prag *de minimis* në situata të caktuara. Ndihma “*de minimis*” mbulon shuma të vogla ndihme Shtetërore të cilat nuk përbëjnë ndihmë Shtetërore në kuptim të nenit 107 (1) të Traktatit dhe të cilat për këtë arsye nuk janë subjekt i kërkesës për njoftim. Në vitin 1992³⁰⁰ Komisioni nxori një Njoftim për *de minimis* i cili u rishikua në vitin 1996 dhe një udhëzim për ndihmën Shtetërore për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme në vitin 1996.³⁰¹ Sipas Njoftimit të vitit 1996, Komisioni prezumon që ndihma nën 100.000 Euro gjatë një periudhe tre vjeçare, nuk mund të kategorizohet sipas nenit 107 (1) TFBE. Më vonë në vitin 1998 Komisionit iu njoh e drejta për të miratuar Rregullore në lidhje me *de minimis*.³⁰² Rrjedhimisht, Komisioni miratoi Rregulloren Nr. 69/2001, e cila parashikonte pragje poshtë të cilave, ndihmat përjashtoheshin nga detyrimi për njoftim sipas nenit 108 (3) TFBE.³⁰³ Kjo Rregullore u zëvendësua nga Rregullore 1998/2006.³⁰⁴

ekezekutimin e projekteve të një interesi të përbashkët evropian).Guidelines on State aid to promote risk finance investments, OJ 2014 C19/04, Guidelines on State aid to airports and airlines, OJ 2014 C99/03.(Udhëzim për ndihmën Shtetërore për promovimin investimeve financiare).

³⁰⁰ Community Guidelines on State Aid for Small and Medium-Sized Enterprises (SMEs) [1992] OJ. C 213/2. (Udhëzim i Komisionit për Ndihmën Shtetërore për Ndërmarrjet e Vogla dhe të Mesme).

³⁰¹ Community Guidelines on State Aid for Small and Medium-Sized Enterprises (SMEs) [1996] OJ. C 68/9. (Udhëzim i Komisionit për Ndihmën Shtetërore për Ndërmarrjet e Vogla dhe të Mesme).

³⁰² Council Regulation (Rregullore e Keshillit) 994/98 [1998] OJ L 142/1. Neni 2(1) i Rregullores parashikon: “Komisioni nëpërmjet një Rregulloreje të miratuar sipas procedurës së parashikuar në nenin 8 të Rregullores Nr. 994/98 vendos, duke marrë në konsideratë zhvillimin dhe funksionimin e tregut të përbashkët, disa kategori ndihmesh të cilat nuk mund të kategorizohen sipas kushteve të nenit 107(1) TFBE dhe për këtë arsye përjashtohen nga detyrimi për njoftim parashikuar në nenin 108(3) TFBE....”

³⁰³ Commission Regulation (EC) No 1998/2006 of 15 December 2006 on the application of Articles 87 and 88 of the Treaty to *de minimis* aid [2006] OJ L 379/5 (Rregullore e Komisionit (KE) Nr. 1998/2006 e 15 Dhjetorit 2006 për zbatimin e neneve 87 dhe 88 të Traktatit ndihma *de minimis*).

Në Komunikimin për Modernizimin e Ndhmës Shtetërore përmendej mundësia e rishikimit të Rregullores *de minimis*. Rishikimi do të realizohej në bazë të një vlerësimi të detajuar, duke marrë parasysh gjendjen në gjithë Shtetet Anëtare dhe në tregun e përbashkët.³⁰⁵ Kështu, në janar të vitit 2012 filluan konsultimet publike nga Komisioni në lidhje me mënyrën e përdorimit të Rregullores *de minimis* nga Shtetet Anëtare. Ndërsa, në mars të vitit 2013 Komisioni filloi një konsultim të ri në lidhje me Rregulloren *de minimis*. Në 1 janar të vitit 2014 ka hyrë në fuqi Rregullorja Nr. 1407/2013.³⁰⁶ Rregullorja Nr. 1407/2013, parashikon një prag prej 200.000 Euro ndihmë Shtetërore për një ndërmarrje të vetme në një periudhë prej tre vitesh. Ky prag nuk ndryshon nga ai i parashikuar nga Rregullorja paraardhëse.

6.3.1.2. Rregullore zbatuese

Rregullorja Zbatuese lejon Komisionin të deklarojë, nëpërmjet rregulloreve të tjera, që disa kategori të ndihmës Shtetërore janë të pajtueshme me tregun e brendshëm dhe përjashtohen nga detyrimi për njoftim i parashikuar në nenin 108(3) TFBE. Kategoritë përfshijnë: ndihmën *de minimis*, ndihmën për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme, ndihmën për kërkim dhe zhvillim, ndihmën për mbrojtjen e ambientit, ndihmën për punësim dhe

³⁰⁴ Commission Regulation (EC) No 69/2001 of 12 January 2001 on the application of Articles 87 and 88 of the EC Treaty to *de minimis* aid (Rregullore e Komisionit (KE) Nr. 69/2001 e 12 Janarit 2001 për zbatimin e Neneve 87 dhe 88 të TKE-së për ndihmën *de minimis*).

³⁰⁵ Para. (20) (a) i Komunikimit për Modernizimin e Ndhmës Shtetërore.

³⁰⁶ Commission Regulation (EU) No 1407/2013 of 18 December 2013 on the application of Articles 107 and 108 of the Treaty on the Functioning of the European Union to *de minimis* aid [2013] OJ L 352/1 (Rregullore e Komisionit (BE) Nr. 1407/2013 e 18 Dhjetorit 2013 për zbatimin e neneve 107 dhe 108 të Traktatit) për funksionimin e Bashkimit Evropian për ndihmën *de minimis*).

trajnim si dhe ndihmën rajonale që është në përputhje me hartën e miratuar nga Komisioni për çdo Shtet Anëtar.

Rregullorja e Këshillit Nr. 733/2013³⁰⁷ e cila ndryshoi Rregulloren Zbatuese parashikon kompetencën e Komisionit për të përjashtuar në bllok kategori të tjera ndihme. Në nenin 1 të Rregullores Nr. 733/2013 parashikohet një listë e plotë e kategorive të ndihmës të cilat mund të përjashtohen në grup nga Komisioni. Ato janë: ndihma për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme, ndihma për kërkim dhe zhvillim, ndihma për mbrojtjen e ambientit, ndihma për punësim dhe trajnim, ndihma për ruajtjen e trashëgimisë kulturore, ndihma për dëmet e shkaktuara nga fatkeqësi natyrore, ndihma për shpërblim e dëmeve të shkaktuara nga kushtet atmosferike në peshkim, ndihma për pyjet, ndihma për sportin.

6.3.1.3. Rregullore për përjashtimet në grup

Pasi Këshilli të ketë miratuar Rregulloren Zbatuese, Komisioni mund të fillojë përcaktimin e kriterëve për përjashtimet në grup të kategorive të reja të ndihmës. Kjo mund të realizohet duke ndryshuar Rregulloren për Përjashtimet në Grup. Komisioni mund të shtojë kategori të reja të ndihmës që përjashtohen dhe gjithashtu mund të ndryshojë mënyrën sipas së cilës përjashtohet në grup shuma maksimale e ndihmës.

³⁰⁷ Council Regulation No 733/2013 of 22 July 2013 amending Regulation (EC) No 994/98 on the application of Articles 92 and 93 of the Treaty establishing the European Community to certain categories of horizontal State aid [2013] OJ L204/ 11 (Rregullore e Këshillit Nr. 733/2013 i 22 Korrikut 2013 e cila ndryshon Rregulloren Nr. 994/98 për zbatimin e neneve 92 dhe 93 të Traktatit për krijimin e Komunitetit Evropian për disa kategori horizontale të ndihmës Shtetërore).

Në kuadër të Modernizimit të Ndhmës Shtetërore, në 21 Maj të vitit 2014 u miratua një Rregullore për Përfjashtimet në Grup e cila hyri në fuqi në 1 Korrik të vitit 2014.³⁰⁸ Nëse plotësohen kushtet e kësaj Rregulloreje skemat e ndihmës ose ndihma individuale përfjashtohet nga detyrimi për njoftim parashikuar në nenin 108(3) TFBE dhe pritja e autorizimit nga Komisioni. Rregullorja e vitit 2014 duke përfutuar nga ndryshimet e Rregullores Zbatuese në vitin 2013, të analizuara më sipër, zgjeron përfjashtimet në grup.³⁰⁹ Rregullorja për Përfjashtimet në Grup e vitit 2014 në krahasim me Rregulloren për Përfjashtimet në Grup të vitit 2008 rrit prapun e njoftimeve për shumë masa ndihmë Shtetërore. Gjithashtu, janë thjeshtuar dhe qartësuar kushtet që duhet të plotësojë një mase ndihmë Shtetërore për të përfutuar prej përfjashtimit në grup të parashikuar nga Rregullorja e sipërpërmendur (Jones dhe Sufrin, 2014:489).

6.3.1.4. Nocioni i ndihmës Shtetërore: një përkufizim më i mirë

Në kuadër të Modernizimit të Ndhmës Shtetërore, Komisioni publikoi një Njoftim mbi Nocionin e Ndhmës Shtetërore. Nëpërmjet këtij Njoftimi, Komisioni synon të sqarojë disa koncepte shumë të rëndësishme që lidhen me nocionin ndihmës Shtetërore. Në këtë mënyrë, Komisioni kontribuon në një zbatim më të thjeshtë, më transparent dhe më të qëndrueshëm të nocionit të sipërpërmendur. Njoftimi, ka të bëjë vetëm me nocionin e ndihmës Shtetërore sipas nenit 107(1) TFBE. Rrjedhimisht, ai sqaron elementet e

³⁰⁸ Commission Regulation (EU) No 651/2014 of 17 June 2014 declaring certain categories of aid compatible with the internal market in application of Articles 107 and 108 of the Treaty [2014] OJ L 187/1. (Rregullore e Komisionit (EU) Nr. 651/2014 e 17 Qeshorit 2014 e cila deklaron disa kategori të ndihmës Shtetërore të pajtueshme me tregun e brendshëm në zbatimin e neneve 107 dhe 108 të Traktatit).

³⁰⁹ Do të përfjashtohen në grup: infrastruktura lokale, infrastruktura e transmetimit, infrastruktura e energjisë dhe kërkimit, fondet rajonale të zhvillimit urban, ruajtja e kulturës dhe trashëgimisë, punimet audio-vizuale.

ndryshëm, të cilët sipas jurisprudencës, përbëjnë ndihmë Shtetërore bazuar në nenin e sipërpërmendur. Ashtu siç janë analizuar në kapitullin e parë të kësaj teme këto elemente janë: financimi i masës ndihmë nga burimet Shtetërore, dhënia e një avantazhi ekonomik, përzgjedhja si dhe efektet e saj në konkurrencë dhe tregtinë në Bashkimin Evropian.

6.3.2. Aspekte procedurale të reformës

Në kuadër të Modernizimit të Ndihmës Shtetërore u ndryshua Rregullorja Procedurale e miratuar në vitin 1999 nëpërmjet Rregullores së Këshillit Nr. 2013/734/EC të datës 22 Korrik 2013 (në vazhdim “Rregullorja e re Procedurale”).³¹⁰Rregullorja e re Procedurale përdor për herë të parë fjalën “ankim” në legjislacionin dytësor të BE-së për ndihmën Shtetërore. Sipas neneve 10(1) dhe 10(2) të Rregullores së re Procedurale *“Komisioni do të shqyrtojë pa vonesë çdo ankim të paraqitur nga palët e treta në përputhje me nenin 20(2) të së njejtës Rregullore dhe do të bëjë të mundur që Shteti Anëtar të informohet plotësisht dhe rregullisht në lidhje me zhvillimin dhe përfundimin e hetimit”*. Për më tepër, neni 20 (2) i Rregullores së re Procedurale parashikon që *“çdo palë e interesuar mund të informojë Komisionin, nëse gjykohet se ndihma është e paligjshme. Kur Komisioni vlerëson se informacioni që ka në zotërim nuk është i mjaftueshëm, ai do të njoftojë palën e interesuar”*. Rrjedhimisht, Rregullorja e re Procedurale nuk parashikon detyrimin ligjor të Komisionit për të marrë një vendim pas përfundimit të hetimeve në lidhje me një ankim.

³¹⁰ Council Regulation 2013/734/EC of 22 July 2013 OJ L204/15, 31 July 2013, amending Council Regulation 1999/659/EC of 22 March 1999 laying down detailed rules for the application of Article 93 of the EC Treaty, OJ L 83/1, 27 March 1999. (Rregullore e Këshillit 2013/734/EC, 22 Korrik 2013 OJ L204/15, 31 Korrik 2013, e cila ndryshon Rregulloren e Këshillit 1999/659/EC, 22 Mars 1999 për përcaktimin e rregullave të detajuara për zbatimin e nenit 93 të Traktatit të Komunitetit Evropian).

Ndryshimet tregojnë qëllimin e Komisionit për të ruajtur mundësinë e refuzimit të ankimeve pa marrë një vendim (Catalán, 2013:31).

Rregullorja e re Procedurale formalizon disa hapa në lidhje me procedurën shqyrtimit të ankimeve. Së pari, çdo ankues duhet të tregojë se ai është palë e interesuar sipas kuptimit të nenit 108(2) TFBE dhe nenit 1(h) të Rregullores Procedurale.³¹¹ Palë të interesuara sipas neneve të sipërpërmendura janë përfituesit e ndihmës, si dhe ndërmarrjet konkurruese e bashkimet e tyre, interesi i të cilave mund të cenohet nga dhënia e ndihmës. Së dyti, nenit 20(1) dhe (2) të Rregullores së re Procedurale çdo palë e interesuar (përfshirë dhe ankuesin) duhet të plotësojë një formë ankimi e cila përmban disa informacione të detyrueshme që janë përcaktuar nga Rregullorja zbatuese miratuar nga Komisioni.³¹² Qëllimi i Komisionit është të përmirësojë cilësinë e ankimeve të paraqitura dhe të rrisë transparencën dhe sigurinë juridike.³¹³ Ankimet e paraqitura që nuk plotësojnë këto kushte do të trajtohen si informacione për tregun.³¹⁴ Së treti, neni 20(2) i Rregullores së re Procedurale formalizon mundësinë e Komisionit për t'i konsideruar të tërhequr ankimet në qoftë se ankuesi nuk jep informacion ose nuk bashkëpunon gjatë procedurës. Nuk është e qartë nëse hapat e shtuar nga Rregullorja e re Procedurale do të kontribuojnë në lehtësimin e punës së Komisionit në lidhje me shqyrtimin e ankimeve. Për më tepër, e paqartë mbetet dhe mënyra e përdorimit diskrecionit të Komisionit për të vendosur prioritetet në lidhje me ankimet.

³¹¹ Po aty Recitali 15.

³¹² Po aty.

³¹³ Council Regulation 2013/734/EC of 22 July 2013 OJ L204/15, 31 July 2013, amending Council Regulation 1999/659/EC of 22 March 1999 laying down detailed rules for the application of Article 93 of the EC Treaty, OJ L 83/1, 27 March 1999, Recital 15, Recital 14. (Rregullore e Këshillit 2013/734/EC, 22 Korrik 2013 OJ L204/15, 31 Korrik 2013, e cila ndryshon Rregulloren e Këshillit 1999/659/EC, 22 Mars 1999 për përcaktimin e rregullave të detajuara për zbatimin e nenit 93 të Traktatit të Komunitetit Evropian)

³¹⁴ Po aty.

Bazuar në Rregulloren e re Procedurale, Komisionit pas fillimit të procedurës së shqyrtimit formal, i lejohet të kërkojë informacion jo vetëm nga Shteti Anëtar që ka bërë njoftimin por dhe nga Shtete të tjera Anëtare. Kushti i vetëm që duhet të respektojë Komisioni në këtë rast është që informacioni i paraqitur nga Shteti Anëtar që ka bërë njoftimin të jetë i pamjaftueshëm. Sipas recitalit 3 të Rregullores së re Procedurale kërkesat për informacion mund të përdoren në çështje që janë komplekse. Informacioni do të përfshijë të gjithë informacionin e nevojshëm në treg për të bërë të mundur përfundimin e vlerësimit nga Komisioni. Rregullorja e re Procedurale bën një dallim ndërmjet kërkesave të thjeshta për informacion që i drejtohen ndërmarrjeve dhe rrethanave kur Komisioni mund t'i kërkojë informacion nëpërmjet një vendimi.

Gjithsesi, kompetenca e Komisionit për të kërkuar informacion është e kufizuar.³¹⁵ Neni 6a (2) i Rregullores së re Procedurale parashikon që Komisionit i lejohet të kërkojë informacion vetëm gjatë procedurës së shqyrtimit formal, e cila është identifikuar nga ana e Komisionit si joefektive deri në momentin e kërimit të informacionit. Nga ana tjetër, përpara se kërkesa t'i dërgohet përfituesit të ndihmës Shtetërore, është i nevojshëm një autorizim nga Shteti Anëtar. Këto kufizime u diktuan nga Shtetet Anëtare të cilët kërkojnë të kontrollojnë dhe kufizojnë shkëmbimin e informacionit ndërmjet palëve të interesuara dhe Komisionit (Nehl, 2014:246).

³¹⁵ Propozimi fillestar i Komisionit parashikonte për një shtrirje më të gjerë t137 kompetencave hetuese të Komisionit.

Proposal of 5 December 2012 for a Council Regulation amending Council Regulation 1999/659/EC of 22 March 1999 laying down detailed rules for the application of Article 93 of the EC Treaty, OJ L 83/1, 27 March 1999 (COM(2012) 725 final), (Propozim i 5 Dhjetorit 2012 për një Rregullore të Këshillit që ndryshon Rregulloren e Këshillit 1999/659/EC of 22 March 1999 e cila parashikon rregulla të detajuara për zbatimin e nenit 93 të Traktatit të Komunitetit Evropian).

Komisioni nuk synon të ndryshojë karakterin bilateral të procedurës për ndihmën Shtetërore.³¹⁶ Rrjedhimisht, në mënyrë që të ruajë statusin procedural të Shteteve Anëtare, neni 6a (8) detyron Komisionin t'i japë Shtetit Anëtar përkatës një kopje të kërkesës ose vendimit për informacion. Ndërsa neni 6a (3) parashikon që përgjigjet e dhëna nga ndërmarrjet pas një kërkesë për informacion t'i dërgohen në të njëjtën kohë Komisionit dhe Shtetit Anëtar. Sipas nenit 6a (5) Komisioni mund t'i dërgojë Shtetit Anëtar kërkesa të thjeshta për informacion duke vendosur një afat jo më shumë se një muaj. Për më tepër, në mënyrë që të garantohet e drejta e Shtetit Anëtar për t'u mbrojtur në bazë të nenit 7 (8) ata kanë mundësinë të bëjnë të njohur opinion e tyre, përpara miratimit të vendimit përfundimtar. Afati për ta përdorur këtë mundësi është jo më vonë se një muaj nga dërgimi i informacionit nga Komisioni. Fatkeqësisht, Rregullorja e re Procedurale nuk e parashikon këtë të drejtë për palët e interesuara. Të drejtën për të kërkuar informacion Komisioni duhet ta përdorë në përputhje me parimin e proporcionalitetit.³¹⁷

Shkëmbimi i informacionit mes palëve të ndryshme gjatë procedurës administrative për ndihmat Shtetërore ngre shqetësime persa i përket mbrojtjes së sekretit profesional dhe informacionit konfidencial. Për këtë qëllim, neni 7 (10) i Rregullores së re Procedurale parashikon që Komisioni duhet t'i kushtojë vëmendje interesave legjitime të ndërmarrjeve në mbrojtjen e sekretit profesional dhe informacioneve të tjera konfidenciale.

Në rast dhënie informacioni të pasaktë Rregullorja e re Procedurale i jep të drejtën Komisionit të vendosë gjoba. Nëse kërkesa për informacion është dërguar nëpërmjet një

³¹⁶ Council Regulation 2013/734/EC of 22 July 2013 OJ L204/15, 31 July 2013, amending Council Regulation 1999/659/EC of 22 March 1999 laying down detailed rules for the application of Article 93 of the EC Treaty, OJ L 83/1, 27 March 1999, Recital 14. (Rregullore e Këshillit 2013/734/EC, 22 Korrik 2013 OJ L204/15, 31 Korrik 2013, e cila ndryshon Rregulloren e Këshillit 1999/659/EC, 22 Mars 1999 për përcaktimin e rregullave të detajuara për zbatimin e nenit 93 të Traktatit të Komunitetit Evropian).

³¹⁷ Po aty.

vendimi të Komisionit atëherë ky i fundit ka të drejtën të vendosë penalitete në formën e pagesave periodike. Këto sanksione mund të përdoren vetëm përkundrejt palëve të interesuara. Rregullorja e re Procedurale nuk parashikon masa në rastet kur Shtetet Anëtare hezitojnë të japin informacion ose japin informacion të pasaktë. Për më tepër, të gjitha vendimet e marra nga Komisioni në kuadër të kompetencave të reja të garantuara nga Rregullorja e re Procedurale të tilla si: kërkesa për informacion nëpërmjet vendimeve formale, vendime për të vendosur gjoba ose sanksione në formën e pagesave periodike ose vendimi për publikimin e informacioni konfidencial janë objekt shqyrtimi nga Gjykatat. Kjo krijon një ndryshim në parimin themelor që rregullon të drejtën për ndihmën Shtetërore në BE sipas të cilit të gjitha vendimet i drejtohen Shteteve Anëtare dhe përkeqëson asimetrinë dhe mungesën e ekuilibrit të krijuar nga Rregullorja e re Procedurale (Nehl, 2014:247).

Rregullorja e re Procedurale³¹⁸ nuk synon të ndryshojë karakterin bilateral të procedurës për ndihmën Shtetërore. Kjo Rregullore shton kompetencat hetimore të Komisionit. Rrjedhimisht, Komisionit pas fillimit të procedurës së shqyrtimit formal, i lejohet të kërkojë informacion jo vetëm nga Shteti Anëtar që ka bërë njoftimin por dhe nga Shtete Anëtare të tjera, shoqata ndërmarrjesh. Komisioni ka të drejtën në bazë të Rregullores së re Procedurale të vendosë gjoba ose penalitete me pagesa periodike në rast mosdhënie informacioni ose informacion të pasaktë nga palët e treta. Në këtë mënyrë ajo krijon më shumë detyrime për palët e treta duke mos garantuar të drejtat e tyre procedurale.

³¹⁸ Council Regulation 2013/734/EC of 22 July 2013 OJ L204/15, 31 July 2013, amending Council Regulation 1999/659/EC of 22 March 1999 laying down detailed rules for the application of Article 93 of the EC Treaty, OJ L 83/1, 27 March 1999 (Rregullore e Këshillit 2013/734/EC, 22 Korrik 2013 OJ L204/15, 31 Korrik 2013, e cila ndryshon Rregulloren e Këshillit 1999/659/EC, 22 Mars 1999 për përcaktimin e rregullave të detajuara për zbatimin e nenit 93 të Traktatit të Komunitetit Evropian).

Veç kësaj, Rregullorja Procedurale³¹⁹ nuk parashikon zgjerimin e të drejtave procedurale të palëve të interesuara. Të drejtat e tyre gjatë fazës së shqyrtimit formal janë pothuajse inekzistente. Ky rol i kufizuar i palëve të interesuara vetëm gjatë fazës së shqyrtimit formal e privon Komisionin nga një burim informacioni mjaft i rëndësishëm. Procedurat duhet të jenë më transparente veçanërisht në lidhje me të drejtat e palëve të interesuara dhe shqyrtimin e ankimeve nga Komisioni. Mungesa e një statusi procedural të palëve të interesuara gjatë fazës së shqyrtimit paraprak bën që procedura administrative përpara Komisionit të mos jetë transparente.

Përmirësimi i të drejtave procedurale të palëve të interesuara duhet të kishte qenë në fokus të ndryshimeve të Rregullores Procedurale për arsyt në vijim:

- Karta e të Drejtave Themelore ka fuqi ligjore të detyrueshme, pas hyrjes në fuqi të Traktatit të Lisbonës,³²⁰ Rrjedhimisht, institucionet e Bashkimit Evropian duke përfshirë dhe Komisionin duhet të respektojnë të drejtat e parashikuara nga Karta. Neni 41 i Kartës parashikon të drejtën e mirëadministrimit. Kjo e drejtë përfshin: të drejtën e çdo personi t'u dëgjuar përpara se kundër tij të merren masa që do ta cënonin atë; të drejtën për të parë dosjen dhe detyrimin e administratës të arsyetojë vendimet e marra. Për më tepër BE po përgatitet për të ratifikuar Konventën për të Drejtat dhe Liritë Themelore. Të gjitha këto zhvillime duhet të kishin ndikuar në reformën e procedurave në lidhje me ndihmën Shtetërore.

³¹⁹ Po aty.

³²⁰ Fjala e parë e nenit 6, paragrafi 1 i Traktatit për Funkcionimin e Bashkimit Evropian parashikon: *“Bashkimi njeh të drejtat, liritë dhe parimet e parashikuara në Kartën e të Drejtave Themelore të Bashkimit Evropian, datë 7 dhjetor 2000, siç u përshtat në Strasburg , më 12 dhjetor 2007, e cila ka të njëjtën fuqi ligjore me Traktatet”*.

- Përmirësimi (shtimi) i të drejtave të palëve të interesuara dhe përfituesve të ndihmës Shtetërore rrit efikasitetin e kontrollit të ndihmës Shtetërore. Komisioni, veçanërisht në kuadër të analizës ekonomike të çështjeve të ndihmës Shtetërore ka nevojë për më shumë informacion. Në treg këtë informacionin e kanë shoqëritë në krahasim me administratën. Rrjedhimisht duke i dhënë mundësinë Komisionit të komunikojë drejtpërsëdrejti me përfituesit e ndihmës Shtetërore do të ndryshonte dhe natyra bilaterale e procedurave aktuale të ndihmës Shtetërore (Nehl, 2009:409).
- Duke patur parasysh rritjen e numrit të ankimeve nga palët e interesuara dhe numrit të njoftimeve nga Shtetet Anëtare, është e rëndësishme që procedurat e Komisionit të realizohen në kohë. Megjithatë, zgjidhja e ankimeve vazhdon të marrë shumë kohë dhe procedura nuk është transparente. Gjithashtu dhe procedurat për ndihmën e njoftuar marrin shumë kohë.³²¹
- Jurisprudenca e re në lidhje me shqyrtimin e ankimeve.³²² Në çështjen *Athinaiki Techniki*³²³ Gjykata e Drejtësisë ka bërë një deklaratë të re në lidhje me statusin e ankuesve gjatë procedurës së shqyrtimit paraprak. Sipas Gjykatës dhe pse ankuesit nuk mund të mbështeten në të drejtën për t'u mbrojtur, ato kanë të drejtë të jenë të lidhur me të në mënyrë të përshtatshme.³²⁴ Gjithashtu, Gjykata në çështjen e

³²¹European Court of Auditors, "Do the Commission's Procedures ensure effective management of state aid control?", Special Report, No 15, 2011. (Gjykata Evropiane e Auditorëve). Sipas këtij raporti në vitet 2007-2008, në 40% të çështjeve, Komisionit i duheshin 6 muaj për të miratuar një vendim për fazën e shqyrtimit paraprak; në rreth 25% të rasteve të nisura midis vitit 2005 dhe 2008, procedura formale ka zgjatur më shumë se 18 muaj.

³²²Çështje T-351/02, *Deutsche Bahn v Commission (Deutsche Bahn k Komisionit)* [2006] ECR II-1047, Çështje C-521 P *Athinaiki Techniki v Commission (Athinaiki Techniki k Komisionit)* [2008] ECR I-5829, Çështje T-152/06 *NDSHT Nya Destination Stockholm Hotell & Teaterpaket AB v. Commission, (NDSHT Nya Destination Stockholm Hotell & Teaterpaket AB k Komisionit)* [2009] ECR II-1517.

³²³ Çështje C-521 P *Athinaiki Techniki v Commission (Athinaiki Techniki k Komisionit)* [2008] ECR I-5829.

³²⁴Po aty.

sipërpërmendur deklaron që pasi janë paraqitur komentet nga ankuesi sipas nenit 20(2) të Rregullores Procedurale, ose pasi ka kaluar një afat i arsyeshëm për paraqitjen e tyre, Komisioni është i detyruar në bazë të nenit 13(1) të Rregullores Procedurale të mbyllë procedurën e shqyrtimit paraprak me një vendim.³²⁵ Rrjedhimisht, një ankim në lidhje me ndihmë Shtetërore të paligjshme, fillon procedurën shqyrtimit paraprak siç parashikohet nga neni 108(3) TFBE dhe procedura duhet përfunduar me një vendim. Gjykata, në këtë rast ka forcuar pozitën ligjore të ankuesit për të marrë nga Komisioni një vendim përfundimtar, i cili mund të jetë objekt shqyrtimi nga Gjykatat (Nehl, 2009:401).

- Fusha të tjera të së drejtës së konkurrencës kanë pranuar dhe njohur të drejtat procedurale të palëve të interesuara. Nenet 101 dhe 102 të Traktatit për Funksionimin e Bashkimit Evropian të cilët ndalojnë marrëveshjet midis ndërmarrjeve, praktikat e bashkërenduara dhe abuzimin me pozitën dominuese dhe neni 107 TFBE i cili ndalon ndihmën Shtetërore kanë si qëllim të luftojnë shtrembërimet e konkurrencës që ndikojnë në tregtinë ndërmjet Shteteve Anëtare. Vetëm origjina e shtrembërimit të konkurrencës është e ndryshme: në rastet e parashikuara nga nenet 101 dhe 102 TFEB janë ndërmarrjet ato që shkaktojnë shtrembërimin ndërsa në rastin e ndihmës Shtetërore janë Shtetet Anëtare ato që shkaktojnë shtrembërimin. Në rastin e marrëveshjeve të ndaluara, praktikave të bashkërenduara, abuzimit me pozitën dominuese parashikuar nga neni 101 dhe 102 TFBE, Rregullorja e Këshillit 1/2003/1/EC, parashikon të drejtën e ankuesve për të

³²⁵Çështje C-521 P *Athinaiki Techniki v Commission (Athinaiki Techniki k Komisionit)* [2008] ECR I-5829. para. 40.

marrë pjesë në procedurën shqyrtimit të ankimit³²⁶ për më tepër Rregullorja Zbatuese e Komisionit 773/2004//EC parashikon në mënyrë të detajuar të drejtat procedurale të palëve të interesuara.³²⁷ Kështu, në qoftë se qëllimi i së Drejtës Evropiane të Konkurrencës është të eliminojë çdo lloj shtrembërimi të konkurrencës, pavarësisht nga origjina e tyre do të ishte në interes të zbatimit të secilës dispozitë duke përfshirë dhe nenin 107(1) TFBE që të udhëhiqet nga një procedure administrative që ndjek këtë qëllim (Bartosch, 2007:483).

³²⁶ Neni 27; Council Regulation 2003/1/EC of 16 December 2002 on the implementation of the rules on competition laid down in Articles 81 and 82 of the Treaty OJ L 1/1. (Rregullore e Këshillit 2003/1/EC e 16 Dhjetorit 2002 mbi zbatimin e rregullave të konkurrencës të parashikuara nga nenet 81 dhe 82 të Traktatit për Komunitetin Evropian).

³²⁷ Commission Regulation 2004/773/EC of 7 April 2004 relating to the conduct of proceedings by the Commission pursuant to Articles 81 and 82 of the EC Treaty, OJ L123/18, 27 April 2004. (Rregullore e Komisionit 2004/773/EC e 7 Prillit 2004 në lidhje me kryerjen e procedurave nga Komisioni sipas neneve 81 dhe 82 të Traktatit të Komunitetit Evropian). Ankuesit kanë të drejtë: (i) të marrin një kopje të versionit jo-konfidencial të deklaratës së vërejtjeve dhe të paraqesin vërejtjet e tyre (neni 6 (1)); (ii) të marrin pjesë në seancën verbale (neni 6(2)); (iii) të dëgjohen nëse Komisioni nuk ka ndërmend të shqyrtojë ankimin (neni 7); (iv) të ketë akses të pjesshëm në dosje (neni 8); dhe (v) të marrin një vendim formal për refuzimin e ankimit, vendim i cili mund të kundërshtohet përpara Gjykatave të Bashkimit (neni 7(2)).

KAPITULLI VII

INTEGRIMI EVROPIAN DHE KONTROLLI I NDIHMËS SHTETËRORE:

RASTI I SHQIPËRISË

7.1. Hyrje

Komisioni Evropian ka propozuar krijimin e Procesit të Stabilizim-Asociimit (PSA) si një strukturë për marrëdhëniet mes vendeve të Ballkanit Perëndimor dhe Bashkimit Evropian (Hoffmann, 2005:60). Qëllimi i këtij procesi është të ndihmojë këto vende në plotësimin e kriterëve për anëtarësim në Bashkimin Evropian. Marrëveshjet e Stabilizim-Asociimit (MSA) janë një element shumë i rëndësishëm i procesit të sipërpërmendur nga pikëpamja ligjore. Qëllimi i këtyre marrëveshjeve është të mbështesë konsolidimin e demokracisë, shtetit të së drejtës, zhvillimin ekonomik dhe bashkëpunimin rajonal. Sipas MSA-ve vendet e Ballkanit Perëndimor kanë detyrimin të përafrojnë legjislacionin e tyre kombëtar me *acquis communautaire*. Në veçanti, sipas MSA-ve, këto vende duhet të miratojnë rregulla kombëtare në lidhje me ndihmën Shtetërore. Prezantimi i një sistemi të brendshëm të monitorimit të ndihmës Shtetërore është një kusht për anëtarësimin e vendeve të Evropës Ballkanit Perëndimor në Bashkimin Evropian.

Në kuadër të procesit të Stabilizim-Asociimit, MSA-ja ndërmjet Shqipërisë dhe BE-së u nënshkrua më 12 qershor 2006 dhe hyri në fuqi më 1 prill 2009. Qëllimet kryesore të MSA-së janë të mbështesë përpjekjet e Shqipërisë në forcimin e demokracisë dhe shtetit ligjor, si dhe të mbështesë tranzicionin drejt një ekonomie tregu funksionale të integruar në

tregun e brendshëm të BE-së.³²⁸ MSA-ja kërkon që Shqipëria të garantojë që rregullat për konkurrencën dhe ndihmën Shtetërore të jenë në përputhje me *acquis communautaire*. Gjatë periudhës së para-anëtarësimit Shqipëria duhet të ketë tregues të pranueshëm të zbatimit të këtyre rregullave. Komisioni Evropian vlerëson ligjet e miratuara nga Shqipëria në kuadër të konkurrencës dhe kontrollit të ndihmës Shtetërore dhe zbatimin e tyre nëpërmjet raportit të progresit i cili hartohet çdo vit. Sipas kushteve të MSA-së, Shqipëria nuk duhet të lejojë asnjë ndihmë Shtetërore e cila shtrembëron ose rrezikon të shtrembërojë konkurrencën duke favorizuar ndërmarrje të caktuara ose produkte të caktuara.

Ky kapitull analizon detyrimet e Shqipërisë që rrjedhin nga MSA në kuadër të kontrollit të ndihmës Shtetërore. Një fokus i veçantë do t'i kushtohet Komisionit të Ndhmës Shtetërore, organ i cili ka kompetencën të zbatojë dispozitat ligjore për ndihmën e Shtetërore në Shqipëri. Është e rëndësishme që ky autoritet kontrollues të jetë i pavarur si nga dhënësit e ndihmës Shtetërore ashtu dhe nga përfituesit e saj.

7.2. Detyrimet e Shqipërisë sipas Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit – ndihma Shtetërore

Titulli VI i MSA-së “Përafrimi i legjislacionit, imponimi i ligjeve dhe rregullat e konkurrencës” përmban dispozitat në lidhje me ndihmën Shtetërore. Sipas nenit 71, të MSA-së “*çdo ndihmë Shtetërore e cila shtrembëron ose rrezikon të shtrembërojë konkurrencën duke favorizuar ndërmarrje të caktuara ose prodhime të caktuara, nuk*

³²⁸ Neni 1, Ligj Nr. 9590, datë 27.07.2006 “Për ratifikimin e marrëveshjes së stabilizim asociimit, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Komuniteteve Evropiane e Shteteve të tyre Anëtarë”.

*përputhet me funksionimin e duhur të Marrëveshjes, duke qenë se mund të ndikojë në tregtinë ndërmjet Komunitetit dhe Shqipërisë”:*³²⁹ Për më tepër, Marrëveshja e Stabilizim Asociimit parashikon që të gjitha praktikat që përfshijnë ndihmë Shtetërore do të vlerësohen në bazë të kriterëve që lindin nga zbatimi i nenit 87 të Traktatit për krijimin e Komunitetit Evropian (tani neni 107 TFBE) dhe gjithashtu instrumenteve interpretuese që përdoren nga institucionet e Komunitetit (Bashkimit).³³⁰ Përveç kësaj, MSA-ja parashikon detyrime të mëtejshme për Shqipërinë si: krijimin e një organi të pavarur i cili do të ketë kompetenca për të zbatuar dispozitat për ndihmën Shtetërore, krijimin e transparencës në lidhje me ndihmën e Shtetërore,³³¹ krijimin e një inventari të skemave të ndihmës të dhëna para krijimit të Komisionit të Ndihmës Shtetërore.³³²

Gjatë fazës së para-anëtarësimit Shqipëria duhet të përmbushë tre kushte në lidhje me kontrollin e ndihmës Shtetërore: përafrimin e legjislacionit, një kapacitet administrativ të kënaqshëm dhe rezultate të besueshme të zbatimit të legjislacionit (Blauberger, 2009:1035). Në përmbushjen e detyrimeve që rrjedhin nga MSA-ja, Shqipëria ka miratuar legjislacion për ndihmën Shtetërore të përbërë kryesisht nga Ligji për Ndihmën Shtetërore³³³ dhe një Vendim të Këshillit të Ministrave të vitit 2005 për miratimin e Rregullores në lidhje me procedurat dhe format e njoftimit.³³⁴

³²⁹ Shiko nenin 71 (iii) Ligj Nr. 9590, datë 27.07.2006 “Për ratifikimin e marrëveshjes së stabilizim asociimit, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Komuniteteve Evropiane e Shteteve të tyre Anëtarë”.

³³⁰ Neni 71/2 Ligj Nr. 9590, datë 27.07.2006 “Për ratifikimin e marrëveshjes së stabilizim asociimit, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Komuniteteve Evropiane e Shteteve të tyre Anëtarë”.

³³¹ Neni 71/4 Ligj Nr. 9590, datë 27.07.2006 “Për ratifikimin e marrëveshjes së stabilizim asociimit, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Komuniteteve Evropiane e Shteteve të tyre Anëtarë”.

³³² Neni 71/6 Ligj Nr. 9590, datë 27.07.2006 “Për ratifikimin e marrëveshjes së stabilizim asociimit, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Komuniteteve Evropiane e Shteteve të tyre Anëtarë”.

³³³ Ligj nr. 9374, datë 21.4.2005 “Për ndihmat Shtetërore”, Gazeta Zyrtare nr. 36, fq. 36.

³³⁴ Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 817, datë 28.12.2005 “Për miratimin rregullores “Për procedurat dhe formën e njoftimit” Gazeta Zyrtare Nr. 102 fq. 103.

Për më tepër, në janar të vitit 2008 u publikua një raport mbi inventarin e skemave ekzistuese të ndihmës Shtetërore në Shqipëri. Inventari përfshin të dhënat për ndihmën Shtetërore të dhënë që nga viti 2000.³³⁵ E rëndësishme, është gjithashtu transparenca e ndihmës Shtetërore e cila sigurohet ndër të tjera me paraqitjen e raporteve vjetore nga Komisioni i Ndhmës Shtetërore bazuar në metodologjinë e Bashkimit Evropian.³³⁶ Ligji për ndihmën Shtetërore parashikon krijimin e një Komisioni për Ndhmën Shtetërore i cili është organi vendimmarrës dhe një Departament të Ndhmës Shtetërore në Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes i cili është organi administrativ.

Një tjetër detyrim parashikuar nga MSA për Shqipërinë është të vlerësojë ndihmën rajonale duke marrë parasysh që i gjithë territori do të konsiderohet sipas kriterëve të nenit 87 (3) (a) Traktati për krijimin e Komunitetit Evropian (tani neni 107 (3) (a) TFBE) gjatë dhjetë viteve të para, pas hyrjes në fuqi të MSA-së. Harta rajonale në lidhje me ndihmën Shtetërore është miratuar në vitin 2012 me një vendim të Komisionit të Ndhmës Shtetërore Shqiptare dhe është në përputhje me *acquis*.³³⁷

Pjesë e MSA-së është dhe një Protokoll mbi Prodhimet e Hekurit dhe Çelikut.³³⁸ Sipas këtij protokolli Palët njohin nevojën të trajtojnë menjëherë çdo dobësi strukturore të

³³⁵Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 45 datë 16.01.2008 “Për miratimin e raportit të inventarit të skemave ekzistuese të ndihmës Shtetërore në Shqipëri”, Gazeta Zyrtare nr. 9, fq. 9.

³³⁶ Neni 71/5 ligj Nr. 9590, date 27.07.2006 “Për ratifikimin e marrëveshjes së stabilizim asociimit, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Komuniteteve Evropiane e Shteteve te tyre Anëtarë”.

³³⁷Commission Staff Working Document – Albania 2012 Progress Report, accompanying the document from the Commission to the European Parliament and the Council enlargement strategy and main challenges 2012-2013 (Dokument pune i stafit të Komisionit Progres Raporti 2012 për Shqipërinë që shoqëron Komunikatën e Komisionit për Parlamentin Evropian dhe Këshillin, Strategjia e zgjerimit dhe sfidat kryesore për periudhën 2012-2013.)COM (2012) 600 at pg. 37.

http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/key_documents/2012/package/al_rapport_2012_en.pdf. Aksesuar Nentor 2015.

³³⁸ Protokoll 1 “Për prodhimet e hekurit dhe çelikut”, ligj Nr. 9590, date 27.07.2006 “Për ratifikimin e marrëveshjes së stabilizim asociimit, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Komuniteteve Evropiane e Shteteve te tyre Anëtarë”.

sektorit të hekurit dhe çelikut për të siguruar konkurrencën globale të industrisë së Shqipërisë. Rrjedhimisht, Shqipëria do të krijojë, brenda një periudhe tre vjeçare programin për ndryshimet e nevojshme për industrinë e saj të hekurit dhe çelikut, në mënyrë që ky sektor të jetë i suksesshëm në kushtet normale të tregut.³³⁹ Bashkimi Evropian pranon që Shqipëria mund të ofrojë në raste tepër të veçanta një ndihmë financiare shtetërore për qëllime ristrukturimi, me kusht që:

- të çojë në realizimin e veprimtarisë së firmave përfituese në kushtet normale të tregut, në fund të periudhës së ristrukturimit; dhe
- sasia dhe intensiteti i kësaj ndihme të jenë tepër të kufizuara për atë çka është jashtëzakonisht e nevojshme, në mënyrë që të rivendosë këtë realizueshmëri, dhe të jenë të reduktuara në mënyrë progresive; dhe
- programi i ristrukturimit të jetë i lidhur me një racionalizim global dhe masa kompensuese për të luftuar pasojat devijuese të ndihmës financiare të dhënë në Shqipëri.

Protokolli kërkon transparencë të plotë në lidhje me zbatimin e ristrukturimit të nevojshëm dhe programit të ndryshimit nëpërmjet një shkëmbimi të plotë dhe të vazhdueshëm të informacionit për palën tjetër. Këshilli i Stabilizim Asociimit është autoriteti monitorues. Shqipëria ka konfirmuar qëllimin e saj për të mos dhënë ndihmë Shtetërore për ristrukturimin e industrisë së hekurit dhe çelikut..³⁴⁰

³³⁹Protokolli 1 neni 5 “Për prodhimet e hekurit dhe çelikut”, ligj Nr. 9590, date 27.07.2006 “Për ratifikimin e marrëveshjes së stabilizim asociimit, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Komuniteteve Evropiane e Shteteve të tyre Anëtarë”.

³⁴⁰Commission Staff Working Document – Albania 2009 Progress Report, accompanying the document from the Commission to the European Parliament and the Council enlargement strategy and main challenges 2009-2010 (Dokument pune i stafit të Komisionit Progres Raporti 2009 për Shqipërinë që shoqëron Komunikatën e Komisionit për Parlamentin Evropian dhe Këshillin, Strategjia e zgjerimit dhe sfidat kryesore për periudhën

Marrëveshja e Stabilizim Asociimit krijon Këshillin e Stabilizim Asociimit i cili përbëhet nga anëtarë të Këshillit të Bashkimit Evropian dhe anëtarë të Komisionit Evropian, nga njëra anë, dhe anëtarë të Qeverisë së Shqipërisë, nga ana tjetër.³⁴¹ Këshilli i Stabilizim Asociimit, me qëllim arritjen e objektivave të MSA-së, ka kompetencën të marrë vendime brenda objektit të Marrëveshjes, të cilat janë të detyrueshme për palët. Palët, duhet të marrin masat e nevojshme për t'i zbatuar vendimet e marra. Këshilli i Stabilizim Asociimit mund të japë dhe rekomandime.³⁴² Këshilli i Stabilizim Asociimit asistohet gjatë zbatimit të detyrave të tij nga Komiteti i Stabilizim Asociimit, i përbërë nga përfaqësues të Këshillit të Bashkimit Evropian dhe përfaqësues të Komisionit Evropian, nga njëra anë, dhe përfaqësues të Shqipërisë, nga ana tjetër. Këshilli i Stabilizim Asociimit mund t'i delegojë Komitetit të Stabilizim Asociimit cilëndo kompetencë të tij.³⁴³ MSA parashikon marrjen e masave të nevojshme pas konsultimeve me Këshillin e Stabilizim-Asociimit në lidhje me praktikën për ndihmën Shtetërore të cilat nuk janë në përputhje me kushtet e përcaktuara në Marrëveshje.³⁴⁴

2009-2010) COM (2009) 533, fq. 30 i dispoouneshëm në: http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/key_documents/2009/al_rapport_2009_en.pdf. Aksesuar Nëntor 2015.

³⁴¹Neni 117, ligj Nr. 9590, date 27.07.2066 “Për ratifikimin e marrëveshjes së stabilizim asociimit, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Komuniteteve Evropiane e Shteteve te tyre Anëtarë”.

³⁴²Neni 118 ligj Nr. 9590, date 27.07.2066 “Për ratifikimin e marrëveshjes së stabilizim asociimit, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Komuniteteve Evropiane e Shteteve te tyre Anëtarë”.

³⁴³Neni 120-121 ligj Nr. 9590, date 27.07.2066 “Për ratifikimin e marrëveshjes së stabilizim asociimit, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Komuniteteve Evropiane e Shteteve te tyre Anëtarë”.

³⁴⁴Neni 71/9 ligj Nr. 9590, date 27.07.2066 “Për ratifikimin e marrëveshjes së stabilizim asociimit, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Komuniteteve Evropiane e Shteteve te tyre Anëtarë”.

7.3. Ligji për ndihmën Shtetërore

Ligji shqiptar për Ndhimën Shtetërore (në vazhdim “LNSH”) ka hyrë në fuqi më 1 janar të vitit 2006, para nënshkrimit të MSA-së.³⁴⁵ Tre rregulloret për njoftimin dhe procedurat, ndihmën rajonale, ndihmën për shpëtim dhe ristrukturim janë miratuar gjatë vitit 2005.³⁴⁶ LNSH transponon saktë rregullat e MSA-së në legjislacionin kombëtar dhe kjo përfshin ndalimin e përgjithshëm të ndihmës Shtetërore dhe elementët kryesorë nga përjashtimet në bllok, ndihmën për ndërmarrjet e mëdha dhe të vogla, ndihmën për punësim, trajnim, kërkim dhe zhvillim dhe ndihmën *de minimis* (Schutterle, 2005:263). LNSH gjithashtu prezanton kriteret kryesore për ndihmën rajonale, si dhe ndihmën për ristrukturimi dhe shpëtim.

Ligji për Ndhimën Shtetërore u ndryshua në vitin 2009 për të pasqyruar zhvillimet e reja në BE në lidhje me ndihmën Shtetërore.³⁴⁷ Ndryshimet e vitit 2009, prezantuan rregulla për ndihmën Shtetërore për riskun e kapitalit dhe për mbrojtjen e mjedisit. Gjithashtu, ligji për ndihmën Shtetërore u ndryshua në vitin 2016,³⁴⁸ duke synuar përmirësimin e kuadrit ligjor në fushën e ndihmës Shtetërore në përputhje me detyrimin për të përafëruar me tej legjislacionin shqiptar me *acquis communautaire*. Ndryshimet dhe shtesat reflektojnë në legjislacionin e brendshëm disa ndryshime që ka pësuar legjislacioni i

³⁴⁵ Ligj Nr. 9374, datë 21.4.2005 “Për ndihmën Shtetërore”, i ndryshuar, Gazete Zyrtare nr. 36, fq. 36.

³⁴⁶ Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 817, datë 28.12.2005 “Për miratimin e rregullores për procedurat dhe formën e njoftimit” Gazetë Zyrtare nr. 102, fq.103; Vendim i Këshillit të Ministrave nr 815, datë 28.12.2005 për miratimin e rregullores “Për kushtet dhe procedurat për ndihmën rajonale”, Gazetë Zyrtare nr. 102, fq. 102. Vendim i Këshillit të Ministrave nr 816, datë 28.12.2005 për miratimin e rregullores “Për kushtet dhe procedurat për ndihmën për shpëtim dhe ristrukturim” Gazetë Zyrtare nr. 102, fq.102.

³⁴⁷ Ligj Nr.10 183, datë 29.10.2009 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.9374, datë 21.4.2005 “Për ndihmën Shtetërore”

³⁴⁸ Ligj nr.21/2016 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9374, datë 21.4.2005, “Për ndihmën shtetërore”, të ndryshuar, Fletore.zyrtare nr.47, faqe:3140

Bashkimit Evropian në fushën e ndihmës shtetërore, si dhe rekomandimet e progres raporteve të Komisionit Evropian për kontrollin e ndihmës shtetërore në Shqipëri.³⁴⁹ Ndryshimet e vitit 2016 prezantojnë ndër të tjera rregulla për ndihmën *de minimis*, rregulla për kompensimin që jepet për ofrimin e shërbimeve me interes të përgjithshëm ekonomik si dhe rregulla me qëllim përafrimin e mëtejshëm të procedurave të Komisionit të Ndhmës Shtetërore me ato të Komisionit Evropian.

Qëllimi i ligjit është të rregullojë parimet dhe procedurat në lidhje me kontrollin e ndihmës Shtetërore si dhe të mbështesë zhvillimin ekonomik dhe shoqëror të vendit. LNSH gjithashtu ka për qëllim të përmbushë detyrimet e Shqipërisë të ndërmarra në kuadër të marrëveshjeve ndërkombëtare të cilat përmbajnë dispozita për ndihmën Shtetërore. Ligji për Ndhmën Shtetërore nuk zbatohet për sektorin e peshkimit dhe bujqësisë. Kjo është në përputhje me MSA-në e cila përjashton produktet bujqësore dhe të peshkimit nga zbatimi i ndihmës Shtetërore.

7.4. Përkufizimi i ndihmës Shtetërore

Ligji shqiptar për ndihmën Shtetërore nuk përmban një përkufizim të nocionit të ndihmës Shtetërore. Kjo është në përputhje me të Drejtën Evropiane për Ndhmën Shtetërore. Neni 107 Traktati për Funkcionimin e Bashkimit Evropian nuk përkufizon ndihmën Shtetërore, por përcakton një test për kualifikimin e ndihmës Shtetërore (Craig & de Burca, 2008:1086). Në nenin 4 të ligjit për Ndhmën Shtetërore parashikohet ndalimi i

³⁴⁹ Relacion për projektligjin “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.9374, datë 21.4.2005, “Për ndihmën Shtetërore”, të ndryshuar”

ndihmës Shtetërore: “*ndalohet çdo ndihmë e dhënë nga burimet shtetërore, në çfarëdo lloj forme, e cila, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, shtrembëron ose kërcënon të shtrembërojë konkurrencën, duke dhënë përparësi për një ose disa ndërmarrje të caktuara ose për prodhimin e produkteve të caktuara*”. Për më tepër, neni 4/2 i LNSH-së përcakton format kryesore të ndihmës që përfshijnë kryesisht: grantet dhe subvencionet; përjashtimin, uljen dhe diferencimin e taksave; faljen e pagesave të prapambetura dhe gjobave; faljen e borxheve ose mbulimin e humbjeve; garancitë mbi kreditë ose dhënien e kredive me norma interesi të ulëta; uljen e detyrimeve të sigurimeve shoqërore; uljen e çmimit të produkteve të ofruara, shitjen e pronës shtetërore nën çmimin e tregut ose blerjen e produkteve me çmim më të lartë se ai i tregut; zmadhimin e kapitalit shtetëror të ndërmarrjet ose ndryshimin e vlerës së tij në rrethana, të cilat nuk janë të pranueshme për një investitor privat, që vepron në kushte ekonomike normale. Përfitues i ndihmës Shtetërore konsiderohet çdo ndërmarrje dhe person fizik i cili merr ndihmë Shtetërore.³⁵⁰

Sipas ligjit për Ndihmën Shtetërore lejohet ndihma me karakter social që i jepet konsumatorëve individualë me kusht që kjo ndihmë të jepet pa diskriminim lidhur me origjinën e produkteve në fjalë. Gjithashtu, lejohet ndihma që jepet për të shmangur efektet e shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore ose nga gjendja e jashtëzakonshme. Formulimi i përdorur në nenin 7 të ligjit për Ndihmën Shtetërore pasqyron atë të përdorur në nenin 107/2 TFBE në lidhje me ndihmën e lejueshme. Neni 107 paragrafi 2 Traktati për Funkcionimin e Bashkimit Evropian parashikon që: *janë të pajtueshme me tregun e brendshëm: ndihma me karakter social, që u jepet konsumatorëve individualë, me kusht që*

³⁵⁰ Neni 3/5, ligj Nr .9374, datë 21.4.2005”Për ndihmën Shtetërore”, i ndryshuar.

*kjo ndihmë të jepet pa diskriminim lidhur me origjinën e produkteve që prek; ndihma për shlyerjen e dëmit të shkaktuar nga fatkeqësitë natyrore ose ngjarjet e jashtëzakonshme.*³⁵¹

Neni 13 i ligjit për Ndhmën Shtetërore parashikon ndihmën Shtetërore që mund të lejohet. Rrjedhimisht mund të lejohet ndihma Shtetërore që: nxit zhvillimin ekonomik të rajoneve të Republikës së Shqipërisë, të karakterizuara nga standarde jetese shumë të ulëta, ose të zonave ku ka papunësi serioze; nxit realizimin e një projekti të rëndësishëm për Republikën e Shqipërisë ose jepet për të mënjanuar gjendje të rënda në ekonominë e vendit; lehtëson zhvillimin e veprimtarive të caktuara ekonomike ose zhvillimin e zonave të caktuara ekonomike, deri në atë masë sa kjo ndihmë nuk është në kundërshtim me detyrimet e marrëveshjeve ndërkombëtare, të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë; nxit zhvillimin kulturor dhe ruajtjen e trashëgimisë, deri në atë masë sa nuk ndikon ndjeshëm në kushtet e tregtisë dhe në konkurrencë; është në përputhje me dispozitat e këtij ligji ose me aktet e tjera normative të nxjerra në zbatim të tij. Kjo është në përputhje me nenin 107 paragrafi 3 TFBE i cili i jep Komisionit Evropian të drejtën të miratojë në kushte të caktuara ndihmë Shtetërore që shtrembëron konkurrencën dhe ndikon në tregtinë ndërmjet Shteteve Anëtare. Komisioni Evropian ka theksuar se përjashtimet e përmendura më sipër nuk duhet të interpretohet në mënyrë të zgjeruar (Baudenbacher, 1997:1086).

Në Bashkimin Evropian janë ndërmarrë reforma të ndryshme në kuadër të kontrollit të ndihmës Shtetërore siç janë: Plani i Veprimit për Ndhmën Shtetërore i vitit 2005 dhe Modernizimi i Ndhmës Shtetërore i vitit 2012. Plani i Veprimit për Ndhmën Shtetërore

³⁵¹ Neni 107/2 pika c TFBE parashikon: ndihma që i jepet ekonomisë në disa zona të caktuara të Republikës Federale të Gjermanisë të prekura nga ndarja e Gjermanisë, për aq kohë sa kjo ndihmë është e nevojshme për të kompensuar pozitën e pafavorshme ekonomike që ka shkaktuar kjo ndarje. Pesë vjet pas hyrjes në fuqi të Traktatit të Lisbonës, Këshilli, me propozim të Komisionit, mund të miratojë një vendim që e shfuqizon këtë gërmë. Kjo gërmë nuk mund të zbatohet në Shqipëri.

përfshinte strategjinë e Lisbonës për zhvillim dhe punësim. Objektivat kryesore të Planit të Veprimit për Ndihmën Shtetërore ishin: më pak ndihmë Shtetërore dhe më mirë e shënjestruar; qasje (analizë) ekonomike; procedura më efektive, parashikueshmëri më e lartë dhe rritje e transparencës; kompetenca të ndara ndërmjet Komisionit dhe Shteteve Anëtare. Ndërsa, reforma tjetër ambicioze e nisur nëpërmjet Komunikimit për Modernizimin e Ndihmës Shtetërore, në vitin 2012 kishte tre objektiva kryesore: (i) nxitjen e një rritje të qëndrueshme, të zgjuar dhe përfshirëse në një treg të brendshëm konkurrues; (ii) përqendrimin e shqyrtimit *ex-ante* nga Komisioni në rastet me ndikim më të madh në tregun e brendshëm duke rritur në të njëjtën kohe bashkëpunimin me Shtetet Anëtare në zbatimin e ndihmës Shtetërore dhe (iii) përmirësimin e rregullave dhe dhënien e vendimeve më të shpejta.³⁵² Gjatë këtyre reformave është miratuar nga institucionet përkatëse të BE-së legjislacion dytësor për kontrollin e ndihmës Shtetërore. Rrjedhimisht, edhe legjislacioni shqiptar për kontrollin e ndihmës Shtetërore duhet të përshtatet me këto ndryshime. Komisioni Evropian në raport progresin e vitit 2012 përcakton se "përpyqje të mëtejshme janë të nevojshme për të përafuar kuadrin e përgjithshëm ligjor për kontrollin e ndihmës Shtetërore me *acquis*".³⁵³

³⁵² Communication from the Commission to the European Parliament, the Council, the European Economic and Social Committee and the Committee of the Regions (Communication on State Aid Modernisation). (Komunikim për Modernizimin e Ndihmës Shtetërore). (Komunikim nga Komisioni për Parlamentin Evropian, Këshillin, Komitetin Ekonomik dhe Shoqëror dhe Komitetin e Rajoneve), COM (2012) 209, 8.5.201, para. 8.

³⁵³ Commission Staff Working Document – Albania 2012 Progress Report, accompanying the document from the Commission to the European Parliament and the Council enlargement strategy and main challenges 2012-2013 (Dokument pune i stafit të Komisionit Progres Raporti 2012 për Shqipërinë që shoqëron Komunikatën e Komisionit për Parlamentin Evropian dhe Këshillin, Strategjia e zgjerimit dhe sfidat kryesore për periudhën 2012-2013.) COM (2012) 600 fq. 37 i disponueshëm në: http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/key_documents/2012/package/al_rapport_2012_en.pdf. Aksesuar Nentor 2015.

7.5. Komisioni i ndihmës Shtetërore

Ligji shqiptar mbi Ndhimën Shtetërore krijon një organ të pavarur vendimmarrës i cili është Komisionit të Ndhimës Shtetërore (në vazhdim “KNSH”). Siç u përmend më lart, ky është një nga detyrimet sipas MSA-së e cila kërkon që Shqipëria të krijojë “një organ funksionalisht të pavarur” me të gjitha kompetencat për kontrollin e ndihmës Shtetërore. Komisioni i Ndhimës Shtetërore përbëhet nga pesë anëtarë. Ministri përgjegjës për ekonominë është kryetari i komisionit. Anëtarët e KNSH-së emërohen nga Këshilli i Ministrave, me propozimin e Ministrit të Financave, të ministrit përgjegjës për integrimin evropian, të Ministrit të Drejtësisë dhe një përfaqësues nga shoqëria civile. Anëtarët e KNSH-së duhet të jenë profesionistë të cilët kanë përvojë në fushën e ekonomisë. Mandati i tyre është katër vjet. Gjithsesi, ligji nuk përcakton nëse anëtarët e komisionit mund të rizgjidhen duke ndjekur të njejtën mënyrë si në rastin e emërimit të parë. Për më tepër, ligji nuk përcakton rastet e mbarimit të mandatit të anëtarit të KNSH-së. Ligji parashikon që shpërblimi i anëtarëve të KNSH-së përcaktohet nga Këshilli i Ministrave. Kjo kompetencë e Qeverisë për të përcaktuar shpërblimin e anëtarëve të KNSH-së është një faktor që ndikon në pavarësinë e këtij organi. Komisioni i parë i Ndhimës Shtetërore në Shqipëri është themeluar në mars të vitit 2006.³⁵⁴

KNSH-ja është një organ vendimmarrës në lidhje me kontrollin e ndihmës Shtetërore. Ai vlerëson dhe autorizon skemat e ndihmës Shtetërore dhe ndihmat individuale dhe mund të urdhërojë kthimin e ndihmës së paligjshme. KNSH monitoron përdorimin e ndihmës Shtetërore dhe përfitimet e saj ekonomike. Ligji për Ndhimën Shtetërore detyron

³⁵⁴ Neni 16, ligj Nr .9374, datë 21.4.2005”Për ndihmën Shtetërore”, i ndryshuar.

KNSH-në shprehimisht të botojë vendimet e saj në Gazetën Zyrtare të Republikës së Shqipërisë. Kjo kontribuon në transparencën e regjimit të kontrollit të ndihmës Shtetërore dhe është gjithashtu e rëndësishme për të rritur ndërgjegjësimin ndaj kësaj mase të re ligjore në komunitetin e biznesit dhe ndërmjet palëve të interesuara.³⁵⁵

Ligji parashikon gjithashtu dhe krijimin e Drejtorisë së Ndihmës Shtetërore pranë ministrisë që mbulon çështjet e ekonomisë (në vazhdim "Drejtoria"). Drejtoria është një strukturë administrative për kontrollin e ndihmës Shtetërore. Deri në fillim të vitit 2010, detyrat hetuese dhe operacionale u kryen nga Drejtoria e Ndihmës Shtetërore. Më pas këto detyra iu kaluan Sektorit të Ndihmës Shtetërore (në vazhdim "SNSH") në Drejtorinë e Mekanizmave të Tregut dhe Ndihmës Shtetërore në Ministrinë e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës (METE). SNSH ka të njëjtin numër personeli (katër) me ish-Drejtorinë e Ndihmës Shtetërore dhe ka ruajtur të njëjtat përgjegjësi dhe detyra.³⁵⁶

Aktualisht një Sektor për Ndihmën Shtetërore kryen funksione hetuese dhe operacionale në drejtorinë e tregut të brendshëm në Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes.³⁵⁷ Disa nga kompetencat e këtij sektori janë: të grumbullojë, përpunojë dhe mbikëqyrë të dhënat për ndihmën shtetërore; të marrë njoftimet dhe përgatisë vendimet e Komisionit; të marrë raportet nga dhënësi i ndihmës për mënyrën e zbatimit dhe rezultatin ekonomik të arritur nga përdorimi i kësaj ndihme; të mbajë regjistrin

³⁵⁵ Neni 17, ligj Nr. 9374, datë 21.4.2005 "Për ndihmën Shtetërore", i ndryshuar.

³⁵⁶ Commission Staff Working Document – Albania 2009 Progress Report, accompanying the document from the Commission to the European Parliament and the Council enlargement strategy and main challenges 2009-2010 (Dokument pune i stafit të Komisionit Progres Raporti 2009 për Shqipërinë që shoqëron Komunikatën e Komisionit për Parlamentin Evropian dhe Këshillin, Strategjia e zgjerimit dhe sfidat kryesore për periudhën 2009-2010) COM (2009) 533, fq. 73 i disponueshëm në:

http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/key_documents/2009/al_rapport_2009_en.pdf. Aksesuar Nëntor 2015.

³⁵⁷ <http://www.ekonomia.gov.al/al/ministria/drejtore/drejtorie-e-pergjithshme-e-konkurrueshmerise-dhe-partneritetit/drejtorie-e-tregut-te-brendshem>

e ndihmës Shtetërore; të marrë vendime, në bazë të dispozitave të këtij ligji; të hartojë udhëzime dhe t'i paraqesë për miratim pranë Komisionit; të përgatisë raportin vjetor për ndihmat Shtetërore.³⁵⁸

Komisioni i ndihmës Shtetërore është një organ kolegjal dhe i pavarur në përmbushjen e funksioneve të tij. Neni 16 i ligjit për ndihmën Shtetërore parashikon: *“komisioni i Ndhmës Shtetërore është organi vendimmarrës për kontrollin e ndihmës shtetërore. Komisioni është i pavarur në kryerjen e funksioneve të veta”*. Gjithsesi, ky parashikim nuk mjafton për të garantuar pavarësinë e KNSH-së.

Pavarësia e Komisionit të Ndhmës Shtetërore shqiptare është kritikuar shpesh nga raportet e progresit të Komisionit Evropian.³⁵⁹ Është e vështirë për KNSH-në të ketë pavarësi pasi anëtarët e këtij komisioni propozohen nga ministritë, të cilat janë njëkohësisht dhënës të ndihmës Shtetërore. Sipas ligjit për ndihmën Shtetërore, KNSH kryesohet nga ministri përgjegjës për ekonominë dhe një anëtar është përfaqësues i Ministrisë së Financave, këto ministri janë dhënësit më të mëdhenj të ndihmës Shtetërore. Ligji për Ndhmën Shtetërore parashikon gjithashtu që një anëtar i KNSH-së të propozohet nga Ministria e Drejtësisë, e cila zakonisht nuk i jep ndihmë Shtetërore dhe një anëtar nga

³⁵⁸ Neni 18, ligj Nr .9374, datë 21.4.2005”Për ndihmën Shtetërore”, i ndryshuar.

³⁵⁹ Commission Staff Working Document – Albania 2009 Progress Report, accompanying the document from the Commission to the European Parliament and the Council enlargement strategy and main challenges 2009-2010 Dokument Pune i Stafit të Komisioni – Progres Raporti për Shqipërinë viti 2009, i cili shoqëron dokumentin nga Komisioni për Parlamentin dhe Këshillin, strategjia e zgjerimit dhe sfidat kryesore 2009-2010 COM (2009) 533, fq. 30. I disponueshëm në: http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/key_documents/2009/al_rapport_2009_en.pdf. Aksesuar Nëntor 2015. Commission Staff Working Document – Albania 2012 Progress Report, accompanying the document from the Commission to the European Parliament and the Council enlargement strategy and main challenges 2012-2013 (Dokument pune i stafit të Komisionit Progres Raporti 2012 për Shqipërinë që shoqëron Komunikatën e Komisionit për Parlamentin Evropian dhe Këshillin, Strategjia e zgjerimit dhe sfidat kryesore për periudhën 2012-2013.)

COM (2012) 600 at pg. 37.

http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/key_documents/2012/package/al_rapport_2012_en.pdf. Aksesuar Nëntor 2015.

ministria që mbulon çështjet e integritetit,³⁶⁰ një anëtar të propozohet nga shoqëria civile. Ndryshimet e ligjit për ndihmën Shtetërore të miratuara në vitin 2016 kanë zvogëluar numrin e anëtarëve të KNSH-së që përfaqësojnë dhënësit e ndihmës Shtetërore. Sipas ndryshimeve anëtari i KNSH-së që propozohet nga ministri që mbulonte çështjet e ekonomisë, tashmë propozohet nga ministri përgjegjës për integrimin evropian. Gjithsesi, mbetet e diskutueshme shkalla e garantimit të pavarësisë që garanton një zgjidhje e tillë (Bieguriski, 2012:568). Gjithashtu miratimi i raporteve vjetore të KNSH-së nga ana e Këshillit të Ministrave, mund të ndikojë në pavarësinë e Komisionit të Ndhmës Shtetërore.

Për më tepër, Sektori i Ndhmës Shtetërore, si një zyrë mbështetëse me detyrat e saj kryesore të përzgjedhë dhe përpunojë informacione si dhe të hartojë vendime, në praktikë mund të paragjykojë vendimet e KNSH-së. Kjo zyrë, siç u përmend më sipër, është e vendosur në drejtorinë e tregut të brendshëm të Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes dhe është nën varësinë e saj. Kjo ministri është një nga dhënësit kryesore të ndihmës Shtetërore. Ky fakt mund të ngrejë pyetje në lidhje me objektivitetin e propozimeve të përgatitura nga Sektori i Ndhmës Shtetërore dhe në lidhje me objektivitetin e vendimeve të vetë Komisionit të Ndhmës Shtetërore.

7.6. Rregullat procedurale në lidhje me kontrollin e ndihmës Shtetërore

Kuadri ligjor shqiptar për procedurat në fushën e ndihmës Shtetërore përbëhet kryesisht nga ligji shqiptar për ndihmën Shtetërore dhe nga rregullorja për procedurat dhe

³⁶⁰ Ky është një ndryshim i prezantuar nga Ligj nr.21/2016 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9374, datë 21.4.2005, “Për ndihmën shtetërore”, të ndryshuar, Fletore.zyrtare nr.47, faqe:3140. Shiko nenin 12.

formën e njoftimit.³⁶¹ Sipas ligjit për ndihmën Shtetërore *"Dhënës të ndihmës shtetërore"* janë organet e pushteteve shtetërore dhe të qeverisjes vendore, si dhe çdo ent tjetër, që vepron në emër të shtetit, të cilat mund ose janë të autorizuar të japin ndihmë shtetërore.³⁶² Rrjedhimisht, ligji përkufizon si dhënës të ndihmës Shtetërore organet e pushtetit qendror dhe atij lokal, si dhe çdo ent tjetër që vepron në emër të shtetit i cili është ose mund të jetë i autorizuar të japë ndihmë Shtetërore. Për më tepër, bazuar në rregulloren për procedurat dhe formën e njoftimit çdo dhënës i ndihmës Shtetërore ka detyrimin ligjor të njoftojë Drejtorinë e Ndihmës Shtetërore (tani Sektori i Ndihmës Shtetërore) në lidhje me çdo plan për dhënien e një ndihme të re, pavarësisht nga forma e saj dhe nga përfituesit.³⁶³ Ndihma e njoftuar, sipas procedurës së sipërpërmendur, nuk mund të vihet në zbatim para se Komisioni i Ndihmës Shtetërore të ketë marrë një vendim për lejimin e saj me ose pa kushte.³⁶⁴ Kjo procedurë është në përputhje me procedurën e parashikuar nga e Drejta Evropiane për Ndihmën Shtetërore sipas të cilës Shtetet Anëtare nuk mund të zbatojnë ndihmën Shtetërore gjatë periudhës në të cilën Komisioni Evropian është duke shqyrtuar ndihmën Shtetërore (Craig dhe de Burca, 2008:1100).

Kontrolli në lidhje me ndihmën Shtetërore fillon pas marrjes së një njoftimi të plotë nga dhënësi i ndihmës në lidhje me çdo plan për dhënien e ndihmës.³⁶⁵ Ligji parashikon që njoftimi duhet të paraqitet pranë Sektorit të Ndihmës Shtetërore, i cili është

³⁶¹ Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 817, datë 28.12.2005 "Për miratimin e rregullores për procedurat dhe formën e njoftimit" Gazetë Zyrtare nr. 102, fq.103.

³⁶² Neni 3/1 ligj Nr .9374, datë 21.4.2005"Për ndihmën Shtetërore", i ndryshuar.

³⁶³ Neni 3 i Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 817, datë 28.12.2005 "Për miratimin rregullores "Për procedurat dhe formën e njoftimit" Gazeta Zyrtare Nr. 102 fq. 103.

³⁶³Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 45 datë 16.01.2008 "Për miratimin e raportit të inventarit të skemave ekzistuese të ndihmës Shtetërore në Shqipëri", Gazeta Zyrtare nr. 9, fq. 9.

³⁶⁴ Neni 3/1 i Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 817, datë 28.12.2005 "Për miratimin rregullores "Për procedurat dhe formën e njoftimit" Gazeta Zyrtare Nr. 102 fq. 103.

³⁶⁵ Neni 69 ligj Nr .9374, datë 21.4.2005"Për ndihmën Shtetërore", i ndryshuar.

organi që merr të gjitha njoftimet.³⁶⁶ Njoftimi i plotë në bazë të ligjit është ai që lejon KNSH-në të vlerësojë pajtueshmërinë e ndihmës Shtetërore. Kjo është në përputhje me rregulloren e KE 659/1999, sipas së cilës "njoftim i plotë" konsiderohet i gjithë informacioni i nevojshëm që do të mundësonte Komisionin të merrte një vendim. Sektori i Ndhmës Shtetërore mund të kërkojë informacion në rast se ai gjykon që informacioni i paraqitur nga dhënësi i ndihmës nëpërmjet njoftimit të planit për ndihmë është i paplotë.³⁶⁷

Neni 22 i LNSH-së detyron KNSH-në të marrë një vendim për miratimin, me ose pa kushte, ose për refuzimin e ndihmës së njoftuar. Ligji parashikon një afat prej 60 ditësh nga marrja e njoftimit të plotë brenda të cilit KNSH duhet të marrë një nga vendimet e sipërpërmendura. Duket se ligjvënësi shqiptar nuk ka ndjekur nenin 108 TFBE i cili krijon një procedurë me dy faza në lidhje me shqyrtimin e masave ndihmë Shtetërore. Faza e parë, ajo e shqyrtimit paraprak, ka të bëjë me njoftimin nga Shteti Anëtar të planit për dhënien e ndihmës Shtetërore dhe hetimin paraprak nga Komisioni. Kjo fazë mund të përfundojë me një vendim pozitiv të Komisionit, kur ndihma është e pajtueshme me tregun e brendshëm ose me një vendim negativ, kur ka dyshime serioze në lidhje me pajtueshmërinë e ndihmës Shtetërore me tregun e brendshëm, dhe rrjedhimisht fillimin e fazës së dytë. Vendimet e mësipërme, në lidhje me fazën e parë sipas Rregullores 659/1999 duhet të merren nga Komisioni Evropian brenda dy muajve.³⁶⁸ Faza e dytë, ajo e shqyrtimit formal, sipas së drejtës procedurale në lidhje me ndihmën Shtetërore në BE, është e ashtuquajtura procedura

³⁶⁶ Neni 20 ligj Nr .9374, datë 21.4.2005 "Për ndihmën Shtetërore", i ndryshuar.

³⁶⁷ Neni 7 i Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 817, datë 28.12.2005 "Për miratimin rregullore "Për procedurat dhe formën e njoftimit" Gazeta Zyrtare Nr. 102 fq. 103.

³⁶⁸ Neni 4/4 Council Regulation 1999/659/EC of 22 March 1999 laying down detailed rules for the application of Article 93 of the EC Treaty, OJ L 83/1, 27 March 1999, as amended. (Rregullore e Këshillit 1999/659/EC, 22 Mars 1999 për përcaktimin e rregullave të detajuara për zbatimin e nenit 93 të Traktatit të Komunitetit Evropian, ndryshuar).

kryesore. Kjo procedurë fillon nëse Komisioni ka dyshime serioze në lidhje me ligjshmërinë e ndihmës së propozuar ose mënyrën se si ajo do të përdoret.³⁶⁹ Rregullorja 659/1999 i jep Komisionit një periudhë prej 18 muajsh, për përfundimin e procedurës së shqyrtimit formal.³⁷⁰

Gjithashtu, LNSH përcakton procedurat e kontrollit *ex-post*, të cilat parashikohen më në detaje në rregulloren që përcakton procedurat dhe formën e njoftimit. Kur KNSH ose Sektori i Ndhmës Shtetërore kanë informacion për një ndihmë që mendohet e paligjshme atëherë i kërkohet dhënësit të ndihmës Shtetërore të paraqesë informacionin e nevojshëm për shqyrtim.³⁷¹ Sipas ligjit për ndihmën Shtetërore do të konsiderohet ndihmë e paligjshme çdo ndihmë Shtetërore e dhënë në kundërshtim me këtë ligj ose në kundërshtim me vendimet e marra nga Komisioni i Ndhmës Shtetërore.³⁷² Gjatë procedurës *ex post*, mund të kërkohet informacion shtesë. Në këtë rast do të ndiqen të njëjtat procedura me ato që ndiqen kur kërkohet informacion shtesë gjatë kontrollit *ex ante* të ndihmës Shtetërore. KNSH-ja mund të marrë një vendim me anë të të cilit i kërkon dhënësit të ndihmës pezullimin e zbatimit të çdo ndihme të paligjshme, derisa Komisioni të ketë marrë një vendim për lejueshmërinë e kësaj ndihme. Për më tepër, Komisioni mund të marrë një vendim, për të kërkuar nga dhënësi i ndihmës, që, në mënyrë të përkohshme, të kthejë çdo ndihmë të paligjshme, për sa kohë që komisioni nuk ka marrë një vendim për lejueshmërinë e ndihmës. Komisioni merr këtë vendim nëse nuk ka dyshim që masa në fjalë përbën

³⁶⁹ Procedurat e shqyrtimit të masave ndihmë Shtetërore janë analizuar në kapitullin III të kësaj teme.

³⁷⁰ Neni 7/7 Council Regulation 1999/659/EC of 22 March 1999 laying down detailed rules for the application of Article 93 of the EC Treaty, OJ L 83/1, 27 March 1999, as amended. (Rregullore e Këshillit 1999/659/EC, 22 Mars 1999 për përcaktimin e rregullave të detajuara për zbatimin e nenit 93 të Traktatit të Komunitetit Evropian, ndryshuar).

³⁷¹ Neni 25 ligj Nr .9374, datë 21.4.2005”Për ndihmën Shtetërore”, i ndryshuar.

³⁷² Neni 3/9 ligj Nr .9374, datë 21.4.2005”Për ndihmën Shtetërore”, i ndryshuar.

ndihmë shtetërore ose nëse ka urgjencë për të vepruar ose nëse ekziston një rrezik serioz për shkaktimin e një dëmi të konsiderueshëm dhe të pariparueshëm për një konkurrent. Kjo është e ngjashme me procedurat e ndjekura nga Komisioni Evropian, i cili mund të nxjerrë një "vendim për pezullim" ose "vendim për kthim" në rastin e ndihmës Shtetërore të paligjshme. KNSH duhet të urdhërojë kthimin e ndihmës Shtetërore të paligjshme nga përfituesi i saj, së bashku me interesat, ashtu siç parashikohet në ligj. Megjithatë, Komisioni i Ndhmës Shtetërore nuk mund të kërkojë kthimin e ndihmave Shtetërore të paligjshme në qoftë se kanë kaluar dhjetë vjet nga data kur është dhënë ndihma Shtetërore.³⁷³ Ligji për ndihmën Shtetërore gjithashtu parashikon shqyrtimin gjyqësor të vendimeve të KNSH.³⁷⁴ Sipas nenit 30 të ligjit për ndihmën Shtetërore kundër vendimeve të Komisionit mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë brenda 30 ditëve nga marrja dijeni për vendimin. Gjithsesi, ankimi nuk pezullon zbatimin e vendimit të Komisionit.

7.7. Vendime të Komisionit të Ndhmës Shtetërore

Edhe pse ligji për ndihmën Shtetërore në Shqipëri është në fuqi që prej vitit 2006, dhënësit e ndihmës Shtetërore hezitojnë të njoftojnë sektorin e ndihmës Shtetërore në lidhje me skema të ndihmës Shtetërore ose ndihmë Shtetërore individuale. Komisioni Evropian ka shprehur shqetësimin e tij në lidhje me kontrollin *ex-ante* të ndihmës Shtetërore në Shqipëri duke vënë në dukje se numri i njoftimeve të ndihmës Shtetërore nga organet e pushtetit

³⁷³ Neni 17/1 i Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 817, datë 28.12.2005 "Për miratimin rregullores "Për procedurat dhe formën e njoftimit" Gazeta Zyrtare Nr. 102 fq. 103.

³⁷⁴ Neni 30 ligj Nr .9374, datë 21.4.2005 "Për ndihmën Shtetërore", i ndryshuar.

qendror është i ulët dhe nuk ka njoftime nga organet e pushtetit lokal.³⁷⁵Nga ana tjetër, KNSH ka miratuar pothuajse të gjitha skemat e ndihmës të cilat i janë njoftuar. Komisioni i Ndhmës Shtetërore nuk ka dhënë vendime për skema ndihme të paligjshme duke urdhëruar në këtë mënyrë kthimin e saj.

Komisioni i Ndhmës Shtetërore ka marrë 19 njoftime në lidhje me plane për dhënien e ndihmës Shtetërore, të cilat janë të gjitha njoftime nga organet e pushtetit qendror.³⁷⁶ KNSH ka dhënë 25 vendime në lidhje me skemat e ndihmës Shtetërore dhe ndihmën Shtetërore individuale si dhe 18 vendime në lidhje me skemat ekzistuese të ndihmës Shtetërore.³⁷⁷

Në mënyrë që të jetë efektiv autoriteti monitorues i ndihmës Shtetërore duhet të ketë kompetencën të ekzekutojë vendimet e tij, përfshirë edhe raste politikisht të ndjeshme (Botta, 2013:84). KNSH-ja nuk ka mundur të zbatojë rregullat në lidhje me ndihmën Shtetërore në raste politikisht të ndjeshme si ato të krijuara nga sektori i energjisë elektrike në Shqipëri. Në Shqipëri, prodhimi i energjisë dhe furnizimi ka qenë një problem që prej viteve '90.³⁷⁸Ky sektor ka probleme të vazhdueshme të tilla si humbje në rrjet të energjisë elektrike dhe atë të shpërndarjes si dhe shkallë të ulët të mbledhjes së faturave. Shoqëria shtetërore e prodhimit të energjisë KESH sh.a. për të mbuluar humbjet si dhe për të importuar energji ka marrë kredi nga banka të ndryshme të cilat janë garantuar nga Qeveria

³⁷⁵ Progres raporti për Shqipërinë, Tetor 2014, fq. 27. I disponueshëm në http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/key_documents/2014/20141008-albania-progress-report_en.pdf. Aksesuar 2 Shkurt 2015.

³⁷⁶ Numri total i njoftimeve në lidhje me skemat e reja të ndihmës Shtetërore është nxjerrë nga Fletoret Zyrtare. Ai përfshin vendime të miratuara deri në Maj të vitit 2015.

³⁷⁷ Bazuar në të dhënat e marra gjatë një takimi me Sektorin e Ndhmës Shtetërore në datë 21 Maj 2015.

³⁷⁸ Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 1023, datë 9.7.2008 "Për miratimin e raportit vjetor "Për ndihmat Shtetërore të vitit 2008".

Shqiptare. Komisioni i Ndhmës Shtetërore Shqiptare është njoftuar në lidhje me garanci të tilla dhe ka dhënë vendimet si më poshtë.

Nga fundi i vitit 2011 nga Qeveria Shqiptare u lëshua një letërgaranci në favor të ndërmarrjes KESH sh.a., me qëllim lehtësimin e likuiditeteve të nevojshme për të bërë pagesën e faturave të importit të energjisë, masë e cila iu njoftua KNSH-së. Komisioni i ndihmës Shtetërore vendosi që masa e sipërpërmendur nuk përbënte ndihmë Shtetërore, sipas përcaktimit të nenit 4 të ligjit nr. 9274, datë 21.4.2005 “Për ndihmën shtetërore”, të ndryshuar.³⁷⁹ Sipas KNSH-së garancia e qeverisë në favor të KESH-it, nuk përbënte ndihmë Shtetërore pasi ajo nuk kishte efekte në shtrembërimin e konkurrencës. Ky vendim nuk është në përputhje me praktikën e Komisionit Evropian në rastet e shqyrtimit të garancive të veçanta shtetërore. Në përgjithësi, në mënyrë që të përcaktohet nëse është duke u dhënë një avantazh ekonomik me anë të një garancie Komisioni Evropian e bazon vlerësimin e tij mbi parimin e një investitori që vepron në një ekonominë e tregu ("parimi i investitorit privat")³⁸⁰ (Hancher & Salerno, 2011:250).

Gjatë vitit 2013, Qeveria Shqiptare lëshoi dy garanci të tjera në favor të shoqërisë shtetërore të prodhimit të energjisë KESH sh.a. Një tjetër vendim për miratimin e këtyre garancive u dha nga KNSH-ja.³⁸¹ Këtë herë Komisioni i Ndhmës Shtetërore argumentoi, se garancia shtetërore, në fjalë, nuk i jepte një avantazh ekonomik KESH-it dhe sipas

³⁷⁹ Vendim nr. 42, datë 11.9.2012 “Për shqyrtimin e aktit normativ nr. 4, datë 14.12.2011 “Për një ndryshim me ligjin nr. 10 355, datë 2.12.2011 “Për buxhetin e vitit 2011”, të ndryshuar”

³⁸⁰ Ky parim është trajtuar në kapitullin e dytë.

³⁸¹ Vendim nr. 46, datë 28.3.2014 “Për shqyrtimin e VKM-së nr. 1101, datë 28.12.2013 “Për miratimin e garancisë qeveritare, të lëshuar në favor të Raiffeisen Bank Albania sh.a., në kuadër të kushteve të kontratës së kredisë, ndërmjet kësaj banke dhe KESH sh.a.”, si edhe VKM-së nr. 1102, datë 28.12.2013 “Për miratimin e garancisë qeveritare, të lëshuar në favor të Intesa Sanpaolo Bank Albania sh.a., në kuadër të kontratës së huasë, ndërmjet kësaj banke dhe KESH sh.a.”.

Njoftimit të Komisionit mbi zbatimin e neneve 87 dhe 88 të Traktatit të KE-së për ndihmën Shtetërore në formën e garancisë të vitit 2008, masa në fjalë nuk përbënte ndihmë Shtetërore. Vendimi, nuk përmban një analizë të saktë. Komisioni i Ndhmës Shtetërore me qëllim përjashtimin e ekzistencës së ndihmës Shtetërore tek garacitë qeveritare të sipërpërmendura përpiqet të argumentojë plotësimin e katër kushteve sipas Njoftimit të Komisionit mbi zbatimin e neneve 87 dhe 88 të Traktatit të KE-së për ndihmën Shtetërore në formën e garancisë të vitit 2008.³⁸²

Sipas Komisionit të Ndhmës Shtetërore, KESH sh.a. nuk është në vështirësi financiare, garancia e lëshuar lidhet me një transaksion të përcaktuar financiar, dhe primi dhe normat e interesit, të ofruara nga bankat, reflektojnë normën e tregut, pasi KESH sh.a. i ka kërkuar ato në treg të hapur. Në arsyetimin sipas të cilit garancia nuk mbulon më shumë se 80% të huasë, KNSH argumenton që KESH-it sipas legjislacionit që zbatohet në sektorin e energjisë, i është besuar ofrimi i shërbimeve me interes të përgjithshëm ekonomik.³⁸³ Kështu sipas KNSH-së letërgarancia e lëshuar nga Qeveria është një kompensim për një shërbim të interesit të përgjithshëm ekonomik.

Kompensimi i shërbimit të interesit të përgjithshëm ekonomik nuk përbën Ndhmë Shtetërore, nëse plotësohen katër kushte kumulative të përcaktuara nga Gjykata Evropiane e Drejtësisë në çështjen *Altmark*.³⁸⁴ Vendimi i KNSH-së nuk përmban një

³⁸² Katër kushtet kumulative janë: (a) huamarrësi nuk është në vështirësi financiare; (b) matja e mundshme e shtrirjes së garancisë në kohën e dhënies (c) garancia nuk mbulon më shumë se 80% të huasë (d) për garancinë paguhet një çmim tregu.

³⁸³ Vendimi i referohet ligjit nr. 9072 datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”.

³⁸⁴ Shiko çështjen C-280/00, *Altmark* [2003] ECR I-7747. Katër kushtet kumulative janë: 1) përfituesit i është përcaktuar qartë detyrimi i ofrimit të shërbimit publik; 2) parametrat për llogaritjen e ndihmës përcaktohen paraprakisht në mënyrë transparente dhe objektive; 3) ndihma nuk tejkalon kostot e nevojshme për të siguruar ofrimin e shërbimit publik; 4) ndihma e nevojshme për kompensimin e ofrimit të shërbimit publik përcaktohet mbi bazën e kostos që do të kishte një ndërmarrje eficiente që ushtron veprimtarinë e saj në një sektor të tillë.

analizë të këtyre katër kushteve kumulative . Si pasojë, KNSH ka miratuar subvencione për KESH-it duke arsyetuar se ato nuk përbëjnë ndihmë Shtetërore pa u mbështetur në një analizë të saktë.

7.8. Më pak ndihmë Shtetërore në Shqipëri?

Kur u miratuan rregullat në lidhje me ndihmën Shtetërore në Shqipëri, shuma e ndihmës Shtetërore të dhënë në vend në krahasim me Prodhimin e Brendshëm Bruto (PBB) ishte, tashmë, e krahasueshme me mesataren e BE-së. Kështu, sipas Raportit Vjetor të Komisionit Shqiptar të Ndihmës Shtetërore të vitit 2007, totali i ndihmës Shtetërore në vitin 2005 përfaqësonte 0.35 % të PBB-së dhe në vitin 2006 ai përfaqësonte 0.37 % të PBB-së, total i cili ishte më i ulët se mesatarja e BE-së për të dy vitet.³⁸⁵ Sipas Raporteve të Progresit të Komisionit Evropian ndihma Shtetërore në Shqipëri është e kufizuar dhe e krahasueshme me mesataren në Bashkimin Evropian.³⁸⁶ Gjithsesi, gjatë vlerësimit të të dhënave statistikore duhet të marrim në konsideratë faktin se në Shqipëri numri i njoftimeve për dhënien e ndihmës Shtetërore nga organet e pushtetit qendror është i ulët dhe nuk ka njoftime nga organet e pushtet lokal.³⁸⁷ Kjo tregon se jo të gjitha skemat e

³⁸⁵Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 1023, datë 9.7.2008 “Për miratimin e raportit vjetor "Për ndihmat Shtetërore të vitit 2008".

³⁸⁶Commission Staff Working Document – Albania 2009 Progress Report, accompanying the document from the Commission to the European Parliament and the Council enlargement strategy and main challenges 2009-2010 Dokument Pune i Stafit të Komisioni – Progres Raporti për Shqipërinë viti 2009, i cili shoqëron dokumentin nga Komisioni për Parlamentin dhe Këshillin, strategjia e zgjerimit dhe sfidat kryesore 2009-2010 COM (2009) 533, fq. 30. I disponueshëm në: http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/key_documents/2009/al_rapport_2009_en.pdf. Aksesuar 14 Shkurt 2015.

³⁸⁷ Progres raporti për Shqipërinë, Tetor 2014, fq. 27. I disponueshëm në http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/key_documents/2014/20141008-albania-progress-report_en.pdf. Aksesuar 2 Shkurt 2015.

ndihmës Shtetërore i njoftohen Komisionit të Ndhmës Shtetërore siç parashikohet nga ligji për ndihmën shtetërore.

Në lidhje me nivelet e ndihmës Shtetërore në Shqipëri edhe pas miratimit të ligjit për ndihmën Shtetërore shuma e përgjithshme e ndihmave Shtetërore në krahasim me PBB nuk ka rënë në mënyrë sistematike. Mbi të gjitha ajo është rritur, kështu në vitin 2007 shuma e përgjithshme e ndihmës Shtetërore në Shqipëri u dyfishua në krahasim me vitin 2005 dhe 2006.³⁸⁸ Përveç kësaj shuma e përgjithshme e ndihmës shtetërore në Shqipëri është rritur nga viti 2009 deri në 2012, nga një shumë totale ndihmë Shtetërore prej 0,61 % të PBB-së në vitin 2009³⁸⁹ në një shumë totale të ndihmës Shtetërore prej 1.5 % të PBB-së në vitin 2012.³⁹⁰

Ndihma për sektorë të veçantë (ndihma vertikale) është ndihma që zbatohet në aktivitete ekonomike në një sektor të caktuar të ekonomisë ose industrisë (Jones & Sufrin, 2014:118). Ndërsa, ndihmë horizontale janë llojet e ndihmës të dhëna nga Shtetet Anëtare për çdo sektor ekonomik për arritjen e objektivave specifike të interesit publik. Ndihamat horizontale jepen për të mbështetur mbrojtjen e mjedisit, trajnimin e punonjësve, projekte kërkimore etj.³⁹¹ Në lidhje me llojet e ndihmave të dhëna në Shqipëri dhe përqindjen e ndihmave sektorale në krahasim me ndihmat horizontale sipas raportit të progresit të Komisionit Evropian të vitit 2010, tre të pestat e ndihmës shtetërore është dhënë në mbështetje të sektorëve të veçantë kryesisht ofrojnë shërbime publike, duke përfshirë

³⁸⁸ Vendimi i referohet ligjit nr. 9072 datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”.

³⁸⁹ Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 635, datë 23.7.2010 “Për miratimin e raportit vjetor “Për ndihmat Shtetërore të vitit 2009”.

³⁹⁰ Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 640, datë 24.7.2013 “Për miratimin e raportit vjetor “Për ndihmat Shtetërore të vitit 2012”.

³⁹¹ Po aty.

furnizimin me ujë dhe hekurudhat.³⁹² Veçanërisht, i është dhënë ndihmë Shtetërore, sektorit të energjisë. Megjithatë ka pasur një rritje të ndihmave Shtetërore për kërkimin dhe zhvillimin, trajnimin, ndihmën Shtetërore për punësim,³⁹³ si dhe ndihmë Shtetërore për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme.

³⁹² Commission Staff Working Document – Albania 2009 Progress Report, accompanying the document from the Commission to the European Parliament and the Council enlargement strategy and main challenges 2009-2010 Dokument Pune i Stafit të Komisioni – Progres Raporti për Shqipërinë viti 2009, i cili shoqëron dokumentin nga Komisioni për Parlamentin dhe Këshillin, strategjia e zgjerimit dhe sfidat kryesore 2009-2010 COM (2009) 533, fq. 48. I disponueshëm në: http://ec.europa.eu/enlargement/pdf/key_documents/2009/al_rapport_2009_en.pdf. Aksesuar Nëntor 2015.

³⁹³ Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 635, datë 11.6.2014 “Për miratimin e raportit vjetor “Për ndihmat Shtetërore të vitit 2013”.

KAPITULLI VIII

KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME

8.1. Konkluzione

Kërkimi analizoi kontrollin e ndihmës Shtetërore në Bashkimin Evropian. Tema identifikoi problemet që vërehen gjatë zbatimit të rregullave për ndihmën Shtetërore nga të gjithë aktorët, si ato të përfshirë në kontrollin mbikombëtar të ndihmës Shtetërore ashtu dhe ata kombëtare. Ky projekt nuk u kufizua vetëm në vlerësimin e kuadrit ligjor të kontrollit të ndihmës Shtetërore në Bashkimin Evropian. Tema analizoi, gjithashtu, reformat e ndërmarra në kuadër të kontrollit të ndihmës Shtetërore, duke evidentuar probleme dhe duke bërë propozime për reforma të reja. Kërkimi jep rekomandime në lidhje me reforma të ardhshme të kontrollit të ndihmës Shtetërore të cilat do të adresojnë të metat e identifikuara në sistemin e kontrollit të ndihmës Shtetërore.

Kjo temë përfshin rendin ligjor mbikombëtar i cili përbëhet nga legjislacioni parësor dhe dytësor i Bashkimit Evropian, prej të cilit rrjedhin kompetencat e Komisionit për të marrë vendime dhe për të zbatuar politikat e BE-së në lidhje me ndihmat Shtetërore. Gjithashtu, në rendin ligjor mbikombëtar përfshihet dhe juridiksioni i Gjykatës së Drejtësisë për të rishikuar vendimet e Komisionit. Ndërsa përsa i përket rendit ligjor kombëtar tema analizoi në mënyrë kritike kompetencat e gjykatave kombëtare të përfshira në kontrollin e ndihmës Shtetërore. Gjithashtu, kërkimi përfshin dhe rendin ligjor shqiptar. Në kuadër të procesit të Stabilizim-Asociimit, Shqipëria ka nënshkruar Marrëveshjen e

Stabilizim Asociimit me Bashkimin Evropian. MSA-ja kërkon që Shqipëria të garantojë që rregullat për konkurrencën dhe ndihmën Shtetërore të jenë në përputhje me *acquis communautaire*. Veçanërisht, vëmendje iu kushtua Komisionit të Ndihmës Shtetërore, organ i cili ka kompetencën të zbatojë dispozitat ligjore për ndihmën e Shtetërore në Shqipëri.

Kapitulli i parë i temës prezantoi legjislacionin parësor dhe dytësor të Bashkimit Evropian në lidhje me ndihmën Shtetërore i cili përbën bazën ligjore të kërimit. Për më tepër, kapitulli prezantoi institucionet kryesore të Bashkimit Evropian dhe kompetencat e tyre në lidhje me ndihmën Shtetërore në BE. Gjithashtu, pyejtjet kërimore dhe hipoteza e kërimit, u prezantuan në këtë kapitull.

Në kapitullin e dytë të temës u analizua e drejta materiale në lidhje me ndihmën Shtetërore, e cila është pjesë e së drejtës së konkurrencës në Bashkimin Evropian. Rregulli bazë i parashikuar nga Traktati për Funksionimin Bashkimit Evropian është që ndihma Shtetërore e cila shtrembëron konkurrencën dhe ndikon në tregtinë ndërmjet Shteteve Anëtare është e papajtueshme me tregun e brendshëm. Neni 107(1) TFBE parashikon elementët e ndihmës Shtetërore të cilat aplikohen për të vlerësuar pajtueshmërinë e një mase ndihmë me tregun e brendshëm. Sipas Gjykatës së Drejtësisë këto janë kushte kumulative të cilat duhet të përmbushen në mënyrë që ndihma Shtetërore të konsiderohet e papajtueshme me tregun e brendshëm. Nocioni i ndihmës Shtetërore në Bashkimin Evropian është interpretuar në mënyrë të zgjeruar dhe ekzistenca e një shume të vogël ndihme, nuk përjashton *ex ante* mundësinë e ndikimit të tregtisë ndërmjet Shteteve Anëtare, ose mundësinë e shtrembërimit të konkurrencës.

Për më tepër nenet 107(2) dhe (3) TFBE parashikojnë përjashtime nga neni 107(1) TFBE dhe i japin Komisionit një diskrecion të gjerë në aprovimin e ndihmave Shtetërore. Komisioni ka nxjerrë një numër të madh Njoftimesh, Udhëzimesh, Komunikatash, Rekomandimesh ku shpjegon se si duhet dizenuar një masë ndihme në mënyrë që të konsiderohet e pajtueshme me tregun e brendshëm. Ky grup rregullash ka ndihmuar Shtetet Anëtare të Bashkimit Evropian duke udhëzuar institucionet publike të tyre si dhe Komisionin të përballojë presionin politik. Por nga ana tjetër niveli i detajimit në udhëzime dhe nevoja për të qenë konsistent me praktikën më të hershme ka rezultuar në një sistem kompleks rregullash që nuk është gjithmonë koherent, veçanërisht si pasojë e ndryshimit të politikave në kohë.

Legjislacioni parësor dhe dytësor i Bashkimit Evropian përbën bazën ligjore të kontrollit të ndihmave Shtetërore në nivel mbikombëtar. Kjo kornizë ligjore është zhvilluar në vite, dhe ka kodifikuar praktikën gjyqësore të Gjykatave Evropiane me qëllim rritjen e sigurisë dhe transparencës të së Drejtës Evropiane për ndihmat Shtetërore. Kontrolli i ndihmës Shtetërore realizohet në rendin ligjor mbikombëtar dhe atë kombëtar. Secili prej rendeve ligjore përfshin aktorë të ndryshëm. Tema analizoi procedurat specifike të përdorura nga secili prej këtyre aktorëve dhe kompetencat përkatëse.

Aktori kryesor në kontrollin ndihmës Shtetërore në aspektin mbikombëtar është Komisioni. Neni 107 TFBE i jep të drejtën vetëm Komisionit për të kontrolluar ndihmat Shtetërore me një përjashtim sipas të cilit Këshilli duke vepruar në mënyrë unanime mund të deklarojë që ndihma Shtetërore është e pajtueshme me tregun e brendshëm “nëse një vendim i tillë justifikohet nga rrethana të jashtëzakonshme”. Kohëzgjatja e procedurave administrative në çështjet në lidhje me ndihmat Shtetërore përpara Komisionit u analizuan

në mënyrë kritike në kapitullin e tretë të temës. Ekzistenca e një procedure administrative përpara Komisionit që përbëhet nga dy faza: ajo e shqyrtimit paraprak dhe ajo e shqyrtimit formal bën që kjo procedure të mos jetë e shpejtë. Për më tepër, Kodi i Praktikave të Mira krijon një fazë tjetër shtesë atë njoftimit paraprak. Veç kësaj, mungesa e afateve procedurale të detyrueshme brenda të cilave duhet të përfundojë shqyrtimi nga Komisioni ka bërë që procedurat në lidhje me ndihmën Shtetërore të zgjasin shumë.

Rregullorja e re Procedurale³⁹⁴ nuk synon të ndryshojë karakterin bilateral të procedurës për ndihmën Shtetërore. Kjo Rregullore shton kompetencat hetimore të Komisionit. Rrjedhimisht, Komisionit pas fillimit të procedurës së shqyrtimit formal, i lejohet të kërkojë informacion jo vetëm nga Shteti Anëtar që ka bërë njoftimin por dhe nga Shtete të tjera Anëtare, dhe shoqata ndërmarrjesh. Komisioni, në bazë të Rregullores së re Procedurale, ka të drejtën të vendosë gjoka ose penalitete me pagesa periodike në rast mosdhënie informacioni ose informacion të pasaktë nga palët e treta. Në këtë mënyrë ajo krijon më shumë detyrime për palët e treta duke mos garantuar të drejtat e tyre procedurale. Veç kësaj, Rregullorja Procedurale³⁹⁵ nuk parashikon shtimin e të drejtave procedurale të palëve të interesuara. Të drejtat e tyre gjatë fazës së shqyrtimit formal janë pothuajse inekzistente. Ky rol i kufizuar i palëve të interesuara vetëm gjatë fazës së shqyrtimit formal e privon Komisionin nga një burim informacioni mjaft i rëndësishëm. Procedurat duhet të jenë më transparente veçanërisht në lidhje me të drejtat e palëve të interesuara dhe shqyrtimin e ankimeve nga Komisioni. Mungesa e një statusi procedural të palëve të

³⁹⁴ Council Regulation 2013/734/EC of 22 July 2013 OJ L204/15, 31 July 2013, amending Council Regulation 1999/659/EC of 22 March 1999 laying down detailed rules for the application of Article 93 of the EC Treaty, OJ L 83/1, 27 March 1999.

³⁹⁵ Po aty.

interesuara gjatë fazës së shqyrtimit paraprak bën që procedura administrative përpara Komisionit të mos jetë transparente.

Më tej, tema analizon Gjykatat Evropiane, juridiksionin dhe jurisprudencën e tyre në lidhje me ndihmën Shtetërore. Në këtë mënyrë përfundon analiza e kontrollit mbikombëtar të ndihmës Shtetërore. Roli i Gjykatave të Bashkimit Evropian është i rëndësishëm në zbatimin e rregullave të kontrollit të ndihmës Shtetërore. Gjykata e Drejtësisë që në vitet e para të Komunitetit (Bashkimit) ka dhënë kontributin e saj në përkufizimin e nocionit të ndihmës Shtetërore. Për më tepër, Gjykata e Drejtësisë ka luajtur një rol të rëndësishëm duke i njohur kompetenca të zgjeruara Komisionit në fushën e kontrollit të ndihmës Shtetërore. Gjykata e Drejtësisë që në vendimet e saj të hershme ka pranuar kompetencën e Komisionit për të urdhëruar kthim të ndihmës së paligjshme nga Shtetet Anëtare. Veç kësaj, vendimet e Gjykatës kanë zgjeruar kompetencën e Komisionit për të hetuar ndihmën Shtetërore, për të pezulluar ndihmën dhe për të detyruar qeveritë e Shteteve Anëtare të japin informacion. Si rrjedhim, ndikimi i Gjykatave të Bashkimit në zbatimin e rregullave të ndihmës Shtetërore është pozitiv.

Gjithsesi, një problem në lidhje me rishikimin gjyqësor në çështjet për ndihmën Shtetërore është ekzistenca e një informacioni të kufizuar. Kufizimet në informacionin e disponueshëm në çështjet gjyqësore të sipërpërmendura favorizohen nga ekzistenca e një procedure bilaterale ndërmjet Komisionit dhe Shtetit Anëtar. Siç u analizua dhe më sipër palët e treta nuk gëzojnë të drejta procedurale gjatë fazës së shqyrtimit paraprak nga Komisioni. Kështu fillimisht Shtetet Anëtare janë burimi më i rëndësishëm i informacionit për Komisionin. Gjithsesi, ky problem mund të adresohet nëpërmjet një reforme të Rregullores Procedurale.

